



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**MIRATOHET**

KRYETARI I KËSHILLIT

**Z. EDI RAMA**

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**Z. DAMIAN GJIKNURI**

Kryetari i Këshillit Bashkiak

**Z. Imer Hoxha**

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. 95 Datë 27.11.2017

Kryetari i Bashkisë

**Z. Besnik Dushaj**

**PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË TROPOJË**

**PLANI I ZHVILLIMIT**

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.2, Datë 09.12.2017

DPKZHT: HASAN ÇUKA

STUDIO KONSULENTE "STUDIO B&L": ERMAL BLETA, Nr.Liç. A.0925/4

STUDIO B & L  
Sh.p.k  
Tiranë Albania



Plani i Zhvillimit Territorial është përgatitur në kuadrin e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tropojë.

Përgatitur nga:

Studio B&L me Pier Vittorio Aureli dhe Martino Tattara

Doriana Bozgo Bleta, Ermal Bleta, Roland Lika - *Endri Këqaj, Juela Guri, Saimir Duçellari*

Martino Tattara, Pier Vittorio Aureli - *Antonio Paolillo, Ezio Melchiorre, Ian Lowrie, Luciano Aletta, Matteo Novarino, Tommaso Mola Meregalli*

*Andrian Vaso, Bukurosh Onuzi, Devis Agaraj, Genti Neschwatal, Ilia Kristo*

Kontakt: [studio@arkitekt-bl.com](mailto:studio@arkitekt-bl.com)  
[info@dogma.name](mailto:info@dogma.name)

Me mbështetjen e:



**HELVETAS**  
Swiss Intercooperation



KOMUNA TROPOJË

**FAZA 3 | PLANI I ZHVILLIMIT TERRITORIAL  
BASHKIA TROPOJË**



1000



## PASQYRA E LËNDËS

1		HYRJE	13
1.1		Dispozita ligjore	15
1.2		Dispozita ligjore sektoriale	20
1.3		Konsiderata mbi planet e niveleve të tjera dhe efekteve të tyre mbi territorin vendor	21
2		PËRMBLEDHJE E STRATEGJISË TERRITORIALE	25
2.1		Vizioni	27
2.2		Objektivat Strategjike	27
3		PLANI I ZHVILLIMIT	31
3.1		Ndarja e territorit në pesë sisteme territoriale	33
3.2		Ndarja e territorit në njësi strukturore	34
3.3		Zonimi sipas kategorive bazë dhe nënkategorive të përdorimit të propozuar të tokës	39
4		ZONA DHE OBJEKTE TË RËNDËSISË KOMBËTARE DHE TERRITORET FQINJE	45
4.1		Burime mjedisore në territorin e bashkisë së Tropojës	47
4.2		Trashëgimia kulturore në territorin e bashkisë së Tropojës	47
4.3		Elemente të tjera të rëndësisë kombëtare	48
4.4		Përmirësimi i ndërveprimit	48
5		PLANI I MBROJTJES SË MJEDISIT	51
5.1		Mbrojtja e peizazhit	57
5.1.1		Vlerësimi i ndikimeve në mjedis në nivel objektivash strategjike	57



5.1.2	Udhëzimet dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 12	58
5.2	Mbrojtja e burimeve ujore, habitateve ujore dhe cilësisë së tokës	61
5.2.1	Vlerësimi i ndikimeve në mjedis në nivel objektivash strategjike	61
5.2.2	Udhëzimet dhe masat zbutëse për të arritur Objektivat Mjedisore 1, 2 dhe 5	65
5.3	Mbrojtja e natyrës (biodiversiteti dhe zgjerimi i hapësirave të gjelbra urbane)	69
5.3.1	Vlerësimi i ndikimeve në mjedis në nivel objektivash strategjike	69
5.3.2	Ripyllëzimi	72
5.3.3	Brezi i Gjelbër Evropian	73
5.3.4	Udhëzimet dhe masat zbutëse për mbrojtjen e natyrës (biodiversiteti dhe zgjerimi i hapësirave të gjelbra urbane)	73
5.4	Përmirësimi i Cilësisë së Ajrit	76
5.4.1	Vlerësimi i ndikimeve në mjedis në nivel objektivash strategjike	76
5.4.2	Udhëzimet dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 3	77
5.5	Hotspot-e	79
6	<b>RUAJTJA E ASETETEVE KULTURORE</b>	81
6.1	Parashikime për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore	83
6.2	Ruajtja dhe përmirësimi i monumenteve kulturore	84
7	<b>ZHVILLIMI EKONOMIK</b>	87
7.1	Zhvillimi ekonomik dhe urban	89
8	<b>PËRMIRËSIMI I MJEDISIT BUJQËSOR</b>	99
8.1	Parashikime për mbrojtjen e tokës bujqësore	101
8.1.1	Rehabilitimi i tokave të braktisura me agro-pylltari dhe permakulturë	101
8.1.2	Ripërdorimi i tarracave	103
8.2	Infrastruktura bujqësore	103
8.3	Pajimi bujqësor	103
8.4	Projekt me Partneritet Publik-Privat (PPP) për bujqësinë	107
9	<b>PLANI PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT</b>	117



9.1	Zhvillimi turistik në rajon	119
9.2	Menaxhimi i shtigjeve	123
9.3	Shërbime dhe struktura ndihmëse turistike	129
9.4	Strehimi turistik	131
9.5	Projekte me Partneritet Publik-Privat (PPP) për turizmin	133
<b>10</b>	<b>  PLANI I MASAVE NË RRJETIN RRUGOR DHE TRANSPORTIN</b>	<b>137</b>
10.1	Rrjeti rrugor	139
10.1.1	Hyrja për në territorin e bashkisë Tropojë	139
10.1.2	Përcaktimi i Politikave të Zhvillimit të Rrjetit Rrugor mbi bazën e Planeve Kombëtare	140
10.1.3	Zhvillimi i rrjetit rrugor në Bashkinë e Tropojës	143
10.1.4	Parkimi	149
10.2	Propozimet për transportin publik	155
10.2.1	Transporti publik rrugor	155
10.2.2	Transporti publik ujor	159
10.2.3	Terminali i pasagjerëve	160
10.3	Platformë për shërbim	161
10.4	Rrjeti i lëvizshmërisë së butë	161
<b>11</b>	<b>  ZHVILLIMI URBAN</b>	<b>165</b>
11.1	Zhvillimi ekonomik dhe urban	167
11.2	Parashikimi dhe shpërndarja demografike e popullsisë	175
11.2.1	Projeksioni i popullsisë	175
11.2.2	Kapaciteti mbajtës	177
11.3	Tipologjitë e propozuara hapësinore dhe metodat e ndërhyrjes në territor	179
11.3.1	Vendbanimet bujqësore e blegtorale	181
11.3.2	Vendbanimet pranë pikave të prodhimit	181
11.3.3	Vendbanimet me qendra administrative	181
11.4	Tipologjitë hapësinore	183
11.4.1	Vendbanimet bujqësore e blegtorale	185
11.4.2	Vendbanimet pranë pikave të prodhimit	201
11.4.3	Vendbanimet me qendra administrative	209



12		PLANI I MASAVE PËR SHËRBIME SOCIALE DHE HAPËSIRA PUBLIKE	249
12.1		Strukturat publike	271
12.2		Qendrat komunitare	271
12.3		Hapësirat publike	273
12.4		Shkollat	278
12.5		Kujdesi ndaj shëndetit	291
12.6		Varrezat	293
12.7		Plani i strehimit social	295
12.8		Mbrojtje kombëtare, civile dhe kundër zjarrit	297
13		PLANI I MASAVE PËR INFRASTRUKTURËN BAZË URBANE	303
13.1		Rjeti i propozuar i furnizimit me ujë të pijshëm	305
13.2		Sistemi i propozuar i kanalizimeve të ujërave të zeza	307
13.3		Rjeti i furnizimit me energji elektrike dhe i komunikimit elektronik	309
13.4		Menaxhimi i mbetjeve	309
14		ZBATIMI I PPV	315
14.1		Përkufizimet për termat e referencës për planet, duke detajuar më tej planet sektoriale	317
14.2		Përkufizimi i njësive, të cilat do jenë subjekt hartimi PDV/PDZRK	317
14.3		Partneriteti Publik-Privat (PPP)	321
14.4		Projektet pilot	322
15		MONITORIMI I PLANIT TË ZHVILLIMIT	325
15.1		Fazat e zhvillimit	327



15.2	Ndryshimet e nevojshme në kuadrin ligjor dhe administrativ lokal	327
15.3	Treguesit e monitorimit të zbatimit të PPV	328
15.4	Faktorët që mund të shkaktjnë rishikimin pjesor të PPV	373
16	<b>PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE</b>	377
16.1	Plani i Investimeve Kapitale	379
16.2	Buxheti i bashkisë	379
16.2.1	Fillimi i procesit bazuar në politikat strategjike	379
16.2.2	Të ardhurat nga burimet e veta vendore	380
16.2.3	Kapacitetet fiskale të taksapaguesve	382
16.2.4	Taksapaguesit familjarë	382
16.2.5	Taksapaguesit biznese dhe institucione	383
16.2.6	Të ardhurat nga taksat vendore	383
16.2.7	Të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël	384
16.2.8	Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	384
16.2.9	Të ardhurat nga tarifat vendore	390
16.2.10	Të ardhura të tjera jo tatimore	398
16.2.11	Gjobat dhe të ardhurat e tjera jo tatimore	399
16.2.12	Të ardhurat nga burimet qendrore	401
16.2.13	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve (FZHR)	403
17	<b>RAPORTI I KAPACITETIT INSTITUCIONAL</b>	491
17.1	Nevoja për ndërtimin e kapacitetit institucional	493
17.2	Marrëveshjet e zbatimit, procedurat dhe stafi i strukturës së nevojshme për zbatimin	506
17.3	Vlerësimi i nevojave për personel dhe hapësira	513
18	<b>KONSULTIME ME PALËT E INTERESUARA</b>	517
18.1	Dëgjuesë publike për planin e zhvillimit territorial, rregullorja lokale dhe vlerësimi strategjik mjedisor	519
18.2	Forumi për Bashkërendimin e Planifikimit në nivel vendor (FBPV)	521
18.3	Këshillim publik në Bjaram Curri	523



## LISTA E HARTAVE

- 1 | HARTA E PESË SISTEMEVE TERRITORIALE
- 2 | HARTA E PËRDORIMIT TË TOKËS - KATEGORITË
- 3 | HARTA E NJËSIVE STRUKTUTORE
- 4 | HARTA E PËRDORIMIT TË TOKËS - NËNKATEGORITË
- 5 | HARTA E RRJETIT RRUGOR TË PROPOZUAR SIPAS KATEGORIVE TË KODIT RRUGOR
- 6 | HARTA E TRANSPORTIT PUBLIK
- 7 | HARTA E VIJËS SË KUQE
- 8 | HARTA E ZONAVE TË RËNDËSISË KOMBËTARE DHE NDËRLIDHJET E TYRE
- 9 | HARTA E PLANIT TË MBROJTJES SË PEIZAZHIT
- 10 | HARTA E PLANIT TË MBROJTJES SË BURIMEVE UJORE
- 11 | HARTA E PLANIT TË MBROJTJES SË PASURISË KULTURORE
- 12 | HARTA E PLANIT TË MBROJTJES SË PASURISË NATYRORE
- 13 | HARTA E PROPOZIMEVE PËR INFRASTRUKTURËN BUJQËSORE
- 14 | HARTA E INFRASTRUKTURËS SË TURIZMIT
- 15 | HARTA E INSTRUMENTEVE TË ZHVILLIMIT
- 16 | HARTA E MËNYRAVE TË NDËRHJRJES
- 17 | HARTA E INTENSITETIT TË ZHVILLIMIT
- 18 | HARTA E KAPACITETIT MBAJTËS TË POPULLSISË
- 19 | HARTA E KAPACITETIT MBAJTË TË POPULLSISË



- 20 | HARTA E PLANIT TË STREHIMIT DHE PROGRAMEVE TË STREHIMIT SOCIAL
- 21 | HARTA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE (ÇERDHET)
- 22 | HARTA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE (KOPSHTET)
- 23 | HARTA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE (CIKLI I ULËT)
- 24 | HARTA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE (TË MESMET)
- 25 | HARTA E STRUKTURAVE SHËNDETËSORE
- 26 | HARTA E MENAXHIMIT TË MBETJEVE
- 27 | HARTA E PROPOZIMEVE TË INFRASTRUKTURËS SË FURNIZIMIT ME UJË
- 28 | HARTA E PROPOZIMEVE TË INFRASTRUKTURËS SË UJËRAVE TË ZEZA
- 29 | HARTA E INFRASTRUKTURËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE
- 30 | HARTA E PROJEKTEVE PILOT
- 31 | HARTA E FAZAVE TË ZHVILLIMIT - FAZA 1
- 32 | HARTA E FAZAVE TË ZHVILLIMIT - FAZA 2
- 33 | HARTA E FAZAVE TË ZHVILLIMIT - FAZA 3
- 34 | HARTA E FAZAVE TË ZHVILLIMIT - FAZA 4
- 35 | HARTA E FAZAVE TË ZHVILLIMIT
- 36 | HARTA E NJËSIVE ME PDV
- 37 | HARTA E ZONAVE ME PRIORITET ZHVILLIMI EKONOMIK DHE URBAN
- 38 | HARTA E INSTITUCIONEVE PUBLIKE




12  
13  
14  
15  
16  
17  
18  
19  
20  
21  
22  
23  
24  
25  
26  
27  
28  
29  
30  
31  
32  
33  
34  
35  
36  
37  
38  
39  
40  
41  
42  
43  
44  
45  
46  
47  
48  
49  
50  
51  
52  
53  
54  
55  
56  
57  
58  
59  
60  
61  
62  
63  
64  
65  
66  
67  
68  
69  
70  
71  
72  
73  
74  
75  
76  
77  
78  
79  
80  
81  
82  
83  
84  
85  
86  
87  
88  
89  
90  
91  
92  
93  
94  
95  
96  
97  
98  
99  
100



**1 HYRJE**





## 1.1 Dispozita ligjore

*Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit (i ndryshuar)*

1. Objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) janë:
  - balancimi i nevojave dhe interesave kombëtarë e vendorë për zhvillimet në territor;
  - krijimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm në territor dhe sipas parimeve të këtij ligji;
  - drejtimi i zhvillimit të sistemeve të banimit e sistemeve të tjera të ndërtueshme;
  - rregullimi i përdorimeve të tokës, intensitetit e shtrirjes së ndërtimit në sistemet natyrore, bujqësore dhe urbane të territorit;
  - planifikimi i programeve dhe masave për të garantuar rigjenerimin urban, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, të tokës së kultivueshme, peizazheve dhe hapësirave të gjelbra;
  - rregullimi i vendndodhjes dhe programeve për infrastrukturën publike e servituset publike, sipas këtij ligji;
  - rregullimi i ruajtjes, përdorimit dhe, sipas rastit, mbarështimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe historike, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
2. Plani i Përgjithshëm Vendor zbatohet nëpërmjet planeve sektoriale, planeve të detajuara vendore dhe lejeve të ndërtimit.

*VKM Nr. 686, date 22.11.2017*

*Neni 54, Përmbajtja PPV-së*

Dokumenti i PPV-së, në varësi të territorit për të cilin hartohet, kuadrit kohor dhe nismës për hartimin e planit, bazohet në këtë përmbajtje:

1. Bazën e të dhënave të integruara të territorit në platformën GIS, sipas standardeve të regjistrimit të integruar të territorit;
2. Strategjinë territoriale të njësisë vendore, që përfshin:
  - dokumentin e analizës metabolike të territorit që i paraprin strategjisë terri-



toriale, vizionin strategjik dhe objektivat e zhvillimit;

- planin e veprimeve strategjike/prioritare, investimeve kapitale dhe projektet pilot të zhvillimit;
- hartat që ilustrojnë strategjinë e zhvillimit të territorit në shkallën që varion nga 1:5,000 deri në 1:25,000.

3. Planin e zhvillimit të territorit të njësisë vendore, që përfshin:

- dokumentin e analizës së thelluar të territorit që i paraprin planit të zhvillimit;
- propozimin me përcaktime territoriale në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujqor dhe infrastrukturor;
- hartat që shoqërojnë dhe pasqyrojnë përmbajtjen e secilit prej sistemeve më sipër, në shkallën që varion nga 1:5,000 deri në 1:25,000;
- relacionin e propozimeve;
- vlerësimin ekonomik dhe financiar për zbatimin e PPV-së;
- planin e veprimeve, investimeve dhe projekteve për zbatimin e PPV-së;
- treguesit për monitorimin e zbatimit të PPV-së.

4. Rregulloren e zbatimit të PPV-së.

5. Studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe të ndikimit në mjedis.

*Neni 54, Parashikimet e PPV-së*

**Përmbajtja e planit të zhvillimit të territorit**

1. Propozimet e PPV-së ose plani i zhvillimit të territorit përmbajnë, të paktën:

- planin e propozimeve territoriale;
- planin e mbrojtjes së mjedisit;
- planin e shërbimeve dhe infrastrukturave publike;
- planin e veprimeve për zbatimin e PPV-së;
- shtojcat I-II-III të PPV-së sipas formatit në fund të kësaj rregulloreje.

2. Plani i propozimeve territoriale përmban, të paktën:

- ndarjen e territorit sipas pesë sistemeve;



- zonimin sipas kategorive bazë dhe nënkategorive të përdorimit të propozuar të tokës;
  - ndarjen e territorit në njësi;
  - pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave, përfshirë hapësirat publike dhe përcaktimin e kushteve teknike kryesore për realizimin e infrastrukturave;
  - zonat e mbrojtura të rëndësisë kombëtare, të trashëgimisë kulturore dhe monumentet;
  - përcaktimin e zonave kryesore të zhvillimit ekonomik dhe urban;
  - tipologjitë e propozuara hapësinore;
  - përcaktimin e njërive, të cilat do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-së;
  - shpërndarjen e popullsisë në territor sipas treguesve të parashikimit demografik dhe ekonomik, të specifikuar në nivel territori urban;
  - planin e strehimit, bazuar në nevojat e konstatuara, e tashmë dhe ato të projektuara, duke përcaktuar zonat/njësitë për dendësim, rigjenerim, rihvillim, konservim, urbanizim nëse janë zona të reja dhe territoret për programe sociale të strehimit;
  - përcaktimin e zonave/njërive, ku do të zbatohen instrumentet për drejtimin e zhvillimit sipas ligjit, në rast se parashikohen të tilla.
3. **Plani i mbrojtjes së mjedisit, i cili përmban:**
- parashikimet për mbrojtjen e peizazhit;
  - parashikimet për mbrojtjen e elementeve ujore;
  - parashikimet për shtimin dhe/ose zgjerimin e hapësirave të gjelbra;
  - parashtrimin e dy varianteve për zgjidhje të problematikës së evidentuar për sa u përket hotspoteve;
  - parashikimet për përmirësimin e cilësisë së ajrit.
4. **Plani i shërbimeve dhe infrastrukturave publike, i cili përmban:**
- infrastrukturë publike të propozuar sipas pikës 11, të nenit 3 të ligjit;
  - konsiderata nga planet e niveleve të tjera, sipas ndikimit në territorin vendor;



- tipologjinë, cilësinë, shpërndarjen në territor dhe rrezet e mbulimit të shërbimeve sociale (edukim, shëndetësi etj.) që propozohen.
5. Planin e veprimeve për zbatimin e PPV-së, i cili përmban:
- fazat e zbatimit të zhvillimit, të ndara në periudha kohore brenda vlefshmërisë së planit për zonat me prioritet zhvillimi, PDV-të, rrjetet kryesore të infrastrukturave publike dhe projektet pilot;
  - koston e përgjithshme për zbatimin dhe aktivitetet kryesore të financuara, të shoqëruara me planin e investimeve kapitale;
  - ndryshimet e nevojshme në kuadrin ligjor dhe administrativ në nivel vendor.
6. Indikatorët për monitorimin e zbatimit të PPV-së.
7. Shtojcat e PPV-së, të cilat përmbajnë të gjitha dokumentet e përmendura për këtë qëllim, studimet ndihmëse që merren nga institucionet përgjegjëse për sektorë të caktuar, si dhe studime për qëllime të veçanta që ndërmerren nga vetë autoriteti vendor.

#### *Neni 56 Përmbajtja e rregullores së PPV-së*

Rregullorja e PPV-së përmban, të paktën:

1. Përkufizimet e termave të përdorura;
2. Shpjegimin e kodeve të përdorura për:
  - kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës;
  - sistemet;
  - zonat;
  - njësitë;
  - kode të tjera sipas rastit.
3. Rregullat e përdorimit të tokës, të cilat përmbajnë, të paktën:
  - kategoritë bazë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës;
  - aktivitetet dhe funksionet në përputhje me kategoritë e përdorimit të tokës, sipas rastit;
  - përdorimet që lejohen, ndalohen apo kushtëzohen, përfshirë kushtet për-



katëse.

4. Rregullat për çdo zonë dhe njësi që përmbajnë, të paktën:
  - kushtet e zhvillimit sipas rregullores së zhvillimit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;
  - aktivitetet dhe funksionet e lejuara, të kushtëzuara dhe të ndaluara, sipas kategorive dhe nënkategorive të përdorimit të tokës;
  - normat, treguesit dhe standardet e zbatueshme të planifikimit, sipas kësaj rregulloreje;
  - të drejtat dhe kufizimet ligjore, publike apo private, që rrjedhin nga përdorimi i treguesve të zhvillimit;
  - listën e instrumenteve që mund të përdoren për të drejtuar zhvillimin sipas ligjit, përfshirë të drejtat dhe kufizimet ligjore që rrjedhin prej tyre.
5. Rregullat e nënndarjes dhe të bashkimit të parcelave në çdo njësi që përmbajnë, të paktën:
  - kushtet për procesin e ndarjes dhe bashkimit;
  - aksesin në infrastrukturë;
  - afatet e nënndarjes dhe të zhvillimit, sipas rastit.
6. Rregullat e sistemit rrugor dhe të transportit që përmbajnë, të paktën:
  - përcaktimin dhe përshkrimin e kategorive të rrjetit rrugor, në përputhje me legjislacionin e posaçëm;
  - kushtet teknike dhe përmasat;
  - parametrat e skemës së lëvizshmërisë dhe të transportit publik, në përputhje me legjislacionin e posaçëm;
  - përcaktimin e vijës së ndërtimit (vija e kuqe) përgjatë dy anëve të trupave rrugorë.
7. Rregullat e ruajtjes së mjedisit, peizazhit, burimeve natyrore, zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore që përfshijnë, të paktën:
  - normat dhe standardet për zhvillimet, që kanë ndikim në mjedis, shëndet, peizazh dhe në trashëgimi kulturore, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi;
  - normat, standardet dhe rregullat për zonat dhe objektet e trashëgimisë kul-



turore, historike dhe mjedisore;

- përcaktimin e vijës mbrojtëse përgjatë elementeve ujore (vija blu);
- rregulla arkitektonike dhe estetike, sipas rastit;
- rregullat për shfrytëzimin e hapësirave nga “Personat me aftësi të kufizuara”, në përputhje me legjislacionin e posaçëm.

8. Autoritetet e planifikimit vendor, gjatë hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe rregullores në zbatim të tij, nuk duhet të shkelin kriteret minimale të treguesve të zhvillimit, përcaktuar në rregulloren (kombëtare) të zhvillimit, por në çdo rast, në rregulloret e tyre vendore, mund të përcaktojnë tregues zhvillimi që reflektojnë nevojat e territorit në administrim, të tilla si: diellëzimi, pozicioni gjeografik, kushtet klimaterike etj.

9. Kategoritë bazë të përdorimit të tokës

## 1.2 Dispozita ligjore sektoriale

*Ligj nr. 115/2014, datë 31.07.2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në republikën e Shqipërisë”*

*Ligj nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”*

*VKM nr. 691, datë 29.07.2015, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015–2020”*

*VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” (i ndryshuar)*

*Ligj nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” (i ndryshuar)*

*Vendim nr. 280, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje” (i ndryshuar)*

*Ligj nr. 8378, datë 22.07.1998, ndryshuar me ligjin nr. 9808, datë 24.09.2007 dhe ligjin nr. 10488, datë 05.12.2011, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”*

*Ligj nr. 9220, datë 15.04.2004, “Për administrimin e shërbimit të varrimit” (i ndryshuar)*

*Ligj nr. 80/2014, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9220, datë 15.04.2014, Për shërbi-*





*min publik të varrimit”*

*Ligj nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për trashëgiminë kulturore”*

*VKM 405, datë 01.06.2016, “Për miratimin e strategjisë së Strehimit Social 2016-2025”*

*Ligj nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin urban”*

*Ligj nr. 111/2012, datë 03.12.2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”*

*Ligj nr. 8681, datë 02.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambeve” (i ndryshuar)*

*VKM nr. 289, datë 15.04.2005, “Për përcaktimin e kërkesave dhe të procedurave për miratimin e lejeve, të autorizimeve dhe të koncesioneve për përdorimin e ujit”*

*VKM nr. 177, datë 31.03.2005, “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”*

*Ligj nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (i ndryshuar)*

*Ligj nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit” (i ndryshuar)*

*Ligj nr. 8756, datë 26.03.2001, “Për emergjencat civile” (i ndryshuar)*

*Ligj nr. 10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar)*

### **1.3 Konsiderata mbi planet e niveleve të tjera dhe efekteve të tyre mbi territorin vendor**

Pozicioni gjeografik dhe prania e elementeve të rëndësishme territoriale brenda kufijve të bashkisë Tropojë kanë bërë që ky territor të jetë subjekt i një sërë planesh e studimesh në shkallë kombëtare dhe rajonale. Këto plane, edhe pse në shkallë dhe me qëllime të ndryshme, ndërtojnë një sërë linjash guidë ku mbështetet vizioni për territorin.

Sipas hierarkisë këto plane janë:

*Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit (VKM Nr. 881, datë 14.12.2016), si instrumenti më i lartë i planifikimit territorial në Shqipëri, ka qenë në qendër të konsideratave gjatë procesit të hartimit të PPV-së. Kjo ka sjellë ndërtimin e një vizioni vendor që është tërësisht në përputhje me atë kombëtar për planifikimin e territorit.*

*Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar “Alpet e Shqipërisë”, ende i paaprovuar, ndan territorin në zona dhe përcakton rregullat për përdorimin e këtyre zonave. Njësitë*



strukture brenda territorit të zonave të mbrojtura të mbuluara nga ky plan menaxhimi, ku sipas PPV-së Tropojë duhet të përqendrohet zhvillimi, gjenden në brendësi të “zonave për zhvillim të qëndrueshëm” të këtij plani menaxhimi. Në përkufizimin e këtyre njësive strukture në PPV merren në konsideratë edhe aspekte të tjera të lidhura me brezat mbrojtës të sipërfaqeve ujore, praninë e zonave ekzistuese të banuara, praninë e infrastrukturës etj. E njëjta metodologji është përdorur edhe për zonën e parkut rajonal të Nikaj-Mërturit.

Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit për Alpet e Shqipërisë është në proces paralel me hartimin e PPV-së Tropojë. Bashkërendimi midis këtyre dy planeve do të jetë një proces i vazhdueshëm deri në mbyllje të punës, në mënyrë që produkti final të jetë në përputhshmëri të plotë. Zhvillimi i turizmit është thelbësor për këtë territor pasi konsiderohet si gjenerator zhvillimi edhe në fusha të tjera të ekonomisë.

Përveç planeve të mësipërme, puna për hartimin e PPV-së Tropojë është mbështetur në analizën e strategjive kombëtare të sektoreve. Këto strategji synojnë arritjen e përputhshmërisë me objektivat dhe aktet ligjore të BE-së, në pritje të integritit të Shqipërisë në BE. Kjo do të garantojë fondet e nevojshme për bashkinë nga qeveria qendrore, për zbatimin e planit nëpërmjet projekteve të propozuara.

Mbetet për të theksuar gjithsesi se ndeshen disa mospërputhje midis vizioneve dhe strategjive kombëtare të sektorëve të ndryshëm. Këto mospërputhje kanë të bëjnë me strategjitë për mbrojtjen dhe zgjerimin e elementeve natyrore dhe zonave të mbrojtura dhe lejet për shfrytëzimin e tyre. Më specifikisht i referohemi lejeve për ndërtimin e hidrocentraleve në brendësi të zonave të mbrojtura dhe rehabilitimit të mjedisit mineral pas shfrytëzimit të tij, që duket se nuk zbatohet edhe pse i rregulluar me ligj.







25

## 2 PËRMBLEDHJE E STRATEGJISË TERRITORIALE





## 2.1 Vizioni

Vendosur në Shqipërinë Veri-Lindore, Tropoja është një nga rajonet më pak të njohura të vendit. Territori i saj malor mbetet gjerësisht i panjohur për shumicën e shqiptarëve, por ka fituar vëmendjen e turistëve të huaj, veçanërisht *hiker*-ve evropianë, që e vizitojnë rajonin për të shijuar kushtet e tij natyrore të paprekura dhe shtigjet alpine.

Mundësia për të krijuar vizionin e ardhshëm për Tropojën është një mundësi unike për të ngritur strategji, veprime dhe projekte konkrete që e bëjnë Tropojën një rajon unik, ku zhvillimi i ardhshëm socio-ekonomik bazohet në ndërlidhjen e kujdesshme midis përmirësimit, mbrojtjes dhe përdorimit të resurseve të saj territoriale.

Vizioni për të ardhmen e Tropojës bazohet në leximin e kujdesshëm të aseteve lokale të rajonit dhe në të kuptuarit se shfrytëzimi i tyre duhet të bëhet në përfitim të ekonomisë dhe popullsisë vendase, pa cënuar vlefshmërinë dhe mundësinë e përdorimit të tyre në të ardhmen.

## 2.2 Objektivat Strategjike

### *SO1 Mbrojtja e mjedisit*

Pavarësisht se parqet dhe rezervat natyrore janë të pranishëm në rajon, duke e bërë kështu një pjesë të madhe të territorit subjekt të niveleve të ndryshme të mbrojtjes, plani synon të përforcojë mbrojtjen mjedisore nëpërmjet një seri veprimesh specifike, duke vendosur në objektiv mbrojtjen e jetës së egër, përmirësimin e ekosistemit prodhues, përforcimin e mbrojtjes nga zjarri, zbutjen e ndryshimeve klimaterike (veçanërisht në lidhje me erozionin e tokës) dhe forcimin e strukturave administrative dhe menaxhuese të zonave të mbrojtura (përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit publik).

### *SO2 Ruajtja e aseteve kulturore dhe natyrore*

Ky objektiv strategjik synon të ngrëjë politika dhe rregullore të qarta për mbrojtjen e monumenteve dhe trashëgimisë kulturore të pranishme në të gjithë territorin e Bashkisë së Tropojës (përfshirë një kod të ri ndërtimi për ndërtimet e reja dhe rinovimet) dhe të fillojë një seri ndërhyrjesh që trajtojnë kullën dhe shtëpitë tradicionale malore, të ndërtaura me gure, që sot janë në rrezik.

(në faqen  
paraardhëse)  
Tropojë: Harta  
e strategjisë  
territoriale





### *SO3 Zhvillimi i turizmit*

Zhvillimi i turizmit në zonën e Tropojës është i lidhur ngushtë me përmirësimin e tipareve të peizazhit të rajonit dhe me bashkimin e këtyre përbërësve të ndryshëm të peizazhit në një park të madh territorial. Për të arritur këtë qëllim, veprimet strategjike prekin ruajtjen dhe rehabilitimin e shumë shtigjeve historike që ende sot përshkojnë territorin, rikuperimin e ndërtesave të papërdorura, si struktura hotelesh, dhe zhvillimin e një pritjeje hoteliere të denjë në Bajram Curri, nga ku turistët do të arrijnë lehtësisht pikën e fillimit të ekskursioneve, falë një sistemi të ri publik lëvizjeje.

### *SO4 Përmirësimi i bujqësisë dhe blegtorisë*

Bujqësia dhe blegtoria ende sot janë dy format kryesore të prodhimit në territorin e Tropojës, veçanërisht në malësitë lindore. Pavarësisht vështirësive të dekadave të fundit, këto veprimtari duhet të përforcohen dhe të mbështeten nëpërmjet investimeve në veprimtari të reja që përfshijnë të korrat alpine, rehabilitimin e infrastrukturave të braktitura bujqësore dhe nëpërmjet mbështetjes së bashkëpunimit midis fermerëve. Vlera e të korrave lokale duhet të rritet, zinxhiri i prodhimit, nga kultivimi deri te përpunimi dhe tregtimi, duhet të plotësohet, ndërkohë që prodhimet lokale duhet të bëhen të disponueshme për vizitorët dhe duhet të jenë krenaria e rajonit të Tropojës.

### *SO5 Përmirësimi i aksesueshmërisë së territorit dhe lidhjet e brendshme*

Aksesueshmëria në rajonin e Tropojës duhet të përmirësohet: ndërkohë që, nga njëra anë është e rëndësishme të përmirësohen rrugët kombëtare pasi, për momentin, mënyra më e mirë për të mbërritur në Tropojë nga Tirana është nëpërmjet Kosovës, nga ana tjetër, është thelbësore të përmirësohet aksesueshmëria e të gjitha pjesëve të territorit nëpërmjet një sistemi eficient të transportit publik, duke lejuar p.sh. turistët të lëvizin lirshëm midis Bajram Currit dhe pikave të shumfishta të fillimit të ekskursioneve potenciale.

### *SO6 Konsolidimi i zonave urbane dhe rurale*

Në kontrast me bukurinë e peizazhit, si Bajram Curri ashtu edhe qendrat rurale vuajnë nga një mungesë e hapësirës së denjë publike. Ndërkohë që, në Bajram Curri, hapësira e re publike e qytetit është parashikuar si një tërësi sipërfaqesh të shtruar që, duke ndjekur topografinë, krijojnë fragmente tarracash dhe shkallësh, në qendra më të vogla urbane, hapësira kryesore urbane është parashikuar si një trotuar këmbësorësh që lidh mjediset kryesore publike, si administrata lokale, ambulanca dhe zyra postare. Në këtë mënyrë, çdo qendër urbane do të shenjohej nga një vend specifik takimesh dhe jete qytetare.






### *SO7 Përditësimi dhe implementimi i infrastrukturës bazë urbane*

Në mënyrë të ngjashme me shumë pjesë të tjera urbane dhe rurale të Shqipërisë, edhe rajoni i Tropojës ka nevojë për një përmirësim dhe implementim të infrastrukturave bazike urbane, si në Bajram Curri ashtu edhe në vendbanime rurale, përfshirë realizimin e një sistemi funksional kanalizimesh për të gjithë territorin e bashkisë (si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane), ndërtimin e një impianti trajtimi të ujërave të zeza në Bajram Curri dhe zhvillimin e një sistemi plotësisht funksional të hedhjes së mbeturinave.

### *SO8 Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar*

Plani synon të njohë rëndësinë dhe të përforcojë bashkëpunimin ndërkufitar me vendet fqinje, si Kosova dhe Mali i Zi, pasi është e nevojshme të krijohen ndërveprime në terma të mbrojtjes mjedisore dhe zhvillimit ekonomik.





### 3 PLANI I ZHVILLIMIT





### 3.1 Ndarja e territorit në pesë sisteme territoriale

Bazuar në VKM Nr. 686, date 22.11.2017, territori i Bashkisë Tropojë është ndarë në 5 sistemet bazë të përkufizuara dhe kodifikuara si më poshtë:

#### *Sistemi urban*

Ky sistem lidhet me të gjitha strukturat e ndërtuara të pranishme në territor, nga shtëpitë dhe monumentet historike, deri te shtëpitë e kohëve të fundit, nga ndërtesat publike te strukturat industriale, etj. Qëllimi i identifikimit të këtij sistemi është të japë një vështrim të përgjithshëm të të gjithë peizazhit të ndërtuar dhe të theksojë llojshmërinë tipologjike të pranishme në zonën e territorit bashkiak.

#### *Sistemi bujqësor*

Një nga ndodhitë më negative të 25 viteve të fundit ka qenë rënia drastike e prodhimit bujqësor dhe shkatërrimi pasues i menaxhimit të tij në lidhje me kutivimin, vaditjen dhe kullimin. Pavarësisht kësaj situatë, toka rurale përbën ende një aset madhor të territorit. Për ta fuqizuar atë, të gjitha karakteristikat e saj janë hartëzuar – nga pemishtet e vogla deri te fushat e gjera – dhe së bashku formojnë sistemin bujqësor.

Kategoria	Sipërfaqje e kthyer nga B (m2)	Sip min e parcelës për ndërtim (m2)	%A	Sip mbi të cilën aplikohet KSHT	KSHT	Sip e ndërtueshme
BA1.1	156259	600	70.00%	109200.00	40.00%	43680
BA1.3	42818	1000	40.00%	16800.00	40.00%	6720
BA2.1	647185	2000	20.00%	129200.00	40.00%	51680
BA2.2	635540	1300	30.00%	190320.00	40.00%	76128
BA3.1.1	4632733	5000	8.00%	369600.00	40.00%	147840
BA3.1.2	7160127	5000	8.00%	572000.00	40.00%	228800
BA3.2.1	191396	3000	14.00%	26460.00	40.00%	10584
BA3.2.2	1331760	3000	14.00%	186060.00	40.00%	74424
<b>Totale</b>	<b>14797818</b>					<b>639856</b>

(në faqen paraardhëse)  
Harta e 5 sistemeve territoriale



### *Sistemi natyror*

Elemente natyrore si kodrat dhe malet janë aspekte madhore të territorit bashkiak. Për këtë arsye, të gjithë elementet e sistemit natyror janë hartëzuar me kujdes dhe së bashku formojnë sistemin natyror dhe përshkruajnë mundësinë e tyre drejt një të ardhmeje të qëndrueshme për rajonin. Në vend që të konsiderohen si mbetje të territorit të urbanizuar, tipare natyrore si shpatet dhe pyjet me pisha bëhen *pengesa* natyrore që kufizojnë dhe orientojnë zhvillimin urban.

### *Sistemi ujor*

Uji përbën një nga burimet madhore të territorit. Territori ofron një pasuri ujërash, por për shkak të keqmenaxhimit dhe ndotjes, i njëjti territor vuan nga një pamjaftueshmëri kronike e ujit. Përveç rivendosjes së një përdorimi më racional të ujit, kanalet dhe lumenjtë mund të luajnë një rol themelor në lejimin e depërtimit të gjerë fizik të territorit dhe të bëhen strumbull për riorganizimin territorial. Lumenjtë dhe kanalet mund të bëhen një *hapësirë publike* territoriale që ka fuqinë të riorientojë territorin drejt burimeve të tij më të çmuara. Të gjithë elementet që lidhen me ujin përbëjnë sistemin ujor.

### *Sistemi infrastrukturor*

Ky sistem mbledh të gjithë elementet që mbështesin lëvizjen në territorin bashkiak, nga autostrada te hekurudha, te rrugët lokale dhe shtigjet këmbësore. Analiza dhe hartëzimi i këtij sistemi dëshmon për llojshmërinë e gjerë të mjeteve të lëvizjes dhe përshkueshmërinë e mundshme në gjithë territorin, nëpërmjet pranisë së një rrjeti të shpërndarë të rrugëve të shtruara dhe të pashtuara. Elementet e këtij sistemi përfaqësojnë një aset të veçantë për ta interpretuar territorin si një park dhe, rrjedhimisht, si një rajon gjerësisht të depërtueshëm nëpërmjet mjeteve të ndryshme të transportit. Një synim themelor i PPV-së është riorganizimi dhe përmirësimi i rrjetit aktual të lëvizjes, përtej qëllimit të tij të thjeshtë logjik. Sistemi infrastrukturor përmban edhe infrastruktura të tjera, si shërbime të furnizimit me energji elektrike dhe të mbetjeve urbane.

## **3.2 Ndarja e territorit në njësi strukturore**

I gjithë territori bashkiak është ndarë në mënyrë të kujdesshme në njësi strukturore, mbi bazën e dispozitave ligjore përkatëse, të cilat përcaktojnë si njësi strukturore “ndarjen më të vogël të territorit për qëllime zhvillimi, e cila përcaktohet gjatë procesit të planifikimit” (VKM Nr. 686, date 22.11.2017). Procesi i ndarjes së territorit në njësi strukturore ka marrë në konsideratë faktorë dhe parametra të ndryshëm dhe mund të përmblihet si më poshtë:



1. Përgjithësisht zonat urbane janë ndarë në njësi strukturore me përmasa të pandryshuara, midis 4-5 ha, për të thejstuar zhvillimin e PDV-së - zonat rurale dhe bujqësore përgjithësisht janë ndarë në njësi strukturore me përmasa të pandryshuara, midis 3-8 ha.
2. Njësitë strukturore janë nën-ndarë duke marrë parasysh funksionin kryesor të secilës prej tyre dhe duke shmangur bashkëjetesën e programeve të papërputhshëm brenda të njëjtës njësi strukturore; përjashtimi kryesor i dallueshëm nga ky rregull përfaqësohet nga zonat e afërsisë me funksion bujqësor dhe banim (të ashtuquajturat zonat e afërsisë), ku bashkëjetesa nuk konsiderohet e papajtueshme por, përkundrazi, tipar i veçantë pozitiv i territorit. Analiza e detajuar më sipër e përdorimit të tokës, e zhvilluar gjatë fazës analitike të procesit të hartimit të PPV-së, ka qenë me rëndësi të veçantë për të përcaktuar struktura homogjene të përdorimit të tokës në brendësi të secilës njësi strukturore të propozuar.
3. Kufijtë e secilës njësi strukturore janë gjurmuar në vijim të pranisë së elementeve ekzistues natyrorë dhe artificialë të territorit, si rrugët, hekurudhat, kanalet, lumenjtë, burimet ujore, etj. Gjithashtu, kufijtë janë përcaktuar duke ndjekur trajektoren e rrugëve të projektuara apo gjurmëve të tjera territoriale dhe duke marrë në konsideratë praninë e zonave të detyrueshme mbrojtëse tampon (*buffer*).
4. Njësitë strukturore janë përcaktuar duke marrë në konsideratë parametra të rëndësishëm të urbanizimit si intensiteti i ndërtimit, koeficienti i shfrytëzimit të truallit dhe lartësia e ndërtesës. Gjithashtu, është bërë edhe një lexim arkitektonik i territorit, në mënyrë që çdo njësi strukturore të karakterizohet nga tipologji të njëjta hapësinore dhe nga prania e ndërtesave të së njëjtës periudhë historike. Ekzistenca e vlerave të veçanta të trashëgimisë historike brenda të njëjtës njësi strukturore është përcaktuar për të siguruar aplikimin e niveleve koherente të mbrojtjes në të gjithë njësine strukturore.



<b>SISTEMI URBAN</b>	<b>2032</b>
Sipërfaqja e territorit urban	1,057,3 km <sup>2</sup>
Sipërfaqja e infrastrukturës	6 km <sup>2</sup>
Popullsia 2016	27,682 banorë
Popullsia 2031	31'281 banorë
Strehimi social	4,000 m <sup>2</sup>
Shërbime sociale - arsim	223,742 m <sup>2</sup>
Shërbime sociale - shëndetësi	56,500 m <sup>2</sup>
Transporti publik	28 linja
Ndarja në zona (njësi)	602 / 5,801 njësi strukturore totale
Sipërfaqe të gjelbra dhe sportive	152,987 m <sup>2</sup>
Hapësira kulturore dhe për rekreacion	8,275 m <sup>2</sup>
Monumente dhe objekte të trashëgimisë kulturore	113,157 m <sup>2</sup>
Detyrimet në lidhje me kërkesat fetare	-
Intensiteti për ha	0.27
Parkime për banorë	1/2 njësi/banorë
Treguesit ekonomikë (sektorë)	Turizëm natyror dhe kulturor, tregti, industri përpunuese e prodhuese, bujqësi dhe agrobiznes
Pronat publike dhe private	-
Tendencat e zhvillimit të territorit	-





<b>SISTEMI BUJQËSOR</b>		<b>2032</b>
Sip. Territor bujqësor		95,900 ha
Sip. Territor bujqësor primar (Boniteti I-IV)		0 ha
Sip. Territor bujqësor dytësor (Boniteti V-X)		95,900 ha
Sip. Territor bujqësor me sistem ujitjeje		-
Rrjet ujitje i përmirësuar		331 km
Sip. T. Pafryt.		-
<b>SISTEMI UJOR</b>		<b>2031</b>
Ujëra tokësore		12.5 km <sup>2</sup>
Ujëra Bregdetare (km <sup>2</sup> )		-
<b>SISTEMI INFRASTRUKTURE</b>		<b>2031</b>
Rrugë kombëtare		-
Rrugë interurbane		250 km
Rrugë urbane parësore		-
Hekurudha		-
Porte		-
Aeroporte		-
Gazdote		-
Elektrodote		62.5 km
Ujësjellës/ Kanalizime		180 km/ 17.2 km



<b>SISTEMI NATYROR</b>		<b>2032</b>
Sip. e përgjithshme		935.6 km <sup>2</sup>
Sip. pyjore		672.1 km <sup>2</sup>
Sip. kullota		105.7 km <sup>2</sup>
Sip. të gjelbra (km <sup>2</sup> )		-
Zona të mbrojtura sipas legjislacionit të posaçëm		513.3 km <sup>2</sup>



### 3.3 Zonimi sipas kategorive bazë dhe nënkategorive të përdorimit të propozuar të tokës

Për të siguruar realizimin e objektivave të përcaktuara në vizionin për zhvillimin e territorit, PPV-ja përcakton kategoritë dhe nënkategoritë sipas Përdorimit të propozuar të Tokës për secilën nga njësitë strukturore të përcaktuara.

Përkufizime dhe propozime të lidhura me kategoritë e përdorimit të tokës përshkruhen më poshtë:

a. Përdorimi Banim, me kod "A";

Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të banimit dhe strukturave ndihmëse në funksion të tij si: funksione të lehta apo në shkallë të vogël tregtimi, ndërtim banimi sezonal, funksione turistike të lehta, zyra, banka, dhe funksione publike.

b. Përdorimi Ekonomi dhe Industri , me kod "IE";

Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të industrisë dhe ekonomisë dhe strukturave ndihmëse në funksion të tyre si: industri e rëndë, nxjerrje dhe përpunim materialesh ndërtimi, nxjerrje dhe përpunim mineralesh, park logjistik, industri përpunuese, ushqimore, magazinime, etj.

c. Përdorimi Bujqësi, me kod "B";

Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të bujqësisë dhe strukturave ndihmëse në funksion të saj si: toka bujqësore, fusha bujqësore, tarraca të mbjella me ullishte, vreshta, drurë frutorë, prodhimet e serave, struktura për prodhimin e vajrave, të shitjes, të magazinimit, agro-turizëm, etj.

d. Përdorimi Shërbime, me kod "S";

Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të shërbimeve dhe strukturave ndihmëse në funksion të tyre si: restorante, bare, dyqane, shërbime tregtare, supermarkete, hipermarkete, tregtim me pakicë e me shumicë, ushqimore, aktivitete të vogla prodhuese, hoteleri, panaire, zona parkimi, qendra biznesi, zyra, etj.


e. Përdorimi i Veçantë, me kod "V";

Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të varrezave.

f. Përdorimi Ujëra, me kod "U";

Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të ujërave mbitokësore, si aktivitete të lehta rekreative, peshkim, struktura të lehta për





lundrim apo parkim, pellgje ujitës, shtigje rekreative për këmbësorë apo me biçikleta, linja ujore, lumenj, përrenj, liqene, përfshirë brigjet, etj., sipas legjislacionit për ujërat.

g. Përdorimi Tokë Natyrore, me kod "N";

Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të natyrës, si pyje, male, kodra, fusha, kullota, toka të pafrytshme, e gjithçka tjetër që përfshin mjedisi natyror sipas përcaktimeve të ligjeve për mjedisin, biodiversitetin, zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës.

h. Përdorimi Trashëgimi dhe Monumente kulture dhe historike, me kod "M";

Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të trashëgimisë dhe monumenteve të kulturës dhe historike, zona A, parku arkeologjik si dhe zona monumentale.

i. Përdorimi Zona Ushtarake, me kod "ZU";

Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të zonës ushtarake.

j. Përdorimi Institucione, me kod "IS";

Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të institucioneve, administrata publike shtetërore pavarësisht nivelit, sistemit gjyqësor, bankat, mediat, institucione të mbrojtjes civile dhe kombëtare përjashtuar ato që përfshihen në kategoritë e tjera, të shërbimeve të ndihmës dhe kujdesit social, të shoqërisë civile, sistemi i burgjeve dhe institucioneve fetare, etj.

k. Përdorimi Aktivitete sociale dhe rekreative, me kod "AR";

Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të aktiviteteve sociale dhe rekreacionit si: qendër kulturore, terrene sportive, salla koncertesh, kinema, teatër, muze, opera, hapësira publike, argëtuese, parqe, hapësira rekreative, funksione publike, gjelbërim, shërbime për interes vendor, etj.

l. Përdorimi Arsim, me kod "AS";

Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të arsimit publik.

m. Përdorimi Shëndetësi, me kod "SH";

Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion të strukturave të shëndetit publik.

n. Përdorimi Infrastruktura, me kod "IN".

Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përdorimin e territorit në funksion

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
kategorive të  
përdorimit të  
tokës





të infrastrukturës si stacione, terminale, impjante të trajtimit të ujërave të zeza, fabrika riciklimi, kompostimi, landfille, porte, rrugë kryesore nacionale, nyje transporti, hekurudha, ujësjellës, mbetjet e ngurta dhe të lëngshme, furnizimi me ujë, naftë, gaz, bio-karburantet, furnizimi me energji elektrike, komunikimi elektronik, elementët mbrojtës të tokës nga erozioni, rrëshqitjet e tokës, mbrojtja nga zjarri, etj., sipas legjislacioneve të posaçëm.

o. Përdorimi Banim dhe Industri e Ekonomi, me kod "IE, A";

Kjo kategori e përdorimit të tokës shkrin në një njësi ndërtimore banimin dhe punën si funksione të kombinuara. Për shembull, inkubatorët e biznesit dhe parqet logjistike, magazinat tregtuese, zyrat, strukturat ndihmëse përkatëse etj. mund të plotësohen me funksione banimi për ata që punojnë atje.

p. Përdorimi Banim dhe Shërbime (tregtare), me kod "S+A / S, A";

Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përzierjen e banimit me shërbime tregtare si zyra, dyqane, bare, restorante, supermarkete, hipermarkete, aktivitete të vogla prodhuese, tregtim me shumicë dhe pakicë etj. brenda të njëjtës njësi ndërtimore. Synimi kryesor i kësaj kategorie të përdorimit të tokës është të mbështesë fleksibilitetin e të jetuarit dhe punuarit brenda të njëjtës strukturë.

q. Përdorimi Industri, Ekonomi dhe Shërbime (tregtare), me kod "IE, S";

Kjo kategori e përdorimit të tokës bazohet në përzierjen e funksioneve të banimit, atyre tregtare, dyqane, bare, zyra, restorante, supermarkete, hipermarkete, aktivitete të vogla prodhuese, panaire, tregtim me shumicë dhe pakicë etj. brenda të njëjtës njësi ndërtimore. Qëllimi kryesor i kësaj tipologjie është të mbështesë fleksibilitetin e veprimtarive prodhuese brenda të njëjtave hapësira.

r. Përdorimi Shërbime dhe aktivitete rekreative, me kod "AR+S";

Kjo kategori e përdorimit të tokës i referohet shërbimeve të vogla tregtare dhe turistike si hotele, B&B, restorante dhe strehim agro-turistik, shërbime tregtare në shkallë të vogël, hapësira sportive, hapësira rekreative, shërbime publike, zona parkimi, funksione publike, aktivitete sociale etj.

s. Përdorimi Banim dhe shërbime dhe aktivitete rekreative, me kod "AR+S+A";

Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përzierjen e banimit me shërbimet tregtare dhe turistike si hotele, B&B, restorante dhe strehim agro-turistik, shërbime tregtare në shkallë të vogël, hapësira sportive, hapësira rekreative, shërbime publike, zona parkimi, funksione publike, aktivitete sociale etj.

sh. Përdorimi Banim dhe Bujqësi, me kod "B, A";

Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përzierjen e shërbimeve të banimit




dhe atyre bujqësore, si fermat dhe magazinat, brenda të njëjtës njësi strukturore.

t. Përdorimi Bujqësi dhe Natyrë, me kod "B+N";

Kjo kategori e përdorimit të tokës i referohet zonave specifike ku llojet natyrore dhe kultivimi bujqësor formojnë një sistem heterogjen unik.








**4 ZONADHE OBJEKTE TË RËNDËSISË KOMBËTARE DHE TERRITORET  
FQINJE**





#### 4.1 Burime mjedisore në territorin e bashkisë së Tropojës

Bashkia Tropojë, për vet pozicionin gjeografik të saj, në territorin që mbulon mbart një sërë elementesh me rëndësi kombëtare dhe jo vetëm. I tërë territori i bashkisë shtrihet në basenin e lumit Drin, duke u pozicionuar thuajse në qendër të këtij baseni që mbledh ujërat e brendshme të një territori që kalon në pesë shtete të ndryshme (Maqedoni, Greqi, Kosovë, Serbi, Shqipëri dhe Mal i Zi). Kjo e bën territorin e bashkisë fortësisht të karakterizuar nga ujërat, qofshin ato sipërfaqësore apo nëntokësore. Me sistemin ujor lidhet edhe prania e parqeve natyrore, si Parku kombëtar Lugina e Valbonës, rezerva strikte natyrore Lumi i Gashit si dhe një pjesë e monumenteve natyrore të shpallura apo të propozuara në këtë PPV. Tërësia e këtyre elementeve ka rëndësi thelbësore për këtë territor si nga pikëpamja natyrore ashtu edhe ajo social-ekonomike dhe, në të njëjtën, kohë është pjesë e rëndësishme e trashëgimisë natyrore kombëtare. Përkufizimi i qartë i kësaj rëndësie dhe marrja e masave konkrete për ruajtjen, administrimin dhe përmirësimin e kësaj trashëgimie është më se urgjente. I rëndësishëm gjithashtu për t'u përmendur është edhe fakti që kjo trashëgimi natyrore është pjesë e programit të krijimit të një rrjeti të gjelbër evropian. Kjo është mundësi shumë e rëndësishme për përmirësimin e bashkëpunimit në këtë sektor me vendet fqinje, me të cilët ndajmë territorin e alpeve dhe krijimin e një programi të përbashkët administrimi të këtij sistemi.

#### 4.2 Trashëgimia kulturore në territorin e bashkisë së Tropojës

Krahas trashëgimisë natyrore, në territorin e kësaj bashkie gjenden edhe monumente të rëndësishme të trashëgimisë kulturore. Edhe pse në vendimin e KKT-së nr.1, datë 09.09.2015 nuk përmendet asnjë monument në Bashkinë Tropojë, është e rëndësishme të theksojmë se këto monumente janë pjesë e rëndësishme e identitetit kulturor dhe kombëtar. Mjafton të përmendim kullën e Mic Sokolit, kullën ku u mbajt konferenca e Bujanit apo zonat arkeologjike të vendbanimeve Ilire për të kuptuar vlerat e këtyre monumenteve. Krahas monumenteve tashmë të njohura ligjërisht, si të tilla në Tropojë ndeshen edhe struktura të tjera me vlera të qarta të arkitekturës vendase, ku mund të përmendim kullën e Thepit, e cila ka tërhequr që nga hera vëmendjen e studiuesve e udhëtarëve që kanë përshkuar këtë territor dhe që sot është në kushte të mjerueshme. Ky PPV sugjeron që studime të mëtejshme të bëhen mbi disa struktura që qartësisht paraqesin vlera arkitektonike ose historike, në mënyrë që rrjeti i trashëgimisë kulturore të shtohet dhe, mbi të gjitha, të hartohen plane për restaurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e kësaj pasurie, që ndër të tjera mund të kthehet edhe në një gjenerator ekonomie për popullsinë vendase.

(në faqen  
paraardhëse)  
Tropojë:  
Harta e zonave  
të rëndësishme  
kombëtare dhe  
ndërlidhjet e  
tyre



### 4.3 Elemente të tjera të rëndësishme kombëtare


Elemente të tjera të rëndësishme në nivel kombëtar, në bashkinë Tropojë, gjejmë hidrocentralin e Fierzës, më i madhi ndër tre hidrocentralet e *kaskadës* së Drinit dhe infrastrukturën e transmetimit të energjisë elektrike që lidh Shqipërinë me rrjetin evropian të transmetimit. Për t'u përmendur gjithashtu është edhe zona e ish-njësive administrative të Bytyçit, ku spikat përqendrimi i aktivitetit minerar. Me gjithë rëndësinë që ky aktivitet ka për ekonominë kombëtare, nuk mund të lëmë pa përmendur impaktin që ai ka në territor, në peizazh dhe mbi të gjitha në shëndetin e banorëve të zonës. Aktiviteti minerar duhet të mbahet nën kontroll të rreptë dhe mbi të gjitha duhet të përmirësohet bashkëpunimi midis institucioneve qendrore dhe atyre vendore në mënyrë që të zbatohet në mënyrë të përpiktë Ligji nr. 10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë".

### 4.4 Përmirësimi i ndërveprimit

Tërësia e këtyre elementeve është një gjenerator i rëndësishëm shkëmbimesh midis Tropojës dhe bashkive fqinje, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë. Kjo është arsyeja kryesore për të cilën ky PPV konsideron si parësor përmirësimin e arritshmërisë së këtyre elementeve, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës rrugore, por edhe nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së transportit publik. Gjithashtu, thelbësor është përmirësimi i infrastrukturës lidhëse midis Tropojës dhe territoreve fqinje, si dhe ngritja e një bashkëpunimi institucional ndërkufitar.







**5 PLANI I MBROJTJES SË MJEDISIT**







Siç përshkruhet në Termat e Referencës (ToR), Plani i Mbrojtjes së Mjedisit (PMM) është menduar si një mjet operacional për menaxhimin dhe zgjidhjen e problemeve të mjedisit, nëpërmjet adoptimit të një përqsajeje të integruar të menaxhimit urban dhe territorial dhe konfigurohet si një pjesë integrale e VSM-së, i cili bën një analizë gjithëpërfshirëse të çështjeve mjedisore dhe njëkohësisht vlerësimin e ndikimit në mjedis të propozimeve të planit.

Duke filluar me përkufizimin e dhënë në ToR dhe specifikat e territorit, të evidentuara nëpërmjet analizimit të çështjeve kritike të identifikuar në hartën e rrezeve dhe kufizimeve si dhe në udhëzimet e shprehura në strategjinë rajonale, PMM merret me:

- mbrojtjen e peizazhit;
- mbrojtjen e burimeve ujore, habitateve ujore dhe cilësisë së tokës;
- përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe trajtimin më të mirë të çështjeve energjetike;
- mbrojtjen e natyrës (biodiversiteti dhe zgjerimi i hapësirave të gjelbra urbane);
- trajtimin e zonave të ndjeshme dhe të pikave hotspot të identifikuar në plan.

Qasja e përgjithshme, e përshtatur në mënyrë transversale në lidhje me çështjet e ndryshme të renditura më sipër, i kushton vëmendje të veçantë elementeve si më poshtë:

- identifikimit të informacionit që duhet në lidhje me zonat dhe çështjet e mjedisit, për të cilat nuk ka informacion të mjaftueshëm;
- identifikimit të mangësive ligjore dhe institucioneve kombëtare, në krahasim me standardet evropiane dhe ndërkombëtare (p.sh. anëtarësimi ose jo nëpër traktate, konventa, protokolle ose programeve evropiane apo ndërkombëtare);
- zhvillimit të aktiviteteve trajnuese, informuese dhe të pjesëmarrjes;
- aspekteve të vlerësimit dhe monitorimit.

Për më tepër, në lidhje me çështjet specifike, më poshtë do të nënvizohen disa tipare karakteristike të zgjedhjeve të bëra.

Për sa i përket temës së peizazhit, ky koncept nuk është i përcaktuar mirë në kuadrin legjislativ lokal, dhe nuk është në përputhje edhe me përkufizimet kryesore të shprehura për këtë temë në nivel evropian. Shqipëria nuk është në fakt nga vendet nënshkruese të Konventës Evropiane të peizazhit (Firence, 2000). Për të identifikuar planin e veprimeve kemi zgjedhur t'i referohemi konceptit të peizazhit të shprehur në këtë dokument, i cili përfshin peizazhet e "zakonshëm", si dhe ato të emergjencave dhe mer parasysh në mënyrë holistike aspektet natyraliste, por edhe ato që lidhen me bujqësinë dhe trashëgiminë kulturore, si dhe komponentë identitarë të lidhur me perceptimin



e peizazhit nga komuniteti lokal. Duke pasur parasysh mungesën e legjislacionit të shprehur më sipër dhe mungesën e ndjeshmërisë në këtë fushë, të administratave, bizneseve dhe qytetarëve, gjithashtu konsiderohet e dobishme për të futur në mes të politikave mbrojtëse qasjen e vlerësimit ekonomik të peizazhit, një disiplinë që synon të shpjegojë ndikimin në vlerat ekonomike të peizazhit, duke siguruar gjithashtu një justifikim *pragmatik* të kufizimeve dhe politikave mbrojtëse. Peizazhi konsiderohet si një alternativë ekonomike, e aftë për të gjeneruar të mira për individët. Përdorimi i mjeteve të vlerësimit ka një qëllim të dyfishtë: identifikimin e përfitimeve të pritshme nga veprimet e caktuara dhe transformimin e territorit duke matur efikasitetin dhe efektivitetin e shpenzimeve publike lidhur me këtë ndërhyrje. Kjo është një disiplinë tashmë e konsoliduar.

Kjo disiplinë mund të gjejë përdorim në një gamë të gjerë vlerësimesh në lidhje me situata të ndryshme. Për të dhënë disa shembuj mund të jetë me vlerë të merren parasysh ndikimet në cilësinë e përgjithshme të peizazhit ose cilësitë e elementeve të veçantë dhe ndikimin në vlerën e aktiviteteve të tjera, të tilla si në tregun e pasurive të patundshme (“çmimi hedonik”), apo gatishmërisë për të paguar për hektar për të ruajtur apo përmirësuar peizazhin (metodë e vlerësimit të paparashikuar). Përkufizimi i peizazhit që i referohet vlerësimit është marrë nga Konventa Evropiane e Peizazhit dhe procesi i vlerësimit nuk është menduar si një procedurë teknike bazuar vetëm te specialistët, por siguron komponentët e pjesëmarrjes së komuniteteve lokale. Në këtë mënyrë arrihet rezultati me anën e harmonizimit të politikave evropiane për peizazhin.

Gjithashtu, si pjesë e politikave të ngritjes së vetëdijes dhe zhvillimit të qëndrueshmërisë mjedisore të administratës publike, bizneseve dhe qytetarëve, propozohet, duke vënë theksin në zonat e mbrojtura, koncepti i Prokurimit Publik të Gjelbër, d.m.th. integrimin e vlerësimeve mjedisore në procedurat e prokurimit të Administratës Publike, i cili është mjete për të zgjedhur ato produkte edhe shërbime të cilat kanë një efekt të vogël apo të reduktuar në shëndetin e njeriut dhe në mjedis, në krahasim me produktet dhe shërbimet e tjera që përdoren për të njëjtin qëllim. Praktika e Prokurimit të Gjelbër Publik, si dhe e zvogëlimit të ndikimit mjedisor të aktiviteteve të Administratës Publike, ka për qëllim të ushtrojë një *efekt rimorkimi* në treg për produktet ekologjikisht miqësore dhe të zhvillimit të aktiviteteve në kompanitë vendase dhe ndërkombëtare duke përfshirë kriteret e kualifikimit mjedisor në kërkesën e shprehur nga autoritetet publike për blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

Gjithashtu, në rastin e temës së mbrojtjes dhe zgjerimit të hapësirave të gjelbra urbane është ndjekur mundësia e integritit tematik, duke nënvizuar pluralizmin e funksioneve dhe shërbimeve të ofruara nga hapësirat e gjelbra në lidhje me zonat e ndërtuara dhe të banuara të qytetit. Për këtë qëllim, i është referuar modelit teorik të Shërbimeve të Ekosistemit (shërbimeve mjedisore), i cili synon të theksojë rolin që luajnë sistemet natyrore, megjithëse të atrofizuara, në aspektin e qëndrueshmërisë urbane, përfitimet



dhe shërbimet konkrete (të karakterit mjedisor, social, kulturor, etj.), të cilat ndihmojnë për të përmirësuar cilësinë e jetës.


Përsa i përket trajtimit të zonave të ndjeshme dhe pikave hotspot të identifikuar në plan, ToR parashikon prezantimin e dy opsioneve për zgjidhjen e problemeve të identifikuar. Në rastin specifik të Bashkisë Tropojë nuk janë identifikuar zona hotspot në vetvete megjithatë, duke konsideruar aspektet e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin administrativ të bashkisë, mund të trajtohet nga ky këndvështrim.

Në zonat e përcaktuara në këtë mënyrë, plani identifikon objektivat dhe programet strategjike si dhe veprimet prioritare që do të zbatohen, dhe atyre i bashkëngjiten një sërë planesh / programesh / projektesh specifike. Plani për Mbrojtjen e Mjedisit shpreh vlerësimet e ndryshme të propozimeve në lidhje me impaktet/ndikimet e pritshme, kohën dhe prioritetin.

Më hollësisht, janë adaptuar shkallët e mëposhtme të vlerësimit:

- Impaktet/ndikimet e pritshme mbi:
  - shëndetin dhe sigurinë e njeriut (ShS);
  - biodiversitet (Bio);
  - vlerat kulturore dhe historike (VKH);
  - produktivitetin ekonomik (PEk);
  - forcimin e kapaciteteve (Kap);
  - ngritjen e aseteve të reja (NAR).
- Koha:
  - Afatshkurtër (ASh);
  - Afatmesme (AM);
  - Afatgjatë (AGj).
- Prioriteti:
  - I lartë (L);
  - Mesatar (M);
  - I ulët (U).







## 5.1 Mbrojtja e peizazhit

### 5.1.1 Vlerësimi i ndikimeve në mjedis në nivel objektivash strategjike

*Objektivi Mjedisor 12: Garantimi i ruajtjes së peizazheve të veçanta dhe zonave peizazhistike me veçori dalluese në nivel lokal e kombëtar dhe krijimi i një imazhi peizazhi me cilësi të lartë.*

Përcaktimi i impaktit mbi cilësinë e peizazhit, buron kryesisht nga veçoritë vizive të hapësirës dhe nga elementet karakteristike të peizazhit që janë të pranishme në këtë hapësirë. Peizazhi çënohet më shumë nga infrastruktura që shtrihet në zona të hapura, ku impaktet janë më të dukshme për shkak të një niveli të lartë shtrirjeje (impakte të përhershme, të pakthyeshme). Ndikimi është veçanërisht i lartë në rastin e një ndërhyrjeje infrastrukturore në zona me peizazh të jashtëzakonshëm, apo me tipare të veçanta, si dhe në zona peizazhistike me elemente natyrore të mbrojtur, të cilët mbartin një kuptim të rëndësishëm simbolik.

Impaktet mbi veçoritë peizazhistike të zonave mund të përkufizohen si direkte, kumulative, indirekte dhe të dobëta. Strukturat infrastrukturore në hapësirë, bëhen elemente të peizazhit dhe pjesë përbërëse e tij. Kështu që, sistemimi i këtyre strukturave duhet të bëhet në përputhje me tipologjinë ekzistuese të peizazhit. Marrja në konsideratë e veçorive natyrore dhe topografisë së zonës ku parashikohet të zhvillohet projekti, do të reduktojë fragmentimin e peizazhit.

Përsa i përket aktivitetit minerar në zonë, evidentohet fakti që ky aktivitet ndikon mbi peizazhin ekzistues dhe topografinë përgjatë periudhës së kryerjes së aktivitetit. Ndër ndikimet më të dukshme përmenden ato që lidhen me ndryshimin e pjerrësisë së terrenit dhe ndryshime vizuale të peizazhit. Gjithashtu, ndikime ka edhe në zhvillimin e proceseve tokësore të tokëformimit etj., në sipërfaqen ku zhvillohet aktiviteti. Për më tepër ky aktivitet ka edhe ndikime kumulative siç është erozioni.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv. Procesi i projektimit është gjithëpërfshirës. Me qëllim që të integrohen dhe kërkesat mjedisore në këtë proces, është e nevojshme të përfshihen të gjithë aktorët zyrtarë ose jo në projektim, me qëllim përfshirjen e kriterëve mjedisore që në fazën e hartimit të draft-projekteve të ndërhyrjes në infrastrukturë dhe projekteve të tjera sipas propozimeve të PPV-së.

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e planit  
të mbrojtjes së  
peizazhit



### 5.1.2 Udhëzimet dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 12

Për të siguruar ruajtjen e peizazheve të jashtëzakonshme, zonave të peizazheve me karakteristika të dallueshme në nivel lokal e kombëtar dhe një imazh të cilësisë së lartë të peizazhit, duhet të ndiqen udhëzimet e mëposhtme:

- Ndërhyrjet e infrastrukturës së re nuk duhet të integrohen në zonat e veçanta të peizazhit apo peizazheve me karakteristika të dallueshme në nivel lokal e kombëtar;
- Në integrimin hapësinor të projekteve specifike duhet të kërkohen vende jashtë zonave me peizazhe të veçantë apo zonave me peizazhe me karakteristika të dallueshme në nivel lokal e kombëtar;
- Duhet të zbatohen masat e duhura teknike për të siguruar një imazh të cilësisë së lartë të peizazhit, veçanërisht në rastin e aktiviteteve apo ndërhyrjeve në zona me status mbrojtjeje apo që përmbajnë vlera kulturore;
- Me integrimin e infrastrukturës së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndërtimet e reja.

#### *Strategjia e Peizazhit*

Në rastet kur projekti specifik i mbivendoset ndonjë peizazhi ekzistues bujqësor apo rural, duhet të ndiqet një qasje ku synohet mbrojtja e vlerave rurale dhe rezidenciale dhe pasurimi i peizazhit përgjatë anëve të rrugëve. Objektivat e punimeve peizazhistike:

- Të zhvillohet një peizazh, karakteristikat e të cilit lidhen me modelin, shkallën dhe diversitetin e karakteristikave të peizazhit ekzistues;
- Të minimizohen ndërhyrjet vizuale dhe të zvogëlohet natyra negative e çdo pengese vizuale;
- Të mbrohen, rikthehen apo zmadhohen elementet e peizazhit ekzistues, të prekur drejtpërdrejt nga propozimi;
- Të ndihmohet në krijimin e kushteve të këndshme e të sigurta për drejtimin e automjeteve.

#### *Masat e përgjithshme zbutëse ndaj peizazhit*

Gjatë zgjedhjes dhe projektimit të detyrave të propozuara, konsideratë duhet t'i jepet shmangies së ndikimeve kudo që të jetë e mundur. Në këtë kuadër, alternativa përfundimtare e miratuar për çdo projekt duhet të zgjidhet e tillë që të minimizojë ndikimin



në karakteristikat e banimit, karakteristikat topografike, pemët dhe pyjet. Megjithatë, disa ndikime janë të pashmangshme, dhe masat e propozuara synojnë të zbutin natyrën negative të këtyre ndikimeve.

Lidhur me aktivitetin minerar, PPV dhe VSM parashikojnë marrjen e masave përkatëse zbutëse ndaj ndikimeve në peizazh prej këtij aktiviteti. Si objektiv madhor në këtë kuadër, synohet shfrytëzimi i burimeve minerare në mënyrë që të mos dëmtojnë mjedisin, dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë së aktiviteteve minerare (përfshirë monitorimin dhe kontrollin e tyre).

Përsa i përket ndërhyrjeve infrastrukturore, në rastet kur shtrirja vertikale propozon argjinatura të larta që krijojnë ndikime të rëndësishme në mjedis, këto përforsime të larta nuk duket se janë zgjidhja më optimale. Ato duhet të jenë, aty ku është e mundur, të reduktuara deri në nivelin e tokës apo në 1m lartësi.

Masa të tjera të përgjithshme përfshijnë:

- Në skarpata, për të parandaluar rënien e shkëmbinjve, duhet të jenë më të preferueshme bordurat e gjera sesa platformat e ndërmjetme. Skajet e skarpatave duhet të rumbullakosen. Shpatet e parregullta duhet të jenë më të preferueshme se sipërfaqet gjeometrike.
- Zbatimi i standardeve kombëtare shqiptare të rrugëve për pastrimin e kantiereve dhe rivegjetacionin, për të siguruar ruajtjen e komoditeteve të nevojshme të peizazhit.
- Për mbushje, shpatet duhet t'i nënshtrohen hidrombjelljes me një përzierje farash që përfshin si farat e barit, ashtu edhe të shkurreve. Përveç kësaj, mbjellja në vendet e ndjeshme, veçanërisht në afërsi të ambienteve të banimit dhe rekreacionit, do të përdoret për të reduktuar apo zbutur pengesat vizuale të shkaktuara nga ngritja e argjinaturave të projekteve.
- Për zonat potenciale në një nivel të caktuar (pas optimizimit të lartësisë së projektit) bimësia e propozuar do të përmirësojë ndikimet negative të automjeteve, si dhe hapësirën vizuale të projektit të propozuar.
- Përgjatë gjatësisë së projektit përkatës do të trajtohen sipas rastit: venddepozitimet për mbeturinat, zonat e përkohshme të ndërtimit, zonat e peizazhit brenda kryqëzimeve, zonat e vogla të fushave të copëzuara, fermat apo pronat e tjera të siguruar për ndërtimin e projektit. Tek pikat e mbetjeve do të mbillet në mënyrë hidraulike. Zonat e përkohshme të ndërtimit do të jenë të rrethuara dhe të integruara vizualisht duke përdorur mbjelljen e bimëve sipas kërkesës.



### *Faza e ndërtimit*

- Kontratat do të jenë të përshtatura për të siguruar praktika të mira të punës, në mënyrë që të zvogëlojnë në nivelin më të ulët të mundshëm çfarëdo ndikim negativ që rrjedh nga ndërtimi dhe për të siguruar që makineritë veprojnë brenda zonës përkatëse të ndërtimit të projektit. Në të gjitha rastet, rregulloret kombëtare do të mbështeten, kur të jetë e mundur me udhëzime, nga praktikat ndërkombëtare.
- Zonat e përkohshme të ndërtimit do të pozicionohen në një mënyrë të tillë që të shmangin ndikimet e mëtejshme në pronat ekzistuese të banimit, pemët, gardhet, kanalet e kullimit etj. Këto zona, përpara ose në fund të kontratës së ndërtimit, do të rikthehen plotësisht në gjendjen e mëparshme.
- Lidhur me shfrytëzimin e materialeve inerte, nxjerrja e zhavorrit nga shtretërit e lumenjve është e kontrolluar në përputhje me ligjin Nr.10 137, datë 11.5.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.
- Përsa i përket zonave të magazinimit, kontraktori do të kërkohet të përgatisë dhe zbatojë një plan të magazinimit të përkohshëm në konsultim me punëdhënësin dhe Agjencinë përkatëse Rajonale të Mjedisit. Ky plan do të hartohet para fillimit të punimeve të dheut. Në këtë plan kontraktori duhet të përcaktojë qartë sasinë e materialit që do të hidhet apo ruhet përkohësisht, para se të fillojnë punimet përfundimtare. Plani gjithashtu do të specifikojë llojin e materialit dhe burimin e tij, p.sh. gërmim hendeqesh, dhë sipërfaqësor etj.
- Me përfundimin e çdo projekti përkatës, shpatet anësore, duke përfshirë gërmimet dhe argjinaturat, bankinat dhe sipërfaqet e tjera të buta do të përgatiten për t’u mbuluar me dhé, dhe do të mbillen apo vishen me bimësi mbrojtëse.

### *Masa zbutëse specifike*

- Në zonat malore, hapësira që kërkon okupimin e tokës do të ruhet në minimum, me qëllim që të shmanget prerja e panevojshme e pemëve.
- Në zonat përgjatë brigjeve lumore, sipërfaqja e tokës së okupuar do të mbahet në minimum, me qëllim shmangien e prerjes së panevojshme të pemëve në këto zona. Distancat që duhen ruajtur në këto raste përcaktohen në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.
- Aty ku është e mundur, argjinaturat e projektit duhet të ulen në minimumin e





mundshëm.

- Pjerrësitë e argjinaturave do të jenë sa më të buta. Mbi gjithë argjinaturat do të shpërndahej dhe ato do të mbillen me bimë që mund të adoptohen në kushtet lokale.
- Në vendet ku rruga kalon pranë pronave private, do të ngrihen mbulesa bimore, me qëllim reduktimin e ndërhyrjes pamore.
- Përsa i përket aktiviteteve minerare, duhet të bëhet sistemimi i karrierve me terraca dhe mbushja e hapësirave të tyre me sterile të stoqeve përkatëse si dhe mbyllja e grykave të puseve të kërkim-shfrytëzimit dhe të galerive.
- Sipërfaqet e relievit, të cilat mund të dëmtohen nga depozitimi i mineralit dhe sterileve duhet që të rehabilitohen menjëherë sapo të jetë kryer ndërhyrja përkatëse.

## 5.2 Mbrojtja e burimeve ujore, habitateve ujore dhe cilësisë së tokës

### 5.2.1 Vlerësimi i ndikimeve në mjedis në nivel objektivash strategjike


*Objektivi Mjedisor 1: Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj*

Ndikimi më i madh gjatë fazës së ndërtimit pritet në zhvillimet e infrastrukturës, sidomos asaj rrugore, të mbetjeve, të qendrave të shërbimeve, etj., ndërkohë që ndikimet nga zhvillime të tjera do të jenë të kufizuara në një territor më të ngushtë lokal. Nuk priten ndikime në ata sektorë ose nën-sektorë ku përqendrimi më i madh i aktiviteteve do të ketë të bëjë me plotësimin e boshllëqeve ligjore dhe të strukturës (aktivitete *soft*) ku gjithë detyrat dhe angazhimet do të jenë të natyrës institucionale dhe organizative.

Përmes okupimit të tokës, ndërtimet në infrastrukturë prodhojnë ndikime të gjera të pakthyeshme, që reflektohen pas zhvillimit si një ndryshim në përdorimin e tokës. Toka bujqësore dhe pyjet do të pësonin shkatërrim të pakthyeshëm në seksionet e marra nga ndërtimet e reja ose ato të rindërtuara mbi seksionet e vjetra. Shpesh, ndërtimet e reja krijojnë edhe fragmentime të tokës bujqësore. Ndikimet afatshkurtër (të riparueshme) që mund të ndodhin gjatë fazës së ndërtimit përfshijnë lidhjet përmes tokave bujqësore ose pyjore, dëmtimet dhe okupimet e tokave ose dëmtimin e produkteve për shkak të afërsisë me sheshet e ndërtimit, ndotjet e tokës etj.

Për shkak të zhvillimeve të reja në infrastrukturë, përdorimi i tokës bujqësore ekzistuese





pëson ndryshim nga ana e pozicionimit të lidhjeve të reja infrastrukturore. Projektet që zbatohen mund të sjellin rënien e përhershme të potencialit dhe prodhimtarisë së tokës bujqësore, që nënkupton humbjen e përhershme të funksionimit të tokës për prodhimtarinë bujqësore. Nëse projektet e infrastrukturës shtrihen edhe përtej territoreve aktuale të zhvillimit, fragmentimi i tokës bujqësore do të rritet dhe kushtet për prodhimtarinë bujqësore do të përkeqësohen edhe më tej.

*Objekti Mjedisor 2: Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore, duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të riciklueshme nga mbetjet që gjenerohen gjatë ndërtimit / rehabilitimit të infrastrukturës*

Aktivitetet ndërtimore në përgjithësi (rindërtime ose të reja) janë burim i prodhimit të sasive të mëdha të mbetjeve, dhe gjithashtu krijojnë presione mbi përdorimin e burimeve natyrore. Mbetjet gjenerohen jo vetëm përkohësisht gjatë fazës së ndërtimit, por edhe në mënyrë të vazhdueshme gjatë fazës operacionale si edhe për efekt të proceseve të mirëmbajtjes së strukturave. Impakti nga gjenerimi i mbetjeve ndërtimore është i përhershëm dhe në mjaft raste i pakthyesëm në lidhje me impaktin ndaj burimeve natyrore. Prandaj, ky impakt negativ ndaj mjedisit duhet të pakësohet me anë të masave për menaxhimin e mbetjeve.

Duke konsideruar mënyrën sesi gjenerohen dhe llojin e strukturës, sasitë e mbetjeve të gjeneruara nga zhvillimet në infrastrukturë në nivel lokal priten të jenë më të lokalizuara dhe më lehtësisht të menaxhueshme.

Shqipëria ka kryer transpozimin e Direktivës 2008/98/EC mbi mbetjet, me anë të VKM-së nr. 175, datë 19.01.2011 siç referohet edhe në “Strategjinë Kombëtare Ndërsëktoriale për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025” dhe në “Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025”. Në këtë aspekt, SKZHI II prezanton si objektivë mjedisore “55 për qind e masës totale të mbetjeve të ripërdoret ose riciklohet deri në 2020”.

Ndërtimet e reja ose zgjerimet e infrastrukturave sipas sektorëve, brenda kuadrit të zbatimit të masave specifike të angazhimeve për secilin nga drejtimet e veprimeve prioritare respektive të Planit, ofrojnë një mundësi ideale gjatë fazës së ndërtimit për ripërdorimin ose përpunimin e materialeve dhe mbetjeve industriale të prodhuara, ku efekti i sinergjisë reflektohet veçanërisht në faktet e mëposhtme:

- Sasi të mëdha mbetjesh mund të përdoren veçanërisht në ndërtimet e rrugëve dhe infrastrukturave të ngjashme ku materialet mbushëse janë mjaft të nevojshme;
- Substanca potenciale toksike të mbetjeve mund të mobilizohen në mënyrë permanente në rast se ato përdoren në mënyrën e duhur;
- Kompozite të reja të ndërtimit shpesh kanë karakteristika më të mira funksio-

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e planit  
të mbrojtjes së  
burimeve ujore



nale në krahasim me ato konvencionale.

*Objektivi Mjedisor 5: Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokësore, ujërat sipërfaqësore dhe burimet e ujit të pijshëm*

Impaktet më të mëdha për arritjen e këtij objektivi mjedisor priten nga zhvillimet e sektorëve kyç të lidhur me ujin, si edhe ato që mund të ndikojnë në cilësinë dhe funksionimin natyror të baseneve ujore (ujësjellës/kanalizimet, vaditja dhe bujqësia e blegtoria në përgjithësi, industria ushqimore dhe përpunuese, shërbimet dhe turizmi, shëndetësia, etj.).

Impaktet mbi ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore dhe burimet e ujit të pijshëm janë karakteristike të periudhës së ndërtimeve ose rindërtimeve të infrastrukturës dhe gjithashtu në vijim të operimit të strukturave edhe më tepër. Kjo, në varësi respektive të sektorëve përkatës në lidhje me nevojën për përdorimin e ujit ose ndërveprimet me burimet dhe trupat natyrore ujqorë. Në shumicën e rasteve këto impakte krijohen si të limituara në mjedisin lokal, megjithatë në mjaft raste ndodh efekti kumulativ i impaktit dhe krijohen ngarkesa ndotjeje të mëdha që ngrihen në nivel rajonal dhe disa herë edhe ndërkuftar. Impaktet ndërtimore të infrastrukturës ngelen në përgjithësi afat-shkurtër dhe të rikthyeshme (rasti p.sh. i cilësisë së ujërave). Pas fazës ndërtimore, impaktet janë kryesisht më pak të përhapura, por të pakthyeshme (rasti p.sh. i impaktit të morfologjisë së vijës ujore natyrore, kushteve hidrologjike, ruajtja e zonave). Impaktet e mësipërme mund të prodhojnë ndryshime në elementët cilësorë për krijimin e statusit ekologjik të ujërave sipërfaqësore, që janë elementët biologjikë, hidromorfologjikë, mbështetës, kimikë dhe fiziko-kimikë dhe në statusin kimik të ujërave. Nëse udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse zbatohen, ndryshimet në elementet cilësorë nuk do të kapërcejnë së tepërmi që të kërcënojnë arritjen e objektivave mjedisore.

Veprimet e sektorëve që ndikojnë në ujërat dhe objektivat mjedisore mbi ujërat përmblihen si më poshtë:

- Pozicionimi i veprave infrastrukturore mund të ndikojë në mënyrë permanente, të drejtpërdrejtë ose indirekt, në situatën hidrologjike në një zonë të caktuar, duke sjellë edhe situatë eko-morfologjike mbi rrjedhën e ujit;
- Rrjedhja e vazhdueshme e substancave të rrezikshme që rezultojnë nga burime të ndryshme ndotëse (impakt në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore);
- Derdhja e substancave të rrezikshme për shkak të ngjarjeve të jashtëzakonshme (impakt potencial direkt, në distancë të largët, deri ndërkuftar, mbi cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore);





- Ndryshimet në regjimin ujqor të ujërave nëntokësore për shkak të ujërave të ndërhyrjeve të veprave infrastrukturore (direkt ose në distancë);
- Pozicionimi i strukturave infrastrukturore në zonat akuifere me ndjeshmëri të lartë ose shumë të lartë mund të kenë impakt negativ mbi burimet ujore ekzistuese dhe potenciale (direkt, indirekt, ndërkuftar);
- Pozicionimi në zonat e burimeve ujore të mbrojtura (ndikim lokal, potencialisht rajonal dhe ndërkuftar).

Shqipëria ka aprovuar Ligjin nr. 111/2012 “Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujqore” dhe “Strategjinë Kombëtare Sektoriale për Furnizimin me Ujq dhe Kanalizimet 2014-2040”, “Strategjinë Ndërsektoriale për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025” dhe “Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025”. Midis të tjerave, këto dokumente përcaktojnë që aktivitetet në ujq dhe tokat anash ujërave mund të kryhen vetëm nëse ato janë bazuar mbi planet e zhvillimit hapësinor dhe nuk mund të pozicionohen diku tjetër pa gjeneruar kosto të larta disproporcionale. Pozicionimi i këtyre aktiviteteve mund të ndikojë thelbësisht mbi statusin ekologjik të rrjedhave ujore dhe të pakësojë zonat e mbajtjes dhe impaktet kumulative mbi biodiversitetin e zonës dhe shërbimet e ekosistemeve të zonës.

#### 5.2.2 Udhëzimet dhe masat zbutëse për të arritur Objektivat Mjedisore 1, 2 dhe 5

##### *Objektivat Mjedisore 1 dhe 2*

Duke zënë një territor të caktuar, ndërtimi i infrastrukturës së parashikuar do të shkaktojë ndikime të gjera të përhershme, të cilat do të pasqyrohen si një ndryshim në strukturën dhe përdorimin e tokës. Prandaj, kur planifikohet integrimi i infrastrukturës së parashikuar në mjedis, duhet të garantohet menaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe mbrojtja e saj.

Aktivitetet në tokën bujqësore dhe pyjore duhet të reduktohen në nivelin më të ulët të mundshëm, dhe duhet t’i jepet prioritet i lartë planifikimit të aktiviteteve në tokë me potencial me të varfër të prodhimit, dhe tokë jashtë zonave të dendura pyjore apo zonave pyjore me funksione të rëndësishme të prodhimit të lëndës së parë të drurit. Me integrimin e infrastrukturës së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndërtimet e reja. Infrastruktura e parashikuar duhet të planifikohet në atë mënyrë që të mos rrisë probabilitetin e rrëshqitjeve të tokës në zonën përreth aktiviteteve.

Për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, do të duhet që projektet specifike të plotësohen me udhëzime për të promovuar riciklimin dhe ripërdorimin



e mbetjeve të ndërtimit në ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës së re, dhe më e rëndësishmja, përdorimin e materialeve të certifikuara të ndërtimit, prodhuar nga riciklimi i post-produkteve ose mbetjeve nga sektorët e tjerë. Kur përdoren materiale ndërtimi për infrastrukturën e re, të cilat nuk janë me origjinë primare natyrore, duhet të merret parasysh fakti se:

- kërkohen sasi më të mëdha të materialeve të ndërtimit, kryesisht si mbushje;
- mobilizohen në mënyrë të përhershme disa substanca të rrezikshme nga materialet e mbetjeve;
- materialet e reja të ndërtimit mund të kenë cilësi më të mira funksionale se materialet me origjinë natyrore.

#### *Masa zbutëse specifike*

- Punimet në dhera të ndotura
  - Gjatë punimeve mund të zbulohen dhera të ndotura. Këto dhera duhen larguar. Pastaj duhet vendosur tokë artificiale me gjeomembranë, argjilë dhe shtresë plehu, mbi të cilën duhet të mbillet bar dhe pemë. Kjo tokë artificiale duhet të mbulojë edhe sipërfaqet e ndotura që nuk do të lëvizin.
  - Të gjithë materialet ndotës (dherat dhe mbetjet) që do të largohen, duhet të depozitohen dhe groposen në vende të caktuara, ku duhet të jenë të izoluar nga ujërat nëntokësorë.
- Ripërdorimi i materialit të gërmuar
  - Materiali, i cili gërmohet nga prerja e seksioneve është një burim natyral dhe përdorimi i tij në bazë të një skeme do të maksimizohet duke përdorur teknika konstruktive të cilat intensifikojnë ngjeshjen e materialeve për t'u përdorur si mbushje inxhinerike.
  - Megjithatë, pashmangshmërisht do të ketë një sasi të konsiderueshme material, i cili, për shkak të veçorive të tij fizike dhe strukturore, nuk është i përshtatshëm për t'u përdorur si mbushje inxhinerike brenda skemës. Ky material mund të jetë i përshtatshëm për aktivitete të tjera, siç është krijimi i peizazhit, ku nuk aplikohen kërkesa kaq të rrepta strukturore. Ripërdorimi i këtij material do të maksimizohet brenda projektit përkatës, dhe çdo material i tepërt do të transportohet jashtë zonës.
  - Materiali i gërmuar i parashikuar për ripërdorim do të trajtohet dhe transportohet në minimum, dhe do të depozitohet në mënyrë të tillë që të mini-



mizojë ndikimet e gërryerjes. Koha midis gërmimit dhe ripërdorimit gjatë periudhës së lagësht duhet të jetë sa më e vogël. Gjatë periudhave të zgjatura me lagështirë, kontraktori duhet të ndërpresë gërmimin dhe vendosjen e materialit për të parandaluar degradimin për shkak të lagështirës.

- Erozioni
  - Duhet ndërmarrë mbrojtja e argjinaturave nga erozioni, me qëllim që të sigurohet stabilizimi i argjinaturave, përfshirë edhe përzgjedhjen me material më pak të erodueshëm, përdorimin e gabioneve dhe gurëve të thyer, si dhe një ngjeshje të mirë, veçanërisht përreth urave dhe tombinove.
  - Mbjellja e pemëve duhet përfunduar sa më shpejt të jetë e mundur, menjëherë pas mbushjes, për të lehtësuar rigjenerimin e një mbulese stabilizuese të tokës. Aty ku është e nevojshme do të kërkohet hapje e kanaleve për të siguruar mbjelljen e suksesshme të bimëve.
  - Aty ku është e nevojshme, zonat e shkarkimit prej strukturave kulluese do të pajisen me gurë të thyer, për të reduktuar erozionin, veçanërisht në rastet kur janë instaluar strukturat e kullimit dhe/ose nivelet e formacioneve të rrugës janë ngritur dhe krijojnë shpate të zhveshura, të cilat kërkojnë stabilizim, përpara fillimit të sezonit të shirave.

#### *Objektivi Mjedisor 5*

Në mënyrë që të kufizohen efektet e presionit që do të ushtrojë infrastruktura e parashikuara në burimet ujore dhe kështu të parandalohen ndikimet negative në cilësinë e ujit (sidomos ujit të pijshëm), duhet të shmangët integrimi hapësinor i infrastrukturës së re në zonat e mbrojtura ujore.

Në integrimin hapësinor të infrastrukturës së re, është e nevojshme që të shmangët integrimi i objekteve në zonat në rrezik nga erozioni. Në rast të ndërhyrjeve në këto zona, duhet të provohet se niveli ekzistues i rrezikut nga përmbytjet në zonën përreth nuk do të rritet. Udhëzimi i lartpërmendur duhet të merret parasysh në mënyrë që të reduktojë presionin e infrastrukturës së re në zonat në rrezik nga erozioni, dhe për të siguruar se niveli i rrezikut në zona të veçanta nuk do të rritet.

Kur planifikohen ndërhyrjet në zonat me rrezik jashtëzakonisht të lartë, shumë të lartë dhe të lartë të akuiferëve, është e nevojshme që të studiohen dhe planifikohen zgjidhjet e duhura teknike për të parandaluar ndikimet negative gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit, si dhe në rastin e ngjarjeve të jashtëzakonshme (p.sh. rrjedhjet e substancave të rrezikshme). Shqyrtimi i udhëzimit të lartpërmendur do të reduktojë probabilitetin e ndotjes nëntokësore, duke siguruar ndikime të kufizuara të presionit të infrastrukturës



së re në ujërat nëntokësore.

Aktivitetet e tilla mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në statusin ekologjik të rrjedhave ujore, të zvogëlojnë basenet mbrojtëse ujore, dhe të prodhojnë ndikime kumulative mbi biodiversitetin e zonës dhe shërbimet e ekosistemeve të zonës. Në rastet e përjashtimit të kësaj mase, kjo duhet të bëhet e mundur vetëm në bazë të argumentimit të ekspertëve, duke deklaruar se elementi i infrastrukturës nuk mund të integrohet në vende të tjera pa shpenzime jashtëzakonisht të larta. Në llogaritjen e këtyre shpenzimeve duhet të përfshihen edhe kostot që vijnë si pasojë e pakësimit të shërbimeve që vijnë nga ekosistemi. Shqyrtimi i udhëzimit të lartpërmendur do të bëjë një llogaritje më të saktë dhe të balancuar të kostove.

Në mënyrë që të zvogëlohen ndjeshëm ndikimet negative në cilësinë e ujërave, duhet të merren masat e mëposhtme:

- të blihen pajisjet e duhura për t'u marrë me derdhjet e substancave të rrezikshme në rrjedhat ujore;
- të sigurohet qarkullimi i rrjedhave ujore dhe kështu të parandalohet eutrofikimi përmes planifikimit të duhur;
- të sistemohen shtretërit e lumenjve me anë të mbjelljes së pemëve përgjatë argjinaturave në formë gardhesh çifte, pas sistemimit të argjinaturave;
- fuqizimi i zbatimit të ligjeve e rregulloreve dhe në rast shkeljeje, zbatimi i penalteteve për subjektet që shfrytëzojnë shtretërit e lumenjve për të marrë materiale, lumenjtë e liqenet për akuakulturë, pa licensat përkatëse, si dhe miratimi i një plani të detajuar shfrytëzimi.

#### *Masa zbutëse specifike*

- Në rast se zbatimi i një projekti specifik do të ndikojë ndjeshëm në ndonjë akui-fer, gjatë hartimit të dokumentacionit të projektit duhet bërë edhe një vlerësim i dëmit ndaj ujërave nëntokësore. Vlerësimi duhet të përfshijë gjithashtu edhe një mënyrë për ta kaluar këtë zonë (si p.sh. ndërtimin e një ure) për të garantuar mbrojtjen e ujit nëntokësor.
- Duhet bërë përcaktimi i zonave më specifike për qëllime të përdorimit të ujërave për HEC-e, rezervuare dhe për bujqësinë.
- Ndikimet e ndotjes do të shmangen duke adoptuar praktikatat më të mira të menaxhimit të punës në terren, siç janë:
  - Nuk do të autorizohet depozitimi i produkteve të dëmshme në një distancë





më pak se 50 m nga brigjet e lumenjve si dhe do të kufizohet pranë rrjedhave të tjera ujore siç janë kanalet kulluese;

- Ambientet e magazinimit duhet të rrethohen dhe mbuloohen për të parandaluar derdhje të ndryshme;
- Kanalet anësore do të hapen përpara ndërtimit, për të parandaluar derdhjen e rrjedhjeve të rrugës gjatë ndërtimit, në lumë, apo kanalet kulluese;
- Hedhja e betonit duhet të bëhet duke përdorur armaturën e duhur, për të shmangur ndotjen;
- Kur derdhjet nga kantieri duhet të shkarkohen në një lumë, norma e derdhjeve duhet të kontrollohet, në mënyrë që ajo të mos shkaktojë përmytje lokale në rrjedhën e ujit, apo erozion;
- Në rast se ka derdhje serioze të kimikateve apo lëngjeve gjatë ndërtimit, kontraktori duhet të hartojë një program të masave për ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore;
- Ndërtimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve të lëngëta urbane dhe industriale për të zvogëluar sasinë e lëndëve ndotëse në mjediset ujore, tokësore dhe ajrore;
- Marrja e mostrave të ujërave nëntokësore duhet të bëjë *in situ* matjen e pH, turbullirës dhe përcjellshmërisë elektrike. Të gjitha veprimet e kërkuara dhe, nëse nevojiten, analizat duhet të bëhen në përputhje me legjislacionin shqiptar.


### 5.3 Mbrojtja e natyrës (biodiversiteti dhe zgjerimi i hapësirave të gjelbra urbane)

#### 5.3.1 Vlerësimi i ndikimeve në mjedis në nivel objektivash strategjike

Tropoja është pjesë e rajonit Kukës-Has-Tropojë dhe është një nga portat ndërkufitare që lidh Shqipërinë me Kosovën për shkak të riaktivizimit të aksit Tropojë-Gjakovë dhe Kukës-Prizren. Një pjesë e zonës natyrore e turistike të Alpeve Shqiptare aksesohet nga këto porta. Bajram Curri, qendra administrative e bashkisë së Tropojës, ndodhet rreth 240 km larg Tiranës dhe 120 km larg Prishtinës. Ndërtimi i Rrugës së Kombit (Shqipëri) dhe autostradës “Ibrahim Rugova” (Kosovë) e ka lehtësuar mjaft komunikimin e Tropojës me Tiranën dhe Prishtinën.

Zona përbën një rajon unik natyror me bukuri të rrallë dhe vlerë ekologjike, dhe një





strehë të burimeve të lumenjve kryesorë. Ato përbëjnë një mjedis kryesor ekologjik, ekonomik, kulturor, argëtues dhe dinamik në Shqipëri. Tropoja është një rezervuar i rëndësishëm për biodiversitetin dhe habitatet. Në këtë zonë gjenden një rezervë strikte natyrore, një park kombëtar dhe një park rajonal, si dhe një numër monumentesh natyrore. Kjo shumëllojshmëri e madhe e habitateve, së bashku me treguesit e kushteve klimatike mesdhetare malore, kanë përpunuar në shekuj një gamë mjaft të lartë të diversitetit të bimësisë natyrore në zonë.

Çështja e mbrojtjes dhe zgjerimit të hapësirave të gjelbra urbane lidhet me dy objektiva mjedisore: OM 12 "Garantimi i ruajtjes së peizazheve të veçanta dhe zonave peizazhistike me veçori dalluese në nivel lokal e kombëtar dhe krijimi i një imazhi peizazhi me cilësi të lartë" dhe OM 6 "Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit".

Vlerësimi i ndikimeve në mjedis dhe masat e propozuara në kuadër të OM 12 janë trajtuar në seksionin e Peizazhit. Në vijim paraqitet vlerësimi i ndikimeve në mjedis në kuadër të OM 6 dhe që lidhet me hapësirat e gjelbra urbane.

Ndikimet që kanë të bëjnë me fragmentimin e habitateve dhe biodiversitetin janë karakteristike gjatë fazës së ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës dhe më tej. Ato vërehen më tepër në mjedisin lokal, ndërsa në rastin e projekteve me shtrirje të gjerë impaktet ndihen edhe në nivelin rajonal dhe përgjatë kufijve (p.sh. në migrimin e karnivorëve të mëdhenj, rrugët e migrimit të shpendëve, vijat ujore të kalimit ndërkuftar etj.). Gjatë ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës, impaktet janë kryesisht afat-shkurtër dhe të kthyeshmë (p.sh. ndotje nga zhurmat e sheshit të ndërtimit, kafshët largohen prej makinerve të ndërtimit, etj.). Pas ndërtimit, impaktet janë kryesisht permanente dhe të pakthyeshme për shkak të ndryshimeve në përdorimin e tokës (p.sh. ndërprerja e rrugëve të migrimit, rritja e zhurmës nga strukturat e zhvilluara në vend, pengesa në mjedis-linja elektrike, etj.).

Kjo linjë e ndërhyrjes bazohet në mënyrë të veçantë në Sistemin Urban dhe Strategjinë e Vendbanimeve dhe ka si fokus zhvillimin policentrik të bazuar në forcimin e hierarkisë së sistemeve urbane. Në veçanti tenton që të përmirësojë cilësinë urbane në aspektin fizik, me ndërhyrje kualifikimi dhe përmirësimi të tesutit urban, si dhe përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së shërbimeve bazë dhe në këtë mënyrë rritjen e numrit të vendbanimeve që aksesojnë shërbimet themelore të tilla si transporti, ujësjellësi, kanalizimet. Kjo linjë veprimi gjithashtu ndikon në temën e banesave informale dhe sociale.

Cilësia urbane dhe rajonale i referohet kryesisht cilësisë së jetës së atyre që banojnë në territorin e bashkisë, që do të thotë se i kushton vëmendje pjesëve të ndryshme të territorit dhe marrëdhënieve mes sistemeve të ndryshme që e përbëjnë atë: të maleve dhe luginave, zonave urbane dhe fshatrave, poleve qendrore dhe zonave më marginale. Qendrat kryesore dhe fshatrat më të vegjël nga të cilët karakterizohet territori duhet të

(në faqen paraardhëse)  
Harta e planit të mbrojtjes së pasurisë natyrore



bëhen vende të socializimit dhe të ofrimit të shërbimeve bazë. Duhet vlerësuar rrugët dhe vendet publike si vende takimi dhe diskutimi.

Dimensionet e cilësisë së jetës janë të lidhura ngushtë me komponentët e tjerë si ata ekonomikë, infrastrukturorë, socialë dhe mjedisorë. Cilësia urbane dhe mjedisore nuk lidhet vetëm me aspektet materiale/fizike të qytetit dhe të territorit, por përfshin të gjithë sferën jomateriale të lidhur me mirëqenien lokale. Ajo përshtatet në këtë aspekt me masën e ndryshimeve demografike të lidhura veçanërisht me probleme të mëdha sociale, me shpopullimin e territorit dhe shërbimet e shpërndara me karakter inkluziv dhe social. Në të njëjtën kohë merr rol qendror edhe ofrimi i shërbimeve dhe hapësirave për të rinjtë, me qëllim jo vetëm të ofrojë mundësi për brezin e ri, por edhe për të jetuar dhe shijuar territorin në mënyrë të përgjegjshme, të vetëdijshme dhe të motivuar.

Në sintezë mund të themi që tema i përket:

- Hapësirave urbane, në kuptimin e evolucionit urban, të gjendjes së ndërtesave, pajisjeve dhe sistemit të parkimit, arredimit urban dhe gjelbërimit publik;
- Shërbimeve individuale (kopshtet e fëmijëve, kujdesin për njerëzit, rrjetet e kujdesit) dhe për kohën e lirë.

Treguesit kyç janë:

- Forcimi i rolit të bashkisë si qendër kryesore e funksioneve;
- Fuqizimi i lokaliteteve kryesore për të përmbushur kërkesën për aksesibilitetin e shërbimeve;
- Kualifikimi i shërbimeve bazë në lokalitetet më të vogla / fshatra.

### 5.3.2 Ripyllëzimi

Përsa i përket ndërhyrjeve të ripyllëzimit, duhet theksuar se rëndësia e këtij procesi është shumëplanëshe, si në nivel global, ashtu dhe rajonal dhe lokal. Mbjellja e pemëve të reja ndihmon në uljen e sasisë së CO<sub>2</sub> në ajër. Dioksidi i karbonit është ndër kontribuesit kryesorë në ndryshimet klimatike. Pyllëzimi është një strategji efektive zbutëse për të luftuar ngrohjen globale. Përveç përfitimeve në fushën e klimës, ripyllëzimi ndihmon në mbrojtjen e specieve të rëndësishme të kafshëve. Pyllëzimi ndihmon për të rindërtuar habitatet dhe për ndalimin e degradimit të tyre, duke eliminuar kështu kërcenimet kryesore për shëndetin e specieve.

Shpyllëzimi dëmton tokën dhe habitatet përmes erozionit. Pyllëzimi ndihmon në rigjenerimin e dëmtimeve prej erozionit. Pyllëzimi mund të ndihmojë për të rehabilituar



atë që erozioni ka dëmtuar. Përveç kësaj, pellgjet ujëmbledhës të zonës, të cilët janë dëmtuar nga shpyllëzimi mund të rigjenerohen nëpërmjet ripyllëzimit. Këta pellgje ujëmbledhës rajonalë janë një burim i rëndësishëm për zhvillimin e njeriut.

Pyllëzimi gjithashtu ndihmon banorët në sigurimin e ushqimit, si dhe përdorimin dhe disponueshmërinë e ujit. Rigjenerimi i pyjeve sjell përfitime për nivelet kimike, sociale dhe biologjike të të gjithë ekosistemit. Pyllëzimi ndihmon edhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Kështu që ai është i dobishëm jo vetëm për mjedisin, por edhe për zhvillimin ekonomik.

### 5.3.3 Brezi i Gjelbër Evropian

Përgjatë vijës kufitare të bashkisë është lokalizuar edhe Brezi i Gjelbër Evropian. Ky brez është një lidhje shumë e rëndësishme ekologjike, një nga shtyllat e rrjetit panevropian ekologjik, detajet e të cilit janë të bazuara në praninë e zonave të mëdha natyrore që u zhvilluan në mungesë të aktivitetit të njeriut.

Brezi i Gjelbër i Shqipërisë konsiderohet i gjithë kufiri shtetëror tokësor prej 720 km. Ky konstatim mbështetet në faktin se Shqipëria në të kaluarën ka qenë një vend i izoluar dhe në zonën kufitare nuk lejoheshin aktivite për shfrytëzimin e burimeve natyrore. Në këndvështrimin e larmisë biologjike vargmalet tona kufitare kanë shërbyer si vendstrehim i shumë llojeve të faunës dhe florës Ballkanike. Duke qënë e pamundur të mbrohet i gjithë kufiri, si Brez i Gjelbër i Shqipërisë shërben një rrjet zonash të mbrojtura natyrore ku bëjnë pjesë:

- në krahinën veriore: Liqeni i Shkodrës, Lugina e Valbonës, Lumi i Gashit, Vargmali Korab-Koritnik;
- në krahinën qendrore: Malet Shebenik-Jabllanicë;
- në krahinën jugore: rajoni Ohër-Prespë, Bredhi i Sotirës dhe zona e Butrintit në skajin më jugor.


### 5.3.4 Udhëzimet dhe masat zbutëse për mbrojtjen e natyrës (biodiversiteti dhe zgjerimi i hapësirave të gjelbra urbane)

Për të ruajtur në mënyrë të përhershme mjedisin natyror dhe biodiversitetin, duhet të merren parasysh masat e mëposhtme:

- Krijimi dhe përmirësimi i korridoreve ekologjike përgjatë luginave dhe përgjatë zonave të mbrojtura; kjo konsiston në rivendosjen e lidhjeve ekologjike midis







\*In accordance with UNSCR 1244 and opinion of ICJ.

© European Green Belt Initiative/Coordination Group



parqeve të shumta dhe zonave të mbrojtura, brenda kontekstit të një procesi më të gjerë të rrjetit ekologjik rajonal, duke filluar me hapësirat e mëdha të gjelbra dhe blu;

- Shfrytëzimi i infrastrukturës ekzistuese ka përparësi mbi ndërtimin e infrastrukturës së re;
- Në integrimin hapësinor të infrastrukturës së parashikuar, duhet të shmangët ndërhyrja e projekteve në zonat me karakteristika të çmuara natyrore, në zonat e mbrojtura dhe në zonat e Natura 2000;
- Krijimi i një sistemi monitorimi mjedisor, i cili konsiston në krijimin e një baze të dhënash për të monitoruar rrezikun e paqëndrueshmërisë dhe ndryshimeve klimatike, por edhe konsumin e tokave bujqësore dhe të shpyllëzimit, ose gjuetisë si dhe organizimin e fushatave informuese për qytetarët;
- Krijimi i një zone mbrojtëse për të limituar fenomenin e shpyllëzimit, gjë që synon ruajtjen dhe përmirësimin e lidhjeve ekologjike dhe biodiversitetit, kufizimin e shfrytëzimit të pyjeve dhe vendosjen e masave, rregullimin e aktiviteteve të autorizuara, zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe aktiviteteve edukative e kërkimore;
- Krijimi i zonave buferike përreth zonave të rrezikuara, për ato aktivitete që zhvillohen pranë zonave të mbrojtura. Për shembull, në rastin e rrjedhave ujore, qëllimi i zonës buferike do të jetë për të mbrojtur lumin nga burime të ndryshme të ndotjes (të tilla si zhavorret, groposje të mbeturinave komunale dhe elemente të ndotjes bujqësore ose industriale), por edhe për të identifikuar zonat e rrezikshme për njerëzit për shkak të përmbytjeve, etj.;
- Rritja e cilësisë së menaxhimit të zonave të mbrojtura nga stafi lokal.

Në kuadrin e ndërhyrjeve të ripyllëzimit, Plani parashikon disa veprime prioritare dhe plane/programme si më poshtë:

- Shtimi i ekosistemeve prodhuese
  - Projekt pyllëzimi për mbrojtjen dhe zgjerimin e mjedisit natyror të gështenjës në Bujan
- Parandalimi i erozionit
  - Ripyllëzimi i zonave në rrezik në bashkinë e Tropojës me varietete vendase
- Masa parandaluese mjedisore për industrinë minerare
  - Ripërdorimi i minierave të braktisura për ripyllëzim me pemë për indus-

(në faqen  
paraardhëse)  
Brez i Gjelbër  
Evropian





trinë e ngrohjes (Rrogam, Kam, Zogaj, Valbonë)

- Shtimi i tokës bujqësore dhe bagëtime
- Mbështetje për programin e ripyllëzimit dhe për shtimin e numrit të bagëtime për fermat e vogla

#### 5.4 Përmirësimi i Cilësisë së Ajrit

##### 5.4.1 Vlerësimi i ndikimeve në mjedis në nivel objektivash strategjike

*Objektivi Mjedisor 3: Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimalë të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferikë*

Shkarkimet e ndotësve janë karakteristike gjatë fazës së ndërtimit të infrastrukturës dhe fazës së operimit në një sërë aktiviteteve nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë, por në lidhje direkte me Planin, ndikimi kryesor vjen nga sektori i transportit.

Gjatë fazës së ndërtimit ose të rindërtimit të infrastrukturës, shkarkimi i ndotësve krijon impakt afat-shkurtër në mjedis, kështu që shumica e efekteve të tyre janë të kthyeshme.

Gjatë fazës së operimit të infrastrukturës, shumica e shkarkimeve janë të pranishme si në ajër edhe në ujë e tokë, në varësi të proceseve të aktiviteteve që krijohen nga operimi i infrastrukturës përkatëse.

Zbatimi i masave specifike që synojnë arritjen e qëllimeve të këtij PPV pritet të kenë një impakt pozitiv. Në plan afatgjatë, përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese do të ketë ndikim pozitiv për shkak të pakësimit të shkarkimeve të ndotësve, së pari për shkak të përmirësimit të infrastrukturës rrugore, duke mundur një kohë më të shkurtër të udhëtimit, përmirësimin e trafikut (bllokimeve/ngjeshjeve), duke çliruar më pak gazra dhe duke pakësuar ndotësit e shkarkuar.

Megjithatë, ekziston edhe rreziku që përmirësimi i mëtejshëm i rrjetit rrugor, veçanërisht i atij ndërkufitar, do të prodhojë të ashtuquajturën *kërkesë të detyruar* për shkak të pakësimit të ngjeshjes, e cila nga ana tjetër mund të rrisë sasinë e shkarkimeve të ndotësve, veçanërisht në zona ku nuk kishte ndotje para se të zbatoheshin masat e Planit. Gjithsesi, impaktet negative që mund të vijnë me përmirësimin e rrjetit rrugor mund të pakësohen dhe madje të parandalohen nëpërmjet marrjes njëkohësisht të masave të përgjithshme për promovimin e përdorimit të rrjetit publik të transportit të pasagjerëve dhe lëvizjes me biçikleta. Të dyja këto mënyra transporti parashikohen të përmirësohen nga ky plan.



Rinovimi i mjeteve motorike kontribuon së tepërmi në pakësimin e shkarkuesve ndotës, si edhe zhvillimi i standardeve sipas tipave të aprovuar për mjetet siguron që të arrihen nivelet e synuara për shumicën e shkarkimeve të ndotësve nga transporti. Projektet që lidhen me promovimin e transportit publik do të kontribuojnë gjithashtu në pakësimin e shkarkimeve të ndotësve.

Plani nuk mund të adresojë specifikisht promovimin e rinovimit të mjeteve, por me anë të të gjithë programeve/projekteve, veçanërisht atyre që promovojnë transportin publik të pasagjerëve, ka ndikim pozitiv në mjedis dhe kontribuon qenësisht në arritjen e synimeve për nivelet e shkarkimeve kombëtare.

Përsa i takon shkarkimeve të grimcave pezull në ajër, ato do të pësojnë rritje të përkohshme në zonat ku do të zbatohen masat e rindërtimit të infrastrukturës sipas sektorëve (impakte të kthyeshme). Në përputhje me rregullat që rregullojnë masat për pakësimin e shkarkimeve të grimcave nga sheshet e ndërtimit, zbatimi i punimeve në ndërtim garanton që rritjet e përkohshme lokale të niveleve të ndotësve të mjedisit në ajër të jenë ende të pranueshme për mjedisin dhe njerëzit.

#### 5.4.2 Udhëzimet dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 3

Në planifikimin e politikave dhe aktiviteteve të Planit në zonat e ndotjes së ajrit, duhet të merren parasysh objektivat e SKZHI II dhe standardet e lejuara të emetimeve, të përcaktuara nga BE, OBSH dhe legjislacioni përkatës shqiptar.

Duhet të përgatitet një program i detajuar i masave për zvogëlimin e ndotjes me grimca  $PM_{10}$  dhe  $PM_{2.5}$  për zonat problematike. Programi do të duhet të vërehet gjatë planifikimit të politikave dhe projekteve specifike të Planit për zonat problematike, në një shkallë më të gjerë. Prioritet, në procedurën e përzgjedhjes, duhet t'u jepet varianteve të cilat ofrojnë përmirësimin më të madh të cilësisë së ajrit.

Gjatë përgatitjes së politikave dhe projekteve të reja në infrastrukturë, duhet të respektohen udhëzimet dhe masat në vijim, në mënyrë që të arrihen objektivat e reduktimit të ndotjes së ajrit në zonat e ndikimit të aktiviteteve përkatëse:

- Cilësia e ajrit - komuniteti
  - Monitorim të rasteve të sëmundjeve dhe shkaktarëve;
  - Përcaktimi i zonave urbane të reja me cilësi të lartë ajri për popullsinë;
  - Dizenjim me kushtet dhe kriteret e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, mirëmbajtje dhe zëvendësim i materialeve rezistente ndaj ndryshimit të temperaturave dhe lagështisë;



- Përdorim i mjeteve të transportit publik me emetime të gazeve në nivele të ulëta ose me filtra ajri të reduktimit maksimal.
- Cilësia e ajrit - ekosistemet
  - Identifikimi dhe monitorimi i burimeve të gazeve që shkaktojnë shiun acid;
  - Komunikim ndërkuftar institucional për të shmangur incidentet mjedisore në qarkullimin e ajrit si dhe përcaktimi i masave konkrete të veprimit në raste të incidenteve ndërkuftare;
  - Përcaktimi i kriterëve të tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës dhe qëllimit të përdorimit të saj që në fazat e projektimit;
  - Shtimi i sipërfaqeve me pyje dhe bimësi;
  - Strukturimi i kërkesave për lëndë drusore;
  - Përcaktimi i masave të emergjencave në rastet e aksidenteve industriale për zvogëlimin e ndikimeve në mjedis dhe në cilësinë e tij.

#### *Masa zbutëse specifike*

- Monitorimi i cilësisë së ajrit në të gjithë territorin e zonës duke vendosur stacione automatike të monitorimit si në zonat urbane ashtu dhe ato rurale;
- Koordinimi midis institucioneve qendrore dhe vendore për vlerësimin e kushteve mjedisore që lidhen me cilësinë e ajrit dhe me masat ndaj ndryshimeve klimatike.

Gjatë fazës së ndërtimit, masat më të zakonshme specifike të rekomanduara në punimet e infrastrukturës rrugore konsistojnë në:

- Ngjeshjen e tokës së gërmuar, lagjen e karrexhatës së rrugës, përdorimin e ndarëseve të rrugëve për të kufizuar daljen e pluhurit, larjen e rrotave të makinerive që dalin nga kantieri (gjë që bëhet përditë) etj.;
- Kufizimin e shpejtësisë së makinerive në rrugë.

Ulja e ndikimit nga ndërtimi përfshin gjithashtu:

- vendodhjen potenciale të hapësirave që kërkohen për instalimin e kantierit, magazinim si dhe zonat e stabilizimit të tokës;
- rrugët e transportit që përdoren për shpërndarjen e materialeve.

Përsa i përket fazës së shfrytëzimit të infrastrukturës, propozohen masat specifike të



mëposhtme:

- kontrolli i kufijve të shpejtësisë së automjeteve gjatë sezonit me nivelin më të lartë të ndotjes së ajrit në qendrat kryesore urbane;
- mirëmbajtja e rregullt e sipërfaqeve rrugore për të pakësuar sa më shumë që të jetë e mundur ringritjen e pezullive.


## 5.5 Hotspot-e

Përsa i përket trajtimit të zonave të identifikuara si pikat hotspot në plan, ky seksion parashikon prezantimin e dy opsioneve për zgjidhjen e problemeve të identifikuara në lidhje me këtë të fundit. Në rastin specifik të Bashkisë Tropojë nuk janë identifikuar zona hotspot.

Pavarësisht këtij fakti, në zonë janë identifikuar dy *elemente* të territorit, të cilët janë: zonat/hapësirat e ish-minierave dhe ish-venddepozitimet e hedhjeve, të cilat vlerësohet se kanë ndikim në cilësinë e ujrave dhe të tokave përreth. Ndërkohë që ndikimet përkatëse të këtyre elementeve janë trajtuar në kapitujt përkatës të VSM, Plani i Përgjithshëm Vendor parashikon veprimet strategjike si më poshtë:


- Masa parandaluese mjedisore për industrinë minerare
  - Programe për menaxhimin mjedisor të veprimtarive minerare;
  - Programe për zhvillimin e mënyrave të rigjenerimit të hapësirave të ish-minierave;
  - Ripërdorimi i minierave të braktisura për rryllëzim me pemë për industrinë e ngrohjes (Rrogam, Kam, Zogaj, Valbonë).
- Rehabilitimi i ish-venddepozitimeve
  - Programe për zhvillimin e mënyrave për rigjenerimin e ish-venddepozitimeve;
  - Ripërdorimi i ish-venddepozitimeve nëpërmjet bio-bonifikimit (prodhimin të biomasës) (Bajram Curri, Jaho Salihi (Cërmicë), Tropojë, Zona B (Fierzë), Lekbibaj, Pac, Valbonë).





**6 RUAJTJA E ASETIVE KULTURORE**







## 6.1 Parashikime për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

Në bashkinë e Tropojës ka disa monumente që njihen si pjesë e trashëgimisë kulturore. Duke qenë tashmë të njohur si të tillë, bashkia duhet të ndërmarrë shpejt ato veprime të nevojshme për ruajtjen e tyre në bashkëpunim me institucionet përkatëse në nivel ndërkombëtar, kombëtar dhe rajonal. Kjo trashëgimi është përgjithësisht në kushte shumë të këqija dhe rehabilitimi, ruajtja në të ardhmen dhe arritshmëria publike njohen nga PPV-ja si një hap i domosdoshëm për të rritur potencialin turistik të rajonit dhe për të garantuar ruajtjen e historisë dhe identitetit lokal. Përveç elementeve të njohura ligjërisht të trashëgimisë kulturore ekzistojnë edhe struktura të tjera me rëndësi për kujtesën historike të rajonit si Varreza e Dëshmorëve në Bujan dhe shumë Memoriale të Luftës që përhapen në të gjithë territorin. Në të dy rastet, projektet e rehabilitimit duhet të kryhen në bashkëpunim me institucionet dhe agjencitë që merren me proceset e rehabilitimit dhe ruajtjes pasi është e rëndësishme që një proces i tillë të kryhet nga teknikë dhe punëtorë me përvojë. Hapat që duhet të ndërmerren gjatë procesit mund të përmbliken si më poshtë:

- Hartimi i projektit të rehabilitimit bazuar në një rilevim dhe studim të kujdesshëm të monumenteve, duke përfshirë planin e mirëmbajtjes së tyre;
- Bazuar në projektin e rehabilitimit të hartuar, duhet të kërkohet bashkëpunimi i mundshëm dhe mundësitë e financimit për të garantuar realizueshmërinë e punës;
- Pasi të sigurohet financimi, projekti i rehabilitimit duhet të tenderohet dhe vetëm operatorët e specializuar duhet të pranohen të marrin pjesë, nën mbikëqyrjen e pavarur të ekspertëve të emëruar;
- Pas fazës së ndërtimit / rehabilitimit, bashkia dhe / ose grupet e tjerë të interesit duhet të garantojnë që mirëmbajtja e nevojshme të kryhet gjatë viteve të ardhshme.

Përveç kësaj, pritet që Bashkia e Tropojës të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për të zgjeruar listën e monumenteve zyrtare që janë pjesë e trashëgimisë kulturore. Ka disa monumente të tjera që aktualisht nuk janë të njohura zyrtarisht si të tilla dhe ato duhet të ruhen dhe të rehabilitohen në mënyrë të barabartë, pasi në mënyrë të barabartë përbëjnë mjedisin kulturor të rajonit. PPV rekomandon që hapat e nevojshëm për të arritur njohjen zyrtare me institucionet përkatëse kombëtare (p.sh. Ministria e Kulturës Shqiptare) të ndërmerren menjëherë. Ndër monumentet për të cilat përfshirja në “listën zyrtare” konsiderohet e rëndësishme, vlen të përmenden:

- Institucionet kulturore në Bajram Curri, të tilla si Kinemaja, Biblioteka Publike dhe Qendra Kulturore;
- Disa kulla të përhapura në të gjithë territorin e Tropojës;
- Mullinjtë me ujë.

(në faqen paraardhëse)  
Harta e mbrojtjes së pasurisë kulturore



## 6.2 Ruajtja dhe përmirësimi i monumenteve kulturore

Procesi i ruajtjes dhe përmirësimit të monumenteve kulturore që nuk njihen zyrtarisht si të tillë nuk është shumë i ndryshëm nga ai i hartuar në paragrafin e mësipërm. Megjithatë ka disa dallime që janë të motivuara së pari nga statusi i ndryshëm i këtyre monumenteve dhe i dyti nga përkufizimi më i gjerë që brenda këtij Plani i është caktuar posaçërisht termi “monument kulturor”.

Sa i përket çështjes së parë, pritet që rehabilitimi dhe ruajtja e monumenteve të panjohura zyrtarisht si Kulla e Thepit ose Mulliri në Valbonë do të kërkojnë përpjekje në fazën e krijimit të një projekti të përshtatshëm rehabilitimi. Duke pasur parasysh statusin e paqartë juridik të këtyre monumenteve dhe kushteve të ndryshme të pronësisë (një përzjerje ndërmjet pronësisë publike dhe private), duhet të kërkohet bashkëpunimi ndërmjet palëve private dhe publike dhe bashkia duhet të veprojë si garanci që ruajtja dhe rehabilitimi i këtyre strukturave të arrihet në përputhje me planet e shfrytëzimit të ardhshëm dhe interesin e mundshëm publik. Përveç kësaj, programi për rehabilitimin/ruajtjen e monumenteve kulturore private mund të nisët përmes p.sh. stimuljeve fiskale dhe/ose bashkë-pagesës së shpenzimeve të rinovimit. Projektet në këtë drejtim duhet të fillojnë nga Bashkia Tropojë në bashkëpunim me institucionet kombëtare/ndërkombëtare.

Procesi i ruajtjes dhe rehabilitimit rrjedhimisht bazohet në fazat e mëposhtme:

- Me nismën private ose publike, hartimi i projektit të rehabilitimit bazuar në një rievitim dhe studim të kujdesshëm të monumenteve të përzgjedhura, duke përfshirë planin e mirëmbajtjes;
- Bazuar në projektin e rehabilitimit të detajeve, duhet të kërkohet bashkëpunimi i mundshëm dhe mundësitë e financimit me qëllim që të sigurohet realizueshmëria e procesit, duke përfshirë aplikimin për stimuj dhe/ose forma të bashkë-pagesës;
- Pasi të sigurohet financimi, projekti i rehabilitimit duhet të tenderohet tek operatorë të specializuar nën mbikëqyrjen e ekspertëve të caktuar;

Përsa i përket çështjes së dytë, ndërsa termi “monument kulturor” tradicionalisht përdoret për të përcaktuar një objekt të tillë si një vepër arti, arkitektonike ose një monument, Plani e shtrin këtë përkufizim edhe në fshatrat e përzgjedhura tradicionale dhe tipologjitë e tyre hapësinore. Për këtë arsye, ruajtja dhe përmirësimi i monumentit kulturor nuk mund të arrihet vetëm përmes projekteve të rehabilitimit siç është përmendur më parë, por edhe përmes krijimit të politikave, normave dhe rregulloreve që do të garantojnë zgjerimin e kësaj trashëgimie specifike, ruajtjen dhe shfrytëzimin e ardhshëm të saj. Plani jo vetëm që shoqërohet nga një sërë projektesh që synojnë përmirësimin e kushteve të jetesës në fshatrat historikë (të siguruarit se ato do të vazhdojnë të banohen është kushti i parë për ruajtjen e tyre), por gjithashtu shoqërohet me një sërë rregullash vendore që specifikojnë



parametra, materiale ndërtimi, teknika dhe specifika të tjera të rëndësishme në lidhje me ndërtimin e strukturave të reja, rehabilitimin e atyre të vjetra dhe të gjitha ato punime që ndikojnë në tiparet hapësinore të fshatit.






5.

76

**7 ZHVILLIMI EKONOMIK**





## 7.1 Zhvillimi ekonomik dhe urban

Kemi ndarë çdo njësi vendore në zona të ndryshme ekonomike. Kufiri i çdo zone është përcaktuar duke marrë në konsideratë morfologjinë e territorit, rrjetin rrugor të propozuar dhe tipet e aktiviteteve kryesore ekonomike.

Aktivitetet e listuara u referohen sektorëve të ndryshëm ekonomikë:

- Bujqësisë;
- Turizmit;
- Ekstraktimit (miniera dhe gërmim);
- Burimeve të rinovueshme (dru zjarri).

### Bajram Curri

Zhvillimi urban i qendrës kryesore: Konsolidim dhe zgjerim i qytetit ekzistues.

#### ZE-BC01

(Për shkak të madhësisë së tij, të gjitha njësitë vendore të Bajram Currit janë konsideruar si një zone e vetme ekonomike)

Veprimtaritë	Bajram Curri: <ul style="list-style-type: none"><li>• Thertore, Kolektorë të gështenjave, Qendër certifikimi, Treg lokal, Treg shumice</li><li>• Qendër turistike, Akomodim turistësh</li></ul>
--------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
zhvillimit  
ekonomik dhe  
urban





## Margegaj

Zhvillimi urban i qendrës kryesore: Konsolidim.

### ZE-MA01

(Koçanaj-Margegaj-Shoshan)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	<p>Margegaj:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Pikë shpërndarjeje</li></ul> <p>Koçanaj:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor i drurëve frutorë, Baxho</li></ul> <p>Shoshan:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Infrastruktura turistike</li></ul>
--------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

### ZE-MA02

(Rrogam-Valbonë-Çerem-Dragobi)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt turizmit

Veprimtaritë	<p>Valbonë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Infrastruktura turistike, Akomodime</li></ul> <p>Çerem:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Infrastruktura turistike</li></ul> <p>Dragobi:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Pikë shpërndarjeje, Thertore</li><li>• Infrastruktura turistike</li></ul>
--------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------



## **Tropojë**

Zhvillimi urban i qendrës kryesore: Konsolidim.

### **ZE-TR01**

(Shumicë-Ahmataj-Tropojë-Kasaj-Viçidol)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	Shumicë-Ahmataj: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor, Baxho</li></ul> Tropojë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor i drurëve frutorë, Treg lokal</li><li>• Infrastruktura turistike (Hyrje për në park)</li></ul>
--------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

### **ZE-TR02**

(Begaj-Babinë-Kojel)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	Babinë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor i drurëve frutorë</li></ul>
--------------	--------------------------------------------------------------------------------------

### **ZE-TR03**

(Shkëlzen-Kërmajë-Myhejan-Kovaç)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë; me rëndësi të veçantë është prodhimi i gështenjave dhe bimëve mjekësore

Veprimtaritë	Shkëlzen: <ul style="list-style-type: none"><li>• Infrastruktura turistike (Hyrje për në park)</li></ul> Kërmajë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor gështenjash, Baxho</li></ul> Kovaç: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor bimësh mjekësore</li></ul>
--------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------



### **ZE-TR04**

(Buçaj-Papaj-Gegaj)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	Buçaj: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor, Baxho</li><li>• Infrastruktura turistike (Hyrje për në park)</li></ul>
--------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------



## Llugaj

Zhvillimi urban i qendrës kryesore: Konsolidim.

### ZE-LU01

(Bukovë-Llugaj-Rragam-Sopot)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë, me prezencë të minierave në zonën e Sopotit

Veprimtaritë	Llugaj: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor, Baxho, Treg lokal, Shkollë bujqësore</li><li>• Infrastruktura turistike (pikë informacioni)</li></ul>
--------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

### ZE-LU02

(Luzhë)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	Llugaj: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor, Baxho</li></ul>
--------------	---------------------------------------------------------------------------

### ZE-LU03

(Cernicë-Paqë)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	Cernicë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor, Baxho, Pikë shpërndarjeje</li></ul>
--------------	------------------------------------------------------------------------------------------------



## **Bujan**

Zhvillimi urban i qendrës kryesore: Konsolidim.

### ZE-BU01

(Bllatë-Dojan-Fushë Lumë-Bujan)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	Dojan: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor i drurëve frutorë, Baxho</li></ul> Bujan: <ul style="list-style-type: none"><li>• Pikë shpërndarjeje</li></ul>
--------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

### ZE-BU02

(Markaj-Rosujë-Gri e re-Lëkurtaç-Selimaj-Gri)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë, me rëndësi të veçantë është prodhimi i gështenjave

Veprimtaritë	Markaj: <ul style="list-style-type: none"><li>• Infrastruktura turistike (Hyrje për në park)</li></ul> Gri: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor gështenjash</li></ul>
--------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------



## Bytyç

Zhvillimi urban i qendrës kryesore: Konsolidim.

### ZE-BY01

(Pac-Vlad-Zherkë)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë me prezencë të minierave

Veprimtaritë	Pac: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor, Baxho, Treg lokal</li></ul>
--------------	------------------------------------------------------------------------------------

### ZE-BY02

(Kam Qytet-Kepenek-Zogaj-Prush)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë dhe ekstraktimit (miniera)

Veprimtaritë	Kam Qytet: <ul style="list-style-type: none"><li>• Thertore e vogël, Pikë shpërndarjeje</li></ul> Zogaj: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor, Baxho</li></ul>
--------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

### ZE-BY03

(Mashë-Berishë-Vishoçë)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	Mashë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor i drurëve frutorë</li></ul>
--------------	-------------------------------------------------------------------------------------

Përveç zonave me zhvillime ekonomike specifike, zona kodrinore e Bytyçit duhet të orientohet drejt një ekonomie të prodhimit të lëndëve drusore kryesisht për ngrohje. Cilësia e tokave në këtë territor nuk jep mundësi për zhvillime të tjera dhe aktiviteti i “pylltarisë” përveç prodhimit të lëndës djegëse të rinovueshme do të sillte përmirësime të ndjeshme në cilësinë e tokës.



## Fierzë

Zhvillimi urban i qendrës kryesore: Konsolidim.

### ZE-FI01

(Breglumë-Dushaj)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë, me prezencë të shesheve të ekstraktimit përgjatë lumit Valbonë

Veprimtaritë	<p>Dushaj:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Treg lokal, Thertore</li><li>• Infrastrukturë turistike (pikë informacioni)</li><li>• Terminal tragetesh</li></ul> <p>Breglumë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Infrastrukturë turistike (hyrje në park)</li></ul>
--------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

### ZE-FI02

(Tpla)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	<p>Dushaj:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor, Baxho</li></ul>
--------------	----------------------------------------------------------------------------------



## Lekbibaj

Zhvillimi urban i qendrës kryesore: Konsolidim.

### ZE-LE01

(Lekbibaj-Curraj i poshtëm-Gjonpepaj-Peraj)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë dhe turizmit

Veprimtaritë	Gjonpepaj: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor, Baxho</li></ul> Lekbibaj: <ul style="list-style-type: none"><li>• Treg lokal, Thertore e vogël</li><li>• Infrastrukturë turistike (pikë informacioni)</li></ul>
--------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

### ZE-LE02

(Tetaj-Shëngjergj-Betosh)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	Shëngjergj: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor gështenjash</li></ul>
--------------	------------------------------------------------------------------------------------

### ZE-LE03

(Brisë-Salcë-Palçë)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë, me mundësi për zhvillim të veprimtarive turistike

Veprimtaritë	Salcë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Pikë shpërndarjeje</li></ul>
--------------	-----------------------------------------------------------------------------

### ZE-LE04

(Curraj i sipërm-Qerec-Mulaj)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt turizmit

Veprimtaritë	Curraj i sipërm: <ul style="list-style-type: none"><li>• Pikë shpërndarjeje</li><li>• Infrastrukturë turistike (pikë/qendër informacioni)</li></ul>
--------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------










**8 PËRMIRËSIMI I MJEDISIT BUJQËSOR**





Në përgjithësi mjedisi bujqësor i Tropojës ka nevojë për përmirësime të ndjeshme në mënyrë që të arrihet një nivel i kënaqshëm i prodhimit dhe efektshmërisë. Ndërhyrjet në këtë fushë kanë të bëjnë me tri fusha kryesore: marrëveshjet bujqësore, infrastrukturën bujqësore dhe pajisjet bujqësore.

## 8.1 Parashikime për mbrojtjen e tokës bujqësore

Shumë pjesë të territorit bujqësor të Tropojës kanë hyrë gjatë viteve të fundit në një proces braktisjeje dhe neglizhimi. Plani parashih rehabilitimin e këtij territori dhe kthimin e tij në nivele të kënaqshme të prodhimit dhe efektshmërisë bujqësore nëpërmjet rehabilitimit të tokës së braktisur nëpërmjet agro-pyllumtarisë dhe permakulturës dhe më konkretisht përmes ripërdorimit të terracave të braktisura/neglizhuara.

### 8.1.1 Rehabilitimi i tokave të braktisura me agro-pyllumtarinë dhe permakulturë

Ky projekt parashih promovimin e sistemit agro-pyllumtarisë sidomos në fusha dhe terraca të pakultivuara. Sistemi agro-pyllumtarisë do të konsistojë në diversifikimin e plantacioneve, duke alternuar pemët frutore dhe kulturat e ulëta. Sistemi agro-pyllumtarisë do të kontribuojë në garantimin e një kullimi më të efektshëm dhe si pasojë në stabilizimin e tokës, duke e bërë atë më produktive dhe duke siguruar pleh organik me rezultat përmirësimit e cilësisë dhe sasisë së produkteve.

Veprimi parashih katër konfigurime të ndryshme hapësinore që do të përdoren sipas plantacioneve dhe morfologjisë specifike të fushave. Skema 1 dhe 2 janë dy modele të përdorura tashmë në vendbanimet bujqësore të gjetura në shpatë.





Skema e parë tregon parcela shembull/tip, në kufirin ndërmjet zonave natyrore dhe bujqësore, ku ndarja midis të dyjave nuk është e përcaktuar qartë. Kjo gjeneron një moment të bashkëjetesës së dy sistemeve dhe të kalimit të njëri drejt tjetrit. Kjo strukturë është aplikuar kryesisht në njësitë me kategorinë BN.

Modeli i dytë përshkruan një strukturë të zakonshme të fushave bujqësore të vendosura në terren të pjerrët. Këtu, një seri terracass të parregullta rrisin sasinë e tokës së sheshtë bujqësore dhe maksimizojnë mundësinë e punimit të saj. Pemët mbillen përgjatë kufijve të terracave për të stabilizuar tokën, për të garantuar një kullim korrekt dhe për të mbrojtur fushat nga erërat direkte.

Skemat 3 dhe 4 janë dy modele të propozuara për rehabilitimin e “tokave të reja”, parcela të mëdha toke të zhveshur, joproduktive dhe subjekt i erozionit. Këto terrene janë kryesisht të vendosura në njësinë vendore të Llugajt dhe Tropojës. Këtu, rreshtat alternative të pemëve jo vetëm që do të rrisin produktivitetin e tokës, por gjithashtu do ta stabilizojnë atë, duke bllokuar lëvizjen në rënie të tokës dhe do të shërbejnë si masa

(në faqen paraardhëse)  
Harta e propozimeve për infrastrukturën bujqësore





efektive për ruajtjen e dheut.

### 8.1.2 Ripërdorimi i tarracave

Plani propozon rehabilitimin e tarracave të braktisura mbi shpatet që ndodhen veçanërisht në territorin e Bujanit, Margegajt, Llugajt dhe Tropojës. Kjo do të realizohet nëpërmjet pastrimit të vegjetacionit, konsolidimit të mureve dhe argjinaturave dhe rehabilitimit të rrjetit të kullimit. Si rezultat do të përfitohen toka bujqësore të cilësisë së lartë që do të përdoren për kultivimin e pemëve frutore, vreshtave dhe bimëve mjekësore.

## 8.2 Infrastruktura bujqësore

Kategoria e dytë e ndërhyrjeve adreson përmirësimin e infrastrukturës bujqësore dhe do të përqendrohet në:

### *Rehabilitimin e rezervuareve dhe sistemeve te vaditjes*

Sistemi i ujitjes dhe kullimit të territorit do të rehabilitohet duke filluar nga ato zona me mundësi kultivimi të prodhimeve me cilësi të lartë. Rehabilitimi i përket një numri situatash të përpikta që shpesh përkojnë me ato vende ku sistemi bujqësor kryqëzon sistemet e tjera (p.sh. infrastruktura rrugore, modelet e urbanizuara etj.). Më konkretisht, rehabilitimi i sistemit të ujitjes/kullimit do të bazohet në dy veprime kryesore:

- Rezervuarët jo funksionalë të shpërndarë nëpër kodra duhet të rehabilitohen plotësisht në mënyrë që ata të kryejnë mbajtjen e ujërave të reshjeve dhe në mënyrë rutinore të sigurojnë ujin për ujitje.
- Segmente të veçanta të kanaleve në të gjithë territorin duhet të ndërtohen ose rehabilitohen.

Përveç kësaj, ndërtimi i një pellgu për mbledhjen e ujërave të ndotura, të trajtuara nga impianti i trajtimit në Bajram Curri dhe lidhja e tij me rrjetin e ujitjes, do të rrisë kapacitetin e ujitjes së territorit dhe larminë e burimeve ujore për bujqësinë.



(në faqen  
paraardhëse)  
Modele të  
përzlerieve në  
Agro-Pylltar  
01.  
Thurje e  
përzlerë  
02.  
Kufizim me  
pemë  
03.  
Rreshta të  
alternuar  
04.  
Shirita të  
alternuar

### 8.3 Pajimi bujqësor

Një rrjet ndërtesash të ndryshme shërbimesh për bujqësinë - duke përfshirë pika grumbullimi, thertore, baxho, tregje, qendra shpërndarjeje dhe qendra trajnimi - do të ndërtohen në lidhje të ngushtë me rrjetin rrugor, në mënyrë që do të garantojë një arritshmëri të barabartë dhe të përhapur për fermerët vendas. Menaxhimi i pajisjeve të tilla kërkon








në shumë raste forma të reja organizimi, të bazuara në bashkëpunimin midis fermerëve (p.sh. në formën e kooperativave vendore).

Pajisjet e reja bujqësore përfshijnë:

- Pika grumbullimi të produkteve bujqësore: Këto struktura duhet të shpërndahen në të gjithë territorin e bashkisë dhe veçanërisht në zonat e karakterizuara nga një lloj i caktuar i kulturave. Roli i tyre konsiderohet shumë i rëndësishëm për të garantuar ruajtjen dhe shpërndarjen e duhur të kulturave bujqësore. Pikat e grumbullimit janë struktura të vogla dhe duhet të zhvillohen përmes iniciativës publike dhe/ose private dhe duhet të menaxhohen nga kooperativat vendase.
- Blegtoria lokale, thertoret dhe baxhot: Me qëllim përmirësimin e prodhimit ushqimor bazuar në blegtorinë vendase, strukturat e vogla të thertoreve dhe baxhove duhet të zhvillohen në vende të caktuara në të gjithë territorin. Ndërkohë që thertoret e reja do të plotësojnë ato ekzistuese, baxhot do të kontribuojnë në prodhimin dhe tregtimin e djathërave, qumështit dhe kosit vendas. Këto struktura duhet të zhvillohen përmes iniciativës publike dhe/ose private dhe duhet të menaxhohen nga kooperativat ose sipërmarrësit vendas.
- Strukturat e përpunimit të ushqimit: Objektet e përpunimit të ushqimit duhet të zhvillohen në territor me qëllim plotësimin e zinxhirit vendas të prodhimit. Objektet e përpunimit ushqimor për fruta, gështenjë, bimë mjekësore dhe mjedër janë veçanërisht të rëndësishme pasi ato do të plotësojnë dhe mbështesin prodhimet e vazhdueshme. Këto struktura duhet të zhvillohen përmes iniciativës private, me përkrahje të mundshme publike, dhe duhet të menaxhohen nga kooperativat ose sipërmarrësit vendas.
- Tregjet bujqësore dhe qendrat e shpërndarjes: Tregjet dhe qendrat e shpërndarjes janë variacione në shkallë më të madhe të pikave vendore të grumbullimit dhe do të funksionojnë edhe si pika shitjeje dhe qendra shpërndarjeje. Ato janë të vendosura në vende strategjike si në aspektin e arritshmërisë publike dhe infrastrukture. Ashtu si pikat e grumbullimit, ato janë struktura të vogla dhe duhet të zbatohen përmes iniciativës publike dhe/ose private dhe duhet të menaxhohen nga kooperativat vendase.
- Mbështetja bujqësore dhe qendrat edukative: Qendrat e mbështetjes së bujqësisë do të kontribuojnë për të organizuar dhe promovuar prodhimin në zonat rurale dhe për të trajnuar popullatën vendase duke vepruar edhe si qendra të vogla të arsimit profesional në fushën e bujqësisë. Roli i tyre është të sigurojë asistencë dhe trajnim për fermerët e vegjël vendas. Këto struktura duhet të zhvillohen përmes iniciativës publike dhe duhet të menaxhohen nga institucionet vendore/rajonale.

(në faqen  
paraardhëse)  
Ndërhyrje në  
rezervuarët  
dhe kanalet e  
ujtjes/kullimit





#### 8.4 Projekt me Partneritet Publik-Privat (PPP) për bujqësinë

PPV-ja e Tropojës propozon një sërë projektesh për të nxitur dhe zhvilluar bujqësinë si një nga sektorët kryesorë ekonomikë për rajonin. Këto projekte, në formën e partneritetit publik-privat, parashikojnë ndërtimin e strukturave të ndryshme ndihmëse për bujqësinë, si pikat e grumbullimit dhe qendrat e prodhimit, së bashku me një sërë shërbimesh publike dhe private dhe aktiviteteve tregtare. Këto projekte do të zhvillohen në parcela specifike publike, të përzgjedhura në bashkëpunim me bashkinë gjatë hartimit të PPV (këto zona janë identifikuar në përdorimin e tokës si kategoria IES.3). Vende dhe programe të përshtatshme janë identifikuar përmes pesë hapave:

- Identifikimi i zonave prodhuese dhe llojeve të prodhimit;
- Përcaktimi i shkallës së prodhimit, shpërndarjes dhe proceseve të prodhimit;
- Identifikimi i vendeve të ndërhyrjes;
- Përkufizimi i tipologjisë dhe madhësisë së strukturave;
- Identifikimi i llojit të iniciativave, nxitësve, politikave dhe aktorëve të përfshirë

##### *Lloji i prodhimit:*

Si hap i parë janë klasifikuar zonat kryesore prodhuese brenda territorit të Tropojës. Për secilën prej këtyre zonave janë analizuar llojet kryesore të prodhimit bujqësor; më pas ato janë grupuar sipas sektorëve specifikë të prodhimit dhe llojit të strukturave të nevojshme për grumbullimin dhe përpunimin. Grupet rezultuese janë si më poshtë:

- Kultura fushore (drithëra, grurë, misër, perime të freskëta / të thata etj.);
- Pemishtet dhe Agro-Pylltari (gështenja, arra, etj.);
- Pemë frutore (kumbulla, mollë, etj.);
- Vreshta (verë, rrush, etj.);
- Frutat e pyjeve (boronica, dëllinja e zezë, trëndafili i egër, etj.);
- Bimët mjekësore, bimët aromatike dhe erëzat;
- Produktet e Qumështit (qumësht, djathë, kos, gjalpë, etj.);
- Mishi (të imtat, gjedhët, etj.);
- Bletaria (mjalti, etj.).

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
propozimeve  
për PPP në  
bujqësi







*Shkalla e prodhimit, konsumit, shpërndarjes dhe proceseve të prodhimit:*

Së bashku me llojin e prodhimit, është klasifikuar edhe shkalla e prodhimit dhe konsumit (projeksionet aktuale dhe të ardhshme), shpërndarja dhe proceset e prodhimit. Prodhimi dhe konsumi janë klasifikuar sipas tri niveleve:

- Familjar;
- Vendor/Rajonal;
- Kombëtar/Ndërkombëtar.

Kjo është kategorizuar më tej sipas tri llojeve të shpërndarjes:

- Vendore - Shpërndarje direkte;
- Rajonale - Shpërndarja e ndërmjetme;
- Kombëtare - Shpërndarje të mëdha.

Procesi i prodhimit është thjeshtuar në katër grupe kryesore, duke sintetizuar fazat kryesore të prodhimit:

- Mbledhje dhe magazinim;
- Përpunim i parë ose i pjesshëm;
- Përpunim i plotë;
- Shitje - të drejtpërdrejta dhe të ndërmjetme.

*Identifikimi i vendeve:*

Pas vitit 1990, shumë zona ushtarake, si dhe prona të ish-kooperativave që ende nuk janë privatizuar, janë braktisur në mënyrë progresive. Këto vende sot paraqesin pjesë tërësisht të lëna pas dore të territorit dhe gjithashtu një mundësi për zhvillimin e projekteve pilot për sektorin e bujqësisë dhe jo vetëm. Pas kryerjes së një studimi të detajuar të këtyre zonave, plani ka identifikuar një sërë vendesh për zhvillimin e projekteve PPP.

*Tipologjia dhe madhësia e strukturave*

Madhësia dhe tipologjia e strukturave bujqësore është përcaktuar sipas parametrave të mësipërm. Përveç kësaj, janë vlerësuar edhe kërkesat minimale higjienike dhe dimensionet hapësinore minimale në lidhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ato ndahen në katër kategori kryesore:

- Baxho (të lëvizshme, të vogla, të mesme, të mëdha);



**Bulmetore**

**Thertore**

**Magazinë**

**Pikë Grumbullimi**

100kg/ditë  
17-25 m<sup>2</sup>



Bulmetore e Lëvizshme

1-2 koka/ditë  
25-30 m<sup>2</sup>



Thertore e Lëvizshme

200kg/ditë  
60-100 m<sup>2</sup>



Bulmetore e Vegël

1 koka/ditë  
50-150 m<sup>2</sup>



Thertore e Vegël

150-200 m<sup>2</sup>



Magazinë e Vegël

300-350 koka/vit  
300-500 m<sup>2</sup>



Pikë Grumbullimi e Vegël

500kg/ditë  
150-250 m<sup>2</sup>



Bulmetore e Madhe

20 doka 40 koka/ditë  
150-300 m<sup>2</sup>



Thertore e Madhe

200-350 m<sup>2</sup>




Magazinë e Madhe

600-750 koka/vit  
500-1000 m<sup>2</sup>



Pikë Grumbullimi e Madhe

~1000kg/ditë  
250-500 m<sup>2</sup>



Bulmetore e Mëdhe

20 koka/vitë  
300-600 m<sup>2</sup>



Thertore e Mëdhe

150-450 m<sup>2</sup>



Magazinë e Mëdhe

~1000 koka/vitë  
1500 m<sup>2</sup>



Pikë Grumbullimi e Mëdhe

- Shërbime
- Depozitimi
- Përparimi
- Pikë Grumbullimi
- Zyrë





- Thertore (të lëvizshme, të vogla, të mesme, të mëdha);
- Magazinë bujqësore (e vogël, e mesme, e madhe);
- Pikë grumbullimi (e vogël, e mesme, e madhe).

Skema tregon madhësitë e mundshme të strukturave në lidhje me çdo tipologji. Duhet të merret si udhërrëfyes për bashkinë ose aktorët privatë që synojnë të investojnë në stuktura bujqësore.

*Identifikimi i llojit të iniciativave, nxitësve dhe aktorëve të përfshirë:*

Projektet strategjike nuk duhet të shqyrtohen vetëm si projekte rehabilitimi të zonës së braktisur, por si instrumente që mund të aktivizojnë procese të reja ekonomike në zonat rurale të territorit. Siç është përcaktuar në Programin Strategjik 04S4, Plani mbështet fuqishëm ngritjen e partneritetit publik-privat. Në veçanti, për vendet e identifikuara, janë zhvilluar tre forma të partneritetit publik-privat (PPP) që mund të aplikohen në lidhje me nevojat specifike të pjesëve.

- Formimi i kooperativës sociale publike / dhënia në përdorim e strukturës publike OJQ-së;
- Dhënia në përdorim e zonave publike për kooperativat private / Kooperativat ndihmëse;
- Dhënia në përdorim e hapësirave publike për shërbimin privat dhe ndërtim të strukturave publike.

Tre format e përmendura të partneritetit, këtu, janë menduar si udhëzues për bashkinë për zbatimin e projekteve strategjike. Ato nuk janë ekskluzive dhe lejohen forma të tjera të ndërhyrjes për atë që ato nuk janë në kundërshtim me parimet e këtij plani.

*PPP 01\_ Formimi i kooperativës sociale publike / dhënia në përdorim e strukturës publike OJQ-së*

Kjo politikë synon zhvillimin e sektorit bujqësor në fshatrat e vogla rurale dhe në zonat e largëta të territorit ku prodhuesit vendorë janë shumë të vegjël për të arritur një prodhim për tregun vendas ose shumë të përhapur për të përdorur stuktura ndihmëse të përbashkëta gjatë procesit të prodhimit.

Bashkia mund t'u japë me koncesion grupeve, shoqatave dhe organizatave jofitimprurëse (OJF) menaxhimin e tokës bujqësore publike ose strukturave publike fizike (ish-zona ushtarake, zona të minierave të braktisura, ish-kooperativa etj.). Toka ose ndërtesat do të jepen për përdorim në këmbim të një çmimi simbolik për një periudhë nëntë-vjeçare

(në faqen paraardhëse)  
Dimensionet e mundëshme të strukturave të organizuara sipas tipologjive



Njësi strukt.	Vendndodhja	Tipi i produktit	Tipi i shpërndarjes	Proceset e prodhimit	Tipologjia dhe madhësia e strukturave	Investitor	Funksione të tjera të implementueshme
IES	Degë	Të korra, Perime, Foragjere	Shpërndarje Lokale	Grumbullim, Përpunim Pjesor, Shitje Direkte/me Ndërmjetësi	Pikë Grumbullimi e Vogël	Publik ose Privat	-
IES	Pac	Të korra, Perime, Foragjere/ Bulmet	Shpërndarje Lokale	Grumbullim, Përpunim Pjesor	Pikë Grumbullimi e Vogël, Baxho	Publik ose Privat	Magazinë, Treg Lokal
IES	Tropojë	Pemë Frutore (Gështenja, Arra, etj.), Drurë Frutorë (Kumbulla, Mollë, etj.)	Shpërndarje Rajonale, Kombëtare	Grumbullim, Përpunim Pjesor, Shitje Direkte/me Ndërmjetësi	Pikë Grumbullimi	PPP	Magazinë, Shërbime, Qendër Trajnimi, Qendër Certifikimi
IES	Bujan	Pemë Frutore (Gështenja, Arra, etj.), Drurë Frutorë (Kumbulla, Mollë, etj.)	Shpërndarje Kombëtare	Grumbullim, Përpunim Pjesor	Pikë Grumbullimi	PPP	-
IES	Margegaj	Pemë Frutore (Gështenja, Arra, etj.), Bulmet	Shpërndarje Rajonale, Kombëtare	Grumbullim, Përpunim Pjesor, Shitje Direkte/me Ndërmjetësi	Pikë Grumbullimi e Vogël, Baxho	PPP	Magazinë, Shërbime, Pikë Shpërndarjeje, Qendër Trajnimi, Qendër Certifikimi
IES	Jaho Saliti / Ljugaj	Drurë Frutorë (Kumbulla, Mollë, etj.)	Shpërndarje Rajonale, Kombëtare	Grumbullim, Përpunim Pjesor	Pikë Grumbullimi	Publik ose Privat	-
IES	Ljugaj	Bulmet (Qumësht, Djathë, etj.)	Shpërndarje Rajonale, Kombëtare	Grumbullim, Përpunim Pjesor, Shitje Direkte/me Ndërmjetësi	Baxho	PPP	-
IES	Bllat	Drurë Frutorë (Kumbulla, Mollë, etj.), Produkte Qumshiti	Shpërndarje Lokale	Grumbullim, Përpunim Pjesor, Shitje Direkte/me Ndërmjetësi	Pikë Grumbullimi	Publik ose Privat	-
IES	Fierzë	Drurë Frutorë (Kumbulla, Mollë, etj.), Vreshta	Shpërndarje Lokale, Rajonale	Grumbullim, Përpunim Pjesor, Shitje Direkte/me Ndërmjetësi	Pikë Grumbullimi	PPP	Magazinë, Shërbime, Qendër Trajnimi, Qendër Certifikimi
IES	Tplan	Të korra, Perime, Foragjere/ Produkte Qumshiti (Baxhoje)	Shpërndarje Lokale		Pikë Grumbullimi e Vogël, Baxho	Publik ose Privat	Magazinë, Treg Lokal
IES	Shoshan	Të korra, Perime, Foragjere	Shpërndarje Lokale	Grumbullim, Përpunim Pjesor, Shitje Direkte/me Ndërmjetësi	Pikë Grumbullimi e Vogël	Publik ose Privat	-
IES	Tropojë	Bulmet (Qumësht, Djathë, etj.), Mjalt	Shpërndarje Lokale, Rajonale	Grumbullim, Përpunim Pjesor, Shitje Direkte/me Ndërmjetësi	Baxho	Publik ose Privat	Treg Lokal
IES	Ljugaj	Drurë Frutorë (Kumbulla, Mollë, etj.)	Shpërndarje Lokale, Rajonale	Grumbullim, Përpunim Pjesor, Shitje Direkte/me Ndërmjetësi	Pikë Grumbullimi	Publik	-
IES	Babinë	Pemë Frutore (Gështenja, Arra, etj.), Drurë Frutorë (Kumbulla, Mollë, etj.)	Shpërndarje Lokale	Grumbullim, Përpunim Pjesor, Shitje me Ndërmjetësi	Pikë Grumbullimi	PPP	Magazinë, Shërbime, Pikë Shpërndarjeje
IES	Peraj / Lakbibaj	Drurë Frutorë (Kumbulla, Mollë, etj.), Të korra, Perime, Foragjere	Shpërndarje Lokale	Grumbullim, Përpunim Pjesor, Shitje me Ndërmjetësi	Pikë Grumbullimi e Vogël	Publik ose Privat	Magazinë
IES	Bujan	Pemë Frutore (Gështenja, Arra, etj.)	Shpërndarje Rajonale, Kombëtare	Grumbullim, Përpunim Pjesor, Shitje Direkte/me Ndërmjetësi	Pikë Grumbullimi	PPP	Magazinë, Shërbime, Pikë Shpërndarjeje, Qendër Trajnimi, Qendër Certifikimi



(të rinovueshme). Bashkia mund të nxisë ose të veprojë drejtpërsëdrejti në formimin e këtyre kooperativave dhe të sigurojë investimin fillestar të nevojshëm për krijimin e kooperativës. Këto kooperativa mund të ofrojnë shërbime për prodhuesit e vegjël dhe fermerët e pavarur, duke siguruar punë të mekanizuar, programe trajnimi dhe forma të tjera ndihmesh të nevojshme për prodhim dhe përpunim të parë. Bashkia së bashku me shoqatën dhe OJF-të do të kontribuojnë për të garantuar cilësinë e produkteve dhe certifikimin e përpunimit të prodhimit duke lehtësuar shpërndarjen në tregun vendor dhe rajonal. Këto kooperativa po ashtu kanë qëllimin të formojnë programe trajnimi që do të kontribuojnë në integrimin në tregun e punës të personave në disavantazh (të rinjtë e papunë, grupet minoritare etj.).

### *PPP 02\_Dhënia në përdorim e zonave publike për kooperativat private / Kooperativat ndihmëse*

Një kooperativë ndihmëse është një kompani në të cilën një pjesë e kapitalit është në pronësi të një organi publik. Investitori publik pastaj mund të marrë pjesë në kooperativën bujqësore duke siguruar tokën bujqësore, strukturat fizike të nevojshme për funksionimin e kooperativës (ato mund të jenë edhe në tokën publike) ose me investime direkte. Kjo politikë synon të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet fermerëve të vegjël në mënyrë që të prodhojë më shumë prodhime bujqësore. Bashkia mund t'u japë me koncesion grupeve private të fermerëve menaxhimin e tokës publike ose ndërtesave publike. Toka do të jepet në përdorim për një çmim simbolik për një periudhë nëntë-vjeçare (të rinovueshme). Me krijimin e këtyre kooperativave, bashkia mund të mbështesë grupet private të fermerëve, të përmirësojë standardet e cilësisë së ushqimit duke kontrolluar produktet brenda zinxhirit të procesit të prodhimit, në përputhje me prodhimet sipas standardeve të BE-së. Ky model mund të zbatohet edhe kur ka një grup pronarësh tokash që ende nuk e kanë formalizuar pronën e tyre dhe që i japin me qira ose lejojnë të tretë të punojnë në këto toka. Nëpërmjet krijimit të një kooperative, bashkia mund t'i mbështesë këta bujq në punimin dhe mirëmbajtjen e tokës, në kontrollin e produktit përfundimtar, në certifikimin e produktit në burim, në transformimin dhe trgëtimin e tij. Shembuj të kooperativave ndihmëse mund të jenë: qendra e dehidrimit të frutave, thertore, pika e grumbullimit të gështenjave, baxhot, kooperativat e frutave, kooperativat bujqësore, punishtet e verës dhe paketimi i produkteve përfundimtare.

### *PPP 03\_Dhënia në përdorim e hapësirave publike për shërbimin privat dhe ndërtim të strukturave publike.*

Bashkia mund t'u japë me koncesion grupeve private ose investitorëve të vetëm menaxhimin e tokës publike ose ndërtesave publike. Komuna gjithashtu mund të japë të drejtën për të zhvilluar shërbime ndihmëse si restorante, struktura pritëse dhe laboratorë, në mënyrë që të nxisë aktorët privatë që të investojnë në sektorin e bujqësisë.


(në faqen  
paraardhëse)  
Tabela e  
projekteve PPP



Në këmbim, ata do të garantojnë ndërtimin dhe funksionimin e strukturave bujqësore publike dhe qendrave mbështetëse që do të përdoren në mbështetje të fermerit vendas. Tabela tregon llojin e strukturës dhe ndërhyrjes së propozuar për çdo vend të identifikuar.








**9 PLANI PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT**







Zhvillimi i sektorit turistik paraqet sfidën kryesore për të ardhmen e territorit, si për ndikimin e tij ekonomik, ashtu edhe për mjedisin delikat dhe të brishtë në të cilin do të zhvillohet. Në fakt, më shumë se 90% e këtij territori ende nuk është prekur nga ndonjë aktivitet njerëzor. Megjithatë, presioni i zhvillimit të ri po bëhet gjithnjë e më i dukshëm. Plani propozon një sërë veprimesh të drejtuara për zhvillimin e këtij sektori në lidhje me asetet kryesore natyrore dhe kulturore që janë të pranishme në territor, duke identifikuar qendrat kryesore të zhvillimit turistik dhe hartimin e udhëzimeve të përgjithshme për menaxhimin e shtigjeve të shumta historike, infrastrukturave e reja të shërbimit dhe strukturat e pritjes. Dispozitat e mëposhtme janë hartuar në përputhje me përshkrimet e PKST (Plani Kombëtar i Sektorit të Turizmit për rajonin e Alpeve Shqiptare).

### 9.1 Zhvillimi turistik në rajon


Peizazhi i mrekullueshëm i Tropojës, me formën e tij të qartë të përkufizuar saktë nga lugina të thella dhe maja të larta, të formuara nga lumenj të shumtë që lindin në male, po fiton gjithnjë e më shumë vëmendjen e turizmit kombëtar dhe ndërkombëtar. Gjithnjë e më shumë njerëz sot vijnë në këtë rajon për t'u magjepsur plotësisht nga mjedisi i tij, duke kërkuar aktivitete që më shumë se të "konsumojnë" dhe varfërojnë peizazhin, do t'i bënin ata të ndiheshin plotësisht pjesë e tij. Plani po nxit ekskluzivisht format e turizmit, të përcaktuara më parë në strategji si "turizëm i butë", të cilat bazohen në aktivitete rekreative që do të zhvillohen në përputhje me këtë mjedis të jashtëzakonshëm natyror. *Hiking, sky-running, vozitja, paragliding, ski, rafting* dhe *biking* janë disa shembuj të aktiviteteve që plani parasheh dhe rregullon në zonat kryesore të mbrojtura të Lekbibajt, Margegajt dhe Tropojës.

Përveç kësaj, plani promovon zhvillimin e sektorit rural dhe agro-turizmit në të gjithë rajonin, me një fokus të veçantë në ekosistemin e gështenjave të Bujanit dhe në fushat e bukura bujqësore të Llugajt dhe Bytyçit. Bujqësia, së bashku me turizmin, do të jetë motori i rritjes ekonomike të rajonit, duke u dhënë fshatrave një formë alternative të jetesës, përkundër industrisë së vjetër dhe thujtës së dalë nga përdorimi i minierave.

Plani, gjithashtu, në përputhje me direktivat e PKST dhe të Planit Kombëtar, ka identifikuar 9 zona të urbanizuara që do të punojnë si qendra rreth të cilave do të strukturohen programet dhe aktivitetet turistike të propozuara. Për secilën prej këtyre qendrave janë hartuar përdorime dhe funksione specifike me qëllim përqëndrimin e zhvillimit të infrastrukturave më intensive turistike si hotelet dhe stacionin intermodal për autobusët turistikë në zonën ekzistuese të urbanizuar, duke nxitur kështu forma të reja të turizmit të butë në zonat rurale dhe parqet natyrore.

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
Infrastrukturës  
së Turizmit





### *Qendrat turistike parësore (Kategoria 1 në PKST)*

Bajram Curri është qendra administrative dhe zona kryesore e urbanizuar e Bashkisë së Tropojës. Qyteti ofron të gjitha shërbimet në nivel rajonal dhe është një ndalesë e detyruar në rrugën për në Parkun Kombëtar të lumit Valbona dhe për në zonën e mbrojtur të lumit Gashi. Plani synon të përforcojë rolin kryesor të kësaj qendre urbane, duke promovuar ndërtimin e infrastrukturës turistike dhe pritëse, një stacion intermodal për transportin publik lokal dhe autobusët turistikë, shërbime publike dhe private, aktivitete tregtare dhe përforcimin e ofertës kulturore përmes përmirësimit të mjediseve të brendshme të muzeut dhe ekspozitave në të. Plani parasheh një kapacitet turistik prej rreth 1500 shtretër. Strukturat dhe programet e reja do të shërbejnë nga infrastruktura e përmirësuar, siç përcaktohet në SO7. Në organizimin e ri territorial, Bajram Curri do të jetë qendër e shërbimeve dhe porta e Alpeve.

### *Qendrat turistike dytësore (Kategoria 2 në PKST)*

Po aq të rëndësishme për menaxhimin e flukseve turistike janë edhe të gjitha qendrat e vogla të banimit. Fshatrat Lekbibaj, Dushaj dhe Tropojë e Vjetër janë të vendosur në pika shumë strategjike. Të vendosur përgjatë rrugës kryesore kombëtare, ata përfaqësojnë hyrjen në tri itinerare kryesore turistike: Parku Rajonal i Nikaj-Mërturit, hyrja nga tragetet Koman-Fierzë, zona e mbrojtur e lumit Gashi dhe bjeshkët e pranishme në zonën e Alpeve. Këto qendra do të pajisen me terminalin vendas të autobusëve dhe infrastrukturë të vogël turistike, si pikat e informacionit. Shërbimet në nivel vendor do të përmirësohen dhe së bashku me zhvillimin e formave tradicionale të pritjes, konvertimin e ndërtesave të braktisura ose të papërdorura në shtëpi pritjeje do të jenë pjesë e programit të rigjenerimit dhe konsolidimit të këtyre qendrave - SO6. Plani parasheh një kapacitet turistik prej rreth 250 shtretër në Tropojë të Vjetër, 300 shtretër në Dushaj dhe 500 shtretër në Lekbibaj.

### *Qendrat turistike të treta (Kategoria 3 në PKST)*

Këto fshatra janë ndër qendrat më të vizituara dhe destinacionet kryesore turistike të rajonit të Tropojës. Me përjashtim të Valbonës, ku plani propozon rikonstrukcionin e hotel "Turizmit" dhe ndërtimin e strukturave të reja hoteliere, në Rragam, Çerem dhe Curraj i Epërm plani propozon lloje të ndryshme të strukturave pritëse, siç janë zonat e kampingut, bujtinat dhe fjetinat. Të gjitha këto qendra janë vendosur brenda tre parqeve të mbrojtura, Parku Kombëtar i Luginës së Valbonës, Zona e Mbrojtur e Lumit Gashi dhe Parku Natyror Rajonal Nikaj-Mertur. Për këtë arsye PPV synon të promovojë një turizëm me struktura shumë specifike që janë në përputhje me kulturën e vendit. Plani parasheh një kapacitet turistik prej rreth 1000 shtretër në Valbonë, me 250 shtretër në Rragam, 150 shtretër në Çerem dhe 150 shtretër në Curraj i Epërm.

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
qendrave  
turistike







## *Fshatra historike dhe bjeshkët*

Përveç asaj që u përmend më sipër, një vëmendje e veçantë i është kushtuar shumë fshatrave historike dhe strukturave tradicionale të kullotave alpine (bjeshkët), të cilat janë një burim themelor për territorin, qoftë si element kulturor, qoftë si mundësi për të ripërtërirë këtë trashëgimi duke e ri-interpretuar atë për përdorime të reja. Disa nga ndërtesat historike, të cilat tani nuk shfrytëzohen me kapacitet të plotë ose nuk përdoren fare, do të rishikohen duke u siguruar mundësinë e përdorimit si struktura hoteliere të shpërndara me një ofertë minimale shërbimesh.

## 9.2 Menaxhimi i shtigjeve

### *Shtigjet dhe pajisjet për turizmin e butë*

Shtigjet historike dhe të *hiking* janë braktisur ngadalë dhe nuk marrin kujdesin e duhur, duke rezultuar në shtigje që në shumë raste nuk janë të dukshme, të identifikueshme ose të kalueshme. Duke pasur parasysh potencialin e rajonit për t'u bërë një destinacion turistik për *hikers*-at, është thelbësore të përmirësohet gjendja dhe mirëmbajtja e shtigjeve. Plani propozon një sërë ndërhyrjesh që synojnë të përmirësojnë gjendjen e shtigjeve ekzistuese dhe të rrisin dukshmërinë dhe sigurinë e tyre. Plani propozon gjithashtu pajisjen e këtyre shtigjeve me objekte shumë të thjeshta por themelore, të cilat do t'i bënin këto plotësisht të përdorshme nga vizitorët, udhëtarët dhe komunitetet vendase. Rreth Tropojës është e mundur të identifikohen 5 lloje të ndryshme shtigjesh: rrugë të asfaltuara, shtigje bujqësore, shtigje në pyll, shtigje ngjitëse/shkëmbore dhe kalime lumi. Secili prej tyre, duke qenë i lidhur me një peizazh specifik, karakterizohet nga tipare të ndryshme në aspektin e materialeve sipërfaqësore, qasjes dhe vështirësisë, shpenzimeve të mirëmbajtjes, duke kërkuar kështu lloje të ndryshme ndërhyrjesh.




*Shtigjet dhe pajisjet për turizmin e butë*

*Rrugët e asfaltuara* do të pajisen me shtylla bore dhe sinjalistikë rrugore. Këto do të ndjekin udhëzimet e kodit rrugor për sa i përket distancës nga rruga, ngjyrave dhe dimensioneve.


Pemët e shënuara do të përdoren për të nxjerrë në pah *shtigjet në pyje*, pasi për shkak të bimësisë së pasur çdo shenjë tjetër nuk do të ishte e dukshme ose do të ishte e vështirë

(në faqen  
paraardhëse)  
Diagrama e  
administrimit  
të shtigjeve






*gur kilometrik*




*stol*




*burim*




*shkallë*




*kalim lumi*




*zonë pushimi*



*strehë*



*ballkon*



*pikë vështrimi*





për t'u vendosur.

Hunj me lartësi 90cm do të shënojnë *shtigjet bujqësore* dhe pjesa e sipërme e tyre do të jetë e ngjyrosur dhe e numëruar.

Për *shtigjet ngjitëse/shkëmbore*, shenjat do të pikturohen në gurë të sigurtë, ndërsa shtyllat e hekurta do të instalohen në kalimin e lumenjve që janë subjekt përmbytjesh gjatë dimrit.

Përveç identifikimit të shtigjeve, është gjithashtu i rëndësishëm pajimi i tyre me një sërë informacionesh që janë thelbësore për udhëtarët ose për këdo që vendos të ecë përgjatë tyre. Ky informacion është thelbësor për të orientuar përdoruesit dhe për t'i bërë ata të lëvizin me lehtësi midis shumë atraksioneve dhe strukturave ekzistuese.

*Për këtë qëllim çdo shteg do të pajiset me:*

- Një seri gurësh kilometrik - gurë të vendosur në tokë në distancën prej 1km nga njëri-tjetri - do të bëjnë të kuptueshme distancën e mbuluar dhe distancën e mbetur për të arritur në destinacion. Guri kilometrik do t'u japë gjithashtu vizitorëve mundësinë për të matur në njëfarë mënyre territorin. Në këtë mënyrë vizitorët do të lexojnë dhe kuptojnë më mirë peizazhin në të cilin lëvizin.
- Shërbimet turistike dhe struktura ndihmëse si tabela sinjalistike në formën e kryqeve të drurit do të vendosen në kryqëzimin me shtigjet e tjera parësore ose dytësore. Këto, së bashku me një panel të vogël informativ në dru, do të tregojnë të gjithë informacionin e nevojshëm.
- Hunj do të përdoren për të treguar çdo informacion tjetër të përkohshëm ose të përhershëm që nuk mund të vendoset në elementet e lartpërmendura.

Në disa raste, shtigjet mund të bëhen një sfidë e vërtetë, madje plotësisht të papërshkueshme për shkak të pranisë së pjerrësive të forta ose të rrjedhave të vogla ujore. Për të kapërcyer këto pengesa, duhet të ndiqet ndërtimi i urave të vogla për këmbësorë, të preferueshme në dru, apo të shkallëve në gur ose dru, në varësi të mjedisit ku do të vendosen, me qëllim që të përmirësohet qasja në shteg.

Çdo shteg do të pajiset së paku me një sërë strukturash të vogla, të cilat do të ndihmojnë vizitorët dhe përdoruesit e përditshëm përgjatë rrugës:

- Shatërvanë, stola, strehëza dhe kazanë/kosha mbeturinash / Shërbime dhe struktura ndihmëse për turistët;
- Vendsoditje - struktura të thjeshta druri të vendosura jashtë rrugëve - lejojnë vizitorët të vrojtjnë peizazhin nga vende të ndryshme, duke pasuruar kështu territorin me

(në faqen  
paraardhëse)  
Aksonometri  
e elementeve  
të pajisjes së  
shtigjeve



*gur kilometrik*



*stol*



*burim*



*shkallë*



*kalim lumi*



*zonë pushimi*



*strehë*







*vendsoditje me  
skelet*



*vendsoditje me  
bazament*






Ementet e pajlsjes së shtigjeve: planimetri dhe imazhe





N  
W E  
S  
1:200,000



një atraksion të ri / Shërbime dhe struktura ndihmëse për turistët;

- Zona pushimi për të ndihmuar vizitorët gjatë ecjes;
- Kasolle dhe strehë për përdorim në rast vështirësish.

Duke përdorur gurin kilometrik si pikë reference, këto elemente do të vendosen përgjatë rrugës në intervale të rregullta për të garantuar shpërndarjen e të gjitha funksioneve përgjatë tërë shtegut. Kjo renditje ritmike gjithashtu do të përforcojë leximin e këtyre shtigjeve si një infrastrukturë që nga njëra anë i lejon njerëzit të përshkojnë këto peizazhe dhe nga ana tjetër kontribuon në strukturimin e tyre.

Duke marrë parasysh kompleksitetin e territorit, direktivat e lartpërmendura do të përshatën në mënyrë specifike sipas çdo rasti. Në fakt, Plan-Menaxhimi për Parkun Kombëtar “Alpet e Shqipërisë” klasifikon territorin që i përket Parkut të Alpeve në zona të ndryshme, ku aktivitetet dhe programet janë të rregulluara saktësisht. Lidhur me pajisjet e shtigjeve, janë parashikuar kufizime për Nën-Zonat Qendrore (ZQ). Në dokument thuhet se “Në ZQ krijohen biokorridore apo shtigje që përdoren vetëm për kalimin e vizitorëve, banorëve dhe shtegtimin e bagëtive. Ndërhyrjet përmirësuese të përkohshme, vetëm në rastet e fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njerëzit, zjarret, sëmundjet, dëmtuesit, largimi i mbetjeve të ngurta, plastike, inertet, etj. dhe vendosja e infrastrukturës për informimin e vizitorëve dhe turistëve do të jenë të lejuara me autorizim të veçantë të AdPKN”. Ju lutemi referojuni gjithë dokumentit për një kuptim më të plotë.

### 9.3 Shërbime dhe struktura ndihmëse turistike

Për të përballuar fluksin turistik në zonat natyrore, sidomos gjatë sezoneve kryesore, kërkohet një kapacitet i fortë menaxhimi dhe infrastruktura të përshatshme. Për shembull, zona e Valbonës vizitohet gjatë verës nga më shumë se 700 turistë çdo ditë dhe numrat po rriten çdo vit. Plani për menaxhimin e turizmit propozon një sërë pajisjesh që do të ndihmojnë bashkinë në përballjen me këtë fluks në rritje të turizmit:

- Kampet bazë janë zona të pajisura me furnizim me ujë, infrastrukturë për ujërat e zeza dhe grumbullimin e mbeturinave. Gjithashtu janë konceptuar si zona kampimi për periudha të shkurtra / Strehim turistik;
- Portat janë zona të pajisura, për aktivitetet në shtigje dhe zonat e mbrojtura natyrore, me burime, tualete, roje dhe qendër informimi / Strehim turistik;
- Qendra e emergjencës, një institucion shëndetësor i vendosur në Bajram Curri dhe pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme mjekësore për të trajtuar viktimat e aksidenteve;
- Pikat e qirasë së pajisjeve sportive do të vendosen në qendrat kryesore turistike ose pranë qendrave të informacionit turistik në mënyrë që të ndihmojnë vizitorët të


(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e Planit  
të Menaxhimit  
për Parkum  
Kombëtar  
“Alpet e  
Shqipërisë”



*rooms*

*common space*

*loggia*




*1x modul*




*2x module*



*5x module*



*konfigurimi nr. 1*



*konfigurimi nr. 2*



mënyrën më të mirë të mundshme;

- Hapësira parkimi për makina janë planifikuar në korrespondencë me rrugët kryesore të aksesit në parqe, vende të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, si dhe pranë portave për në zonat e mbrojtura natyrore;
- Autobusi ndalet në pika kyçe përgjatë rrugës kryesore, duke nxitur kështu turistët të përdorin transportin publik dhe të zvogëlojnë numrin e automjeteve private brenda zonave të mbrojtura natyrore.

Përveç kësaj, Departamenti i Shërbimit dhe Turizmit do të përforcojë strukturat e tij duke hapur një sektor të ri dhe të dedikuar - Sektorin e Turizmit, i cili do të kryejë një regjistrim të të gjitha strukturave aktuale për aktivitete turistike, do të monitorojë kapacitetin pritës të rajonit, do të kontrollojë rregullsinë e aktiviteteve që zhvillohen në territor në lidhje me kërkesat e sigurisë të përcaktuara me ligj.

#### 9.4 Strehimi turistik

Vendimi Nr. 730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifaf, afatet kohore dhe procedurat për klasifikimin e strukturave të akomodimit” është dokumenti që rregullon strehimet e ndryshme turistike. Më poshtë jepen përkufizimet e tipologjive të propozuara nga ky plan:

- Hotel - strukturë me jo më pak se 6 dhoma, ku strehimi dhe shërbimet si ushqimi, pijet, etj. shërbehen nga një staf i kualifikuar, në këmbim të një çmimi të shpallur;
- Hostel (Fjetinë) - ndërtesa ofron strehim dhe ushqim me çmime ekonomike, zakonisht për udhëtarët, studentët dhe punëtorët, ku dhoma ndahet midis disa klientëve të ndryshëm;
- Bed and Breakfast (B&B) - strukturat e pritjes që ofrojnë shërbim shtrati/fjetjeje dhe mëngjesi brenda çmimit të dhomës. Struktura nuk ofron shërbim si restorant dhe hapësira të përbashkëta (numër i kufizuar i dhomave);
- Shtëpi për mysafirë (pension) - strukturë pritëse, një ndërtesë, ose një pjesë e së cilës përdoret si rezidencë e pronarëve dhe ku ofrohet strehim dhe ushqim për vizitorët, kundrejt pagesës;
- Kamping - zonë publike ose private e rrethuar dhe e pajisur me infrastrukturë bazë (ujë, tualete, energji elektrike, etj.), ku udhëtarët mund të vendosen në kampe me çadra, të ngrenë çadrat e tyre ose të parkojnë automjetin.

Strehimet ekzistuese janë në shumicën e rasteve larg standardeve evropiane. Për këtë arsye, plani rekomandon një minimum prej 3 yjesh për të gjitha strukturat e hoteleve të reja. Kriteret për klasifikimin e hotelit mund të gjenden në ligjin e lartpërmendur.

(në faqen  
paraardhëse)  
Modeli i  
strukturës  
turistike







## 9.5 Projekte me Partneritet Publik-Privat (PPP) për turizmin

PPV i Tropojës propozon një sërë projektesh për të nxitur dhe zhvilluar një formë të re të strehimit dhe pajisjeve të turizmit. Këto projekte, në formën e partneriteteve publike-privatë, parashikojnë ndërtimin e strukturave të ndryshme turistike, të tilla si zona kampingu dhe stalla për aktivitetin e kalërimit. Këto projekte do të zhvillohen në parcela specifike, publike, të përzgjedhura gjatë hartimit të PPV (këto zona identifikohen në përdorimin e tokës dhe në pasaportat (tabelat parametrike).

Një shembull i tipologjive të propozuara është hosteli. Kjo strukturë përfytyrohet si një ndërtesë me strukturë druri ku nxiten forma të shkëmbimit midis përdoruesve nëpërmjet krijimit të hapësirave të përbashkëta.


Ndërtesa formohet nga grupimi i modulit bazë prej 10x8m me 8 shtretër të ndarë në dy dhoma, një hapësirë të përbashkët me një kuzhinë të vogël dhe një lozhë. Modulet mund të grupohen për të arritur kapacitetin e 94 shtretërve të vendosur në një strukturë dy katëshe prej 10x30m. Numri i shtretërve mund të ndryshojë sipas llojit të kompozimit të zgjedhur.

Projektet strategjike nuk duhet të shqyrtohen vetëm si ndërhyrje rehabilituese të vendeve të braktisura, por edhe si instrumente që mund të aktivizojnë procese të reja ekonomike, veçanërisht në zonat rurale. Vendet mund të jepen me koncesion nga bashkia për grupe private ose investitorë të vetëm, për menaxhimin dhe ndërtimin e ndërtesave të strehimit turistik. Bashkia gjithashtu mund të japë të drejtën për të zhvilluar shërbime ndihmëse si restorante, si një mënyrë për të inkurajuar aktorët privatë që të investojnë në këto zona. Në alternativë, bashkia mund t'u japë me koncesion grupeve, shoqatave dhe organizatave jofitimprurëse (OJF) menaxhimin e këtyre strukturave që ndërtohen nga operatori publik.

Vendet e propozuara për projektet PPP janë: Rogam, Valbonë, Çerem, Tropojë, Bilatë, Dushaj, Lekbibaj, Peraj.

(në faqen  
paraardhëse)  
Pamje nga  
hoteli i  
propozuar në  
Lekbibaj





(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
Projekteve PPP  
për turizmin





10 PLANI I MASAVE NË RRJETIN RRUGOR DHE TRANSPORTIN







## 10.1 Rrjeti rrugor

Infrastruktura rrugore në Bashkinë Tropojë përgjithësisht është e mirë. Qyteti i Bajram Currit është i lidhur me rrugë automobilistike me qendrat e njësisë administrative si dhe shumë nga fshtrat e Bashkisë së Tropojës si: Markaj, Lekbibaj, Shipshan, Pac, Zogaj, Valbonë, Berishë, Kepenek, Bajram Curri, si dhe me Krumën (Has). Pjesa më e madhe e rrugëve janë të paasfaltuara dhe nuk plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar sipas Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë.

### 10.1.1 Hyrja për në territorin e bashkisë Tropojë

Tropoja lidhet me sistemin kombëtar të rrugëve nëpërmjet rrugëve kombëtare Bajram Curri-Qafë Morinë, Bajram Curri-Fierzë dhe Bajram Curri-Krumë.

- Rruga nacionale SH22 Bajram Curri-Qafë Morinë lidh Tropojën me autostradën "Ibrahim Rugova" (Kosovë) dhe E851, "Rrugën e Kombit" (Shqipëri). Nëpërmjet kësaj rruge, distanca nga Bajram Curri në Tiranë është rreth 258 km. Komunikimi nëpërmjet kësaj rruge është me i lehtë nga pikëpamja e cilësisë së udhëtimit, por kalimi nëpër dy pika kufitare, Qafë Morinë (Tropojë) dhe Morinë (Kukës) rrit kohën e udhëtimit dhe, në rastin e transportit të mallrave, paraqet vështirësi lidhur me procedurat doganore.
- Rruga nacionale Bajram Curri-Fierzë është pjesë përbërëse e rrugës nacionale Bajram Curri-Tiranë. Deri para shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe sidomos pas ndërtimit të "Rrugës së Kombit" dhe autostradës "Ibrahim Rugova", rruga nacionale Bajram Curri-Tiranë nëpërmjet Fierzës ka qenë rruga kryesore e komunikimit të Tropojës me Tiranën, aeroportin "Nënë Tereza" dhe portin e Durrësit. Fillimisht kjo rrugë kalonte nga Qafa e Malit për në Tiranë nëpërmjet Pukës dhe Vaut të Dejës, ku bashkohet me rrugën nacionale Shkodër-Tiranë, ose nëpërmjet Rubikut, Fushë-Arrëzit dhe Milotit ku bashkohet me rrugën nacionale Shkodër-Tiranë dhe është përkatësisht rreth 275 dhe 260 km e gjatë. Si rruga që kalon nga Puka edhe ajo që kalon nga Rubiku, në pjesën më të madhe (deri ku bashkohet me rrugën nacionale Tiranë-Shkodër) është rrugë malore, që lejon shpejtësi mesatare rreth 40 km/orë, me kosto relativisht të lartë për transportin e udhëtarëve, por sidomos të mallrave dhe e vështirë në dimër kur ka borë.
- Pas ndërtimit të hidrocentralit të Fierzës, një alternativë e rrugës për në Tiranë kombinonte transportin rrugor dhe ujqor nëpërmjet Liqenit të Fierzës duke ndjekur itinerarin Fierzë-Koman-Vau i Dejës, ku bashkohet me rrugën nacionale Shkodër-Tiranë. Për arsye të koston së lartë të transportit me traget, kjo rrugë



sot përdoret në masë të vogël. Sidoqoftë, kjo rrugë është shumë panoromike dhe mund të jetë me shumë efektivitet në shërbim të zhvillimit të turizmit.

- Rruga nacionale SH23 Bajram Curri-Krumë lidh Tropojën me Kukësin dhe nga aty me Tiranën. Gjatësia e kësaj rruge është rreth 75km. Rruga është e shtruar me asfalt (vitin e kaluar ka përfunduar rikonstruksioni i rrugës Kukës-Krumë). Një alternativë për banorët e Bytyçit për t'u lidhur me Kukësin dhe Kosovën është edhe nëpërmjet pikës kufitare të Qafë Prushit. Kjo rrugë është malore, e cila lejon shpejtësi të vogël (30-40 km/orë) dhe është e vështirë në dimër kur ka borë. Kjo rrugë përdoret kryesisht nga banorët e njësisë administrative Bytyç që kufizohen me Hasin.

#### *Lidhja e Bashkisë Tropojë me aeroportet*

Bashkia e Tropojës ndodhet pranë disa aeroporteve Kombëtarë dhe Ndërkombëtarë, të cilat janë:

- Aeroporti “Nënë Tereza”, i vetmi aeroport funksional ndërkombëtar në Shqipëri, me një kapacitet mbi 1 milion pasagjerë në vit. Ai ndodhet në qendër të Shqipërisë, rreth 230 km nga qyteti i Bajram Currit.
- Aeroporti i Kukësit, rreth 100 km nga Bajram Curri, i cili aktualisht nuk është në funksionim, por është në gjendje pune.
- Aeroporti i Prishtinës “Adem Jashari”, i cili ndodhet rreth 110 km nga qyteti i Bajram Currit.
- Aeroporti i Gjakovës ndodhet rreth 40 km nga qyteti i Bajram Currit, i cili aktualisht nuk është në funksionim për pasagjerë, por po planifikohet që së shpejti të bëhet funksional.
- Ndërsa në Malin e Zi ndodhet Aeroporti i Podgoricës rreth 287 km larg nga Bajram Curri (nëpërmjet Kosovës).

#### **10.1.2 Përcaktimi i Politikave të Zhvillimit të Rrjetit Rrugor mbi bazën e Planeve Kombëtare**

##### *Plani Kombëtar i Transportit (ANTP) (2010)*

Objekti i këtij studimi (ose ANTP2), i financuar nga BE (Bashkimi Evropian) dhe i kryer nga Louis Berger, ishte rinovimi i Planit të parë Kombëtar Shqiptar të Transportit (ANTP1), i cili është hartuar në vitin 2004 me qëllim ofrimin e një vendi të sigurt, të



besueshëm, të një sistemi frytdhënës dhe plotësisht të integruar të transportit dhe infrastrukturës në Shqipëri, të cilat do të plotësojnë më mirë nevojat e lëvizjes së mallrave dhe pasagjerëve, duke qenë ekologjikisht dhe ekonomikisht të qëndrueshme. Ky studim synon zhvillimin e nën-sektorëve për 20 vitet e ardhshme.

Në ANTP2, së bashku me investimet dhe planet e veprimit është siguruar një strategji për zhvillimin dhe koordinimin për nën-sektorët e transportit. Në mënyrë të veçantë, është siguruar që rrjeti shqiptar i transportit duhet të integrohet në rajonin e Ballkanit dhe në atë Pan-Evropian, duke reflektuar zhvillimin ekonomik dhe parashikimet e trafikut.

Plani Kombëtar i Transportit, financuar nga Komisioni Evropian (ANTP), evidenton se Rrjeti Rrugor i Shqipërisë është rreth 18 000 km, nga të cilat:

- 3 636 km Rrugë Kombëtare (Autostrada);
- 10 500 km Rrugë Interurbane;
- 4 000 km Rrugë të tjera.

Nga ky rrjet rrugor:

- 1 138 km janë Rrugë Primare që lidhin qendrat kryesore;
- 1 998 km janë Rrugë Dytësore.

Nga rrjeti i përgjithshëm rrugor në Tropojë shtrihen:

- 143 km Rrugë Interurbane;
- 6.4 km Rrugë Urbane Dytësore;
- 245 km Rrugë Lokale.


#### *Planifikimi i ndërtimit të rrugëve të reja në Shqipëri*

Nga Plani Kombëtar i Transportit është marrë në konsideratë edhe analiza e planifikimit të rrugëve të reja në Shqipëri, në mënyrë që të kuptohet zhvillimi i ardhshëm i rrjetit kombëtar rrugor, i cili ka ndikim edhe në lëvizjen drejt Bashkisë së Tropojës. Nëpërmjet kësaj analize bëhet e mundur edhe lidhja e rrjetit rrugor të Tropojës me atë kombëtar.

Në këtë plan është propozuar përmirësimi i lidhjeve me akset kryesore, si dhe me mënyrën se si do ndërlidhet me:

- Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza”;





Lidhja e Bashkisë Tropojë me aeroportet brenda dhe jashtë Shqipërisë



Korridoret rrugore si dhe fluksi i trafikuar i trafikut  
Burimi: Plani Kombëtar i Transportit (ANTP2)

- Aeroportin e Kukësit;
- Kosovën;
- Portin e Durrësit.

Në lidhje me Tropojën, ky plan thekson zhvillimin e korridorit tërthor Shkodër-Vau i Dejës-Kukës, i cili rrit aksesin nga ana perëndimore e Shqipërisë.

### 10.1.3 Zhvillimi i rrjetit rrugor në Bashkinë e Tropojës

#### *Strategjia e zhvillimit të rrjetit rrugor*

Strategjia që është përdorur në hartimin e këtij plani konsiston si më poshtë:

- Përmirësimi i aksesueshmërisë në territor dhe në lidhjet e brendshme;
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore;
- Përmirësimi i lidhjeve midis qendrave kryesore me njëra-tjetrën;
- Përmirësimi i lidhjeve midis qendrave kryesore dhe fshatrave;
- Përmirësimi i rrugëve çiklistike;
- Krijimi i rrugëve për këmbësorë;
- Përmirësimi i rrugëve urbane ekzistuese;
- Përmirësimi i rrugëve rurale ekzistuese me ndërhyrje me ndikim të ulët në mjedis (sistemi gjeo-grid).


#### *Klasifikimi i rrjetit rrugor*

Në Bashkinë e Tropojës mungon klasifikimi i rrjetit rrugor sipas Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë. Për këtë arsye, në këtë Plan, klasifikimi i rrjetit rrugor është i domosdoshëm. Ky do të bëhet bazuar në karakteristikat gjeometrike të rrugëve. Bazuar në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, klasifikimi i rrjetit rrugor në zonën e Tropojës do të jetë si më poshtë:

- C Rrugë Interurbane Dytësore:* Rrugë me një karrexhatë, me të paktën një korsi lëvizjeje për sens dhe bankina, me funksion kryesor lidhjen e Tropojës me rritin kombëtar kryesor.







*E Rrugë Urbane Dytësore:* Rrugë me një karrexhatë, me të paktën dy korsi, bankina të shtruara dhe trotuare. Për qëndrimin janë parashikuar zona të pajisura me korsi manovrimi jashtë karrexhatës. Rruga urbane dytësore ka si funksion shpërndarjen e trafikut që vjen nga rrugët kryesore, zonat me funksione të ndryshme social-ekonomike dhe turistike.

*F Rrugë Lokale:* Rrugë urbane ose interurbane, e sistemuar në mënyrë të përshtatshme por që nuk bën pjesë në rrugët e mësipërme. Rrugë lokale janë të gjitha rrugët e tjera me kapacitet të ulët dhe që bëjnë lidhjet midis njësive funksionale dhe, për shkak të shpejtësisë së ulët, mund të përdoren nga mjetet, këmbësorët dhe bicikletat.

*Shtigje për këmbësorë:* Rrugë me bazament natyror, e formuar për kalimin e këmbësorëve ose të kafshëve.

### *Struktura e rrjetit rrugor*

Zhvillimi i rrjetit rrugor në Bashkinë e Tropojës konsiston në rikonstruksionin apo përmirësimin e infrastrukturës rrugore ekzistuese duke përfshirë edhe zgjerimin e tyre sipas klasifikimit të rrjetit, shtrirjen e rrugëve të reja, të cilat do plotësojnë lidhjet që mungojnë sot, duke rritur aksesibilitetin e zonës, përmirësimin e kryqëzimeve kryesore dhe nivelin e shërbimit të rrugëve. Në funksion të zhvillimit të zonës, me rëndësi është rikonstruksioni i rrugëve hyrëse të Bashkisë së Tropojës, të cilat do të paraqiten në vazhdim. Përsa i përket qytetit të Bajram Currit, do të ndërtohet një unazë që do të devijojë trafikun nga qendra e banuar e qytetit.

Lehtësimi i lëvizjes së automjeteve në Bashkinë e Tropojës, si dhe ulja e kostos së transportit do vijë si rezultat i ndërhyrjes në shtresat rrugore, duke i kthyer ato sipas standardit të bazuar në Kodin Rrugor të Shqipërisë. Përsa i përket nyjeve kryesore ku ndërpriten rrugë të kategorive të ndryshme dhe ku kryqëzohen katër ose më shumë rrugë, propozohet ndërtimi i rrethrotullimit, duke marrë parasysh hapësirën e nevojshme, pasi kjo zgjidhje është më efektive në mobilitetin dhe rrjedhshmërinë e automjeteve. Në varësi të flukseve të trafikut, rrethrotullimet mund të jenë me një ose disa korsi lëvizjeje, por gjithmonë të pajisur me ishuj për kalimin e këmbësorëve, kusht ky për sigurinë rrugore të këmbësorëve.

### *Projektet e zhvillimit të rrugëve*

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e rrjetit  
rrugor të sipas  
kategorive të  
kudit rrugor

Duke u bazuar në rrjetin aktual rrugor si dhe duke analizuar zhvillimin urban në të ardhmen, është hartuar rrjeti rrugor kryesor i Bashkisë së Tropojës, së bashku me





klasifikimin e tij. Në këtë plan përfshihet përmirësimi i rrugëve urbane dhe rurale ekzistuese, me ndikim minimal në mjedis, si dhe krijimi i rrugëve çiklistike dhe rrugëve për këmbësorë në zonat urbane, të cilat do të shërbejnë si zona totalisht për këmbësorë.

Në Tabelën 1 paraqitet lista e rrugëve që do të rikonstruktohen.

Siç vërehet edhe në tabelën e mësipërme, janë rreth 698.4 km rrugë, të cilat duhet

Nr	Emërtimi i Rrugës	Tipi i rrugës	Kategoria	Gjatësia (km)	Propozim
1	Iballë-Fierzë	Rrugë Interurbane Dytësore	0->C	49	Rruge e re
2	Lotaj-Vuksanaj-Lekbibaj	Rrugë Interurbane Dytësore	0->F	23	Rruge e re
3	Vau Dejës-Koman	Rrugë Interurbane Dytësore	F->C	32.5	Rikonstruksion
4	Rr. Besëlidhja e Malësisë-Rr. Azem Hajdari	Rrugë Urbane Dytësore	0->E	0.45	Rruge e re
5	Unaza Bajram Curri	Rrugë Urbane Dytësore	F-> E	xxxxx	Rikonstruksion
6	Sheshi Tahir Sinani-Rr. Mic Sokoli	Rrugë Urbane Dytësore	F->E	0.75	Rruge e re
7	Qafa e Luzhës-Luzhë	Rrugë Interurbane Dytësore	0->C	3.6	Rruge e re
8	Varreza-Rr. Besëlidhja e Malësisë-Rr. Azem Hajdari	Rrugë Interurbane Dytësore	0->C	1.19	Rruge e re
9	Kukës-Krumë-Bajram Curri	Rrugë Interurbane Dytësore	C->C	88.8	Rikonstruksion
10	Dushaj-Tplan-Bujan	Rrugë Lokale	0->F	5.6	Rikonstruksion
11	Tplan-Degë-Berishë-Pac	Rrugë Lokale	0->F	15.7	Rikonstruksion
12	Kam-Kepekë-Zogaj-Qafë Prush	Rrugë Lokale	0->F	5.2	Rikonstruksion
13	Lekbibaj-Prisë	Rrugë Lokale	0->F	4.3	Rikonstruksion
14	Gjonpepaj-Peraj	Rrugë Lokale	0->F	13.2	Rikonstruksion
15	Lekbibaj-Tetaj	Rrugë Lokale	0->F	4.25	Rikonstruksion
16	Shëngjergj Betoshë	Rrugë Lokale	0->F	2	Rikonstruksion
17	Ruga për në Curraj të Epërm	Rrugë Lokale	0->F	2.42	Rikonstruksion
18	Qedër Nj.-Resujë-Selimaj (prezantuar nga ADF)	Rrugë Lokale	0->F	0.98	Rikonstruksion
19	Ruga për në Lekurtaj	Rrugë Lokale	0->F	1.42	Rikonstruksion
20	Ruga për në Gri	Rrugë Lokale	0->F	0.74	Rikonstruksion
21	Markaj-Lëkurtaç	Rrugë Lokale	0->F	1.75	Rikonstruksion

Tabela 1  
Lista e rrugëve që do të ndërtohen dhe rikonstruktohen



22	Tetaj-Lëkurtaç	Rrugë Lokale	0->F	7.1	Rikonstruksion
23	Bujan-Resujë	Rrugë Lokale	0->F	1.58	Rikonstruksion
24	Rruga për në Resujë	Rrugë Lokale	0->F	8.16	Rikonstruksion
25	Bjram Curraj-Markaj	Rrugë Lokale	0->F	6.6	Rikonstruksion
26	Rruga për në Selimaj të Poshtëm	Rrugë Interurbane Dytësore	0->C	4.1	Rikonstruksion
27	Lamnica (Selimaj)	Rrugë Interurbane Dytësore	0->C	10.4	Rikonstruksion
28	Dragobi-Çerem	Rrugë Interurbane Dytësore	0->C	15	Rikonstruksion
29	Kërmajë-Kovaç-Myhejan-Astë	Rrugë Interurbane Dytësore	0->C	5	Rikonstruksion
30	Begaj-Babinë	Rrugë Interurbane Dytësore	0->C	5.5	Rikonstruksion
31	Dretova (Begaj)	Rrugë Interurbane Dytësore	0->C	10.5	Rikonstruksion
32	Tropojë-Shumicë				Rikonstruksion
33	Kërmajë-Shkëlzen				Rikonstruksion
34	Kërmajë-Brahaj				Rikonstruksion
35	Gosturan (Myhejan)				Rikonstruksion
36	Buçë-Qeli				
37	Rruga Poër në Papaj				
38	Rruga për në Padesh				
39	Rruga për në Stanet e Zapflakës				
40	Tropojë-Pitamina e Epërme				
41	Rruga Nacionale për në Kasaj				
42	Rruga Nacionale për në Gjecaj				
43	Rruga për në Boshnjak				
44	Gegaj-Boshnjak				
45	Trezhnicë-Boshnjak				
46	Qafë Morinë-Gegaj				
47	Mejdan				



48	Rruga për në Luzhë				
49	Ragan (Llugaj)-Rrogam (Llugaj)				
50	Llugaj(qendër)-Luzhë				
51	Dushaj-Breglum-Rajë				
52	Rruga Nacionale për në Breglum				
53	Dushaj-Dushaj i Sipërm				
54	Rruga për në Çukaj(Tplan)				
55	Rruga për në Bregu Isuf Ukaj				
56	Rruga për në Rexhaj (Berishë)				
57	Rruga për në Visoçë (Berishë)				
58	Rruga për në Shëngjergj (Berishë)				
59	SH23-Leniç				
60	Qytet Kam-fshat Kam				
61	Rruga për në Kam				
62	Rruga për në Mjckërbardhë(Zogaj)				
63	Rruga për në Haxhibegë (Zogaj)				
64	Rruga për në Mëhalla e Epërme (Zogaj)				
65	Rruga për në Vlad and Zherkë				
66	Rruga për në Sianaj (Vlad)				
67	Zherkë-Kepenek				
68	Zherkë-Viçidol				
Total					698.4

Shënim  
Me 0 janë  
shënuar rrugët  
të cilat nuk  
përputhen me  
klasifikimin e  
rrjetit rrugor  
sipas Kodit  
Rrugor dhe  
gjithashtu  
nuk janë të  
asfaltuara

të rikonstruktohen. Në funksion të zhvillimit të zonës, rol të rëndësishëm luan edhe rikonstruksioni apo rehabilitimi i rrugëve hyrëse në zonë apo në qytetin e Bajram Currit, siç janë:

- Rruga nacionale SH23 Kukës-Krumë-Bajram Curri, e cila kërkon një përmirësim të kthesave, me qëllim rritjen e shpejtësisë së lëvizjes dhe të sigurisë rrugore;



- Rruga Iballë-Fierzë, mbi gjurmën ekzistuese, e cila do të shtojë një alternativë të re për të aksesuar Tropojën;
- Rruga e re Vuksanaj-Lekbibaj-Bajram Curri, e cila do të shtojë një alternativë të re për të aksesuar Tropojën, kryesisht për turistët që vizitojnë pjesën perëndimore të Alpeve Shqiptare;
- Korridori Vau i Dejës-Koman-Fierzë-Bajram Curri, e cila është pjesë e aksit rrugor Adriatik-Gjakovë;
- Ndërtimi i urës në rrugën SH22 në hyrje të qytetit të Bajram Currit, pranë fshatit Dojan, e cila do të lehtësojë lëvizjen e automjeteve të rënda, autobusave dhe automjeteve të tjera;
- Ndërtimi i rrugës “Sali Kolgeci” nga rruga “Besëlidhja e Malësisë” deri në kryqëzimin e rrugës “Azem Hajdari”, e cila do të luajë rolin e një *bypass* për rrjedhën e trafikut;
- Ndërtimi i Unazës së qytetit të Bajram Currit, e cila do të devijojë rrjedhën e trafikut nga qendra e qytetit;
- Ndërtimi i një ure të re mbi Liqenin e Komanit, në afërsi të digës, e cila, për shkak të punimeve në portat e reja shkarkuese, duhet të zhvendoset dhe duhet të jetë në kuotë +4 m mbi atë të urës ekzistuese. Ura e re duhet të lidhet me rrugën ekzistuese dhe atë Iballë-Fierzë.

Bazuar në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, në këtë Plan janë propozuar edhe seksionet tip të rrugëve. Në Tabelën 2 paraqiten karakteristikat gjeometrike të seksioneve tërthore. Ndërsa, në Figurën 4 janë paraqitur seksionet tip të rrugëve.







#### 10.1.4 Parkimi

Kategoritë	Lloji i territorit	Nr. i korsive për sens	Shpejtësia km/orë	Fluksi l korsi në orë	Gjerësia e korsisë	Trotuarë	Gjerësia e trotuarit	Korsi e dedikuar Bus	Korsi e dedikuar Bicikletë	Parkim
C	Inter-urbane Dytësore	Interurbane	$\geq 1$	50-80	950	3.75	Jo	Jo	Jo	Jo
D	Inter-urbane Kryesore	Urbane	$\geq 2$	40-60	800	3.5	Po	5	Po	Po
E	Urbane Kryesore	Urbane	$\geq 1$	20-40	600	3	Po	3	Jo	Po
F	Lokale	Urbane	$\geq 1$	20-40	400	2.75	Po	1.5-2	Jo	Jo
	Shëtitorë	Urbane					Po	Jo	Po	Jo

Tabela 2  
Tabela e tipareve gjeometrike të seksioneve tërthore

Burimi: Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë







Seksonet tip të rrugëve




Rrugë Urbane Dytëzore  
Tropi i rrugës 15m




Rrugë Urbane Dytëzore  
Tropi i rrugës 23m




Rrugë Lokale  
Tropi i rrugës 7.5-10m



Rrugë Lokale  
Tropi i rrugës 9-13m




Rrugë Lokale  
Tropi i rrugës 6m



Rrugë Lokale  
Tropi i rrugës 8.5m







Rritja e numrit të automjeteve private në Bashkinë e Tropojës dhe rritja e numrit të turistëve e bën të domosdoshme rritjen e kapacitetit të parkimit, veçanërisht në zona të cilat kanë një dinamike më të lartë të aktivitetit social dhe ekonomik. Me qëllim parandalimin e problemeve të parkimeve të tejmbushur me automjete në qytetin e Bajram Currit, është i nevojshëm përcaktimi i tarifave të parkimit nga ana e Bashkisë së Tropojës. Parkimi i paligjshëm në rrugë, jashtë zonës së përcaktuar për parkim, zvogëlon numrin e korsive në dispozicion, duke shkaktuar çrregullim të trafikut, për pasojë uljen e kapacitetit të rrugëve dhe rritjen e kohës së udhëtimit dhe përfundimisht ndotjen e mjedisit nga trafiku. Një tjetër kriter është vendosja dhe identifikimi i vendeve të posaçme të parkimit për personat me aftësi të kufizuara. Identifikimi i këtyre mjeteve duhet të bëhet nëpërmjet lejeve dhe targave të posaçme të lëshuara dhe të autorizuara nga Bashkia e Tropojës.

#### *Shtimi i vendeve të parkimit dhe ngritja e sistemeve të informacionit për parkim*


Në zonën e planifikuar për qëllime urbane të caktuara, siç është rasti i ndërtimit të termi-naleve, vendet shtesë të parkimit janë të domosdoshme. Për këtë arsye është propozuar që bashkë me terminalet të ndërtohet dhe një hapësirë parkimi. Parkimet e tjera shtesë që do të plotësojnë nevojat e zhvillimit të zonave të reja urbane, do jenë të integruara në koeficientët e ndërtimit, pra do të ketë kate ndërtimi të destinuar për plotësimin e nevo-jave të parkimit. Si konkluzion është menduar që vendet e parkimit të parashikuara më sipër, shoqëruar me vendet e parkimit në rrugë, do mundësojnë përballimin e kërkesës së pritshme për parkim. Kur këto parkime të jenë ndërtuar do lindë nevoja edhe për një sistem informimi të parkimit, me qëllim udhëzimin dhe orientimin e përdoruesve të mjeteve drejt këtij parkimi publik dhe parkimeve të tjera private që mund të ndërtohen. Informacioni parashikon dhënien e orientimit të lëvizjes si dhe nëse ka vende të lira ose jo në vëndndodhjet e parkimeve, kjo realizohet nëpërmjet mesazheve elektronike të shfaqura në ekranet informative.

#### *Sistemi i parkimit me pagesë*

Aplikimi i Parkimit me pagesë duke vendosur rregulla të çmimeve të parkimit, veçanë-risht për parkimin në rrugë, duhet të vlerësohet në mënyrë të drejtë, duke pasur si qëllim një përdorim më të frytshëm të rrugëve, si dhe për të siguruar kapacitetin e plotë të rrjetit rrugor. Automjetet e parkuara, nëse mund të jenë të parkuara në rrugë ose jashtë saj, duhet të paguajnë për parkimin, gjë që do të sjellë të ardhura të ndjeshme në Bashkinë e Tropojës, të cilat mund të përdoren në një fushë të gjerë, përfshi dhe investime në ndër-timin e infrastrukturës ose përmirësimin e shërbimeve të ndryshme. Duhet patur kujdes trajtimi i bizneseve përgjatë rrugëve, që të mos pësojnë politika taksimi në dëm të imo-

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
transportit  
publik





resave të tyre ekonomike, duke menduar për parkime të rezervuara, zona të përbashkëta të ngarkimit/shkarkimit, etj. Po ashtu rezidentët duhet të kenë të drejtën e parkimit në parkimet publike në zonën e tyre të banimit, duke i pajisur me karta të veçanta. Në Figurën 6 tregohet një aparaturë për sistemin e biletimit të parkimit me pagesë. Gjithashtu, nisur nga eksperiencia që Bashkia e Tiranës ka aplikuar së fundmi në Tiranë, ku pagesa e parkimit kryhet nëpërmjet dërgimit të një mesazhi me celular me tekst targën e automjetit, propozojmë që kjo mënyrë të aplikohet edhe në qytetin e Bajram Currit.

### *Sheshet e kamperave, kampingut dhe pikat panoramike*

Duke qenë se në Bashkinë e Tropojës ndodhen disa pika turistike, të cilat frekuentohen nga turistë të kategorive të ndryshme, që e vizitojnë këtë vend me rulotët e tyre apo dëshirojnë të qëndrojnë në çadra, ky plan propozon disa sheshe kampingu dhe kamperash. Gjithashtu, në këtë plan propozohen edhe 7 pika panoramike, ku turistët mund të parkojnë automjetet e tyre, të pushojnë dhe të shijojnë pamjet mahnitëse që këto pika ofrojnë. Këto pika panoramike janë paraqitur në vizatimet përkrah.

## **10.2 Propozimet për transportin publik**

### **10.2.1 Transporti publik rrugor**

Në Bashkinë e Tropojës, transporti publik përdoret për lëvizjet brenda zonës funksionale dhe jashtë saj. Linjat kryesore nacionale përfshijnë: Tiranë, Durrës, Gjakovë, Krumë dhe Kukës. Linjat e transportit publik nga Bajram Curri në Tiranë si dhe për në qendrat e njësisve administrative (Fierzë, Tropojë, Llugaj dhe Bujan) dhe Gjakovë janë të licensuara. Njëkohësisht, Bajram Curri lidhet me të gjitha qendrat e njësisve administrative si dhe me disa nga fshatrat kryesore me anën e linjave të licensuara të transportit publik.


Transporti publik që lidh zonën me kryeqytetin apo me qytetet e tjera të Shqipërisë realizohet në përgjithësi me mjete prej 17-20 vendesh, nëpërmjet itinerarit Bajram Curri-Qafë Morinë-Gjakovë-Morinë-Kukës-Tiranë, i cili është itinerari më i preferuar për shkak të kohës më të vogël të udhëtimit. Kjo linjë shërben më një frekuencë prej 30 minutash nga ora 06.00 - 14.00.

Transporti publik nga qendrat e njësisve administrative bëhet mesatarisht 6-8 herë në ditë. Në Lekbibaj, ky transport realizohet 3 herë në ditë. Gjithashtu, për fshtrat e mëdhenj të zonës funksionale për në Tropojë dhe Bajram Curri shërbejnë taksi 8+1.

Nga Bajram Curri për në Gjakovë, rreth 37km distancë, udhëtojnë mesatarisht çdo ditë

(në faqen paraardhëse)  
Skema e linjave të propozuara të transportit publik







rreth 5-6 taksi 8+1.

Përdorimi i transportit publik nga qytetarët për të shkuar në punë arrin nivelin më të lartë në Fierzë, me 25%, ndërkohë në qendrën funksionale Bajram Curri është 6.9 %. Infrastruktura e fragmentuar ndërmjet bashkisë dhe njësisë administrative bën që aksesin ndaj këtij transporti të jetë i ulët.

Përdorimi i automjeteve private është rritur me 37% krahasuar me vitin 2006. Sipas censusit të vitit 2011, në zonën e Tropojës ndodhen 36 automjete/1000 banorë. Në vitin 2013, numri i automjeteve private u rrit në 306 krahasuar me 256 që ishte një vit më parë. Ky është një tregues i rëndësishëm, i cili tregon nivelin e frekuentimit të transportit publik.

Të analizohet dhe të ristrukturohet për një sistem të qëndrueshëm transporti, duke marrë parasysh edhe rritjen e fluksit në të ardhmen, duke konsideruar edhe numrin e turistëve që është gjithnjë e në rritje. Me ristrukturimin e rrjetit të transportit publik duhet të vendosen linja të rregullta në përputhje me legjislacionin në fuqi që të lidhë qendrën e Tropojës me njësitë e saj administrative si dhe të lidhë atë me Durrësin, Tiranën dhe Kosovën. Për secilën linjë, Bashkia e Tropojës duhet të përcaktojë oraret e shërbimit, frekuencën, numrin e nevojshëm të mjeteve, tipin e mjeteve (autobus i madh, i vogël, taksi 8+1), vitin e prodhimit të mjeteve në mënyrë që të ofrohet një shërbim komod dhe konform kërkesave në rritje të udhëtarëve dhe nivelit të ndotjes në mjedis. Bashkia duhet të promovojë transportin publik dhe incentivojë qytetarët të përdorin transportin publik, gjë e cila sjell uljen e kostos së transportit, shërbim për të gjitha kategoritë e qytetarëve dhe zvogëlimin e ndotjes së mjedisit. Gjithashtu, është i nevojshëm edhe krijimi i shoqatave të transportit publik, të cilët do të kontribuojnë në formalizimin e transportit publik, që të jepet mundësia e nënkontraktimit të shërbimit dhe rregullimit të itinerareve, orareve dhe çmimeve.



Një tjetër faktor i rëndësishëm është instalimi i linjave urbane për transportin e nxënësve të shkollave si nevojë e përqendrimit të shërbimeve të ofruara nga bashkia në zona më specifike. Shpërngulja dhe shpërndarja e popullsisë gjatë viteve të fundit ka sjellë eliminimin e shkollave në fshatra si mungesë e nxënësve dhe përqendrimin e tyre në zona me densitet të lartë urban si pjesë e përqendrimit të shërbimeve. Përqendrimi i shërbimeve arsimore në Njësitë Administrative krijon nevojën për krijimin e një transporti urban që do të transportojë nxënësit nga shtëpitë e tyre në fshatra drejt shkollës dhe anasjelltas. Është e rëndësishme që mjetet e transportit urban dhe atyre të arsimit të jenë të sigurt, miqësorë me mjedisin, të identifikueshëm lehtë dhe me vende parkimi të specifikuar.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe identifikimi i mjeteve të transportit publik, të cilët duhet të jenë të dallueshëm për këdo, madje edhe për turistët shqiptarë apo të huaj. Gjithashtu, edhe stacionet e autobusëve duhet të jenë të pajisur me një kabinë, stol dhe hartën e transportit publik.

(në faqen  
paraardhëse)  
Skema e  
transportit  
publik ujjor







- Rrugë kryesore
- ..... Rrugë dytësore
- Rrugë jashtë territorit bashkiak
- ⊙ Qendër kryesore
- Qendër dytësore
- Fshat
- ▭ Platformë shërbimesh
- △ Stacion intermodal



Skema e transportit publik ndërqytetas

Ristrukturimi i plotë i sistemit të transportit publik në Bashkinë e Tropojës do të realizohet me përfundimin e përmirësimit të infrastrukturës rrugore. Në Tabelën 3 janë paraqitur linjat e transportit publik ekzistues dhe ato në të ardhmen.

1	B. Curri - Tpla	B. Curri - Lekbibaj (Dushaj)	BC - Dega - Berisha
2	B. Curri - Dushaj	B. Curri - Tropojë (Linjë e dedikuar për mësuesit)	
3	B. Curri - Degë	B. Curri - Kërmajë	B. Curri - Luzhë - Pac
4	B. Curri - Tpla (nga ura e Bujanit)	B. Curri - Pac	Muhejani - Tropoja
5	Luzhë (Shkolla) - Llugaj (Shkolla)	Zherkë - Vlad - B. Curri	Shkëzani - Kërmaja
6	B. Curri - Luzhë (Shkolla)	Mash - B. Curri	Gegaj - Papaj
7	B. Curri - Llugaj (Shkolla)	Rodogosh - B. Curri	Kasaj - B. Curri
8	Sopot - Llugaj (Shkolla) (autobus shkolle)	Prush - B. Curri	Lekbibaj - Salca
9	B. Curri - Cërnic (autobus shkolle)	Prush - Zogaj qendër	Zherka - Kepeneku
10	B. Curri - Valbonë	Gri - B. Curri	Viçidol - B. Curri
11	B. Curri - Dragobi	Selimaj - Lekurtaj - B. Curri	Unaza Jugore Qytet
12	B. Curri - Shoshan	Markaj - B. Curri	Unaza Veriore Qytet
13	B. Curri - Gjakovë - Prishtinë	Bujan - Dojan - B. Curri (Shkolla)	Markaj - Lekurtaj
14	B. Curri - Krumë - Kukës - Tiranë/Durrës	Bujan - Dojan - B. Curri (Shkolla)	-

Tabela 3  
Tabela e linjave të transportit publik ekzistues dhe ato në të ardhmen

### 10.2.2 Transporti publik ujq

Aktualisht, një mënyrë tjetër transporti për në Tropojë është ai ujq, i cili kryen transportin e pasagjerëve nga Komani në Fierzë, nëpërmjet liqenit të Komanit. Bazuar në vizitën e kryer në terren, vihet re se porti i trageteve në bashkinë e Tropojës është në kushte primitive, i cili nuk ofron asnjë nga shërbimet bazë të një stacioni, dhe gjithashtu është pronë private, ku përdorimi i tij kryhet kundrejt një pagese. Për këtë arsye, në këtë Plan propozohet ndërtimi i porteve të trageteve në mënyrë bashkëkohore, të cilët duhet të jenë të pajisur me të gjitha shërbimet e duhura për udhëtarët, si: biletari, tualete, bare, vende parkimi etj. Këto porte duhet të funksionojnë në formën e mini-terminaleve intermodale, ku të ndërthuret me rrjetin e transportit publik.

Gjithashtu, ky Plan propozon ngritjen e 2 linjave të reja të transportit ujq, të cilat do të



rrisin alternativat e transportit për të aksesuar zonën. Këto linja, jo vetëm që do të shërbejnë si mënyra të reja transporti, por ato do të kenë edhe funksion turistik, itineraret e të cilave ofrojnë peizazhe mahnitëse. Këto linja janë:

- Fierzë-Bajram Curri;
- Aeroporti i Kukësit-Kukës-Fierzë.


Në vijim të përmirësimit të transportit ujqor, propozohen edhe disa ndalesa të reja përgjatë itinerareve vozitëse, të cilat janë:

- Fierzë, Terminal Intermodal;
- Markaj (Tetaj), Terminal Intermodal;
- Salca;
- Poravë, Terminal Intermodal;
- Shëngjergj, Terminal Intermodal.



Në Figurën 12 paraqitet harta e transportit ujqor në Bashkinë e Tropojës.

### 10.2.3 Terminali i pasagjerëve

Faktori tjetër i rëndësishëm në promovimin e transportit publik është krijimi i



Platformë shërbimesh në rrugë kryesore



Platformë shërbimesh në rrugë dytësore



Skema e shërbimeve në transportin publik



infrastrukturës në nisje/mbërritje të udhëtimit të ndërmarrë. Nevoja e një terminali të mirëfilltë pasagjerësh është një prioritet për Bashkinë e Tropojës, pasi përveç krimit të kushteve më të mira për pasagjerët, duke u pajisur me të gjitha shërbimet e nevojshme si shërbime sanitare, tregtare, mjedise pritëse, vende parkimi do të shërbente edhe për rritjen e imazhit të Bashkisë së Tropojës. Ky terminal do të shërbejë për integrimin e të gjitha linjave të transportit, të linjave qytetëse, rreth-qytetëse, ndër-qytetëse dhe linjave të tragetit, ku qytetarët mund të parkojnë automjetet e tyre dhe më pas të përdorin transportin publik për të mbërritur në destinacone të ndryshme. Terminali multimodal duhet të jetë i pozicionuar në një vend strategjik, pranë qytetit, i cila siguron një akses të lehtë për automjetet që vijnë në Tropojë.

### 10.3 Platformë për shërbim

PPV propozon një sërë ndërhyrjesh përgjatë akseve kryesore dhe rrugëve dytësore për të ofruar shërbime të ndryshme gjatë udhëtimeve në këtë territor. Kategoria e platformës është e lidhur me nivelet e ndryshme të infrastrukturës që shërben. Këto platforma mund të përmbajnë një gamë të gjerë shërbimesh. Ato do të punojnë në një sistem që përfshin stacionet intermodale të propozuara në qendrat kryesore të territorit të bashkisë, duke u siguruar mundësinë e lëvizjes përmes transportit publik, midis qyteteve kryesore brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe qendrave të banuara në Tropojë.

Ndërhyrjet ndahen në dy kategori të ndryshme të cilat përfshijnë:

- Platformat e shërbimeve në rrugët kryesore (zona të mbuluara të pritjes dhe të pushimit, stacion autobusash, dyqan/treg, bar/restorant, shesh lojërash për fëmijë, pikë shpërndarje karburanti/shërbim makine/larje makine dhe një zonë parkimi) janë në udhëkryqe shumë strategjike dhe janë zona pushimi për njerëzit që udhëtojnë me mjete të ndryshme transporti. Këto struktura duhet të jenë afër fshatrave të lidhura drejtpërdrejt me rrugët kryesore, duke siguruar mundësinë e biznesit të vogël dhe punësimit për banorët. Tregu do t'u lejojte krijuesve dhe artizanëve vendas të shesin prodhimet e tyre dhe të zhvillojnë një ekonomi vendore.
- Platforma e shërbimeve në rrugët dytësore (zona të mbuluara të pritjes dhe të pushimit, stacion autobusash, kioskë, kopsht dhe parkim) janë zona të vogla pushimi të imagjinuara si vend për ndalim të shkurtër ose pritjen e një autobusi.
- 

### 10.4 Rrjeti i lëvizshmërisë së butë

Tropoja është një nga pikat turistike të zonës së Alpeve Shqiptare, e cila vizitohet nga



shumë turistë vendas dhe të huaj. Kjo zonë ofron peizazhe mjaft të bukura, të cilat shumë prej turistëve dëshirojnë t'i përshkojnë me këmbë ose me biçikleta nëpërmjet shtigjeve ekzistuese. Këto shtigje janë në gjendje jo të mirë, ku mungojnë sinjalistika, hartat orientuese, etj. Për këtë arsye, në këtë Plan propozohet që Bashkia Tropojë të përmirësojë të gjitha shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta me ndërhyrje të lehta pa ndikim negativ në mjedis, të vendosë sinjalistikën e posaçme dhe gjithashtu të evidentojë dhe krijojë pika panoramike përgjatë tyre. Përveç të tjerash, ajo duhet të përgatisë edhe hartat përkatëse të shtigjeve.

Në mënyrë që të rritet më tej aksesimi në Bashkinë Tropojë nëpërmjet shtigjeve, ky Plan propozon hapjen e një pike të re policore në Rosni, e cila do të shërbejë vetëm për këmbësorët.










11 ZHVILLIMI URBAN





## 11.1 Zhvillimi ekonomik dhe urban

Kemi ndarë çdo njësi vendore në zona të ndryshme ekonomike. Kufiri i çdo zone është përcaktuar duke marrë në konsideratë morfologjinë e territorit, rrjetin rrugor të propozuar dhe tipet e aktiviteteve kryesore ekonomike.

Aktivitetet e listuara u referohen sektorëve të ndryshëm ekonomikë:

- Bujqësisë;
- Turizmit;
- Ekstraktimit (miniera dhe gërmim);
- Burimeve të rinovueshme (dru zjarri).

### *Bajram Curri*

Zhvillimi urban i qendrës kryesore: Konsolidim dhe zgjerim i qytetit ekzistues.

### ZE-BC01

(Për shkak të madhësisë së tij, të gjitha njësitë vendore të Bajram Currit janë konsideruar si një zone e vetme ekonomike)

Veprimtaritë	Bajram Curri: <ul style="list-style-type: none"><li>• Thertore, Kolektorë të gështenjave, Qendër certifikimi, Treg lokal, Treg shumice</li><li>• Qendër turistike, Akomodim turistësh</li></ul>
--------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
zhvillimit  
ekonomik dhe  
urban



### *Margegaj*

Zhvillimi urban i qendrës kryesore: Konsolidim.

#### ZE-MA01

(Koçanaj-Margegaj-Shoshan)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	<p>Margegaj:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Pikë shpërndarjeje</li></ul> <p>Koçanaj:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor i drurëve frutorë, Baxho (bulmetore)</li></ul> <p>Shoshan:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Infrastruktura turistike</li></ul>
--------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

#### ZE-MA02

(Rrogam-Valbonë-Çerem-Dragobi)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt turizmit

Veprimtaritë	<p>Valbonë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Infrastruktura turistike, Akomodime</li></ul> <p>Çerem:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Infrastruktura turistike</li></ul> <p>Dragobi:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Pikë shpërndarjeje, Thertore</li><li>• Infrastruktura turistike</li></ul>
--------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------



### *Tropojë*

Zhvillimi urban i qendrës kryesore: Konsolidim.

#### ZE-TR01

(Shumicë-Ahmataj-Tropojë-Kasaj-Viçidol)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	Shumicë-Ahmataj: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor, Baxho</li></ul> Tropojë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor i drurëve frutorë, Treg lokal</li><li>• Infrastruktura turistike (hyrje për në park)</li></ul>
--------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

#### ZE-TR02

(Begaj-Babinë-Kojel)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	Babinë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor i drurëve frutorë</li></ul>
--------------	--------------------------------------------------------------------------------------

#### ZE-TR03

(Shkëlzen-Kërrnajë-Myhejan-Kovaç)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë; me rëndësi të veçantë është prodhimi i gështenjave dhe bimëve mjekësore

Veprimtaritë	Shkëlzen: <ul style="list-style-type: none"><li>• Infrastruktura turistike (hyrje për në park)</li></ul> Kërrnajë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor gështenjash, Baxho (bulmetore)</li></ul> Kovaç: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor bimësh mjekësore</li></ul>
--------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------



#### ZE-TR04

(Buçaj-Papaj-Gegaj)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	Buçaj: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor, Baxho (bulmetore)</li><li>• Infrastruktura turistike (hyrje për në park)</li></ul>
--------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------





### *Llugaj*

Zhvillimi urban i qendrës kryesore: Konsolidim.

#### ZE-LU01

(Bukovë-Llugaj-Rragam-Sopot)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë, me prezencë të minierave në zonën e Sopotit

Veprimtaritë	Llugaj: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor, Baxho, Treg lokal, Shkollë bujqësore</li><li>• Infrastruktura turistike (pikë informacioni)</li></ul>
--------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

#### ZE-LU02

(Luzhë)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	Llugaj: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor, Baxho</li></ul>
--------------	---------------------------------------------------------------------------

#### ZE-LU03

(Cernicë-Paqë)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	Cernicë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor, Baxho, Pikë shpërndarjeje</li></ul>
--------------	------------------------------------------------------------------------------------------------



**Bujan**

Zhvillimi urban i qendrës kryesore: Konsolidim.

**ZE-BU01**

(Bilatë-Dojan-Fushë Lumë-Bujan)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	Dojan: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor i drurëve frutorë, Baxho</li></ul> Bujan: <ul style="list-style-type: none"><li>• Pikë shpërndarjeje</li></ul>
--------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

**ZE-BU02**

(Markaj-Rosujë-Gri e re-Lëkurtaç-Selimaj-Gri)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë, me rëndësi të veçantë është prodhimi i gështenjave

Veprimtaritë	Markaj: <ul style="list-style-type: none"><li>• Infrastruktura turistike (hyrje për në park)</li></ul> Gri: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor gështenjash</li></ul>
--------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------



*Bytyç*

Zhvillimi urban i qendrës kryesore: Konsolidim.

ZE-BY01

(Pac-Vlad-Zherkë)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë me prezencë të minierave

Veprimtaritë	Pac: • Kolektor, Baxho, Treg lokal
--------------	---------------------------------------

ZE-BY02

(Kam Qytet-Kepenek-Zogaj-Prush)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë dhe ekstraktimit (miniera)

Veprimtaritë	Kam Qytet: • Thertore e vogël, Pikë shpërndarjeje  Zogaj: • Kolektor, Baxho
--------------	-----------------------------------------------------------------------------------------

ZE-BY03

(Mashë-Berishë-Vishoçë)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	Mashë: • Kolektor i drurëve frutorë
--------------	----------------------------------------

Përveç zonave me zhvillime ekonomike specifike, zona kodrinore e Bytyçit duhet të orientohet drejt një ekonomie të prodhimit të lëndëve drusore kryesisht për ngrohje. Cilësia e tokave në këtë territor nuk jep mundësi për zhvillime të tjera dhe aktiviteti i pylltarisë, përveç prodhimit të lëndës djegëse të rinovueshme, do të sillte përmirësime të ndjeshme në cilësinë e tokës.



**Fierzë**

Zhvillimi urban i qendrës kryesore: Konsolidim.

**ZE-FI01**

(Breglumë-Dushaj)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë, me prezencë të shesheve të ekstraktimit përgjatë lumit Valbonë

Veprimtaritë	<p>Dushaj:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Treg lokal, Thertore</li><li>• Infrastrukturë turistike (pikë informacioni)</li><li>• Terminal tragetesh</li></ul> <p>Breglumë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Infrastrukturë turistike (hyrje në park)</li></ul>
--------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

**ZE-FI02**

(Tpla)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	<p>Dushaj:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor, Baxho</li></ul>
--------------	----------------------------------------------------------------------------------



### *Lekbibaj*

Zhvillimi urban i qendrës kryesore: Konsolidim.

#### ZE-LE01

(Lekbibaj-Curraj i poshtëm-Gjonpepaj-Peraj)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë dhe turizmit

Veprimtaritë	Gjonpepaj: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor, Baxho</li></ul> Lekbibaj: <ul style="list-style-type: none"><li>• Treg lokal, Thertore e vogël</li><li>• Infrastrukturë turistike (pikë informacioni)</li></ul>
--------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

#### ZE-LE02

(Tetaj-Shëngjergj-Betosh)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë

Veprimtaritë	Shëngjergj: <ul style="list-style-type: none"><li>• Kolektor gështenjash</li></ul>
--------------	------------------------------------------------------------------------------------

#### ZE-LE03

(Brisë-Salcë-Palçë)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt bujqësisë, me mundësi për zhvillim të veprimtarive turistike

Veprimtaritë	Salcë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Pikë shpërndarjeje</li></ul>
--------------	-----------------------------------------------------------------------------

#### ZE-LE04

(Curraj i sipërm-Qerec-Mulaj)

Kjo zonë është e orientuar kryesisht drejt turizmit

Veprimtaritë	Curraj i sipërm: <ul style="list-style-type: none"><li>• Pikë shpërndarjeje</li><li>• Infrastrukturë turistike (pikë/qendër informacioni)</li></ul>
--------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------




## 11.2 Parashikimi dhe shpërndarja demografike e popullsisë

### 11.2.1 Projektioni i popullsisë

Nga të dhënat e Gjendjes Civile Tropojë, del qartë se tendencat demografike janë negative për 10 vitet e fundit, siç shihet dhe në grafikun e mëposhtëm.

Nisur nga të dhënat e gjendjes civile, tendencat demografike të dekadës të fundit dhe duke neglizhuar faktorët ekzogjen të mundshëm mund të përdorim metodën e regresionit linear, metodën gjeometrike dhe atë aritmetike, për të projektuar popullsinë e regjistruar në Bashkinë Tropojë për 15 vitet e ardhshme.



Grafiku 1  
Burimi:  
Gjendja Civile,  
Bashkia Tropojë  
2016  
Përpunimi: IP3

Duke u nisur nga llogaritja e popullsisë me metodën e regresionit linear të korrigjuar, regresionit aritmetik dhe gjeometrik, dalim në përfundimin që popullsia e pritshme në Bashkinë Tropojë për vitin 2031 mesatarisht do të jetë 23,421 banorë.


Projektioni vlerëson që popullsia e regjistruar në gjendjen civile në Njësitë Administrative të Bashkisë Tropojë do të ketë një tendencë në rënie nga 2016 në 2031:

- Një rënie prej 510 njerëz për Njësinë Administrative Tropojë;
- Një rënie prej 979 njerëz për Njësinë Administrative Bajram Curri;
- Një rënie prej 290 njerëz për Njësinë Administrative Bytyç;
- Një rënie prej 871 njerëz për Njësinë Administrative Lekbibaj;
- Një rënie prej 704 njerëz për Njësinë Administrative Fierzë;
- Një rënie prej 170 njerëz për Njësinë Administrative Margegaj;
- Një rënie prej 930 njerëz për Njësinë Administrative Bujan;

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
kapacitetit  
mbajtës të  
popullsisë







- Një rënie prej 371 njerëz për Njësinë Administrative Llugaj.

Bashkia e Tropojës, pritet të njohë një rënie prej 4,824 njerëz për 15 vitet në vijim, gjë që shfaq qartë nevojat e bashkisë për të ndërmarrë politika sociale dhe ekonomike, për të reduktuar eksodin demografik të territorit të saj, ku tendencat migratore theksohen nga të dhënat Census 2011.

Projeksioni demografik									
Viti	Topojë	Bajram Curri	Bytyç	Lekbibaj	Fierzë	Margegaj	Bujan	Llugaj	Bashkia Tropojë
2007	5,635	8,458	2,025	2,700	2,961	3,025	3,626	2,374	30,804
2008	5,606	8,312	2,014	2,682	2,652	3,026	3,596	2,368	30,256
2009	5,517	8,292	1,986	2,012	2,619	3,122	3,471	2,312	29,331
2010	5,482	8,254	2,020	2,235	2,684	3,145	3,467	2,312	29,599
2011	5,495	8,423	2,065	2,126	2,604	3,186	3,265	2,298	29,462
2012	5,520	8,202	2,090	1,976	2,388	2,979	2,947	2,181	28,283
2013	5,545	8,192	2,095	1,972	2,389	3,013	2,902	2,167	28,274
2014	5,445	8,219	2,100	1,967	2,465	3,047	2,857	2,152	28,252
2015	5,443	8,030	2,110	1,961	2,490	3,040	2,859	2,156	28,089
2016	5,464	8,230	2,103	1,912	2,465	3,047	2,881	2,143	28,245
2017	5,412	8,102	2,063	1,811	2,375	3,029	2,783	2,108	27,682
2018	5,378	8,039	2,044	1,750	2,328	3,018	2,720	2,083	27,360
2019	5,345	7,976	2,025	1,691	2,281	3,007	2,657	2,058	27,041
2020	5,311	7,914	2,007	1,633	2,236	2,996	2,595	2,034	26,725
2021	5,278	7,852	1,988	1,575	2,190	2,985	2,534	2,009	26,412
2022	5,245	7,790	1,970	1,518	2,145	2,974	2,473	1,985	26,101
2023	5,212	7,729	1,952	1,462	2,101	2,963	2,413	1,960	25,793
2024	5,179	7,668	1,934	1,407	2,057	2,952	2,353	1,936	25,488
2025	5,147	7,608	1,916	1,353	2,013	2,942	2,294	1,912	25,185
2026	5,114	7,548	1,899	1,299	1,970	2,931	2,236	1,889	24,885
2027	5,082	7,488	1,881	1,246	1,927	2,920	2,178	1,865	24,587
2028	5,050	7,428	1,864	1,194	1,885	2,909	2,120	1,841	24,292
2029	5,018	7,369	1,847	1,142	1,843	2,898	2,064	1,818	23,999
2030	4,986	7,310	1,830	1,091	1,802	2,888	2,007	1,795	23,709
2031	4,954	7,251	1,813	1,041	1,761	2,877	1,951	1,772	23,421
Diferencat 2016-2031									
<b>Total</b>	<b>-510</b>	<b>-979</b>	<b>-290</b>	<b>-871</b>	<b>-704</b>	<b>-170</b>	<b>-930</b>	<b>-371</b>	<b>-4824</b>

Tabela 8  
Projeksioni demografik  
Burimi: IP3


Tabela 3. Projeksioni demografik

### 11.2.2 Kapaciteti mbajtës

Përkrah projeksioneve demografike dhe tendencave të konfirmuara së fundmi në këtë territor vërehet një tendencë e re si ajo e rikthimit të banorëve dikur të emigruar. Kryesisht banorët e rikthyer janë ata që kanë emigruar jashtë kufijve të shtetit, të cilët rikthehen për të investuar kursimet e tyre. Shembuj mund të jenë ai i pikës së grumbullimit dhe përpunimit të gështenjave (ende i papërfunduar) por edhe disa ferma më të përmbajtura në dimensione apo aktivitete të lidhura me turizmin. Kjo tendencë

(në faqen paraardhëse)  
Harta e intensitetit të popullsisë





kthen në domosdoshmëri marrjen në konsideratë të një skenari të ndryshëm nga ai i projekcionit demografik. Skenari i përzgjedhur si më i realizueshmi është ai në të cilin fenomeni i emigrimit është ndaluar dhe tendenca e uljes së rritjes natyrore të popullsisë barazpeshohet nga rritja e tendencës së rikthimit të popullsisë së emigruar. Sipas këtij skenari numri i pritshëm i popullsisë në bashkinë Tropojë do të ishte 31281 banorë. Kapaciteti mbajtës i propozuar nga ky plan merr në konsideratë këtë skenar së bashku me “kapacitetin akomodues turistik” të sugjeruar nga Plani Kombëtar Sektorial Alpet e Shqipërisë dhe arrin një kapacitet mbajtës të zhvillueshëm në kushtet aktuale për rreth 40000 persona, ndër të cilët 4100 përdorues (turistë). Në mënyrë që t’i jepet shtysë zhvillimit ekonomik dhe urban dhe të kontrastohet regresioni demografik, ky plan ka përdorur një përfaqje disi fleksibël duke lënë të hapur mundësi për zhvillim në zona rurale, të cilat në çdo rast janë të kushtëzuara nga nevojat për infrastrukturë. Në tërësinë e tij, në skenarin e zhvillimit total të mundësive të planit, numri maksimal i popullsisë në bashkinë Tropojë do të arrinte 60000 banorë për një sipërfaqe prej 1057.3 km<sup>2</sup>.

### 11.3 Tipologjitë e propozuara hapësinore dhe metodat e ndërhyrjes në territor


Si fillim, është bërë një analizë e kujdesshme mbi gjithë territorin, me fokus vendbanimet. Pas kësaj, janë listuar dhe theksuar karakteristikat e përgjithshme të tyre në mënyrë që të mund të bëhet kategorizimi në shkallë më të madhe në fazën e mëvonshme. Në këtë mënyrë, është më e lehtë të identifikohen karakteristikat specifike për çdo vendbanim, të bëhet një analizë më e detajuar dhe të njihen problematikat specifike apo lokale. Kështu, mund të krijojmë një panoramë të qartë për çdo zonë urbane.

Pas analizës, identifikimit dhe kategorizimit të vendbanimeve, është bërë nga një propozim për secilin për të përmirësuar identitetin dhe karakterin e tyre, në të njëjtën kohë duke dhënë zgjidhje për problemet e tyre. Natyrisht, ndërhyrja është menduar me kujdes për të patur impakt minimal.

Ndërtesat që ndodhen në territorin e bashkisë formojnë tri tipologji kryesore hapësinore në territor: vendbanimet bujqësore e blegtorale, vendbanimet e prodhimit dhe vendbanimet që shërbejnë si qendra administrative. Këto kategori ndahen në nënkategori të tjera, bazuar në morfologjinë e vendbanimit dhe terrenit, llojin e prodhimtarisë me të cilën lidhet vendbanimi dhe shkallën hierarkike për nga rëndësia dhe funksionet administrative. Nga sa vihet re, vendbanimet gjenden thajse gjithmonë pranë lumenjve ose përrenjve të ndryshëm, ose në luginat e tyre. Për rastin e dytë, fshatrat fushorë që kanë tokë të bollshme bujqësore mund të kenë rezervuarë pranë tyre, për vaditje gjatë periudhës së thatësisë.

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
intesiteteve







### 11.3.1 Vendbanimet bujqësore e blegtorale

Këto vendbanime kanë si ekonomi bazë bujqësinë dhe blegtorinë. Në bazë të morfologjisë së relievit e terrenit ku ndodhen, ato ndahen në tri nënkategori:

*Vendbanimet fushore:* Këto vendbanime shtrihen në fushat pranë lumenjve dhe kanë tokë të bollshme bujqësore. Fshatrat mund të ndahen në të shpërndarë - ku banesat janë larg njëra-tjetrës, secila me pronën e saj rreth shtëpisë - dhe agregate - ku banesat janë pranë njëra-tjetrës, në parcela të vogla private, ndërsa tokat bujqësore të grupuara më larg.

*Vendbanime në shpat:* Ndryshimi nga vendbanimet fushore është terreni i pjerrët në të cilin ndodhen. Për pasojë parcelat janë më të vogla e të tarracuara, për t'iu përshtatur relievit. Edhe këto ndahen në të shpërndara dhe agregate.

*Vendbanime në bjeshkë:* Formohen tërësisht nga stane, të përdorura për blegtori gjatë muajve të verës. Këto vendbanime janë të përkohshme dhe, në një pjesë të mirë, të braktisura. Ato gjenden shpesh të grupuara dhe i përkasin të njëjtës familje.

### 11.3.2 Vendbanimet pranë pikave të prodhimit

Të ndërtuara gjatë periudhës së regjimit socialist për strehimin e punëtorëve, këto vendbanime kanë si ekonomi bazë prodhimin, kryesisht minierat e hidrocentralet. Strukturat ndërtimore janë tip, të përsëritura e racionale. Vendbanimet karakterizohen nga rregullsia dhe mungesa e lidhjes me terrenin. Pavarësisht morfologjisë së relievit, fushë, kodër, apo shpat, këto vendbanime janë ndërtuar njësoj. Gjithashtu, banesat janë pranë njëra-tjetrës, të rrethuara nga hapësira publike, duke krijuar agregacione të ndryshme. Mbyllja e shumë aktiviteteve prodhuese, mungesa e shërbimeve dhe infrastrukturës së nevojshme ka bërë që pjesa më e madhe e këtyre vendbanimeve, veçanërisht në zonat më rurale, të braktisen e të rrënohen.

### 11.3.3 Vendbanimet me qendra administrative

Këto vendbanime dallohen nga prania e shërbimeve dhe njësive administrative që ofrojnë. Kryesisht në formë agregate, prania e këtyre shërbimeve ka bërë që këto qendra urbane të zhvillohen e dendësohen më shumë se të tjerat me kalimin e kohës. Sipas hierarkisë dhe numrit të shërbimeve që ofrohen, nga këto vendbanime veçohen Bajram Curri si qendra administrative e bashkisë Tropojë dhe njësitë vendore.

*Bajram Curri:* Është qendër administrative e territorit. Qyteti ofron një gamë të gjerë shërbimesh si zyrat qendrore të administratës, drejtoritë dhe shërbimet e tjera sociale. Bajram Curri është rast i veçantë në territor duke qënë edhe qyteti i vetëm në zonë.


*Njësitë administrative vendore:* Këto vendbanime ofrojnë shërbimet bazë administrative e shoqërore. Megjithatë, këtu banorët kanë si ekonomi baze bujqësinë e blegtorinë, e në raste të rralla prodhimin. Këto ndahen në të shpërndara dhe agregate.

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
mënyrave të  
ndërhyrjes




# Tipologjite Hapësinore

## Harta





Tipologjitë Hapësinore  
Diagramë




#### 11.4 Tipologjitë hapësinore

Ndërtesat që ndodhen në territorin e bashkisë formojnë tri tipologji kryesore hapësinore në territor: vendbanimet bujqësore e blegtorale, vendbanimet e prodhimit dhe vendbanimet që shërbejnë si qendra administrative. Këto kategori ndahen në nënkategori të tjera, bazuar në morfologjinë e vendbanimit dhe terrenit, llojin e prodhimitarisë me të cilën lidhet vendbanimi, dhe shkallën hierarkike për nga rëndësia dhe funksionet administrative. Nga sa vihet re, vendbanimet gjenden thuajse gjithmonë pranë lumenjve ose përrrenjve të ndryshëm, ose në luginat e tyre. Për rastin e dytë, fshatrat fushorë që kanë tokë të bollshme bujqësore mund të kenë rezervuarë pranë tyre, për vaditje gjatë periudhës së thatësisirës.



(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
tipologjive  
hapësinore

Bujqësi/ Blegtori  
Harta





#### 11.4.1 Vendbanimet bujqësore e blegtorale

Këto vendbanime kanë si ekonomi bazë bujqësinë e blegtorinë. Në bazë të morfologjisë së relievit e terrenit ku ndodhen ato ndahen në tri nënkategori:

**1.1 Vendbanimet fushore:** Këto vendbanime shtrihen në fushat pranë lumenjve dhe kanë tokë të bollshme bujqësore. Fshatrat mund të ndahen në të shpërndarë, ku banesat janë larg njëra-tjetrës, secila me pronën e saj rreth shtëpisë, dhe agregate, ku banesat janë pranë njëra-tjetrës, në parcela të vogla private, ndërsa tokat bujqësore të grupuara më larg.

**1.2 Vendbanime në shpat:** Ndryshimi nga vendbanimet fushore është terreni i pjerrët në të cilin ndodhen. Për pasojë, parcelat janë më të vogla e të taracuara për t'iu përshtatur relievit. Edhe këto ndahen në të shpërndara dhe agregate.

**1.3 Vendbanime në bjeshkë:** Formohen tërësisht nga stane, të përdorura për blegtori gjatë muajve të verës. Këto vendbanime janë të përkohshme, dhe në një pjesë të mirë të braktisura. Ato gjenden shpesh të grupuara dhe i përkasin të njëjtës familje.

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
fshatrave  
bujqësorë






Shoshan\_Pamje ajrore

- Konsolidim i vendbanimeve dhe qendrave urbane.
- Vendosje e objekteve në parcela relativisht të vogla, përgjatë rrugës, në mënyrë lineare.
- Propozohet dhënia e mundësisë për ndërtime të reja ose rindërtime në parcelat pranë rrugës të cilësuar si zona urbane.
- Pronari ka të drejtë të ndërtojë në një parcelë minimale private prej 5000m<sup>2</sup> një banesë me njollë deri në 100m<sup>2</sup>, jo më shumë se 2 kate të lartë.
- Pronari ka të drejtë po ashtu të rindërtojë ose të shtojë ndërtesën brenda parametrave të mësipërm.
- Duhet ruajtur distancat e nevojshme nga elementet urbane.








Shoshan\_Diagramë

- Kodi: BA3.1
- Ndërhyrja: Konsolidim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): 0.5
- Nr. i kateve maks: 2
- Lartësia maks. lejuar: 8 m
- Ksht maks. i lejuar: A 8% B 92%
- Minimumi i parcelës nd.: 5000 m<sup>2</sup>
- PDV: Jo

- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesa të reja/ për t'u restauruar  
Zgjatim i parcelës






Llugaj\_Pamje ajrore

- Konsolidim i vendbanimeve dhe qendrave urbane.
- Vendosje e objekteve në parcela relativisht të vogla, përgjatë rrugës, në mënyrë lineare.
- Propozohet dhënia e mundësisë për ndërtime të reja ose rindërtime në parcelat pranë rrugës të cilësuar si zona urbane.
- Pronari ka të drejtë të ndërtojë në një parcelë minimale private prej 600m<sup>2</sup> një banesë 210 m<sup>2</sup>, jo më shumë se 2 kate të lartë.
- Pronari ka të drejtë po ashtu të rindërtojë ose të shtojë ndërtesën brenda parametrave të mësipërm.
- Duhet ruajtur distancat e nevojshme nga elementet urbane.








Llugarj\_Diagramë

- Kodi: BA1.1
- Ndërhyrja: Konsolidim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): 0.5
- Nr. i kateve maks: 2
- Lartësia maks. lejuar: 8 m
- Ksht maks. i lejuar: A 70% B 30%
- Minimumi i parcelës nd.: 600 m<sup>2</sup>
- PDV: Jo

- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesa të reja/ për t'u restauruar  
Zgjatimi i parcelës






Salç\_Pamje ajrore

- Konsolidim i vendbanimeve dhe qendrave urbane.
- Vendosje e objekteve në parcela relativisht të vogla, përgjatë rrugës, në mënyrë lineare.
- Propozohet dhënia e mundësisë për ndërtime të reja ose rindërtime në parcelat pranë rrugës të cilësuar si zona urbane.
- Pronari ka të drejtë të ndërtojë në një parcelë minimale private prej 2000m<sup>2</sup> një banesë deri në 300m<sup>2</sup>, jo më shumë se 2 kate të lartë.
- Pronari ka të drejtë po ashtu të rindërtojë ose të shtojë ndërtesën brenda parametrave të mësipërm.
- Duhet ruajtur distancat e nevojshme nga elementet urbane.









Salç\_Diagramë

- Kodi: BA2.2
- Ndërhyrja: Konsolidim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): 0.5
- Nr. i kateve maks: 2
- Lartësia maks. lejuar: 8 m
- Ksht maks. i lejuar: A 30% B 70%
- Minimumi i parcelës nd.: 2000 m<sup>2</sup>
- PDV: Jo

- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesa të reja/ për t'u restauruar  
Zgjatim i parcelës








Markaj\_Pamje ajrore


- Konsolidim i vendbanimeve dhe qendrave urbane.
- Vendosje e objekteve në parcela relativisht të vogla, përgjatë rrugës, në mënyrë lineare.
- Propozohet dhënia e mundësisë për ndërtime të reja ose rindërtime në parcelat pranë rrugës të cilësuar si zona urbane.
- Pronari ka të drejtë të ndërtojë në një parcelë minimale private prej 1300m<sup>2</sup> një banesë deri në 195m<sup>2</sup>, jo më shumë se 2 kate të lartë.
- Pronari ka të drejtë po ashtu të rindërtojë ose të shtojë ndërtesën brenda parametrave të mësipërm.
- Duhet ruajtur distancat e nevojshme nga elementet urbane.




Markaj\_Diagramë

- Kodi: BA2.2
- Ndërhyrja: Konsolidim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): 0.5
- Nr. i kateve maks: 2
- Lartësia maks. lejuar: 8 m
- Ksht maks. i lejuar: A 30% B 70%
- Minimumi i parcelës nd.: 1300 m<sup>2</sup>
- PDV: Jo

- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesa të reja/ për t'u restauruar  
Zgjatim i parcelës








Sybllicë\_Pamje ajrore

- Bjeshkët, si një pjesë e rëndësishme e jetesës në zonë, synohet të ruhen nga ndërtimet e pakontrolluara.
- Propozohet restaurimi dhe rindërtimi i objekteve ekzistuese, ose ringritja e staneve të rrënuara vetëm brenda gjurmëve të atyre ekzistuese.
- Vatha e bagëtive lejohet të rindërtohet vetëm mbi kufijtë ekzistues.
- Ndërtesat duhet të ndërtohen me materialet tradicionale (gurë, dru) dhe të mos e kalojnë 6m lartësi.









Sybllicë\_Diagramë

- Kodi: N5.2
- Ndërhyrja: Ristrukturim/Konservim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): -
- Nr. i kateve maks: 1
- Lartësia maks. lejuar: 6 m
- Ksht maks. i lejuar: -
- Minimumi i parcelës nd.: -
- PDV: Jo

- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesa të reja/ për t'u restauruar  
Zgjatim i parcelës






Pamje e brendshme e një stani me propozimin e ri

*Rehabilitimi i staneve për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe turizmit*

- Një pjesë e staneve, ato që gjenden pranë rrugëve apo shtigjeve turistike, mund të shfrytëzohen si bujtina apo fjetina për turistët apo udhëtarët.
- Për t'u arritur komoditeti i nevojshëm lejohet shtimi i një gjysmë kati brenda volumit të stanit, pa kaluar kufijtë e lartësisë së përcaktuar nga rregullorja, me qëllim shtimin e hapësirave për të fjetur dhe ndarjen funksionale të ndërtesës.
- Këto ndërhyrje mund të aplikohen edhe në stanet që nuk përdoren për turizëm, por për të përmirësuar kushtet e jetesës së banorëve.
- Sugjerohen nyje higjieno-sanitare, mjedise të veçanta gatimi e depozitimi të materialeve, hapësirë e bollshme për ndriçim dhe një mënyrë për ngrohjen e mjediseve (p.sh. sobë me dru).
- Për çështje ekonomike dhe fleksibiliteti sugjerohet që ndarja e mjediseve të bëhet me panele druri, të cilat në një moment të dytë mund të çmontohen, të ripërdoren apo të lëvizin sipas nevojës.




Prerje  
aksonometrike  
e stanit me  
propozimin e ri




Bujqësi / Blegtori


Bjeshkë



Planimetri tipike e një stani



Planimetri tipike e një stani me organizimin e ri















Modulet e mobiljeve të përdorura në skemën e re



Modulet përmbledhin funksionet bazë të jetesës dhe përfshijnë: K - *Kuzhinë* B - *Njye higjieno-sanitare (Toalet)* P - *Pasazh (Korridor/ Kalim)* S - *Shkallë* D - *Depo/ Magazininim*






Skema të ndryshme planimetrike për organizimin e stanit në varësi të madhësisë dhe kërkesave





Prodhim  
Harta





Prodhim  
Diagramë



11.4.2 Vendbanimet pranë pikave të prodhimit

Të ndërtuara gjatë periudhës së regjimit socialist për strehimin e punëtorëve, këto vendbanime kanë si ekonomi bazë prodhimin, kryesisht minierat e hidrocentralet. Strukturat ndërtimore janë tip, të përsëritura e racionale. Vendbanimet karakterizohen nga rregullsia dhe mungesa e lidhjes me terrenin. Pavarësisht morfologjisë së relievit, fushë, kodër, apo shpat, këto vendbanime janë ndërtuar njësoj. Gjithashtu, banesat janë pranë njëra-tjetrës, të rrethuara nga hapësira publike, duke krijuar agregacione të ndryshme. Mbyllja e shumë aktiviteteve prodhuese, mungesa e shërbimeve dhe infrastrukturës së nevojshme ka bërë që pjesa më e madhe e këtyre vendbanimeve, veçanërisht në zonat më rurale, të braktisen e të rrënohen.



(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
vendbanimeve  
të prodhimit

Prodhim  
Agregat




Fierzë (zona B)\_Pamje ajrore

- Ristrukturim dhe rigjenerim i qendrave urbane.
- Këto vendbanime janë të përcaktuara qartë, janë ngritur kryesisht gjatë periudhës socialiste pranë zonave të prodhimit dhe kanë tipologji standarde ndërtesash.
- Ka hapësira të bollshme urbane të cilat kanë degraduar dhe nuk janë mirëmbajtur.
- Propozohet rikualifikimi i hapësirës urbane dhe ristrukturimi i ndërtesave për t'i sjellë sërish në gjendje përdorimi.






Prodhim  
Agregat




Fierzë (zona B)\_Diagramë

- Kodi: A2.2
- Ndërhyrja: Ristrukturim/Rigjenerim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): 1.5
- Nr. i kateve maks: 6 (5+1)
- Lartësia maks. lejuar: 22 m
- Ksht maks. i lejuar: 30%
- Minimumi i parcelës nd.: n/a
- PDV: Jo

- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesa të reja/ për t'u restauruar  
Zgjatim i parcelës



Prodhim  
Agregate



Rrogam - Plan i Përgjithshëm

- Zhvillim urban dhe rigjenerim i qendrës urbane.
- Përcaktimi i hapësirave urbane si sheshe dhe kopshte.
- Propozohet përmirësimi i hapësirës urbane dhe restaurimi i blloqeve socialiste për t'i bërë serish të përdorshme.
- Riformatimi i vendbanimeve të prodhimit me blloqe të reja përgjatë rrugës.







Rrogam - Pamje e përgjithshme

- Bloqet e reja rezidenciale me ngjyrë të bardhë janë 3 kate të larta dhe rivendosin marrëdhënien me ndërtesat socialiste.
- Ndërtesat me gri janë bloqet ekzistuese të vendbanimit, në nevojë për restaurim.
- Me të kuqe, përgjatë rrugës dhe dy platformat në anë të saj janë hapësirat kryesore publike për vendbanimin.
- Zonat e gjelbra midis ndërtesave do të transformohen në kopshte dhe parqe të vogla.





Rrogam - Pamje ajrore - Blloku R3

- Veprimi kryesor në vendbanim është konsolidimi.
- Zonat A1.3 lejojnë ndërtimin e blloqeve 3 kate të larta dhe restaurimin e hapësirës private.
- Blloqet ekzistuese mund të restaurohen dhe të rimodulohen nga brenda.






Administratë  
Qendra e Bashkisë




Rrogam - Blloku R3 (e shënuar njësisia A1.3)

• Kodi	A1.3
• Ndërhyrja:	Konsolidim
• Intensiteti maks. (m <sup>2</sup> /m <sup>2</sup> ):	0,5
• Nr. i kateve maks:	3
• Lartësia maks. lejuar:	12 m
• Ksht maks. i lejuar:	40%
• Minimumi i parcelës nd.:	n/a
• PDV:	Jo
• Legjenda e Skemës:	
	Ndërtesë e re
	Rigjenerim i hapësirës



Administratë  
Hartë



Administratë  
Diagramë



### 11.4.3 Vendbanimet me qendra administrative

Këto vendbanime dallohen nga prania e shërbimeve dhe njësive administrative që ofrojnë. Kryesisht në formë agregate, prania e këtyre shërbimeve ka bërë që këto qendra urbane të zhvillohen e dendësohen më shumë se të tjerat me kalimin e kohës. Sipas hierarkisë dhe numrit të shërbimeve që ofrohen, nga këto vendbanime veçohen Bajram Curri, si qendra administrative e bashkisë Tropojë dhe njësitë vendore.

**3.1 Bajram Curri:** Është qendër administrative e territorit. Qyteti ofron një gamë të gjerë shërbimesh si zyrat qendrore të administratës, drejtoritë dhe shërbimet e tjera sociale. Bajram Curri është rast i veçantë në territor duke qenë edhe qyteti i vetëm në zonë.

**3.2 Njësitë administrative vendore:** Këto vendbanime ofrojnë shërbimet bazë administrative e shoqërore. Megjithatë, këtu banorët kanë si ekonomi bazë bujqësinë e blegtorinë, e në raste të rralla prodhimin. Këto ndahen në të shpërndara dhe agregate.

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
qendrave  
administrative





Bajram Curri - Plan i përgjithshëm

- Zhvillimi urban dhe rigjenerimi i qendrës urbane.
- Formatimi i hapësirave urbane si sheshe dhe kopshte në çdo lagje të Bajram Currit.
- Përmirësimi i hapësirës urbane dhe restaurim i ndërtesave publike historike për t'i bërë sërish të përdorshme.
- Ristrukturimi i qendrës kryesore administrative duke riformatuar shërbimet dhe infrastrukturën.







Bajram Curri - Pamje e përgjithshme

- Bloqet e reja rezidenciale riformatojnë strukturën urbane që përcakton karakterin e qytetit.
- Ndërtesat me ngjyrë të bardhë janë më shumë se dy kate të larta.
- Ndërtesat me gri janë blloqe të ulëta, magazina, struktura prodhimi dhe shërbime.
- Pemët e mbjella në rreshta paralelë formatojnë bulevardin kryesor në qytet.
- Hapësirat e gjelbra midis ndërtesave do të transformohen në kopshte dhe parqe të vogla. Oborret, gjithashtu, do të rigjenerohen.






Bajram Curri - Diagramë

- Diagrama tregon ndërhyrjet kryesore në strukturën urbane duke theksuar rihvillimin urban dhe hapësirat e gjelbra.
- Me të kuqe tregohen gjithë ndërtesat e propozuara (biloqe rezidenciale, hotele, magazina dhe shërbime)







Bajram Curri - Skema e blloqeve

- Skema e blloqeve tregon zonat e ndërhyrjes dhe ndan qytetin në njësi.
- Çdo njësi ka përdorimin e vet të tokës me programin dhe veprimtarinë e lejuar.





Bajram Curri Pamje ajrore - Blloku BC1

- Veprimtaritë kryesore të kësaj njësie janë restaurimi/rigjenerimi.
- Njësia A2.1 lejon restaurimin e blloqeve dhe shtimin e papafingos për programet e strehimit social.
- Hapësirat e gjelbra ekzistuese mund të restaurohen dhe të përmirësohen duke shtuar kënde lojërash.




Administratë  
Qendra e Bashkisë



Bajram Curri - Blloku BC1 (e shënuar njësia A2.1)

- Kodi: A2.1
- Ndërhyrja: Ristrukturim/Rigjenerim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): 1.2
- Nr. i kateve maks: 3 (2+1)
- Lartësia maks. lejuar: 12 m
- Ksht maks. i lejuar: 40%
- Minimumi i parcelës nd.: n/a
- PDV: Jo

- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesa të reja/ për t'u restauruar  
Çati e re e jetueshme  
Rigjenerim i hapësirës







Bajram Curri Pamje ajrore - Blloku BC2

- Veprimet kryesore në këtë njësi janë restaurimi/rigjenerimi.
- Njësia A2.2 lejon restaurimin dhe shtimin e një papafingoje për programet e strehimit social.
- Hapësirat e gjelbra ekzistuese mund të restaurohen dhe të plotësohen me kënde lojërash.



Administratë  
Qendra e Bashkisë




Bajram Curri - Blloku BC2 (e shënuar njësis A2.2)

- Kodi: A2.2
- Ndërhyrja: Ristrukturim/Rigjenerim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): 1.5
- Nr. i kateve maks: 6 (5+1)
- Lartësia maks. lejuar: 22 m
- Ksht maks. i lejuar: 30%
- Minimumi i parcelës nd.: n/a
- PDV: Jo
- Legjenda e Skemës:

Ndërtesa të reja/ për t'u restauruar

Çati e re e jetueshme

Rigjenerim i hapësirës








Bajram Curri Pamje ajrore - Blloku BC3

- Veprimet e lejuara për këtë njësi janë zhvillimi/rizhvillimi.
- Njësia A3.1 lejon restaurimin e blloqeve dhe zhvillimin e banesave sociale me një maksimum prej gjashtë katesh.
- Hapësirat e gjelbra ekzistuese mund të restaurohen dhe të plotësohen me kënde lojërash.





Bajram Curri - Blloku BC3 (e shënuar njësia A3.1)

- Kodi: A3.1
- Ndërhyrja: Zhvillim/Rizhvillim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): 1.5
- Nr. i kateve maks: 6 (5+1)
- Lartësia maks. lejuar: 22 m
- Ksht maks. i lejuar: 30%
- Minimumi i parcelës nd.: n/a
- PDV: Jo

- Legjenda e Skemës:  
Strehim i ri social  
Rigjenerim i hapësirës








Bajram Curri Pamje ajrore - Blloku BC6

- Veprimet kryesore në këtë njësi janë zhvillimi/rizhvillimi.
- Njësia A2.3 lejon ndërtimin e blloqeve rezidenciale me dendësi mesatare me një maksimum prej katër katesh.
- Hapësirat e gjelbra mund të restaurohen dhe të plotësohen me kënde lojërash.





Bajram Curri - Blloku BC6 (e shënuar njësis A2.3)

- Kodi: A2.3
- Ndërhyrja: Zhvillim/Rizhvillim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): 1
- Nr. i kateve maks: 4
- Lartësia maks. lejuar: 16 m
- Ksht maks. i lejuar: 25%
- Minimumi i parcelës nd.: n/a
- PDV: Po

- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesë e re  
Rigjenerim i hapësirës








Bajram Curri Pamje ajrore - Blloku BC7

- Veprimet kryesore në këtë njësi janë zhvillimi/rizhvillimi.
- Njësia A2.3 lejon ndërtimin e blloqeve të reja rezidenciale me dendësi mesatare, me një maksimum prej katër katesh.
- Hapësirat e gjelbra mund të restaurohen dhe të plotësohen me kënde lojërash.







Bajram Curri - Blloku BC7 (e shënuar njësis A2.3)

- Kodi: A2.3
- Ndërhyrja: Zhvillim/Rizhvillim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): 1
- Nr. i kateve maks: 4
- Lartësia maks. lejuar: 16 m
- Ksht maks. i lejuar: 25%
- Minimumi i parcelës nd.: n/a
- PDV: Po

- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesë e re  
Rigjenerim i hapësirës






Bajram Curri Pamje ajrore - Blloku BC 8

- Veprimet kryesore në këtë njësi janë restaurimi/rigjenerimi.
- Njësia A2.2 lejon restaurimin e blloqeve dhe shtimin e një papafingoje për programet e strehimit social
- Hapësirat e gjelbra mund të restaurohen dhe të plotësohen me kënde lojërash.








Bajram Curri - Blloku BC8 (e shënuar njësis A2.2)

- Kodi: A2.2
- Ndërhyrja: Ristrukturim/Rigjenerim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): 1.5
- Nr. i kateve maks: 6 (5+1)
- Lartësia maks. lejuar: 22 m
- Ksht maks. i lejuar: 30%
- Minimumi i parcelës nd.: n/a
- PDV: Jo
- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesë për t'u restauruar  
Çati e re e jetueshme  
Rigjenerim i hapësirës






Bajram Curri Pamje ajrore - Blloku BC9

- Veprimet kryesore në këtë njësi janë restaurimi/rigjenerimi.
- Njësia A2.2 lejon restaurimin e blloqeve dhe shtimin e një papafingoje për programet e strehimit social
- Hapësirat e gjelbra mund të restaurohen dhe të plotësohen me kënde lojërash.








Bajram Curri - Blloku BC9 (e shënuar njësia A2.2)

- Kodi: A2.2
- Ndërhyrja: Zhvillim/Rizhvillim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): 1.5
- Nr. i kateve maks: 6 (5+1)
- Lartësia maks. lejuar: 22 m
- Ksht maks. i lejuar: 30%
- Minimumi i parcelës nd.: n/a
- PDV: Jo

- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesë e re  
Rigjenerim i hapësirës








Bajram Curri Pamje ajrore - Bloku BC10

- Veprimet kryesore në këtë njësi përdorimi miks janë zhvillimi/rizhvillimi.
- Njësia A2.3 lejon ndërtimin e blloqeve rezidenciale me dendësi mesatare, me lartësi maksimale prej pesë katesh dhe magazina ose ndërtesa industriale me lartësi dy kate.
- Hapësirat mund të restaurohen dhe të plotësohen me zona të gjelbra.




Administratë  
Qendra e Bashkisë



Bajram Curri - Blloku BC10 (e shënuar njësi SA3)

- Kodi: SA3
- Ndërhyrja: Zhvillim/Rizhvillim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): S 1.2 A 1.4
- Nr. i kateve maks: S 2 A 5
- Lartësia maks. lejuar: 22 m
- Ksht maks. i lejuar: S 60% A 30%
- Minimumi i parcelës nd.: n/a
- PDV: Po

- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesë e re  
Rigjenerim i hapësirës








Bajram Curri Pamje ajrore - Blloku BC11

- Veprimi kryesor në këtë njësi është konsolidimi.
- Njësitë BA1.1 lejojnë ndërtimin e shtëpive gjysmë të veçuara me dendësi të ulët, deri në dy kate të larta.
- Hapësirat mund të restaurohen dhe të plotësohen me zona të gjelbra.




Administratë  
Qendra e Bashkisë



Bajram Curri - Blloku BC11 (e shënuar njësia BA1.1)

- Kodi: BA1.1
- Ndërhyrja: Konsolidim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): 0.5
- Nr. i kateve maks: 2
- Lartësia maks. lejuar: 7 m
- Ksht maks. i lejuar: 40%
- Minimumi i parcelës nd.: n/a
- PDV: Jo

- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesë e re  
Rigjenerim i hapësirës








Bajram Curri Pamje ajrore - Bloku BC12

- Veprimet kryesore në këtë njësi janë restaurimi/rigjenerimi.
- Njësia A2.2 lejon restaurimin e blloqeve dhe shtimin e një papafingoje për programet e strehimit social
- Hapësirat e gjelbra mund të restaurohen dhe të plotësohen me kënde lojërash.








Bajram Curri - Blloku BC12 (e shënuar njësisë A2.2)

- Kodi: A2.2
- Ndërhyrja: Ristrukturim/Rigjenerim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): 1.5
- Nr. i kateve maks: 6 (5+1)
- Lartësia maks. lejuar: 22 m
- Ksht maks. i lejuar: 30%
- Minimumi i parcelës nd.: n/a
- PDV: Jo
- Legjenda e Skemës:
  - Ndërtesë për t'u restauruar
  - Çati e re e jetueshme
  - Rigjenerim i hapësirës






Bajram Curri Pamje ajrore - Blloku BC13

- Veprimet kryesore në këtë njësi përdorimi miks janë zhvillimi/rizhvillimi.
- Njësitë IEA lejojnë ndërtimin e blloqeve të reja rezidenciale me dendësi mesatare, me lartësi maksimale katër kate dhe magazina ose ndërtesa industriale të larta një kat.
- Hapësirat mund të restaurohen dhe plotësohen me gjelbërim.








Bajram Curri - Blloku BC13 (e shënuar njësi IEA)

- Kodi: IEA
- Ndërhyrja: Zhvillim/Rizhvillim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): IE 0.5 A 1.2
- Nr. i kateve maks: IE 1 A 4
- Lartësia maks. lejuar: IE N/A A 15 m
- Ksht maks. i lejuar: IE 50% A 35%
- Minimumi i parcelës nd.: n/a
- PDV: Po

- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesë e re  
Rigjenerim i hapësirës






Bajram Curri Pamje ajrore - Blloku BC14

- Veprimet kryesore në këtë njësi përdorimi miks janë zhvillimi/rizhvillimi.
- Njësitë IEA lejojnë ndërtimin e blloqeve të reja rezidenciale me dendësi mesatare, me lartësi maksimale katër kate dhe magazina ose ndërtesa industriale të larta një kat.
- Hapësirat mund të restaurohen dhe plotësohen me gjelbërim.








Bajram Curri - Blloku BC14 (e shënuar njësisia IEA)

- Kodi: IEA
- Ndërhyrja: Zhvillim/Rizhvillim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): IE 0.5 A 1.2
- Nr. i kateve maks: IE 1 A 4
- Lartësia maks. lejuar: IE N/A A 15 m
- Ksht maks. i lejuar: IE 50% A 35%
- Minimumi i parcelës nd.: n/a
- PDV: Po

- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesë e re  
Rigjenerim i hapësirës








Bajram Curri Pamje ajrore - Blloku BC15

- Veprimet kryesore në këtë njësi përdorimi miks janë zhvillimi/rizhvillimi.
- Njësitë IES1 lejojnë ndërtimin e blloqeve të reja rezidenciale me dendësi mesatare, me lartësi maksimale dy kate dhe magazina ose ndërtesa industriale të larta një kat.
- Hapësirat mund të restaurohen dhe plotësohen me gjelbërim.






Bajram Curri Bajram Curri - Biloku BC15 (e shënuar njësia IES1)

- Kodi: IES1
- Ndërhyrja: Zhvillim/Rizhvillim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): IE 0.5 S 0.6
- Nr. i kateve maks: IE 1 S 2
- Lartësia maks. lejuar: IE N/A S 10m
- Ksht maks. i lejuar: IE 50% S 35%
- Minimumi i parcelës nd.: n/a
- PDV: Po

- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesë e re  
Rigjenerim i hapësirës








Bajram Curri Pamje ajrore - Blloku BC16

- Veprimet kryesore në këtë njësi përdorimi miks janë zhvillimi/rizhvillimi.
- Njësitë IE2 lejojnë ndërtimin e magazinave ose ndërtesave industriale të ulëta.







Bajram Curri - Blloku BC16 (e shënuar njësia IE2)

- Kodi: IE2
- Ndërhyrja: Zhvillim/Rizhvillim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): 0.5
- Nr. i kateve maks: 1
- Lartësia maks. lejuar: 8m
- Ksht maks. i lejuar: 50%
- Minimumi i parcelës nd.: n/a
- PDV: Po

- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesë e re  
Rigjenerim i hapësirës








Bajram Curri Pamje ajrore - Blioku BC18

- Veprimtaritë kryesore në këtë njësi janë zhvillimi/rizhvillimi.
- Njësitë AR3 lejojnë ndërtimin e fushave të ulëta sportive dhe strukturave të lehta për lojëra.
- Hapësirat mund të restaurohen dhe të plotësohen me gjelbërim.








Bajram Curri - Blloku BC18 (e shënuar njësisia AR3)

- Kodi: AR3
- Ndërrhyrja: Zhvillim/Rizhvimim
- Intensiteti maks. ( $m^2/m^2$ ): 0.2
- Nr. i kateve maks: 1
- Lartësia maks. lejuar: 8m
- Ksht maks. i lejuar: 5%
- Minimumi i parcelës nd.: n/a
- PDV: Jo

- Legjenda e Skemës:  
Struktura të lehta te reja  
Fusha të reja sporti





Tropoja - Pamje e Përgjithshme

- Bllloqet e ulëta me ngjyrë të bardhë përcaktojnë kufirin e qendrës urbane.
- Pemët e mbjella në rreshta përcaktojnë korridorin e gjelbër kryesor në këtë vendbanim.
- Në hyrje të qytetit parashikohet një shesh i ri tregu, ndërsa hapësirat e tjera publike do të rigjenerohen.
- Zona e gjelbërt rrëzë malit do të transformohet në park.







Tropoja - Plan i Përgjithshëm

- Zhvillimi urban dhe rigjenerimi i qendrës urbane.
- Formatimi i hapësirave urbane si sheshe dhe kopshte në qendrën e Tropojës.
- Përmirësimi i hapësirës urbane dhe restaurimi i ndërtesave historike të shërbimit për t'i bërë sërish të përdorshme.
- Ristrukturimi i qendrës administrative duke riformatuar shërbimet dhe infrastrukturën.






Tropoja Pamje ajrore - Bloku T4

- Veprimet kryesore për këtë njësi janë restaurimi/konsolidimi.
- Njësitë A1.1 lejojnë restaurimin e blloqeve dhe mbushjen e boshllëqeve në ndërtesa të vogla.
- Hapësirat e gjelbra ekzistuese mund të restaurohen dhe të plotësohen me kënde lojërash.








Tropoja - Blloku T4 (c shënuar njësia A1.1)

- Kodi: A1.1
- Ndërhyrja Ristrukturim/Konsolidim
- Intensiteti maks. (m<sup>2</sup>/m<sup>2</sup>): 0.8
- Nr. i kateve maks: 2
- Lartësia maks. lejuar: 7 m
- Ksht maks. i lejuar: 28%
- Minimumi i parcelës nd.: n/a
- PDV: Jo

- Legjenda e Skemës:  
Ndërtesë për t'u restauruar  
Rigjenerim i hapësirës






100

**12 PLANI I MASAVE PËR SHËRBIME SOCIALE DHE HAPËSIRA PUBLIKE**





Bajram Curri

- |                   |                                 |                    |
|-------------------|---------------------------------|--------------------|
| park              | shkollë                         | piktë informacioni |
| rrugë e asfaltuar | treg                            | banesa sociale     |
| rrugë             | qendër mbështetje për bujqësinë | shesh              |
| rrugë këmbësorësh | zhamë                           | hapshi futbollit   |
| qendër komunikim  | qendër shëndetësore             | kënd lojtrash      |






Bajram Curri

Si e vetmja qendër me karakter urban në këtë territor, Bajram Curri është në mënyrë të padiskutueshme një qendër graviteti. Këtu gjejmë përqendrimin më të madh të popullsisë edhe të aktiviteteve sociale dhe ekonomike. Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj qendre, bashkëngjitur me dokumentet e planit si harta e përdorimit të tokës dhe rregullorja, është hartuar edhe një model që do të drejtojë zhvillimin urban të kësaj qyteze në të ardhmen. Ky model lind nga një analizë e kujdesshme mbi qytetin dhe ka si qëllim të forcojë karakterin urban ekzistues. Ndërhyrjet e propozuara përqendrohen tek riorganizimi i hapësirave të lira në mënyrë që të bëhen më tërheqëse për banorët. Ky riorganizim është i lidhur fortësisht edhe me krijimin dhe integrimin në strukturën ekzistuese urbane të hapësirave dhe strukturave të reja për shërbime. Këtu mund të përmendim sheshin pranë qendrës kulturore, terminalin e pasagjerëve, tregun qytetas por edhe zonat e dedikuara për zhvillimin e strukturave për shërbime hotelerie të nivelit të lartë. Rimëkëmbja dhe rivënia në funksion e zonës industriale në periferi të qytetit është një tjetër ndërhyrje që paraqitet në modelin për zhvillimin e qendrës.





Tropojë

- |                   |                               |                   |
|-------------------|-------------------------------|-------------------|
| pemë              | shkollë                       | pikë informacioni |
| rrugë e asfaltuar | treg                          | hapësira sociale  |
| rrugë             | qendër ndihmëse për bujqësinë | shesh             |
| rrugë këmbësorësh | zhami                         | kopshtë           |
| qendër komunikare | qendër shëndetësore           | kënd lojtrash     |


















Tropojë

Ndërhyrjet në zonën urbane të Tropojës do të përqendrohen në dy zonat ku janë përqendruar gjithë shërbimet publike kryesore. Një trotuar i gjatë këmbësorësh do të lidhë Qendrën e re Civile me sheshin kryesor të qytetit. Në Tropojë dallohen qartë dy sheshet publike qendrore. Plani propozon konsolidimin e kësaj hapësire publike, duke e bërë të përdorshme vetëm nga këmbësorët dhe duke kufizuar trafikun vetëm për banorët. Të gjitha funksionet publike në pjesën veriore, si qendra e kujdesit shëndetësor dhe xhamia, do të përfshihen në një park të ri publik, një tarracë e gjelbër përballë trotuarit dhe sheshit kryesor. Tregu do të ngrihet në hyrje të qytetit pranë një projekti të ri për banesa sociale dhe, përsëri në hyrje, një stacion i ri intermodal do të shërbejë për lidhjen me këtë qendër dhe zonat përtej saj. Rrugët e mbetura të qytetit do të shtrohen, meqë ka si flukse automjesh ashtu edhe këmbësorësh, duke formuar pjesën e jashtme të zonës urbane.





Margegaj

- |                                                                                                       |                                                                                                                   |                                                                                                        |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|  pemë              |  qendër ndihmëse për bujqësinë |  shez             |
|  rrugë e asfaltuar |  qendër shënjëtare             |  kopsht tullishte |
|  rrugë             |  shkollë                       |  kënd lojërash    |
|  rrugë këmbësorësh |                                                                                                                   |                                                                                                        |





Margegaj

E shtrirë përgjatë rrugës kryesore për në Valbonë, qendra urbane e Margegajt është e grupuar në dy zona kryesore të banuara, fshati Margegaj dhe Koçanaj. Këtu funksionet publike janë vendosur përgjatë rrugës me gjatësi 300m që lidh qytetin e Bajram Currit me Qendrën Administrative të Margegajt, e cila i shërben pothuajse 40% të popullsisë së njësive administrative që jeton në këto zona. Ky sistem ekzistues, i lidhur me marrëdhëniet e ngushta midis rrugëve dhe funksioneve publike, do të përmirësohet duke filluar nga segmenti i parë në Koçanaj, ku trotuari ekzistues do të shtrihet deri në qendrën civile (komunitare). Kjo pjesë e rrugës është një nga më të shkelurat nga turistët gjatë verës, dhe duke bërë më të sigurtë ndikojmë jo vetëm në jetën e popullsisë lokale, por edhe më gjerë. Meqë qendra civile (komunitare) është afër një rrugë kryesore që lidh Koçanajn me fshatin Këlcyrë dhe pastaj vazhdon deri në bjeshkët e Malit të Pllanës, plani propozon ndërtimin e një pike të vogël shpërndarjeje dhe parkimi. Kjo strategji përmirëson arritshmërinë në një zonë sot plotësisht të izoluar nga zona e urbanizuar.







Margegaj

- |                          |                |                         |
|--------------------------|----------------|-------------------------|
| <i>perit</i>             | <i>shkolle</i> | <i>shesh</i>            |
| <i>rrugë e asfaltuar</i> | <i>treg</i>    | <i>koqshi lullshite</i> |
| <i>rrugë</i>             | <i>kisha</i>   | <i>këndi lojtrash</i>   |
| <i>rrugë këmbësorësh</i> |                |                         |





Margegaj

Pjesa e dytë e këtij sistemi përfshin zonat më të urbanizuara të dy vendbanimeve kryesore, Margegaj dhe Koçanaj, si dhe funksionet kryesore publike të njësive administrative: shkollën fillore, ambulancën dhe varrezat. Ndërhyrjet sigurojnë lidhjen midis këtyre funksioneve publike, si dhe mes zonave kryesore urbane. Këtu, rrugët e brendshme kryesore do të shtrohen dhe plotësohen me sinjalistikë për shfrytëzim nga këmbësorët. Do të përmirësohen gjithë funksionet publike e në veçanti hapësirat publike.







Jaho Salihi

- |                   |                               |                  |
|-------------------|-------------------------------|------------------|
| pemë              | qendër komunitare             | zhanë            |
| rrugë e asfaltuar | shkollë                       | shesh            |
| trenuar           | qendër ndihmëse për bujqësinë | hapësht luleshte |
| rrugë këmbësorësh | qendër shëndetësore           | kënd lojërash    |





Jaho Salih

I vendosur përballë qytetit të Bajram Currit, qendra e Jaho Salihit është një nga zonat më të populluara të bashkisë. Edhe pse nuk është një qendër administrative, në fakt është pjesë e njësisë administrative Llugaj, përmasat dhe numri i popullsisë e bëjnë atë një qendër kryesore të rajonit. Duke e konsideruar të barabartë me një qendër administrative, PPV ka detajuar një plan të veçantë për menaxhimin e shërbimeve publike dhe hapësirën e kësaj qendre. Shërbimet publike dhe ndërhyrjet e densifikimit propozohen në kufij të fshatit bujqësor ekzistues, përgjatë rrugës kryesore që lidh qendrën me Bajram Currin. Plani parashih rihvillimin e kësaj pjese të zonës urbane, rehabilitimin e hapësirës publike dhe ngritjen e një tregu të ri lokal. Janë parashikuar ndërhyrje për oborrin ekzistues të shkollës, që përfshijnë një shesh të ri lojërash, dhe për lidhjen e kësaj pjese me zonat e tjera të qendrës, duke propozuar një trotuar të ri dhe shtrimin e rrugëve kryesore rurale.





Bujan

- |                                                                                                       |                                                                                                                   |                                                                                                       |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|  çamë              |  shkollë                       |  shesh           |
|  rrugë e asfaluar  |  rrugë                         |  kapsht lulishtë |
|  rrugë në ndërtim  |  qendër rullmëse për bujqësinë |  kënd lojërush   |
|  rrugë këmbësorësh |  çhami                         |                                                                                                       |
|  qendër komunitare |  qendër shëndetësore           |                                                                                                       |








Bujan

Dojani është qendra kryesore e njësisë administrative Bujan, pranë qytetit të Bajram Currit. Këtu funksionet publike janë relativisht të largëta nga zonat e urbanizuara, duke e bërë pothuajse të pamundur njohjen e këtyre qendrave si një zonë të vetme urbane. Me ndërtimin e një hapësire të re lineare publike, plani synon unifikimin e gjithë këtyre pjesëve të shpërndara të qendrës, duke përcaktuar vendet për hapësira të vogla publike si kopshte apo sheshe të vogla. Plani përforcon gjithashtu praninë e funksioneve publike, ndërtimin e një qendre civile që veç qendrës së sapo ndërtuar administrative dhe qendrës ekzistuese mjekësore do të strehojë një qendër të re për mbështetje ndaj bujqësisë. Ndërhyrje të tjera marrin në konsideratë sektorin e arsimit, ku, për shembull, oborri ekzistues i shkollës do të pajiset me një shesh të ri lojërash. Qendra civile (komunitare), xhamia, shkolla, në këtë mënyrë do të lidhen me zonat urbane dhe do të bëhen të arritshme nga të gjithë banorët e kësaj qendre.





Llugaj

- |                          |                                     |                          |
|--------------------------|-------------------------------------|--------------------------|
| <i>per</i>               | <i>shkollë</i>                      | <i>pikë informacioni</i> |
| <i>rrugë e asfaltuar</i> | <i>trug</i>                         | <i>shesh</i>             |
| <i>tronuar</i>           | <i>qendër rritëse për bujqësinë</i> | <i>kopshë lulishtie</i>  |
| <i>rrugë këmbësorësh</i> | <i>kishë</i>                        | <i>këndë lojërash</i>    |
| <i>qendër komunitare</i> | <i>qendër shëndetësore</i>          |                          |











Llugaj

Qendra urbane e Llugajt shtrihet përgjatë lumit të Bushtricës, në pjesën fundore, para derdhjes në Valbonë. Vendbanimet origjinale bujqësore zhvillohen sipas morfologjisë të përcaktuar qartë, të formuar nga një seri planesh të gjata, secila e kufizuar nga shpate të pjerrëta. E njëjta strukturë mund të gjendet dhe në Jaho Salihi. Vendbanimi linear që rezulton prej tyre, është qendër administrative dhe është plotësuar me një sërë funksionesh publike si dy shkolla, një qendër mjekësore dhe një sallë bashkiake. Qëllimi i planit është të përmirësojë cilësinë e shërbimeve të ofruara nga kjo qendër duke transformuar Llugajn në një qendër të specializuar për bujqësinë, e orientuar në formim dhe edukim. Për këtë arsye, plani, përveç përmirësimit të të gjitha funksioneve ekzistuese, propozon ndërtimin e një tregu lokal dhe të një qendre për mbështetjen e bujqësisë përmes një ndërhyrjeje PPP dhe një shkolle të re profesionale bujqësore që do të integrohet me atë ekzistuese.





Lekbibaj

- |                                                                                                       |                                                                                                                   |                                                                                                         |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|  pemë              |  shkollë                       |  pikë informacioni |
|  rrugë e asfaltuar |  treg                          |  sheesh            |
|  trotuar           |  qendër ndihmëse për bujqësinë |  kopsht luleshte   |
|  rrugë këmbësorësh |  kishë                         |  kënd lojërash     |
|  qendër komunitare |  qendër shëndetësore           |                                                                                                         |








Lekbibaj

Lekbibaj, qendra më e largët, është porta për Parkun Rajonal Nikaj Mertur dhe pikë referimi për 1800 banorët e kësaj njësie administrative. Përkundër rëndësisë së saj, qendra përbëhet kryesisht nga funksione publike, ndërkohë që banesat janë të pakta dhe tërësisht të shkëputura nga qendra. Për shkak të distancës së tyre, përpjekja për t'i lidhur këto funksione me zonën e urbanizuar përreth do të rezultonte në një strategji të pasuksesshme. Plani parashikon që në vend të kësaj të përforcohet kjo “qendër publike” duke krijuar një shesh të vetëm përreth të cilit të organizohen të gjitha funksionet ekzistuese dhe të propozuara publike. Një qendër e re kulturore mbi rrënojat e mëparshme, e cila do të ketë hapësirë për të akomoduar edhe qendrën e re administrative. Ajo ekzistuese, për shkak të dimensionit të saj të kufizuar, do të kthehet në një pikë informacioni turistik. Një treg i ri lokal do t'u japë mundësi fermerëve që të shkëmbejnë direkt produktet e tyre dhe stacioni intermodal, pas ndërtesës së qendrës shëndetësore, do të sigurojë lidhjen mes kësaj qendre dhe pjesës tjetër të bashkisë.





Pac

- |                          |                                      |                          |
|--------------------------|--------------------------------------|--------------------------|
| <i>perim</i>             | <i>shkollë</i>                       | <i>pikë informacioni</i> |
| <i>rrugë e asfaltuar</i> | <i>treg</i>                          | <i>banim social</i>      |
| <i>triturar</i>          | <i>qendër ndihmëse për bujqësinë</i> | <i>shesh</i>             |
| <i>rrugë këmbësorësh</i> | <i>zhambi</i>                        | <i>kopsht lulishte</i>   |
| <i>qendër komunitare</i> | <i>qendër shëndetësore</i>           | <i>kënd lojërash</i>     |








Pac

Qendra e vogël urbane e Pacit është e vendosur në mënyrë strategjike në njësinë lokale Bytyç. Mund të arrihet lehtësisht nga fshatrat përreth dhe është një ndalesë e detyrueshme në rrugën nga Kukësi në Bajram Curri. Kjo lidhje e rëndësishme në fakt ka luajtur një rol domethënës për zhvillimin e kësaj qendre dhe do të luajë edhe në të ardhmen. Ashtu si me qendrat e tjera administrative, gjatë dhe menjëherë pas regjimit socialist, Paci është plotësuar me objekte të ndryshme publike që sot përbëjnë thelbin e infrastrukturës publike të kësaj njësie administrative. Plani vazhdon të punojë në këtë drejtim duke përmirësuar hapësirën ekzistuese publike dhe duke propozuar ndërtimin e një tregu të ri lokal pranë qendrës së bashkëpunimit për bujqësinë, një fushë sportive për shkollën dhe një stacion intermodal afër zonës kryesore urbane. Ky investim në funksionet e reja publike së bashku me përmirësimin e rrugës kryesore të komunikimit dhe përmirësimin e tokës dhe objekteve bujqësore do të ketë një ndikim të rëndësishëm për zhvillimin e kësaj njësie.







Fierzë

- |                          |                                      |                          |
|--------------------------|--------------------------------------|--------------------------|
| <i>peme</i>              | <i>shkolle</i>                       | <i>pikë informacioni</i> |
| <i>rrugë e asfaluar</i>  | <i>treg</i>                          | <i>shesh</i>             |
| <i>triturar</i>          | <i>qendër ndihmëse për bujqësinë</i> | <i>hapësira tullshte</i> |
| <i>rrugë këmbësorësh</i> | <i>zhumi</i>                         | <i>këndë lujërash</i>    |
| <i>qendër komunitare</i> | <i>qendër shëndetësore</i>           |                          |






Fierzë

I vendosur në grykën e lumit Valbona, Dushaj përfaqëson për shumë vizitorë hyrjen kryesore të rajonit. Trageti është ende lidhja më e zgjedhur për të arritur rajonin nga Komani dhe Shkodra, jo vetëm sepse këtu është vendi ku kalon fluksi më i madh turistik në Shqipëri, por edhe sepse tragetet u japin mundësinë vizitorëve të shijojnë një panoramë spektakolare dhe unike udhëtimi mbi lumin Drin. Pikërisht aty fillon dhe propozimi i planit. Rivendosja e ndalesës së trageteve në vendin e saj origjinal është një prioritet për këtë qendër urbane. Kthimi i këtij funksioni të rëndësishëm brenda zonës urbane mund të ketë në fakt një ndikim të madh ekonomik për zhvillimin e ardhshëm të qendrës. Së bashku me rivendosjen e tij, plani parashikon ndërtimin e një stacioni intermodal pranë tij dhe krijimin në anën tjetër të një parku linear që do të përballet me lumin dhe do të përfundojë në një nga ligatinat natyrore që do të trajtojë largimin e ujërave të zeza urbane para se të derdhen në lumë. Vëmendje të veçantë do t'i jepet gjithashtu rikualifikimit të të gjitha hapësirave publike ekzistuese.





Diagramë e agregimit të qendrave komunitare. Zmadhim nga masterplani.





## 12.1 Strukturat publike

Plani për shërbime sociale dhe hapësira publike, përveç përcaktimit të ofertës së shërbimeve publike për pesëmbëdhjetë vitet e ardhshme, luan një rol themelor në konsolidimin e qendrave urbane dhe rurale, S06. Prania e kufizuar e zonave të urbanizuara, e përkufizuar tashmë si qendër e grupimit të shërbimeve publike, lejon që plani të jetë shumë i saktë në përcaktimin e këtyre dispozitave. Plani në fakt, pasi identifikon 9 zona kryesore të urbanizuara, Bajram Curri, Tropojë e Vjetër, Margegaj, Jaho Salih, Dojan (Bujan), Llugaj, Lekbibaj, Pac, Dushaj (Fierzë), propozon për secilin prej tyre një plan të detajuar për menaxhimin e shërbimeve dhe hapësirave publike, duke siguruar praninë e pajisjeve kryesore publike të domosdoshme për funksionimin e tyre, si: tregjet, qendrat administrative dhe kulturore, shkollat e mesme, qendrat mjekësore, banesat sociale dhe sheshet. Këto plane janë menduar si udhëzues për të mbështetur bashkinë.

Fshatrat rurale do të mbështeten në këto qendra për shërbimet e nivelit administrativ, ndërsa do të pajisen me shërbimet e nivelit vendor si ambulanca, shkolla fillore dhe kopshte. Për këto vendbanime, ndryshe nga zonat e urbanizuara, plani propozon një strategji të ndërhyrjes, një metodologji, që do të aplikohet në mënyrë specifike për secilin rast. Këto fshatra nuk paraqesin ndonjë strukturë urbane të dallueshme, duke u paraqitur më shumë si një grup agregat shtëpish në tokë bujqësore. Prandaj, në vend që të mbivendosë një strukturë të re, plani përdor këto struktura vendore për të krijuar hapësira për organizimin dhe shkëmbimin shoqëror.

Paragrafët e mëposhtëm përshkruajnë në detaje planin e ndërhyrjes për shërbimet sociale dhe hapësirat publike. Vëmendje e veçantë i kushtohet llogaritjes së nevojës për shërbime arsimore dhe shëndetësore që duhet të jenë të pranishme në territorin e bashkisë për të përmbushur kërkesat e ligjit të planifikimit. Gjithashtu, janë dhënë disa parime arkitekturore, veçanërisht në lidhje me ndërhyrjet e propozuara për qendrat komunitare dhe rekreative, si dhe për hapësira të reja dhe të rehabilituara publike.


## 12.2 Qendrat komunitare

Për të përmirësuar cilësinë e jetës në territorin e bashkisë, plani propozon ngritjen e shërbimeve sociale dhe kolektive që do të përdoren për aktivitete kulturore dhe sociale. Këto struktura duhet të zhvillohen në afërsi të strukturave administrative ekzistuese, duke iu përshtatur, në aspektin e madhësisë dhe programeve, nevojave të çdo komuniteti. Në mënyrë të ngjashme me shkollat dhe qendrat shëndetësore, ato do të jenë pjesë e shërbimeve themelore për secilën njësi administrative.

Struktura e propozuar, e destinuar si hapësirë qytetare dhe kulturore, është një strukturë fleksibël dhe ekonomikisht e përballueshme ku funksione dhe aktivitete të ndryshme mund të kryhen në të njëjtën kohë dhe në hapësira të ndryshme. Ato nuk janë struktura komplekse, në shumicën e rasteve të propozuara - një dhomë e vetme e madhe që mund







Projekte  
për sheshe,  
trotuarë dhe  
kopshte

të përdoret dhe të ndahet për një ose më shumë nga funksionet e mëposhtme:

- Funksione kulturore si librari, sallë ekspozite, dhomë konferencash dhe projeksionesh video;
- Funksione administrative të tilla si zyrat postare vendore, ATM-të, zyrat me një ndalesë ose dhomat për administratën vendore të njësisë;
- Funksione sociale si një dhomë takimi për komunitetin vendas, një shesh lojërash për fëmijët.

Kur janë së bashku me qendrat administrative, formojnë një strukturë unike, një qendër komunitare lehtësisht të dallueshme bazuar në një parim të vetëm hapësinor: një oborr qendror i hapur që lejon shpërndarjen dhe qasjen në strukturat që e rrethojnë. Një kopsht i mbjellë me lloje bimësh të zonës që kërkojnë mirëmbajtje minimale. Kjo hapësirë qendrore do të lejojë që struktura të shtohet më tej në të ardhmen me struktura të reja kur buxheti ta lejojë ose kur ta kërkojë nevoja për hapësira të reja. Funksionet kështu nuk do të shpërndahen në territor dhe do të përqendrohen në qendrat kryesore të urbanizuara. Në territorin e bashkisë së Tropojës, PPV parashikon krijimin e qendrave komunitare në të gjitha qendrat kryesore administrative: Bajram Curri, Tropojë e Vjetër, Margegaj, Dojan (Bujan), Llugaj, Lekbibaj, Pac, Dushaj (Fierzë).

### 12.3 Hapësirat publike

PPV mbështetet nga një sërë ndërhyrjesh që synojnë përmirësimin e cilësisë së hapësirave publike në Bajram Curri, njësitë administrative dhe fshatrat kryesore. Këto ndërhyrje synojnë të rrisin cilësinë e jetës në të gjithë territorin e bashkisë, duke siguruar që banorët të kenë një vend për tubim dhe ndërveprim shoqëror dhe, në afat të gjatë, të kontribuojnë në pasurimin e kushteve të jetesës në zonat rurale.

Plani identifikon fushat ku ndërhyrjet e tilla duhet të zhvillohen, madhësinë e tyre dhe formatin e përgjithshëm të ndërhyrjeve të mundshme. Këto mund të marrin forma të ndryshme pasi duhet të përshtaten ndaj specifikave mjedisore, atyre të zonave të urbanizuara dhe densitetit të popullsisë. Këto ndërhyrje janë të organizuara sipas kategorive të mëposhtme:

- Hapësira publike si sheshe, kopshte dhe sheshe/kënde lojërash;
- Hapësira publike dhe oborret brenda blloqeve urbane;
- Hapësira publike përgjatë rrugëve kryesore urbane;
- Rrugët për këmbësorë.





Projekte  
për sheshe,  
trotuarë dhe  
kopshte

### *Sheshe të reja publike, kopshte dhe terrene sportive*

Rehabilitimi i shesheve ekzistuese, kopshteve dhe terreneve sportive dhe realizimi i tyre *ex novo* në të gjitha qendrat kryesore të territorit të bashkisë, është objektivi kryesor për hapësirat publike, në përputhje me ndërhyrjet që bashkia ka kryer në vitet e fundit. Çdo njësi vendore do të pajiset me të paktën një hapësirë publike të lirë dhe të arritshme, duke forcuar strukturën e secilës qendër urbane dhe duke e bërë atë më të identifikueshme. Ndërsa dimensionet e këtyre hapësirave ndryshojnë sipas kushteve specifike vendore, ndërhyrjet bazohen në përsëritjen e elementeve dhe materialeve të zgjedhura.

### *Hapësira publike dhe oborret brenda blloqeve urbane*

Këto ndërhyrje kanë të bëjnë me rehabilitimin e hapësirave të lira ndërmjet blloqeve të banimit në zonat urbane, sidomos në qytetin e Bajram Currit. Këto hapësira janë të lëna pas dore dhe përdoren kryesisht si vendparkim për automjete. Ndërhyrjet synojnë t'iu kthejnë këto hapësira banorëve të zonës, duke i transformuar ato në kopshte, sheshe lojërash për fëmijë dhe vende për tubime shoqërore. Zonat që preken nga ky propozim janë lagjet e Bajram Currit dhe të gjitha njësitë strukturore të identifikuara me kategoritë A2.1 dhe A2.2.

### *Hapësira publike përgjatë rrugëve kryesore urbane*

Struktura e shpërndarë e shumë vendbanimeve e bën të vështirë dhe ndonjëherë të pasigurt qasjen në objektet publike brenda të njëjtit fshat, pasi rruga është mënyra e vetme për t'iu arritur ato. Plani parashikon zhvillimin e hapësirave të reja publike përgjatë rrugës kryesore urbane ose rurale të secilës qendër në formën e një trotuari këmbësorësh. Kjo hapësirë e re publike, lineare, do të lidhë mes tyre funksionet kryesore publike të pranishme në secilën qendër dhe do të identifikojë vende për ndërhyrje "molekulare" (si kopshte, *patio*, sheshe publike etj.). Trotuari gjithashtu përmban një sërë pajisjesh të vogla, të vendosura në distancë të rregullt ndërmjet njëri-tjetrit, si pemë, stola, kosha mbetjesh, ndriçues rrugor dhe ndalesa autobusësh. Ndërtimi i tij do të shoqërohet në të njëjtën kohë me ndërtimin e një shtylle të re të infrastrukturës nëntokësore (kanalizime, ujësjellës etj.) në shërbim të të gjitha zonave urbane ose të një sistemi kullimi nëse janë afër fushave bujqësore.

### *Rrugët për këmbësorë*

Në vend të shtimit dhe krijimit të hapësirave të reja publike, nganjëherë vetë rruga mund të bëhet hapësira e re publike. Disa rrugë qendrore të vendosura posaçërisht në zonat e banuara/urbane u janë përkushtuar në total ose pjesërisht këmbësorëve. Disa raste janë ato në Jaho Salihë dhe Tropojë të Vjetër.






*Trotuar Urban*

*Trotuar Lidhës*

*Trotuar Rural*



- trotuar
- pçimë
- stol
- kash mbetesh
- mbriçues rrugor
- ▲ rampë
- mbrojtës stacion autobus
- kolektor uji
- · · elektricitet
- · · sistem i kanalizimit
- kanal



(në faqen  
paraardhëse)  
Diagramë e  
pajisjeve të  
trotuarëve

Projekte  
për sheshe,  
trotuarë dhe  
kopshte



## 12.4 Shkollat

PPV e mbështet hartimin e planit të masave për shërbimet sociale, specifikisht ato arsimore, në analizën në terma të sasisë dhe cilësisë të infrastrukturave ekzistuese që ofrojnë këtë shërbim në territorin e Bashkisë Tropojë, bazuar në udhëzimet e VKM Nr. 686, date 22.11.2017, VKM nr. 319, datë 12.04.2017, Ligjin Nr. 116/2016 *Për performancën e energjisë së ndërtesave* dhe udhëzimet e KE në lidhje me krijimin e mjediseve të shëndetshme (higjienike) në institucionet arsimore.

Analiza në terma sasiorë lidhet me nevojën për institucione sipas ligjit dhe kapaciteti që ofrojnë ato ekzistuese. Ndërhyrjet e sugjeruara, bazuar në këtë analizë, janë grupuar sipas:

- numrit të institucioneve në raport me popullsinë (projeksioni për vitin 2031);
- numrit të institucioneve në raport me rrezen e mbulimit me shërbim;
- sipërfaqes së parcelës dhe raportit të saj me numrin e nxënësve;
- sipërfaqes së ndërtimit dhe raportit të saj me numrin e nxënësve.

### *Numri i institucioneve në raport me popullsinë*

Mbështetur në të dhënat e grumbulluara dhe marrëdhënien që VKM Nr. 686, date 22.11.2017 vendos midis numrit të institucioneve arsimore dhe numrit të popullsisë, tabela e mëposhtme tregon nevojat për shërbime arsimore deri në vitin 2031.

njësia	shkolla të nevojshme sipas standardit				shkolla ekzistuese				shkolla të nevojshme			
	çerdhe	kopsht	shkolla fillore e 9-vjeçare	shkolla të mesme	çerdhe	kopsht	shkolla fillore e 9-vjeçare	shkolla të mesme	çerdhe	kopsht	shkolla fillore e 9-vjeçare	shkolla të mesme
B. Curri	4.4	2.9	0.7	0.5	1	4	3	1	3.4	-1.1	-2.3	-0.5
Bujan	1.6	1.1	0.3	0.2	0	5	6	0	1.6	-3.9	-5.7	0.2
Bytyç	1.3	0.8	0.2	0.1	0	3	9	2	1.3	-2.2	-8.8	-1.9
Fierzë	0.9	0.6	0.2	0.1	0	2	5	1	0.9	-1.4	-4.8	-0.9
Lekbibaj	0.3	0.2	0.1	0.0	0	1	8	1	0.3	-0.8	-7.9	-1.0
Llugaj	1.4	0.9	0.2	0.2	0	2	3	1	1.4	-1.1	-2.8	-0.8
Margegaj	2.2	1.5	0.4	0.2	0	3	4	0	2.2	-1.5	-3.6	0.2
Tropojë	3.6	2.4	0.6	0.4	0	6	12	1	3.6	-3.6	-11.4	-0.6
<b>TOTAL</b>	<b>16</b>	<b>10</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>26</b>	<b>50</b>	<b>7</b>	<b>15</b>	<b>-16</b>	<b>-47</b>	<b>-5</b>

Evidentohen disa raste ku shkollat/kopshtet ndajnë të njëjtën parcelë me qendra shëndetësore/ambulanca. kështu përmendim institucionet që ndajnë të njëjtin oborr (Degë në Fierzë dhe Gjonpepaj në Lekbibaj) dhe ato që ndajnë të njëjtën ndërtesë (Markaj në Bujan, Zogaj në Bytyç dhe Kërrnajë, Buçaj, Gegaj e T'Plan1 në Tropojë).

Në këto kushte, Planit i shfaqen tri detyra për zgjidhje:

- sigurimi i çerdheve për të përmbushur nevojat sipas ligjit;



- menaxhimi i stokut të ndërtesave të shkollave/kopshteve që rezultojnë me tepri;
- ndarja fizike e shërbimit arsimor nga ai shëndetësor, në ato raste kur janë të mbivendosur.

Për të përmbushur nevojat për çerdhe propozohet:

- integrimi i çerdheve në mjediset e shkollave/kopshteve ekzistuese që kanë kapacitete mbi nevojën, duke krijuar struktura të bashkuara, praktikë e njohur në disa nga shkollat në Bashkinë e Tropojës dhe e sugjeruar edhe nga ligji;
- ngritja e çerdheve në ndërtesat e liruara pas zhvendosjes së aktivitetit të shkollave në struktura të tjera fqinje, në rastet e mbivendosjeve të rrezeve të mbulimit me shërbim;
- ngritja e ndërtesave të reja në ato zona ku nuk mund të aplikohen alternativat e para.

Në lidhje me menaxhimin e stokut të ndërtesave që rezultojnë me tepri Plani sugjeron përdorimin e tyre për shkolla të formimit profesional (propozim i planit për përmirësimin e mjedisit bujqësor).

#### *Numri i institucioneve në raport me rrezet e mbulimit me shërbim*

Pavarësisht se raporti nxënës-institucion, në të gjitha shkollat e Bashkisë Tropojë, mund të jetë nën standardin e vendosur në VKM nr. 319, ekzistenca e disa prej këtyre ndërtesave justifikohet me rrezet e mbulimit me shërbim, për shkak të karakterit të shpërndarë të vendbanimeve në zonat rurale të Bashkisë Tropojë dhe kufizimeve në arritshmëri. Raste të tilla, të vendndodhjes së shkollave në zona të izoluara, mund të përmenden:

- shkolla 9-vjeçare “Mushak Haxhia” në Valbonë, Margegaj (33 nxënës);
- shkolla 9-vjeçare+kopsht “Ram Sadria” në Dragobi, Margegaj (27 nxënës);
- shkolla 9-vjeçare në Gegaj, Tropojë (18 nxënës);
- shkolla 9-vjeçare në Lugun e Tropojës, Tropojë (15 nxënës);
- shkolla 9-vjeçare në Degë, Fierzë (45 nxënës).

Duke marrë në konsideratë vendndodhjen gjeografike të ndërtesave të shkollave e kopshteve dhe lidhjen e tyre me infrastrukturën rrugore, për menaxhimin eficient të shpërndarjes së tyre propozohet:

- në raste të mbivendosjes së zonave të mbulimit me shërbim, shkollat/kopshtet të bëhen objekt menaxhimi alternativ, duke zhvendosur veprimtarinë e tyre në institucionet fqinje, brenda rrezes së shërbimit, të cilat kanë kapacitete për të pritur nxënësit e zonave të mbivendosjes;
- të reduktohet numri i shkollave/kopshteve duke fuqizuar sistemin e transportit publik, ose duke organizuar transport të dedikuar për fëmijët, në segmentet rrugore që lidhin shkolla/kopshte që ndodhen “pranë” njëra-tjetrës, të cilat nuk arrijnë të kenë mbivendosje të zonave të mbulimit me shërbim, por që kanë potencial akses të njëra-tjetra, të tilla si Lekbibaj (Salcë-Palç, Gjonpepaj-Mserr), Fierzë (Rajë-Fierzë, T’Pla-T’Pla 1), Bytyç (Vlad-Zherkë-Paç, Mash-Rodogosg-Visoçë, Kepenek-Zogaj-Prush) dhe Llugaj (Llugaj-Luzhë).





*Sipërfaqja e parcelës dhe raporti i saj me numrin e nxënësve*

Sipërfaqet e parcelave të institucioneve arsimore ekzistuese janë nën standardin aktual, përveç:

- shkollës “Ali Podrimja”, Bajram Curri;
- kopshtit Nr. 2, Bajram Curri;
- çerdhes në Lagjen Dardania, Bajram Curri;
- shkollës “Oso Dauti”, Llugaj.

Pavarësisht kësaj, sipërfaqja e ndërtimit për nxënës, përfshirë edhe hapësirat e lira, është përgjithësisht ndjeshëm më e lartë se ajo e rekomanduar nga VKM nr. 319, gjë që justifikon edhe tepriçën e mjediseve në dispozicion për popullsinë aktuale dhe atë të parashikuar për vitin 2031.

Gjithashtu koeficienti i shfrytëzimit të truallit në pjesën më të madhe të rasteve është në përputhje me udhëzimet e VKM ( $\leq 30\%$ ), me përjashtim të disa rasteve si:

- shkolla “Jaho Salih”, Bujan, 38%;
- shkolla fillore në Zherkë, Bytyç, 55%;
- shkolla fillore në Xhuxh (Prush), Bytyç, 35%;
- shkolla fillore në Visoçë, Bytyç, 31%;
- shkolla fillore në Breglumi (Rajë), Fierzë, 33%;
- shkolla “Tinka Kurti”, Lekbibaj, 33%;
- shkolla 9-vjeçare në Salcë, Lekbibaj, 52%;
- shkolla 9-vjeçare në Shëngjergj, Lekbibaj, 61%;
- shkolla 9-vjeçare në Lugu i Tropojës, Tropojë, 34%;
- shkolla “Haxhi Zenuni”, Tropojë, 40%;
- kopshti në Shumicë, Tropojë, 77%;
- shkolla fillore në Myhejan, Tropojë, 42%.

Koeficienti më i lartë se standardi përkthehet në sipërfaqe të lira të jashtme më pak se standardi. Pavarësisht numrit të vogël të nxënësve, këto institucione duhet të sigurojnë mjediset e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve mësimore dhe rekreative të jashtme. Kështu, ndërhyrjet do të konsistojnë në:

- zgjerimin e parcelave, në rastet e pamjaftueshmërisë së sipërfaqeve në dispozicion;
- pajisjen e sipërfaqeve të lira të parcelave me infrastrukturën e duhur për zhvillimin e aktiviteteve të jashtme, në rastet kur sipërfaqja është në dispozicion, por nuk është e pajisur.

*Sipërfaqja e ndërtimit dhe raporti i saj me numrin e nxënësve*

Aktualisht, të gjitha shkollat në Bashkinë e Tropojës e tejkalojnë nevojën për mjediset mësimore për numrin e nxënësve të cilëve u shërbejnë. Raporti i sipërfaqes së ndërtimit për nxënës është disa-fish më i lartë se standardi. Madje edhe në ato raste ku brenda ndërtesave të shkollave janë strehuar edhe shërbime të tjera si qendra shëndetësore, ky

raport vazhdon të jetë mbi nevojën. Këto hapësira të “tepërta” mund të përdoren:



- për të plotësuar me mjediset e brendshme akademike, shoqërore, administrative dhe ndihmëse që sugjeron ligji, ato shkolla që kanë mungesë të tyre;
- për të pritur nxënësit e shkollave që do të “shkrihen” si rezultat i riorganizimit sipas alternativave të përmendura më sipër;
- si mjedise për çerdhe, si një nga alternativat për plotësimin e nevojave për çerdhe.

Analiza në terma të cilësisë lidhet me cilësinë e mjediseve të ndërtesave të shkollave/kopshteve, e cila ndikon në cilësinë e procesit didaktik dhe sidomos në cilësinë e jetës së nxënësve e stafit të shkollave/kopshteve. Bazuar edhe në përshkrimet e VKM nr. 319 ndërhyrjet janë grupuar sipas tri parametrave:

- gjendja e mjediseve të jashtme;
- gjendja e mjediseve të brendshme;
- parametrat e komoditetit.

#### *Gjendja e mjediseve të jashtme*

Ajo që vihet re në shkollat/kopshtet e Bashkisë së Tropojës, majde edhe në ato që kanë qenë rishtazi objekt rikonstruksioni, është mungesa e hapësirave të mirëfillta të jashtme (hapësira sportive, të oborrit, qarkullimi dhe e gjelbër). Aktualisht ato prezantohen si hapësira pa karakter të formuar dhe të papajisura me elementet e nevojshëm për kryerjen e funksioneve si didaktike ashtu edhe atyre rekreative. Plani rekomandon:

- ndërhyrje për krijimin e hapësirave të jashtme të domosdoshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor (mjedise sportive të mirëfillta) dhe mirëqenien e nxënësve të shkollave (oborri dhe hapësira të gjelbëruara);
- trajtimin e hapësirës së jashtme si hapësirë që mund të marrë karakter publik jashtë orarit mësimor;
- ndarjen me kufij të dukshëm e funksionalë të hapësirave të jashtme, në rastin e shkollave/kopshteve që ndajnë të njëjtin mjedis të jashtëm me qendra shëndetësore/ambulanca, si shkolla në Degë të Fierzës dhe ajo e Gjonpepajt në Lekbibaj (qendra shëndetësore brenda oborrit të shkollës).


#### *Gjendja e mjediseve të brendshme*

Nga të dhënat e grumbulluara rezulton se problemet më të zakonshme me të cilat përballen shkollat/kopshtet në Bashkinë e Tropojës dhe si rrjedhim që kanë nevojë për zgjidhje janë:

- nyje higjiene-sanitare në gjendje jo të mirë;
- pajisje/rrjeti elektrike dhe hidraulike në gjendje jo të mirë;
- çati në gjendje jo të mirë;
- mungesë e theksuar e bazës materiale;
- mungesë e laboratoreve.

Cilësia e mjediseve të brendshme është e lidhur ngushtë edhe me cilësinë e ajrit në to, e cila është me rëndësi themelore për shëndetin e fëmijëve dhe stafit pedagogjik e ndihmës. Në këtë kuadër është thelbësore zgjedhja e materialeve të ndërtimit dhe





mobiljeve e pajisjeve didaktike gjatë ndërhyrjeve rikonstruktive dhe mirëmbatja e tyre gjatë jetës së objektit.

#### *Parametrat e komoditetit*

Këto parametra lidhen me tri nivele të komoditetit; atë termik, vizual dhe akustik.

Komoditeti termik është i një rëndësie të veçantë për këtë rajon, për shkak të kushteve të ashpra klimaterike me të cilat përballlet gjatë stinës së dimrit. Masat për përmirësimin e performancës termike të ndërtesave të shkollave/kopshteve kanë të bëjnë me:

- izolimin termik të perimetrit të ndërtesave – veshja e fasadave me material termoizolues dhe përdorimi i dritareve me koeficient të ulët të përcjellshmërisë termike;
- përmirësimin e sistemit të kullimit të ujërave të çatisë dhe të ujërave në nivelin e tokës;
- mbjelljen e sipërfaqeve të jashtme me bimë, për të siguruar mbrojtje nga erërat;
- përmirësimin e sistemit të ngrohjes, ose sigurimin e tij aty ku nuk ka – mundësisht të implementohen metoda alternative të sigurimit të energjisë për ngrohje ose sisteme pasive të ngrohjes.

Ndërhyrjet për të përmirësuar komoditetin vizual në shkollat ekzistuese lidhen me:

- sigurimin e ndriçimit artificial të nevojshëm dhe të pandërprerë;
- përdorimin e ngjyrave dhe materialeve të veshjes së sipërfaqeve reflektuese të dritës, të cilat të mos pengojnë ndriçimin;
- orientimin e mobiljeve kundrejt burimit të dritës, për të favorizuar ndriçimin e sipërfaqeve të punës;
- përdorimin e ngjyrave dhe materialeve veshëse për të krijuar/evituar gjendje të ndryshme emocionale të nxënësit.

Për sa i përket komoditetit akustik, në nivel urban, shkollat në territorin e Bashkisë së Tropojës janë të mbrojtura nga shqetësimet, pasi ndodhen larg akseve të rëndësishme rrugore, kjo për shkak të karakterit kryesisht rural të territorit. Megjithatë, shkolla “Besëlidhja e Malësisë” dhe kopshti Nr.1 në Bajram Curri dhe shkolla “Matosh Uka” në Fierzë, duke u ndodhur në situata urbane, janë të ekspozuara ndaj shqetësimeve akustike të mundshme.

Raste për t’u marrë në konsideratë në terma të komoditetit akustik janë edhe shkollat e bashkuara, brenda strukturave të të cilave janë disa nivele të arsimit, të cilat kanë kërkesa të ndryshme për qetësi në të njëjtat orare përdorimi.

Për të përmbushur kërkesat për komoditet akustik duhet të tregohet kujdes me zgjedhjen e materialeve për ndërhyrjet rikonstruktive, të cilat duhet të sigurojnë parametrat e kërkuar dhe trajtimin e hapësirave të jashtme me bimësi, duke zgjedhur llojin dhe kompozimin e tyre në mënyrë që të favorizojë mbrojtjen akustike.

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
institucioneve  
arsimore  
(kopshtet)









Tabela e ndërhyrjeve për përmirësimin e kushteve në institucionet arsimore

emri i shkollës/ kopshiti/ çerdhes	ndërhyrje	
	sasiore	cilësore
Asim Vokshi Bajram Curri Bajram Curri		përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
Besëlidhja e Matësisë Bajram Curri Bajram Curri	të presë fëmijët e shkollës "Konferenca e Bujanit"	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
Konferenca e Bujanit Bajram Curri Bajram Curri	të përdoret si çerdhe	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
Alli Pedrimja Bajram Curri Bajram Curri	të presë fëmijët e kopshit Nr. 2	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
Kopshiti Nr. 1 Bajram Curri Bajram Curri	të krijojë çerdhe në mjediset shtesë	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
Kopshiti Nr. 2 Bajram Curri Bajram Curri	të përdoret si çerdhe	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
Çerdhja, Lagjia Dardania (Gjongecaj) Bajram Curri Bajram Curri		përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
Jaho Salih Bujan Bujan	të presë fëmijët e shkollës "Bylbyl Breçani" të krijojë çerdhe në mjediset shtesë	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
Hasan Ahmeti Gri Bujan	STOK	
- Vatoc Bujan	të presë një pjesë të fëmijëve të shkollës "Hasan Ahmeti" të krijojë çerdhe në mjediset shtesë	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
Bylbyl Breçani Markaj Bujan	STOK	
- Lekurtaj Bujan	të presë një pjesë të fëmijëve të shkollës "Hasan Ahmeti" të presë fëmijët e shkollës së Selimajt të krijojë çerdhe në mjediset shtesë	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
- Selimaj Bujan	STOK	

(në faqen paraardhëse)  
Harta e institucioneve arsimore (cikll i ulët)








- Vlad Bytyç	STOK	
- Zherkë Bytyç	STOK	
Murat Paci Paci Bytyç	të presë fëmijët e shkollës së Vladit dhe Zherkës	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiëna)
Hoxbë Zogu Zogaj Bytyç	të presë fëmijët e shkollës së Kep- enekut të presë fëmijët e shkollës së Xhuxh-Prushit	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiëna)
- Kepenek Bytyç	STOK	
- Xhuxh (Prush) Bytyç	STOK	
- Rodogosh (Berishë) Bytyç	të presë fëmijët e shkollës së Mashit të presë fëmijët e shkollës së Visoçës	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiëna)
- Mash Bytyç	STOK	
- Visoçë Bytyç	STOK	
- Degë Fierzë	shkollë e izoluar	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiëna)
Niman Syla T'Plan Fierzë	të presë fëmijët e shkollës së T'Plan I	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiëna)
- T'Plan I Fierzë	STOK	
- Breglumi (Rajë) Fierzë	STOK	
Matosh Uka Fierzë Fierzë	të presë fëmijët e shkollës së Breglumi (Rajë)	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiëna)

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
institucioneve  
arsimore (cikli i  
mesëm)







Ndërhyrjet  
(me të kuqe)  
në shkollat  
dhe sheshet  
ekzistuese të  
lojërave

Tinka Kurti Lekbibaj Lekbibaj	të presë një pjesë të fëmijëve të shkollës së Mserrit	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
- Salce Lekbibaj	të presë fëmijët e shkollës së Paçit të presë fëmijët e shkollës së Brisë	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
Sokol Basha Gjonpepaj Lekbibaj	të presë një pjesë të fëmijëve të shkollës së Mserrit	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
- Shëngjergj Lekbibaj		përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
- Palç Lekbibaj	STOK	
- Tetaj Lekbibaj		përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
- Mser Lekbibaj	STOK	
- Brisë Lekbibaj	STOK	
Oso Dauti Llugaj Llugaj	të presë fëmijët e shkollës së Luzhës	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
Lek Qokaj Cërnice Llugaj	të presë një pjesë të fëmijëve të shkollës së Sopotit	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
- Luzhë Llugaj	STOK	
Mushak Kadria Margegaj Margegaj		përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
Haxhi Zekë Byberi Shoshan Margegaj		përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
Ram Sadria Dragobi Margegaj	në zonë të izoluar	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
Mushak Haxhia	në zonë të izoluar	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia)



Valbonë Margegaj		përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
Ali Ibër Neza Astë Tropojë	të presë një pjesë të fëmijëve të shkollës së Myhejanit të presë një pjesë të fëmijëve të shkollës së Viçidolit	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
- Lugu i Tropojës Tropojë	në zonë të izoluar	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
Haxhi Zenuni Buçaj Tropojë	të presë një pjesë të fëmijëve të shkollës së Myhejanit	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
- Gegaj Tropojë	në zonë të izoluar	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
- Viçidol Tropojë	STOK	
- Kasaj Tropojë	në zonë të izoluar	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
- Babinë Tropojë	të presë një pjesë të fëmijëve të shkollës së Sopotit të presë një pjesë të fëmijëve të shkollës "Hysni Zajmi"	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
- Begaj Tropojë		përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
- Sopot Tropojë	STOK	
- Shumicë (Ahmataj) Tropojë	STOK	
Xheladin Gosturani Kovaç Tropojë	të presë një pjesë të fëmijëve të shkollës së Myhejanit të presë një pjesë të fëmijëve të shkollës "Hysni Zajmi"	përmirësim i kushteve të ndërtesës (fasada, çatia) përmirësim i mjediseve të jashtme (oborri, gjelbërim, sport) përmirësim i mjediseve të brendshme (bazë materiale, higjiena)
- Myhejan Tropojë	STOK	
Hysni Zajmi Kërmajë Tropojë	STOK	

Shënim: STOK nënkupton ndërtesat që mbeten të papopulluara



Përditësimi dhe dokumentimi i të dhënave mbi gjendjen ekzistuese të këtyre institucioneve është thelbësor të bëhet periodikisht gjatë viteve në vazhdim, në mënyrë që të ketë një panoramë të qartë të situatës mbi të cilën duhet ndërhyrë ose jo.

## 12.5 Kujdesi ndaj shëndetit

Plani parashikon zhvillimin e objekteve të kujdesit shëndetësor me qëllim përmbushjen e kërkesave të ligjit shqiptar të planifikimit. Objektet e kujdesit shëndetësor janë ambulancat dhe qendrat shëndetësore. Duke marrë në konsideratë parashikimet demografike për popullsinë në Tropojë deri në vitin 2032, është përcaktuar numri i këtyre objekteve për secilën njësi administrative vendore të pranishme në territorin e bashkisë.

Krahasimet dhe llogaritjet e ndryshme tregojnë se, për objektet e kujdesit shëndetësor, ekziston një mospërputhje e konsiderueshme ndërmjet numrit të objekteve që kërkohen për t'i shërbyer numrit të popullsisë dhe shpërndarjes së tyre optimale në territor. Në fakt, është e pamundur shpërndarja e qendrave shëndetësore në fshatra të vegjël, të cilët në të ardhmen duhet të varen nga objektet për shërbimin shëndetësor të fshatrave fqinje.

Llogaritja e nevojës për struktura për kujdesin shëndetësor merr parasysh numrin e objekteve ekzistuese pa vlerësuar gjendjen e tyre fizike dhe dimensionale dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor të ofruar.




Aplikimi i vlerave dhe parametrave të ligjit të planifikimit vë shumë presion mbi kapacitetin financiar të qeverisjes vendore dhe Ministrisë përkatëse për vitet e ardhshme. Për këtë arsye, plani mbështet kombinimin e funksioneve të kujdesit shëndetësor në qendrat qytetare të propozuara për qendrat kryesore, ndërsa për fshatrat rurale, përpjekjet duhet të përqendrohen fillimisht në vendbanimet më të populluara dhe në ato përgjatë rrugëve turistike.

Njësia	Popullsia 2031	Nevojat sipas standardit		Situata ekzistuese		Qendra të nevojshme	
		Ambulancë	Qendër shëndetësore	Ambulancë	Qendër shëndetësore	Ambulancë	Qendër shëndetësore
Bajram Curri	4361	2.2	2.9	0	2	2.2	0.9
Bujan	1620	0.8	1.1	5	3	-4.2	-1.9
Bytyç	1273	0.6	0.8	0	4	0.6	-3.2
Fierzë	903	0.5	0.6	1	4	-0.5	-3.4
Lekbibaj	336	0.2	0.2	2	5	-1.8	-4.8
Llugaj	1416	0.7	0.9	5	0	-4.3	0.9
Margegaj	2176	1.1	1.5	1	6	0.1	-4.5
Tropojë	3607	1.8	2.4	1	10	0.8	-7.6
Total	15692	7.8	10.5	15	34	-7.2	-23.5

Tabela e nevojave për strukturat e kujdesit ndaj shëndetit sipas numrit të popullsisë







Ndërhyrje  
përmirësuese  
të varrezave

## 12.6 Varrezat

Përmirësimi i gjendjes së varrezave ekzistuese dhe përcaktimi i zonave të reja të zgjerimit, veçanërisht për ato në zonat kryesore urbane, janë pjesë e objektivave të këtij plani. Për shkak se shumica e varrezave ekzistuese janë vendosur pranë rrugëve kryesore ose në afërsi të funksioneve publike si shkolla dhe ndërtesa fetare, është shumë e rëndësishme të zvogëlohet ndikimi i tyre vizual. Në shumë prej këtyre varrezave, varret janë të dukshme nga rrugët ose, si në rastin e pranishëm të tyre pranë shkollave, fëmijët duhet të ecin nëpër varre për të arritur në shkollë. Plani propozon mbjelljen e rreshtave të pemëve dhe shkurreve të vogla përgjatë rrugës kryesore të brendshme dhe perimetrit të jashtëm në mënyrë që të krijojë një pengesë natyrore të integruar në mjedis. Një sistem i duhur i kullimit duhet gjithashtu të integrohet me ndërhyrjet e tilla.

Duke marrë për bazë shkallën e vdekshmërisë së popullatës rezidente dhe duke llogaritur numrin e vdekjeve të parashikuara deri në 2032, është përcaktuar përafërsisht dimensiononi i kërkuar i varrezave ekzistuese dhe të reja. Llogaritja nuk mund të ishte më e saktë, pasi për shembull, është e pamundur të merret parasysh numri i emigrantëve që dëshirojnë të varrosen në vendlindjen e tyre.



Tabela e të dhënave të vdekshmërisë

Administrative unit	Resident population at 2017	Mortality rate	Resident population at 2032	Number of decess expected in the administrative unit	Number of decess expected in the main center
B.Curri	8102	0,42	7192	513	-
Margegaj	3029	0,56	2752	265	100
Tropojë	5412	0,56	4895	465	56
Bujan	3029	0,68	2818	320	88
Llugaj	2108	0,53	1713	165	51
Fierzë	2375	0,59	1702	192	60
Bytyç	2063	0,81	1754	250	56
Lekbibaj	1811	0,56	982	125	26

Varrosja është forma më e zakonshme dhe e përbashkët në rajon. Duke marrë parasysh madhësinë e vendbanimeve të pranishme në territor, plani nuk e konsideron të domosdoshme të parashtrijë, të paktën për momentin, forma të tjera të sistemit të varrimit, si vendmbajtje eshtrash apo struktura të tjera të ndërlidhura. Do të prezantohet një formë të re varrimi që ka nevojën të reduktojë konsumin e tokës që konsumon nëpër qendrat kryesore.


Ndër varrezat e reja dhe propozimet për zgjerim, është veçanërisht e rëndësishme ndërhyrja e propozuar për varrezat e reja për Bajram Currin dhe Dojanin. Afër këtyre dy qendrave është Varreza e Dëshmorëve, një strukturë perkujtimore e periudhës socialiste





Ndërhyrje  
përmirësuese  
të varrezave





në të cilën janë varrosur disa prej heronjve më të rëndësishëm kombëtarë. Plani, së bashku me rinovimin e këtij vendi me rëndësi historike e kulturore, propozon ndërtimin e varrezës së re që do të shërbejë për dy qendrat, duke racionalizuar nevojën për toka të reja dhe duke kontribuar në krijimin e një vendi të vetëm për kujtesën kolektive.

Varreza e re do të përdorë parimin formal të Varrezave e Dëshmorëve dhe do të projektohet si një seri terracash, planesh horizontale, që do të ndjekin formën e kodrës. Pemët e pishave në rreshta të vetme dhe të dyfishta do të përdoren për planin e ri, duke përcaktuar kufirin e secilës terracë, ndërkohë që përdorimi i pemëve të bredhit do të kufizohet vetëm për pjesën qendrore të memorialit.

## 12.7 Plani i strehimit social

Plani propozon strategji të ndryshme për të përmbushur nevojat për strehim në rajon. Me këtë qëllim është përpjekur të adresojë nevojat e 150 familjeve të pastreha që janë kryesisht të pranishme në Bajram Curri (të dhënat e raportuara për vitin 2017). Përkundër theksimit të kërkesës për më shumë investime nga qeveria qendrore në mbështetje të familjeve në vështirësi dhe në zgjerimin e qasjes në programet e ndihmës të përcaktuara nga “Strategjia e Strehimit Social 2016-2055”, plani ka përcaktuar dy ndërhyrje strategjike për të rritur ofertën e banesave sociale në të ardhmen e afërt:


### *Ndërtimi i strukturave të reja të banimit social*

Veprimi i parë synon të përmirësojë kapacitetin e bashkisë në ofertën e njësive të banimit social, duke siguruar ndërtimin e njësive të reja dhe promovimin e banesave sociale me qira për të përballuar kërkesën pa përgjigje të personave/familjeve në nevojë, duke marrë parasysh edhe ata qytetarë që aktualisht nuk kualifikohen për strehim social dhe komunitetet e marginalizuara. Plani parashikon ndërtimin e:

- Dy ndërtesa të reja në lagjen Partizani;







Banesa sociale,  
zonat e  
përzgjedhura  
për ndërhyrje  
në Bajram Curri



- Një ndërtesë e re për 5 familje rome.

Ndërtimi i dy ndërtesave të para të banimit do të sigurojë apartamente për më shumë se 30 familje, ndërsa ndërhyrja e dytë do të përmirësojë gjendjen e 5 familjeve rome që jetojnë në kushte shumë të këqija.

#### *Rinovimi i stokut ekzistues të banesave*

Përveç ndërhyrjeve për ndërtime të reja, një veprim tjetër i rëndësishëm do të jetë kombinimi i strategjisë për strehimin social me rinovimin e stokut ekzistues të banesave, veçanërisht për ato të ndërtuara para viteve '90. Këtu janë identifikuar dy ndërhyrje kryesore:

- Rinovimi i ish "Hotelit të Punëtorëve";
- Rinovimi i ndërtesave ekzistuese të banimit me ndërtimin e një kati shtesë për banim social.

Ish "Hoteli i Punëtorëve" është sot shtëpia për katër familje me probleme të ndryshme sociale. Kjo jo vetëm që do të përmirësojë kushtet e jetesës për këto familje, por do t'u lejojë edhe 16 familjeve të tjera që të kenë një shtëpi të re.


Për t'iu përgjigjur kërkesave të mbetura dhe të ardhshme, plani do të japë mundësinë për të krijuar njësi të reja banimi në rreth 90 ndërtesa banimi (të ndërtuara gjatë kohës së socializmit) në Bajram Curri dhe në qendra të tjera, kryesore dhe rurale, si në "Zonën B" në Fierzë. Në të gjitha njësitë strukturore të kategorizuara A2.1 dhe A2.2 do të mund të shtohet një kat shtesë duke zëvendësuar tarracën e sheshtë ekzistuese me një çati druri. Apartamentet e reja do të jenë kështu në papafingo. Ku ka tashmë një çati, kjo ndërhyrje nuk do të lejohet. Ky veprim do të parashikojë gjithashtu ndërhyrjet që përmirësojnë efektshmërinë energjitike. Rinovimet e fasadave, si dhe çatitë me izolim termik dhe përdorimi i dritareve termike do të mundësonin zvogëlimin e efekteve negative të urave termike dhe rritjen e kapacitetit të magazinimit të nxehtësisë të çdo strukture. Ky veprim gjithashtu trajton rehabilitimin e ndërtesave të braktisura në banesat sociale si në Rragam dhe Kam.

#### **12.8 Mbrojtje kombëtare, civile dhe kundër zjarrit**

Në kuadër të politikave për mbrojtjen e zonave të rrezikuara në Bashkinë Tropojë, të cilat kryesisht i referohen rrezikut të dëmtimit nga zjarri, janë parashikuar një sërë objektivash dhe politikash për parandalimin dhe reduktimin e dëmit në zonat pyjore dhe të gjelbra.

Është e domosdoshme nevoja e një monitorimi të rreptë dhe e aplikimit të plotë të





01\_Ndërtesë e re në lagjen Partizani



02\_Ndërtesë e re në lagjen Partizani



03\_Ndërtesë e re për 4 familje Rome



04\_Ish "Hoteli i Punëtorëve"



Banesa sociale,  
zonat e  
përzgjedhura  
për ndërhyrje  
në Bajram Curri



ligjit për Pyjet Nr. 9385/2005 ndryshuar me Nr. 48/2016. Monitorimi i pyjeve është i domosdoshëm për t'i mbrojtur ato nga djegiet aksidentale si pasojë e praktikave të gabuara në zonë për djegien e kullotave apo për shkak të prerjes së drurëve për qëllim ngrohjeje. Zonat e mbrojtura janë të rrezikuara si pasojë e presioneve të zhvillimit në zonë. Dëmi që vjen nga djegiet dhe prerjet e drurëve nuk lidhet vetëm me pyjet por edhe me llojet e rralla dhe endemike që i përdorin ato si habitate.

Zjarret konsiderohen si kërcënimi kryesor për vlerat natyrore të zonës dhe shkallën e natyralitetit të saj. Në disa zona ata kanë lënë gjurmët e tyre shkatërruese, duke djegur pyjet dhe rritur dukshëm nivelin e erozionit të shpateve malore. Një faktor tjetër që ndikon në këtë fenomen është fakti se terreni mbërrihet me vështirësi nga njerëzit, dhe thuajse është i pambërritshëm për makinat. Gjithashtu burimet njerëzore në zonë janë të kufizuara dhe në raste të rënies së zjarrit, ndikimin më të madh në shuarjen e tij e ka terreni më shumë se banorët. Ndryshimet klimatike pritet të ndikojnë negativisht në këtë drejtim. Për të përballuar këtë kërcënim të vazhdueshëm është e rëndësishme të organizohen sisteme efikase të parandalimit dhe shuarjes së zjarrit në pyje.

Shuarja e zjarreve shpesh kërkon pjesëmarrjen e shumë zjarrfikësve dhe në raste të veçanta popullsia vendase bëhet pjesë e shuarjes së zjarreve. Megjithatë është e nevojshme që personeli i zjarrfikësve të jetë i specializuar dhe të ketë njohuri të mira mbi shuarjen e zjarreve, të ketë pajisjet e duhura dhe formimin specifik për përdorimin e tyre, të jetë i organizuar në struktura operative dhe të zhvillojë një strategji për shuarjen e zjarreve, e cila duhet të jetë e përshtatshme për tipet e territorit. Shuarja e zjarreve në pyje kërkon pajisje specifike për tipin e zjarrit, fazën e zhvillimit të tij dhe kushtet mjedisore.

Strategjia parashikon aktivitetet si më poshtë:

- Përmirësim të shërbimit ekzistues zjarrfikës (vënia në dispozicion e mjeteve të reja, përmirësimi i ndërtesës);
- Pajisje me sisteme të përshtatshme të mbrojtjes nga zjarri dhe formimin specifik;
- Forcim i kapaciteteve institucionale për kontributin e përbashkët midis komuniteteve dhe shërbimit zjarrfikës.


Rreziqe të tjerë me peshë janë erozioni dhe përmbytjet që, deri diku, vijnë si rrjedhojë e njëra-tjetrës, por janë të lidhura ngushtë edhe me shpyllëzimin. Prurjet e shumta dhe gati të paparashikueshme të lumenjve gjatë periudhës së reshjeve sposton sedimentet dhe shton aktivitetin eroziv.

Krijimi i pritave përgjatë përrenjve lejon mbajtjen e sedimenteve dhe garanton një rrjedhje më të mirë të lumit dhe minimizon koston e mirëmbajtjes së lumit. Sedimentet e mbajtura mund të përdoren si material për ndërtim. Kjo do të sjellë shmangien e mbishfrytëzimit të lumit për nxjerrje materiali.

Për të zbutur impaktin e ndryshimeve klimatike mbi pasuritë hidrogeologjike duhet të krijohen sisteme të buta të mbajtjes/grumbullimit të ujërave të shiut. Ky sistem do të ulë shpejtësinë e rrjedhjes së ujit dhe do të krijojë mundësinë e shfrytëzimit të ujit për







bujqësinë. Krijimi i hapësirave për ujin dhe sedimentet në zona përmbytjesh të kontrolluara është thelbësor në rast reziku përmbytjesh. Brezat e rezervuar të lumit mund të shfrytëzohen për këtë funksion dhe të kombinohen me infrastruktura të lehta për rekreacion dhe me të mbjella rezituese ndaj ujit.

Një sfidë prioritare për territorin e bashkisë së Tropojës është ndalimi i fenomenit të erozionit. Ky territor klasifikohet si territor me nivel të lartë potencial dhe aktual të erozionit. Ky fenomen në vitet e fundit ka patur një trend në rritje. Ndalimi i erozionit është jetësor për këtë territor dhe mund të arrihet nëpërmjet ndërhyrjeve të mëposhtme:

- Ripyllëzim i “tokave të reja” dhe brezareve të cënuara me kultura autoktone të përshtatshme për konservimin e tokës;
- Ripyllëzim i zonave të cënuara përgjatë lumenjve e përrenjve;
- Program për rehabilitimin e zonave të prekura nga rrëshqitjet e dheut nëpërmjet ripyllëzimit dhe strukturave pritëse.

Masat për të nxitur ndërgjegjësimin e publikut mbi rëndësinë e natyrës, luajnë një rol kyç. Gama e alternativave për të ndihmuar bërjen e natyrës pjesë të qytetarëve është e madhe, që nga përdorimi i elementeve didaktikë (diagramat, tabelat, fotografitë), me sistemet tradicionale të komunikimit (media publike, ekspozita tematike, tryeza të rumbullakëta, shtypi lokal, TV dhe programet e radios, etj.) deri te përdorimi i teknologjive moderne dhe mediave sociale.

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
strategjisë për  
strehim social






100

**13 PLANI I MASAVE PËR INFRASTRUKTURËN BAZË URBANE**







### 13.1 Rrjeti i propozuar i furnizimit me ujë të pijshëm

Në saje të pozicionit gjeografik, territori i bashkisë së Tropojës është më shumë se i pasur për sa i përket burimeve ujore. Rrjeti kryesor, me zanafillë në Valbonë, furnizon me ujë qytetin e Bajram Currit dhe një pjesë të mirë të zonave të banuara rreth tij. Për të përmbushur nevojën për shërbimin e ujësjellësit është përgatitur një studim i shoqëruar nga projekti përkatës për ndërtimin e ujësjellësit me zanafillë burimin “Perlinat e bardha”, i cili do të shërbejë për territoret e njësisë administrative Tropojë dhe Llugaj. Kjo do të sjellë një përmirësim të ndjeshëm në shërbimin e ujësjellësit, megjithatë nuk arrin të plotësojë të gjithë nevojën. Shërbimi i furnizimit me ujë nuk është i kontrolluar për të gjitha vendbanimet e këtij territori. Ende ka vendbanime të cilat nuk janë të lidhura me rrjete të ujësjellësit, të cilat gjenden në zonat më të largëta nga qendra. Ato shërbehen duke marrë ujë nga përrenjtë. Kjo praktikë ka nevojë të rishikohet në mënyrë që t’u garantohet banorëve një shërbim që nuk rrezikon shëndetin e tyre.


Rrjeti kryesor ka nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme dhe përmirësime të sistemit të kontrollit për t’u bërë ballë humbjeve. Sistemet e automatizuara të kontrollit janë një instrument i cili do të ndihmonte në një administrim më të mirë të këtij shërbimi, duke vënë në dukje zonat ku ka humbje. Përmirësimet e sistemit duhet të marrin në konsideratë edhe nevojën për të përballuar kushtet e ashpra klimatike të këtij territori. Përmirësimi i kushteve të kësaj infrastrukture ka për qëllim të garantojë një shërbim të vazhdueshëm të furnizimit me ujë për të gjithë territorin duke minimizuar humbjet.

Thelbësor për këtë është zbatimi i projektit të burimit “Perlinat e bardha”. Ky rrjet i ri do të garantojë mbulimin me shërbim për një pjesë të gjerë të këtij territori. Për sa i përket nevojës për zgjerimin e rrjetit në vendbanimet më të largëta, mundësia për të ofruar një shërbim të kontrolluar të ujësjellësit garantohej nga vetë territori i Bashkisë Tropojë. Këtu ka një numër të mjaftueshëm burimesh, të cilët janë në gjendje të garantojnë zgjerimin e rrjetit. Vënia në shfrytëzim e tyre, falë pozicionit gjeografik dhe prurjeve mesatare, kërkon investime të përmbajtura si për realizimin ashtu edhe për mirëmbajtjen.

Edhe pse ky territor është i pasur me burime ujore, administrimi i mirë i tij është i nevojshëm. Kjo strategji parashikon nxitjen e mekanizmave të mbledhjes dhe depozitimit të ujërave të shiut dhe ripërdorimin e tyre (për ujitje, shkarkime, etj.). Këto mekanizma janë thelbësore për përmirësimin e përdorimit të burimeve natyrore lokale.

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
propozimeve të  
infrastrukturës  
së furnizimit  
me ujë





### 13.2 Sistemi i propozuar i kanalizimeve të ujërave të zeza

Në shumicën e rasteve, ujërat e zeza në bashkinë Tropojë shkarkohen, pa asnjë trajtim, në lumenj apo përrrenj duke çenuar, për shkak të ndotjes, cilësinë mjedisore të tyre por edhe të tokave përreth dhe, si pasojë, të produkteve që këto toka japin. Trajtimi i ujërave të zeza në këtë territor është një çështje urgjente. Ky trajtim duhet të jetë në përputhje me Strategjinë Kombëtare Sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2011-2017 dhe me direktivat që rrjedhin nga BE.

Kanalet e dëmtuara dhe që lejojnë rrjedhje të ujërave duhet të rehabilitohen. Këto kanalet, krahas ndotjes që shkaktojnë në tokën ku rrjedhin, kur ndodhen në afërsi të rrjetit të ujësjellësit rrezikojnë ndotjen e ujit të pijshëm, duke rrezikuar të çënojnë shëndetin për numra të konsiderueshëm banorësh. Kanalet e ujërave të zeza duhet të kenë mbikëqyrje dhe mirëmbajtje të vazhdueshme.

Zgjerimi i zonës së shërbyer mund të bëhet duke bashkuar rrjetin e njësisë administrative Margegaj me atë të Bajram Currit. Ky bashkim do të sillte rritjen e numrit të banorëve të shërbyer nga një sistem qendror, i cili do të përfundojë me një impiant trajtimi të katër ujërave. Ujërat e trajtuara do jenë të një cilësie të tillë që të mundësojnë përdorimin e tyre për vaditje. Mbetjet e tjera, pas një trajtimi të mëtejshëm, do mund të përdoren gjithashtu në bujqësi.

Trajtimi duhet të sigurohet edhe për ato qendra që kanë një sistem të centralizuar që përfundon me gropë septike të përbashkët. Këto gropa septike duhet të përshtaten për të lejuar një trajtim dytësor të ujërave që mbliken në to. Ky trajtim, që mund të bëhet nëpërmjet *ligatinave të ndërtuara*, do të sigurojë cilësi uji të përshtatshme për përdorim në bujqësi dhe do të garantojë mosçënimin mjedisor të lumit ku do të shkarkohet.


Janë disa vendbanime të cilat nuk janë të shërbyera nga sistemi i kanalizimeve dhe nuk bëjnë asnjë trajtim të ujërave të zeza. Në këto vendbanime është e nevojshme të ndërtohen sisteme gjysmë të centralizuara ose sisteme të kombinuara në vend - i centralizuar për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave. Secili sistem duhet të jetë i përbërë nga një pajisje për trajtimin primar dhe një *ligatinë e ndërtuar* për trajtimin dytësor. Kjo ndërhyrje është urgjente në Tropojë, ku rrjeti ekzistues i ujërave të zeza shkarkon në lum pa asnjë trajtim. Gjithashtu, urgjente është pajisja me *ligatina të ndërtuara* për trajtimin dytësor në Fierzë dhe Zonën B, ku janë të ndërtuara rishtas gropat septike të përbashkëta.

Për një administrim të plotë të ujërave të zeza bashkia Tropojë do të vendosë rregulla që detyrojnë krijimin e gropave septike sipas standardeve për ato banesa që nuk janë të lidhura me asnjë rrjet. Këto rregulla duhet të nxisin edhe instalimin e pajisjeve të decentralizuara për trajtim dytësor.

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
propozimeve të  
infrastrukturës  
së ujërave  
të zeza dhe  
menaxhimi i  
derdhjeve të  
tyre







### 13.3 Rrjeti i furnizimit me energji elektrike dhe i komunikimit elektronik

#### *Rikthimi i impianteve të hidrocentraleve*

Rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike në territorin e bashkisë Tropojë ka një kapilaritet të mirë. Kjo është e lidhur edhe me faktin që në këtë territor gjendet një nga hidrocentralet kryesore të vendit, ai i Fierzës dhe disa hidrocentrale më të vogla të shpërndara në territor. Edhe pse me këto kushte të favorshme, mungesa e energjisë dhe tensioni i ulët është një konstante në vendbanimet e largëta. Rreti i shpërndarjes së energjisë do të përforcohet nëpërmjet përmirësimeve në stacionet e transformimit dhe kabinat elektrike si dhe nëpërmjet krijimit të infrastrukturës nëntokësorë të shpërndarjes së energjisë.

Në territorin e Bashkisë Tropojë do të nxitet prodhimi alternativ i energjisë. Ky prodhim është i lidhur me kushtet mjedisore të këtij territori dhe mundësitë që këto kushte krijojnë. Prodhimi i energjisë nëpërmjet shfrytëzimit të erës, diellit dhe biomasës është një mënyrë e efektshme për të ulur varësinë nga rrjeti i centralizuar dhe, sidomos në rastin e vendbanimeve të përkohshme (bjeshkët), është mënyra që më pak çënon mjedisin natyror.

### 13.4 Menaxhimi i mbetjeve

Ky program mbështetet në draft-strategjinë ndërsektoriale të mjedisit 2015-2020 dhe në Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.


Bashkia e Tropojës gjendet në *Zonën e mbetjeve 5*, për të cilën ende nuk është përpiluar plani i menaxhimit të mbetjeve. Për këtë bashki riorganizimi i menaxhimit të mbetjeve dhe shtrirja e këtij shërbimi në tërësinë e territorit është prioritar. Mangësitë në këtë shërbim kanë efekte negative shumë-dimensionale. Nga një anë, këto efekte çënojnë shëndetin e banorëve dhe cilësinë e jetës dhe, nga ana tjetër, kanë një efekt negativ edhe në zhvillimin ekonomik të këtij territori, që gjenerator kryesor të rimëkëmbjes ekonomike ka turizmin.

Një menaxhim i mirë i mbetjeve kërkon që ato të parandalohen dhe reduktohen që në burim sa më shumë të jetë e mundur. Për këtë qëllim është e nevojshme ndërmarra e fushatave informuese dhe të rritjes së ndjeshmërisë mbi këtë çështje. Këto fushata janë të nevojshme, pasi me rritjen e numrit të vizitorëve në këtë territor rritet edhe rreziku i një shtimi të shpejtë të sasisë së mbetjeve të prodhuara.

Aktualisht, në Bajram Curri gjendet pika e grumbullimit të mbetjeve për të gjithë territorin e bashkisë së re. Kjo pikë grumbullimi nuk ofron një menaxhim të efektshëm të mbetjeve. Është urgjente që të ndalohen praktikat që aplikohen aty në mënyrë pakontrolluar, si p.sh. djegia e mbetjeve. Gjithashtu është i nevojshëm ndërtimi i një

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
propozimeve të  
infrastrukturës  
së furnizimit  
me energji  
elektrike





*landfill* të ri, që respekton kushtet teknike dhe ligjore, dhe rinovimi i parkut të mbetjeve të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve. Përveç nevojave materiale, për të ofruar një shërbim të efektshëm është i nevojshëm edhe një studim specifik për organizimin kohor dhe të trajektoreve të udhëtimeve për mbledhjen e mbetjeve.

Bazuar në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, Bashkia do të nxisë ndarjen e mbetjeve në origjinë sipas sistemit të grumbullimit me tre kosha (1. Riciklimet e thata; 2. Riciklimet e lëngshme; 3. Mbetjet e tjera). Për të arritur rezultatet e pritura do të organizohen fushata informimi. Arritja e rezultateve në ndarjen e mbetjeve në origjinë do të përshpejtonte zhvillimin e ekonomive në fushën e riciklimit dhe do të zvogëlonte kapacitetin e nevojshëm për *landfill*.

Praktika e përdorimit të mbetjeve ushqimore për plehërim është gjerësisht e përdorur në zonat rurale. Në zonat rurale, më shumë se 60% e mbetjeve kanë natyrë organike. Këto mbetje, nëpërmjet kompostimit, mund të rifuten në përdorim duke përmirësuar cilësinë e tokës dhe të produkteve të saj pa përdorur fertilizues kimik. Nxitja e kompostimit do të bëhet duke organizuar programe trajnimi dhe mbështetjeje në blerjen e koshave të përshtatshëm për kompostimin shtëpiak.

Organizimi i mbledhjes së mbetjeve sipas sistemit të grumbullimit me tre kosha është hapi i parë për nxitjen e ekonomisë së riciklimit. Nëpërmjet kësaj ekonomie, riciklimet e thata dhe riciklimet e lëngshme mund të rifuten në ciklin ekonomik duke dhënë materiale të para dhe lëndë për plehërosje. Kjo ekonomi ka potencialin të ulë shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve. Mbetjet mund të grumbullohen në stacionet e transferimit pranë qendrave të njësive administrative, ku do të përgatiten për t'u transportuar në Bajram Curri, ku pranë landfillit do të bëhet përpunimi i materialeve të riciklueshme dhe grososja e atyre të pa riciklueshme.

Problemi thelbësor me të cilin bashkia Tropojë përballet së fundmi është menaxhimi i mbetjeve të ndërtimit. Për këtë çështje është urgjente organizimi i strukturave për vënien në zbatim të rregullores nr. 1, datë 30.03.2007, e cila synon të disiplinojë procesin e administrimit të mbetjeve të fushës së ndërtimit, duke vendosur rregulla e kërkesa konkrete për të gjitha subjektet që operojnë në sferën e ndërtimit e të trajtimit të mbetjeve që gjenerohen prej tij. Krahas zbatimit të Nenit 10 për garancinë financiare që parashikon në pikën 1 "Përpara lëshimit të lejes së ndërtimit ose të shembjes për një strukturë që prodhon mbetje ndërtimi, të cilat duhet të depozitohen në një venddepozitim, kërkuesi duhet të depozitojë një shumë në para pranë pushtetit vendor, në sasinë që do të përcaktohet nga këshilli i qeverisjes vendore për çdo ton mbetje të parashikuar nga ndërtimi dhe/ose shembja/prishja, e cila nuk do të jetë më e vogël se 5% e vlerës së strukturës" bashkia Tropojë ka ambicien të arrijë një administrim të efektshëm nga pikëpamja ekologjike të këtyre mbetjeve. Kjo do të arrihet nëpërmjet nxitjes së krijimit të një cikli për ripërdorimin e mbetjeve të ndërtimit. Nëpërmjet këtij cikli do bëhet e

(në faqen  
paraardhëse)  
Harta e  
menaxhimit të  
mbetjeve





mundur, jo vetëm rritja e sasisë së mbetjeve të menaxhuara dhe si rrjedhojë konsum i kufizuar i territorit për qëllime depozitimi të këtyre mbetjeve, por edhe përmirësimi i efektshmërisë ekonomike në saje të rritjes së sasisë dhe cilësisë së materialeve të ricikluara. Kjo sjell dy përfitime, zëvendësimin e nevojës për material primar të virgjër dhe si rrjedhojë zvogëlimin e nevojës për gurore dhe uljen e çmimit të këtyre materialeve duke shtuar konkurrueshmërinë në treg.

- Realizimi i *landfill*-it të bashkisë
- Krijimi i qendrës së kompostimit të mbetjeve organike
- Qendër riciklimi
- Stacion i transferimit të mbetjeve në qendrat rurale







14 ZBATIMI I PPV







100 100  
100 100  
100 100

**14.1 Përkufizimet për termat e referencës për planet, duke detajuar më tej planet sektoriale**

Në territorin e bashkisë së Tropojës nuk ka asnjë dispozitë për zhvillimin e ndonjë plani sektorial.

**14.2 Përkufizimi i njësive, të cilat do jenë subjekt hartimi PDV/PDZRK Statusi dhe përkufizimet kyçe për termat e referencës për planet e detajuara vendore**

Brenda territorit të bashkisë së Tropojës, disa zona dhe njësi strukturore janë subjekt i hartimit të PDV ose PDZRK (në rastin kur vendndodhja e këtyre njësive përkon me zona të shpallura si të rëndësishme kombëtare) për zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Procesi i hartimit të PDZRK koordinohet nga ministri që mbulon çështjen për të cilën hartohet plani dhe, në rastet kur përfshihen disa sektorë koordinimi, realizohet në bashkëpunim dhe bazuar në urdhrin e kryeministrit, në përputhje me dokumentet kombëtare të planifikimit, sipas nenit 18 të Ligjit 107/2014 për planifikimin dhe zhvillimin e territorit; i ndryshuar.

*Termt e referencës për hartimin e Planeve të Detajuara Vendore*

Procesi i hartimit të PDV koordinohet nga kryetari i Bashkisë, i cili është edhe autoriteti përgjegjës për hartimin e planit. Plani i Detajuar Vendor (PDV) me nismë publike hartohet nga grupi i punës mbi bazën e planit të miratuar të veprimeve. Grupi i punës është i përbërë nga specialistë të Bashkisë Tropojë, institucioneve publike në varësi dhe ekspertë të fushave të ndryshme, vendas apo edhe të huaj. Grupi i punës për hartimin e PDV-së, me nismë publike, ngrihet me vendim të kryetarit të njësisë vendore dhe duhet të përmbajë të paktën:

- 2 arkitekt/planifikues;
- 1 ekspert ligjor;
- 1 ekspert mjedisi;
- 1 ekspert vlerësimi pasurish të paluajtshme.

Edhe në rastet kur PDV hartohet me nismë private, procesi i përzgjedhjes së ekspertëve, pjesë e grupit të punës, duhet të bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur dhe transparent, me qëllim përzgjedhjen e konsulencës më të mirë. Në këtë rast grupi i punës duhet të përbëhet nga:

- 2 arkitekt/planifikues;



- 1 ekspert ligjor;
- 1 ekspert mjedisi;
- 1 ekspert vlerësimi pasurish të palujatshme.

Hartimi i planit konsultohet rregullisht me Forumin Këshillimor të PDV, të ngritur pranë njësisë vendore, vullnetarisht apo me kërkesë të posaçme të kryetarit të njësisë. Forumi Këshillimor i PDV përbëhet nga përfaqësues të grupit të interesit nga zona/njësia, përfaqësues të akademisë dhe të shoqërisë civile. Plani i Detajuar Vendor mund të hartohet për të gjithë njësinë/zonën e përcaktuar në Planin e Përgjithshëm Vendor, ose për një grup njësish ose zonash, në rast se ato janë pranë njëra-tjetrës, në mënyrë që të ketë një veprim sa më të harmonizuar e të koordinuar midis tyre. Ndërkohë, PDV për njësitë e përcaktuara me PDV, mund të hartohet edhe në mënyrë të fazuar, pra duke kryer një nën-ndarje të njësisë për qëllime të hartimit të PDV. Në këtë rast, grupi i punës të përcaktuar nga Kryetari i Bashkisë Tropojë, fillimisht në konsultim me Forumin Këshillimor dhe grupet e interesit bën shpërndarjen e Koeficientit të Shfrytëzimit Publik dhe Koeficientit të Shfrytëzimit të Rrugëve në nivel njësie. Shpërndarja e këtyre dy koeficientëve shërben për përcaktimin e njësive më të vogla për hartimin e PDV me faza. Kjo procedurë aplikohet edhe në rastet e hartimit të PDV me nismë private. Pra fillimisht duhet të kryhet shpërndarja e dy koeficientëve dhe më pas të vijohet me nën-ndarjet për qëllime të hartimit të PDV me faza. Nën-ndarjet e reja duhet të jenë midis 1.5-4 hektarë. Më pas vijohet me procedurat përkatëse të specifikuar në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në lidhje me përmbajtjen e PDV dhe hapave të miratimit e konsultimit. Në rastin e PDV me faza secila fazë mund të miratohet më vete.

#### *Përmbajtja e dokumentit të PDV*

Dokumenti i Planit të Detajuar Vendor (PDV) bazohet në dokumentin e planifikimit vendor, dokumentet e planifikimit vendor sektorial dhe në legjislacionin në fuqi. Dokumenti i PDV përmban:

- dokumentin e analizës për zonën/njësinë;
- strategjinë e zhvillimit të zonës/njësisë;
- propozimin me përcaktime territoriale;
- rregulloren e PDV;
- vlerësimin ekonomik dhe financiar për zbatimin e PDV (studimin e fizibilitetit);

hartat që shoqërojnë dhe pasqyrojnë përmbajtjen e secilës prej pikave më sipër,



në shkallën që varion nga 1:500 në 1:2,000, në përputhje me madhësinë e zonës;

- relacionin e propozimeve të planit;
- studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit në mjedis;
- planin e veprimeve dhe investimeve për zbatimin e PDV;
- indikatorët për monitorimin e zbatimit të PDV;
- në rastet e PDV me nismë private, dokumenti i PDV përmban edhe kontratën e bashkëpunimit mes palës private të interesuar për hartimin e PDV dhe autoritetit përgjegjës për hartimin e PDV.

*Dokumenti i analizës përmban:*

- hartat në shkallë 1:500 ose 1:2,000 në varësi të sipërfaqes së zonës/njesisë përkatëse, që prezantojnë rilevimin teknik të topografisë, hapësirave, përdorimeve, parcelave, objekteve dhe infrastrukturave në zonë, emërtimet, dimensionet, si dhe kufirin e saj;
- dokumentim të detajuar fotografik të zonës/njesisë;
- hartën shoqëruar me listën e pronarëve të parcelave dhe objekteve dhe të gjitha të dhënat për çdo pronë sipas regjistrit të pasurive të paluajtshme;
- relacionin me rregullat dhe hartat që tregojnë zonat dhe strukturat e mbrojtura, nëse ka të tilla, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mjedisin dhe për trashëgiminë kulturore;
- analizën e detajuar të problemeve mjedisore, të peizazhit dhe të infrastrukturave, në përputhje me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor apo planeve vendore sektoriale;
- analizën e cilësisë së objekteve ekzistuese dhe të nevojave për rigjenerim, konservim apo mirëmbajtje.

*Propozimi me përcaktime territoriale me komponentët:*

- relacionin dhe hartat për planin e propozuar të përdorimit të tokës pas riorganizimit të parcelave përmes ndarjes dhe/ose bashkimit. Përdorimi i tokës paraqitet për kategoritë bazë, nënkategoritë dhe për funksionet apo aktivitetet sipas shpërndarjes së tyre në parcela dhe në çdo objekt;
- relacionin dhe hartat për planin e propozuar të të gjitha infrastrukturave të nevojshme kryesore dhe dytësore në zonë, përfshirë parkimin;



- paraqitjen grafike të propozimeve për të garantuar akses dhe përdorim të barabartë dhe të pavarur të hapësirave nga të gjithë personat;
- përcaktimin në hartë dhe argumentimin në relacion të objekteve që do të shemben dhe atyre që do të rigjenerohen dhe/ose do të restaurohen;
- paraqitjen volumetrike dhe gjurmën e objekteve/strukturave të parashikuara;
- paraqitjen e detajuar, në relacion dhe në hartë, të shpërndarjes së intensitetit të ndërtimit dhe të koeficientit të shfrytëzimit të tokës për çdo parcelë, si dhe të distancave dhe lartësive të objekteve në përputhje me rregulloren e zhvillimit;
- mënyrën e zbatimit të instrumenteve të drejtimit të zhvillimit në përputhje me ligjin dhe me rregulloret përkatëse.

*Rregullorja e PDV përmban:*

- përkufizimet e termave të përdorur;
- shpjegimin e kodeve të përdorur për:
  - kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës;
  - sistemet/zonat/njësitë;
  - kode të tjera sipas rastit.
- normat, treguesit dhe standardet e zbatueshme të planifikimit, sipas kësaj rregulloreje;
- rregullat e ruajtjes së mjedisit, peizazhit, burimeve natyrore, zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore, që përfshijnë, të paktën:
  - normat dhe standardet për zhvillimet, që kanë ndikim në mjedis, shëndet, peizazh dhe në trashëgimi kulturore, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi;
  - normat, standardet dhe rregullat për zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore, historike dhe mjedisore, nëse ka elemente të tilla në zonë;
  - përcaktimin e vijës mbrojtëse përgjatë elementeve ujore (vija blu), nëse ka elemente të tilla në zonë.
- rregullat për zhvillimin e njësisë/zonës që përmbajnë, të paktën:
  - kushtet e zhvillimit;
  - kategoritë bazë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës;





- aktivitetet dhe funksionet në përputhje me kategoritë e përdorimit të tokës;
- përdorimet që lejohen, ndalohen apo kushtëzohen, përfshirë kushtet përkatëse.
- të drejtat dhe kufizimet ligjore, publike apo private, që rrjedhin nga përdorimi i treguesve të zhvillimit;
- rregullat e nënndarjes dhe të bashkimit të parcelave në çdo njësi:
  - rregullat e sistemit rrugor dhe transportit që përmbajnë, të paktën:
    - përcaktimin dhe përshkrimin e kategorive të rrjetit rrugor në përputhje me legjislacionin e posaçëm;
    - kushte teknike dhe përmasat;
    - parametrat e skemës së lëvizshmërisë dhe të transportit, sipas legjislacionit të posaçëm;
    - përcaktimin e vijës së ndërtimit (vija e kuqe) përgjatë anëve të trupit të rrugës.
  - rregulla arkitektonike, sipas rastit;
  - rregullat për përdorimin e hapësirave nga “Personat me aftësi të kufizuara”.

Në përputhje me pikën 14, të nenit 22 të ligjit, procesi i hartimit të PDV-së shoqërohet nga përgatitja e studimit paraprak të fizibilitetit, ku llogariten përqindjet e përfitimeve nga zhvillimi, në mënyrë të drejtë dhe proporcionale me kostot dhe kontributin në zhvillim. Përfitimet, kontributi dhe kostot janë financiare ose të mira materiale që përfshijnë të drejtat për zhvillim dhe vlerën e rritur të tokës si rezultat i planifikimit ose investimeve publike.

#### 14.3 Partneriteti Publik-Privat (PPP)

Në situatën aktuale, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë më shumë funksione e kompetenca dhe si rezultat edhe më shumë përgjegjësi. Në rastin e bashkisë Tropojë, duke marrë parasysh edhe shtrirjen territoriale, këto përgjegjësi tejkalojnë mundësitë e bashkisë, qoftë në terma ekonomik ashtu edhe në burime njerëzore. Në një kontekst të tillë, modelet e partneritetit publik-privat mund të jenë një mekanizëm për t’i bërë ballë këtyre kufizimeve. Ky mekanizëm do të mbështetet në *Ligj Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”* të ndryshuar me *Ligj nr. 88/2014* dhe *Ligj nr. 77/2015*. Gjatë hartimit të PPV janë identifikuar projekte të mundshme për koncesion/Partneritet



Publik-Privat. Detajet për projektet e sipërpëmendura janë trajtuar në kapitujt specifik (paraardhës), të këtij raporti.

#### 14.4 Projektet pilot

##### O1 - Mbrojtja e mjedisit

O1.1 Projekt-pyllëzimi për mbrojtjen dhe zgjerimin e mjedisit natyror të gështenjës në Bujan

O1.2 Ripërdorimi i minierave të braktisura për ripyllëzim me pemë për industrinë e ngrohjes në Rrogam

##### O2 - Ruajtja e pasurive kulturore

O2.1 Restaurimi i Kullës së Thepit

O2.2 Përmirësimi i rrugës lidhëse midis kullës së Mic Sokolit, banesës së Sali Manit dhe kullës së Binak Alia-s (Pajtimit)

O2.3 Restaurimi i Varrezave të Dëshmorëve

##### O3 - Zhvillimi i Turizmit

O3.1 Krijimi i një faqeje interneti me rrugët kryesore, vendet tërheqëse, veprimtaritë turistike, informacion për florën dhe faunën, gastronominë dhe prodhimet tradicionale, udhërrëfyesit, hotelet dhe bujtinat, kontaktet

O3.2 Pajisja e shtigjeve Valbonë-Theth me shërbimet e nevojshme dhe infrastrukturën e vogla plotësuese (vendsoditje, vende çlodhjeje, etj.)

O3.3 Tjetërsimi i një ish-kazerme ushtarake në Lekbibaj në qendër turistike

O3.4 Tjetërsimi i pjesshëm i staneve ekzistues për mikëpritje turistësh (projekt pilot - të zgjidhet çështja e infrastrukturës bazë, strukturë modulare.)

##### O4 - Përmirësimi i bujqësisë dhe blegtorisë

O4.1 Projekt për rifunksionimin e tarracës në Babinë me pemë frutore

O4.2 Zbatimi i strategjisë për bujqësinë organike (Bio-rajoni)

O4.3 Pika për grumbullim dhe përpunim të produkteve ushqimore (gështenja, bimë mjekësore, thertore, baxho) Vlad, Tropojë, Bajram Curri

O4.4 Qendër në Mbështetje të Bujqësisë, Qendër Shpërndarjeje në Valbonë



04.5 Krijimi i një tregu rajonal në Bajram Curri

04.6 Krijimi i një shkolle bujqësore në Llugaj

05 - Përmirësimi i aksesueshmërisë në territor dhe në lidhjet e brendshme

05.1 Stacion intermodal trageti në Fierzë dhe zgjatimi i linjës Fierzë-Koman deri në qendër të Fierzës

05.2 Mbështetja e shoqatave të transportit kolektiv (për formalizimin e transportit kolektiv, për të dhënë mundësinë e nënkontraktimit të shërbimit dhe për të rregulluar itineraret e transportit, oraret dhe çmimet)

05.3 Ndërtimi i stacionit intermodal në Bajram Curri

06 - Konsolidimi i qendrave urbane dhe rurale

06.1 Zonë e re publike në Bajram Curri, Tropojë, Lekbibaj

06.2 Rehabilitimi i hapësirave publike në lagjen Partizani

06.3 Rikonstruksioni i oborrit të shkollës në Jaho Salih

06.4 Rinovimi i ndërtesës së muzeut të Bajram Currit

06.5 Përmirësimi i varrezave në Margegaj

06.6 Rikualifikimi i ndërtesës ekzistuese me shtimin e një kati për t'u përdorur për strehim social

06.7 Rikualifikimi i "Hotelit të Punëtorëve" dhe i dy ndërtesave në rrugën "Sulejman Vokshi"

06.8 Përmirësimi i varrezave në Margegaj

07 - Përditësimi dhe ngritja e infrastrukturës bazë urbane

07.1 Përmirësimi i rrugëve rurale ekzistuese me ndërhyrje me ndikim të ulët në mjedis (sistemi gjeo-grid)

07.2 Impianti i trajtimit, kompostimit të mbetjeve organike, qendër riciklimi dhe vendgroposjeje në Bajram Curri

07.3 Zinxhir i trajtimit të ligatinave për të kryer trajtimin dytësor të ujërave të zeza në Fierzë

08 - Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkuftar





15 MONITORIMI I PLANIT TË ZHVILLIMIT







## 15.1 Fazat e zhvillimit

PPV është zbatuar në faza të ndryshme, duke mbuluar të gjithë periudhën e vlefshmërisë së planit (2018-2032). Fazat e implementimit janë katër: faza 1, 2018-2020; faza 2, 2021-2022; faza 3, 2023-2027 dhe faza 4, 2028-2032. Të gjitha veprimet dhe projektet e përfshira në PPV dhe që korrespondojnë me objektivat strategjike të planit kanë qenë të shpërndara në bazë të këtyre katër fazave, me projekte pilote dhe ndërhyrje kryesore infrastrukturore të përqendruara në fazën 1 dhe 2 (gjatë pesë viteve të para të vlefshmërisë së planit). Si në shumë raste, puna kryesore infrastrukturore përfaqëson vetëm pikën e fillimit të ndërhyrjeve më të mëdha të nevojshme (si zbatimin e të gjithë rrjetit të ri të kanalizimeve në zonat e mëdha urbane). Këto ndërhyrje specifike, me siguri, kanë për qëllim të vazhdojnë në fazën 3 dhe 4 dhe ndoshta edhe pas 2031. Për treguesit në detaje të fushave prioritare të ndërhyrjes, projektet pilot dhe ndërhyrjet kryesore infrastrukturore të shikohen Plani i Investimeve Kapitale dhe tabelat përkatëse.

## 15.2 Ndryshimet e nevojshme në kuadrin ligjor dhe administrativ lokal

Për zbatimin e PPV, të veprimeve dhe projekteve të tij dhe planit të propozuar të përdorimit të tokës, priten disa ndryshime në nivel ligjor dhe në aspektin e kapaciteteve administrative dhe rolin e administratës lokale. Zbatimi i PPV bazohet në mundësinë që bashkia të fitojë një rol aktiv në menaxhimin e instrumenteve financiare për zhvillimin e tokës, në veçanti për të mbështetur zbatimin e punës infrastrukturore, sidomos në vitet e ardhshme, kur të ardhurat nga taksat mbi ndërtimet e reja, do të zvogëlohen. Shumë nga instrumentet e diskutuara në pjesë të tjera të këtij raporti janë të bazuara në partneritetin publik-privat, me qeveritë lokale dhe bizneset private që ndajnë kostot dhe përfitimet e investimeve publike dhe private. Megjithatë, ato sjellin edhe rrezikun financiar të bashkive dhe kanë për qëllim të plotësojnë, dhe jo të zëvendësojnë, për një buxhet të përshtatshëm të kapitalit, një strategji të shëndoshë për investime kapitale, kontrolle të brendshme financiare të forta, rregulla të fuqishme të rritjes territoriale, dhe një shoqëri civile aktive dhe të përfshirë, të cilat janë të nevojshme për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të minimizuar rrezikun. Dokumenti i fundit “Instrumentet Financiare për Zhvillimin e Tokës” (USAID, 2016) propozon disa rekomandime përkatëse, në lidhje me rolin që pritet të ketë qeverisja vendore, në vitet e ardhshme:

- Qeveria lokale duhet të ketë aftësinë për të rritur dhe për të kontrolluar të ardhurat vetjake dhe t'i lidhë ato me ofrimin e shërbimeve lokale;
- Qeveria lokale duhet të zbatojë metoda standarde dhe të përgjegjshme për vlerësimin e pronave, në mënyrë që të përdorë instrumente të tilla si *Transferimi i të*



### *Drejtave të Zhvillimit;*

- Udhëzime të qarta duhet të përcaktohen për ankandet publike në lidhje me programet e Intensitetit të *Kushtëzuar të Ndërtimit* dhe për programet e *Transferimit të të Drejtave të Zhvillimit*, pasi kjo mund të rrisë në mënyrë të ndjeshme sasinë e të ardhurave të gjeneruara;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë duhet të ndryshohet - duke u imponuar kosto zhvilluesve dhe duke dedikuar një pjesë të të ardhurave tatimore për investime në infrastrukturë, mund të rrisë sasinë e të ardhurave të grumbulluara, të bëjë tatimin më efikas dhe të financojë objekte publike.

Në mënyrë të qartë, këto rekomandime ligjore/administrative janë të lidhura në mënyrë rigoroze me kapacitetin momental në kuadër të pushtetit lokal. Në këtë aspekt, një analizë më e detajuar e kapacitetit të Bashkisë është zhvilluar në një nga kapitujt në vijim.

### **15.3 Treguesit e monitorimit të zbatimit të PPV**

Plani i Përgjithshëm Vendor i bashkisë do të zbatohet përmes veprimeve, projekteve, një përdorimi të detajuar të tokës dhe hartës së zonuar dhe zbatimit të rregulloreve të reja të PPV. Pushteti vendor do të jetë përgjegjës për zbatimin e planit dhe të realizimit të objektivave të tij strategjike. Në të njëjtën kohë, pushteti vendor pritët të kryejë monitorimin periodik dhe sistematik të zbatimit të PPV. Bazuar në dispozitat ligjore, bashkitë kanë detyrimin ligjor për të nxjerrë një raport vjetor lidhur me zhvillimin e territorit të tyre. Ky raport duhet të bazohet në analizën e treguesve të qartë, të aftë për të zbuluar nivelin e zbatimit të planit, devijime të tij dhe probleme në rritje. Grupi i parë i treguesve, që duhet të monitorohen vazhdimisht, janë ato që kanë të bëjnë me transformimin e pesë sistemeve territoriale. Në përgatitjen e PPV, një analizë e detajuar e këtyre pesë sistemeve është bërë në drejtim të vlerave të përdorimit të tokës dhe të parametrave të tjera përkatëse, duke përshkruar saktësisht gjendjen e tanishme të territorit. Meqë PPV përmban drejtimin e transformimeve të këtyre pesë sisteme gjatë periudhës së zbatimit të planit (deri në 2031), raportet e ndërmjetme të monitorimit duhet të konfirmojnë arritjen graduale të vlerave të propozuara. Treguesit e sistemeve territoriale janë ato të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar dhe, përveç atyre, disa tregues të tjerë të rëndësishëm janë propozuar këtu. Treguesit për pesë sistemet territoriale janë:



### *Sistemi urban*

- Sipërfaqja e territorit urban (Stu. të përgjithshme);
- Sipërfaqja e infrastrukturës/banorë;
- Popullsia (ekzistuese dhe e parashikuar / piramida e popullsisë);
- Strehimi privat / social;
- Shërbime administrative;
- Shërbime sociale/banorë, arsim/banorë dhe shëndetësi/banorë;
- Transporti publik dhe privat (nr. makina/familje);
- Ndarja në zona;
- Sipërfaqet e gjelbra/banorë dhe sportive/banorë;
- Hapësira kulturore dhe për rekreacion/banorë;
- Monumentet dhe objektet e trashëgimisë kulturore;
- Detyrimet në lidhje me kërkesat fetare;
- Intensiteti për ha;
- Parkime/banorë;
- Indikatorët ekonomikë (GDP / sektorë / lloji i bizneseve / çmimet / punësimi / punësimi për sektor / taksat vendore / borxhi / shpenzimet sipas sektorit);
- Pronat publike dhe private;
- Tendencat e zhvillimit në territor.

### *Sistemi bujqësor*

- Sip. Territor bujqësor;
- Sip. Primar (Boniteti I-IV);
- Sip. Territor Bujqësor Dytësor (Boniteti V-X);
- Sip. T. Bujqësor me sistem ujitjeje;
- Sip. T. Bujqësor pa sistem ujitjeje;
- Sip. T. Pafryt.



### *Sistemi ujq*

- Ujëra tokësore (km<sup>2</sup>);
- Rrjet ujtitjeje i përmirësuar (km).

### *Sistemi infrastrukturor*

- Sip. rrugë kombëtare;
- Sip. rrugë interurbane;
- Sip. rrugë urbane parësore;
- Hekurudha;
- Porte;
- Aeroporte;
- Gazdote;
- Elektrodate;
- Ujësjiellës-Kanalizime.

### *Sistemi natyror*

- Sip. e përgjithshme (km<sup>2</sup>);
- Sip. pyjore (km<sup>2</sup>);
- Sip. kullota (km<sup>2</sup>);
- Sip. të gjelbra (km<sup>2</sup>);
- Zona të mbrojtura sipas legjislaçionit të posaçëm (km<sup>2</sup>).







TREGUESIT E SISTEMIT	2017	2032	PËRSHKRIMI
<p><b>Sipërfaqe e përgjithshme (km<sup>2</sup>)</b> Sipërfaqja e përgjithshme është sipërfaqja totale e rajonit, përfshirë sipërfaqet ujore të prapatokës. <i>Tregues i bankës botërore</i></p>	1,057.3 km <sup>2</sup>	1,057.3 km <sup>2</sup>	
<p><b>Sipërfaqe toke (km<sup>2</sup>)</b> Sipërfaqe toke është sipërfaqja totale e rajonit, me përjashtim të sipërfaqeve ujore të prapatokës, ujërave territoriale dhe zonave ekonomike ekskluzive. <i>Tregues i bankës botërore</i></p>	1,044.8 km <sup>2</sup>	1,053.6 km <sup>2</sup>	Sipërfaqja totale e tokës nuk përfshin trupat ujore të prapatokës siç janë lumenjtë kryesorë. Ndryshimet nga viti në vit mund të jenë të rezultat i përditësimit apo rishikimit të të dhënave më shumë se sa ndryshimeve.
<p><b>Dendësia e popullsisë (p/km<sup>2</sup>)</b> Dendësia e popullsisë është numri i popullsisë në mes të vitit pjestuar me sipërfaqen e tokës në km<sup>2</sup> <i>Tregues i bankës botërore</i></p>	26.3 p/km <sup>2</sup>	st. 29.7 p/km <sup>2</sup>	
<p><b>Popullsia (2011-31)</b> Popullsia totale bazohet tek përcaktimi <i>de facto</i> i popullsisë, që numëron të tërë banorët pa marrë parasysh gjendjen ligjore ose shtetësinë. <i>Tregues i bankës botërore</i></p>	27,682 p	st. 31,281 p	Numri i popullsisë së pritshme në 2031 bazohet në një skenar ku fenomeni i emigrimit është ndalur dhe tendenca e uljes së rritjes natyrore të popullsisë baraspeshohet nga rritja e tendencës së rikthimit të popullsisë së emigruar.
<p><b>Rritja e popullsisë (%)</b> Rritja vjetore e popullsisë është shkalla eksponenciale e rritjes së popullsisë së mesit të vitit, nga viti t-1 në vitin t, e shprehur në %. <i>Tregues i bankës botërore</i></p>	2007-2017 -10%	st. 13.3%	Shkalla e rritjes së popullsisë totale është llogaritur duke u bazuar në një skenar ku fenomeni i emigrimit është ndalur dhe tendenca e uljes së rritjes natyrore të popullsisë baraspeshohet nga rritja e tendencës së rikthimit të popullsisë së emigruar.



TREGUESIT E SISTEMIT	2017	2032	PËRSHKRIMI
URBAN	0.78% <i>Tot:</i> 8.2 km <sup>2</sup> <i>Industrial:</i> 0.8km <sup>2</sup> <i>Banim:</i> 6.3 km <sup>2</sup>	0.69% <i>Tot:</i> 7.3 km <sup>2</sup> <i>Industrial:</i> 0.8 km <sup>2</sup> <i>Banim:</i> 5.1 km <sup>2</sup>	
<b>Popullsia urbane (%)</b> Popullsia urbane i referohet banorëve të zonave urbane sipas përcaktimeve të zyrave kombëtare të statistikave. <i>Tregues i bankës botërore UNECE</i>	29%	st. 34%	Përkufizimi i rekomanduar bazohet në konceptin e "lokalitetit". Një lokalitet është përcaktuar si një grupim i caktuar i popullsisë, që është zona e përcaktuar nga popullsia që jeton në lagje ose ndërtesa të afërta, ku ndërtesa të afërta janë ndërtesa që: a) formojnë një zonë të ndërtuar të vazhdueshme me formim të qartë të rrjetit rrugor; b) edhe pse jo pjesë e një zone të tillë ato përbëjnë një grup ndërtesash të cilat njihen me një emërtim unik; c) edhe pse nuk përbushin kushtet e mësipërme, përbëjnë një grup ndërtesash me largësi më të vogël se 200m.
<b>Lidhje me shërbimet (% banesa)</b> Përqindje banesash, të cilat brenda njësisë së banueshme kanë të lidhur; a) ujë të pijshëm; b) rrjetin e ujrave të zeza; c) elekticitet; d) telefon. <i>Tregues UNHabitat</i>	22%	st. 57%	<i>Shtim i banesave sociale</i> Zhvillim i politikave të reja për densifikimin dhe konsolidimin e qytetit ekzistues në mënyrë që të gjithë banorët e zonave të shërbehen me infrastrukturën parësore (kanalizime, ujësjellës, etj.).
<b>Banesa në zona të rrezikuara (%)</b> Proporcion i njësive të banimit të ndërtuara në zona të rrezikuara (për 100 njësi banimi). Edhe pse disa banesa mund të jenë ndërtuar me materiale të klasifikuara si rezistues, banorët mund të mos gëzojnë siguri të përshtatshme nëse gjenden në zona të rrezikshme. <i>Tregues UNHabitat</i>	1% nga 8,303 njësi	0% nga 11,251 njësi	<i>Parandalimi i erozionit</i> Fenomeni i erozionit lidhet me modifikimin apo shkatërrimin e habitateve, veçanërisht në pjesën më malore të zonës. Ky përbën një kërcënim jo vetëm për biodiversitetin por edhe për banorët e vendosur pranë këtyre zonave. Cilësitë e ekosistemeve ujore mund të ndryshohen ndjeshëm kur materialet e shkaktuara nga erozioni shpëlahen nga ujërat, dhe habitatet në përgjithësi mund të ndikohen fizikisht nga erozioni që vjen nga zonat e sipërme. Prejta e paligjshme e drurëve dhe degradimi i pyjeve në zonat me shpatë të larta, shoqërohen me rritje të mëtejshme të erozionit që së bashku me erozionin që ndodh natyrshëm, ndikon ndjeshëm tek habitatet.



TREGUESIT E SISTEMIT	2017	2032	PËRSHKRIMI
NATYRË	88.8% <i>Tot:</i> 939.5 km <sup>2</sup>	88.4% <i>Tot:</i> 935.6km <sup>2</sup>	st. km <sup>2</sup> që transformohen në infrastrukturë kompensohen nga rimëkëmbja e zonave të braktisura
	Sigurimi i vazhdimësisë së procesit të evolucionit natyror përtej kufijve shtetërorë (p.sh. korridoret e migrimit të kafshëve të egër)/ Ensuring the continuation of natural evolutionary processes across the state borders (e.g. wildlife migration corridors)	Natyror/ Nature	Vendosja dhe mirëmbajtja e lidhjeve ndërkufitare dhe korridoreve ekologjike të cilët lidhin rrjetet e zonave të mbrojtura të vendeve fqinje/ Establishment and maintenance of transboundary linkages and ecological corridors which link protected area networks of neighbouring countries	GIS mapping / publication data



O8 - Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar/ Improve crossborder cooperation

Strategjia/ Strategy	Veprimet/ Actions	Sistemi/ System	Politika, Programme, Projekte/ Policies, Programmes, Projects	Tregues Monitorimi/ Monitoring Indicators
O8S1 Mbrojtja e biodiversitetit/ Protection of biodiversity	Zvogëlimi i kërcënimeve aktuale/ Mitigate the present threats	Natyrori/ Nature	Përgatitja e një liste paraprake të llojeve bimore target me potencial për t'u ruajtur / Preparation of a tentative list of the potential target plant species for conservation	GIS mapping / publication data
			Ruajtja e habitateve pyjore - mbetjet e fundit të pyjeve të lashta me pisha endemike dhe relike Ballkanase/Maqedonase (Pinus peuce) dhe me pisha Boshnjake (Pinus heldreichii ssp. leucodermis), si edhe pyjet me panjë Heldreich (Acer heldreichii, specie endemike relike tretësore)/ Conservation of forest habitats – the last remains of primeval forests of the endemic and relic Balkan/Macedonian pine (Pinus peuce) and the sub-endemic Bosnian pine (Pinus heldreichii ssp. leucodermis) as well as treestands harbouring the Heldreich's maple	GIS mapping / publication data
			Përgatitja e një liste paraprake të llojeve shtazore target me potencial për t'u ruajtur: macja e egër Evropiane (Felis silvestris), vjedulla (Meles meles), kunadhe pishe (Martes martes), kaprolli (Capreolus capreolus), ujku (Canis lupus), rrëqebulli (Lynx lynx)/ Preparation of a tentative list of the potential target fauna species for conservation: the European wild cat (Felis silvestris), badger (Meles meles), pine marten (Martes martes), roe deer (Capreolus capreolus), wolf (Canis lupus), lynx (Lynx lynx)	GIS mapping / publication data
	Rritja e ndërgjegjësimit publik për çështje mjedisore/ Raising environmental public awareness	Natyrori/ Nature	Organizimi i programeve verore/ Organization of summer programs	activity completed
			Programe të ndërgjegjësimit mjedisor/ Environmental awareness programs	activity completed
			Shkëmbimet e të rinjve/ Youth exchanges	activity completed





O8 - Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar/ Improve crossborder cooperation

Strategjia/ Strategy	Veprime/ Actions	Sistem/ System	Politika, Programe, Projekte/ Policies, Programmes, Projects	Tregues Monitorimi/ Monitoring Indicators
O8S2 Mbështetja e zhvillimit socioekonomik/ Sustain the socioeconomic development	Nismat e bashkëpunimit në nivel institucional/ Cooperation initiatives at institutional level	Natyror/ Nature	Vendosja e bashkëpunimit me administratat e zonave të mbrojtura ndërkufitare në Kosovë dhe Mal të Zi/ Establish cooperation with transboundary of Protected Areas (PA) administration in Kosovo and Montenegro	MoU and activities completed
			Pergatitja e Memorandumit të Mirëkuptimit për mbrojtjen e ZM dhe kafshëve të egra/ Prepare Memorandum of Understanding for PA and wildlife protection	MoU and activities completed
			Shkëmbimi i vizitave periodike në zonat e mbrojtura ndërkufitare në Kosovë dhe Mal të Zi/ Exchange periodical visits in transboundary protected areas in Kosovo and Montenegro	activities completed
	Vlerësimi dhe shtimi i kapaciteteve të partnerëve të ndryshëm vendas për bashkëpunim ndërkufitar/ Assess and enhance the capacities of different local partners for transboundary cooperation	Natyror/ Nature	Grumbullimi i burimeve të disponueshme aktualisht dhe përmirësimi i aftësiwe profesionale dhe kspertizës së zotëruar nga anëtarët e stafëve të institucioneve dhe autoriteteve të ndryshme/ Cumulate currently available resources and upgrade the professional skills and expertise possessed by the staff members of different institutions and authorities	activities completed
			Mundësimi i rezervave të nevojshme për zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar, në terma të mjediseve (zyra, biblioteka, salla konferencash dhe mbledhjesh), të personelit (stafi profesional dhe administrativ), të pajisjeve (p.sh. kompjutera, kamera, automjete)/ Provision of necessary resources necessary for developing transboundary cooperation, in terms of premises (offices, libraries, conference and meeting rooms), personnel (professional and administrative staff), equipment (e.g. computers, cameras, vehicles)	activities completed
	Përmirësimi i infrastrukturës rrugore/ Improvement of road infrastructure		Infrastrukturori/ Infrastructure	Krijimi i lidhjeve rrugore nëpër male përtej kufijve shtetërorë/ Establish road connections through the mountains across the state borders



O8 - Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar/ Improve crossborder cooperation

Strategjia/ Strategy	Veprime/ Actions	Sistemi/ System	Politika, Programe, Projekte/ Policies, Programcs, Projects	Tregues Monitorimi/ Monitoring Indicators	
OBS2 Mbeshtetja e zhvillimit socioekonomik/Sustain the socioeconomic development	Zhvillimi i një modeli zonimi të harmonizuar dhe të përputhshëm në konsultim me të gjitha vendet e përfshira/ Development of a harmonized and compatible zonation pattern in consultations between all involved countries		Zhvillimi i një harte të detajuar të pasurive/kadastrale/ Development of a detailed landownership / cadastral map	GIS mapping / publication data	
		Urban/ Urban	Hartëzimi i rrethit ekzistues të vendbanimeve dhe zhvillimi i prioriteteve ok bashkitë e të dyja anëve të kufijve shtetërorë/ Mapping of the existing settlement network and development priorities of the municipalities on both sides of the state borders	GIS mapping / publication data	
		Natyror/ Nature	Hartëzimi i shtigjeve të korridoreve ekologjik lidhës ndërkufitar prioritar (p.sh. Korridoret e migrimit të kafshëve të egër) në zonat kufitare (shiko edhe OBS1 mësipër)/ Mapping of the routes of the priority ecological transboundary connecting corridors (e.g. wildlife migration corridors) in the border areas (see also OBS1 above)	GIS mapping / publication data	
	Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në rajon/Development of sustainable tourism in the region			Programe për bashkëpunime të ngushta të ofertuesve të shërbimeve turistike/ Programs for close cooperation of the tourist services providers	trainings / publication data
			Natyror/ Nature	Vendosja e emërimit 'zonë e mbrojtur ndërkufitare me vlera të jashtëzakonshme natyrore'/ Establishment of the label of a 'transboundary protected area of exceptional natural values'	GIS mapping / publication data
			Infrastrukturor/ Infrastructure	Qartësimi i regjimeve kufitare dhe statusit të kalimit të kufirit në male, me objektivin për të lehtësuar krijimin e shtigjeve ndërkufitare turistike për hiking / Clarification of the border regimes and status of border crossings in the mountains, with the objective to facilitate establishment of cross-border tourist hiking trails	GIS mapping / publication data
				Promovimi dhe marketimi i prodhimeve vendase bujqësore (p.sh. ushqimet organike) dhe artizanale/ Promotion and marketing of the local agricultural (e.g. organic food) and handicraft products	activity completed
			Infrastrukturor/ Infrastructure	Mbajtja e programeve për shtigjet ndërkufitare për hiking / Maintaining programs for the cross border hiking paths	activity completed
			Zhvillimi i aplikimeve të përbashkëta për fonde në IPA/ Developing common funding applications to IPA		Natyror/ Nature
	Natyror/ Nature	Zhvillimi i planeve të menaxhimit për zonat e reja të mbrojtura/ Development of the management plans for the new protected areas			activities completed
		Masa për ruajtjen e biodiversitetit/ Biodiversity conservation measures			activity completed
	Urban/ Urban	Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimi i qëndrueshëm/ Cultural heritage protection and sustainable development			activity completed



#### 15.4 Faktorët që mund të shkaktojnë rishikimin pjesor të PPV

##### *Ndryshime të pjesshme, si rezultat i monitorimit periodik të zbatimit*

Plani mund t'i nënshtrohet rishikimit dhe ndryshimeve si rezultat i veprimtarisë së monitorimit të zbatimit të përshkruar më lart. Kur rezultatet e këtij aktiviteti të tregojnë se zbatimi i PPV nuk i është referuar treguesve të pritur të monitorimit, të përfshirë në raportet e planit, plani mund të ketë nevojë për rishikim të pjesshëm në një ose më shumë prej përbërësve të tij thelbësorë (planin e veprimeve, atë të përdorimit të tokës dhe rregulloret), në mënyrë që t'u përmbahen më mirë qëllimeve dhe direktivave të pritshme të PPV. Ndryshime të pjesshme të planit mund të miratohen vetëm nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

##### *Ndryshime të pjesshme, si rezultat i ndryshimeve të shpejta në kushtet ekonomike, sociale, demografike dhe mjedisore*

Në rastet e ndryshimeve të shpejta të kushteve ekonomike, sociale apo demografike, Bashkia mund të kërkojë një rishikim të pjesshëm të PPV, në mënyrë që t'u përgjigjet dhe të përballet me këto ndryshime/sfida. Ndryshimet e pjesshme të PPV mund të jenë të lidhura me një krizë ekonomike, ose të lindjes së një mundësie të papritur ekonomike, me zhvillimin e një situatë të re demografike, ose me shfaqjen e kërcënimeve mjedisore që prekin disa komunitete lokale. Ndryshimet mund të jenë rezultat i krizave të ndryshme ose të fatkeqësive në të gjithë sektorët e lartpërmendur. Ndryshime të pjesshme të planit mund të miratohen vetëm nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

##### *Ndryshime të pjesshme, si rezultat i vendimit të qeverisë qendrore*

Plani i përgjithshëm vendor mund të jetë subjekt i një rishikimi të pjesshëm, si rezultat i ndryshimeve në politika, strategji dhe plane, në nivel qendror. Edhe pse Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Shqipërisë dhe Plani Kombëtar Sektorial i Alpeve kanë qenë zhvilluar kohët e fundit, projekte të mëdha nga qeveria qendrore ende mund të kërkojnë rishikimin e pjesshëm të PPV, në mënyrë që të përshtaten me kushtet e reja. Ndryshime të pjesshme të planit mund të miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

##### *Ndryshimet e pjesshme si rezultat i planeve sektoriale lokale*

Ndryshimet e pjesshme të PPV mund të rrjedhin nga rezultatet e zhvillimit të planeve sektoriale për territorin bashkiak/rajonat. Planet specifike/sektoriale mund të tregojnë nevojën për të vazhduar me një rishikim të pjesshëm të PPV, në lidhje me aspekte të veçanta, në qendër të planit të zhvilluar sektorial.

Në këtë kontekst, planet sektoriale mund të hartohen në zbatim të planeve kombëtare sektoriale ose mund të vijnë si rezultat i nevojave apo ndryshimeve të situatës vendore. Bazuar në VKM Nr. 686, date 22.11.2017. Më pas, ndryshimet si rrjedhojë e tyre në



PPV miratohen sërish në Këshillin Kombëtar të Territorit. Të gjitha ndryshimet reflektohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

Faktorë të tjerë mund të çojnë në rishikimin e pjesshëm të Planit të Përgjithshëm Vendor. Të gjitha ndryshimet në PPV e miratuar duhet të miratohen përsëri nga Këshilli Bashkiak.









16 PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE





## 16.1 Plani i Investimeve Kapitale

Plani i Investimeve Kapitale (PIK) është një pjesë përbërëse e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV). PIK përshkruan buxhetin vjetor bashkiak, burimet e financimit të buxhetit bashkiak, planifikimin e ardhshëm të projekteve të mundshme dhe kapacitetin njerëzor dhe financiar të nevojshëm për zbatimin e këtyre projekteve.

PIK është i nevojshëm për bashkitë në mënyrë që ato të jenë në gjendje të bëjnë një planifikim të detajuar dhe buxhet për vitet që do të vijnë dhe për zbatimin e PPV-së. Është e nevojshme të planifikohet dhe të punësohet staf i nevojshëm që do të punoj me këtë plan, njerëz të aftë që mund të monitorojnë dhe zbatojnë projektet e përshkruar në PPV, me të rinj ose të marrë nga stafi ekzistues brenda bashkisë. PIK duhet të rregullohet çdo vit, pasi prioritetet mund të ndryshojnë, stafi mund të luhatet, mund të ketë një atmosferë politike të ndryshuar për shkak të zgjedhjeve, ndryshime në ligj dhe politika dhe parametra financiare, si normat e interesit dhe inflacioni, mund të ndryshojnë. Në këtë plan kostot nuk marrin parasysh huadhënien e kapitalit, inflacionin, etj.

Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) 2018-2032 për Tropojën ka identifikuar strategji zhvillimi, veprime dhe projekte pilot. Strategjitë ndiqen nga projekte, të cilët duhet të zbatohen gjatë viteve 2018-2032. Për periudhën e shkurtër, projektet pilot janë shënuar dhe janë zhvilluar për t'u zbatuar midis 2018-2022. Përveç projekteve pilot, të cilët janë vendosur si një investim minimal, është e nevojshme që bashkia të ofrojë modalitete bazike për banorët e saj.

## 16.2 Buxheti i bashkisë

### 16.2.1 Fillimi i procesit bazuar në politikat strategjike

Mbas reformës territoriale, Bashkia operon në një territor më të gjerë, pra vendosja e një ekuilibri eficient dhe të qëndrueshëm mes tyre kërkoi një vizion të qartë, të bazuar në njohje kapilare të territorit dhe me mbështetje dhe kontribut aktiv dhe të vazhdueshëm nga institucionet vendore, qytetarët, bizneset, pronarët, shoqëria civile, planifikuesit, etj. Është pikërisht Strategjia e ardhshme e zhvillimit të territorit të Bashkisë Tropojë, e cila tashmë është në përfundim, që shihet si lexim dhe mirëkuptim i kësaj shumëllojshmërie. Ky dokument i integruar dhe me programin elektorale të kryetarit dhe dokumentat e tjera strategjike, i shërbeu dhe procesit të planifikimit të integruar të PBA 2017-2019 dhe buxhetit të vitit 2017. Pra, Bashkia Tropojë, në procesin e planifikimit dhe përfitimeve të komunitetit, nuk shikohet si një bashkësi prej shtatë njësisish administrative, por si një organizëm i vetëm, ku çdo zonë ose grup popullate ka të njëjtat raporte me territorin dhe



me administratën vendore.

Sipas nenit 34 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 3 dhe 4, njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj. Njësitë vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.

Për vitin 2017, të ardhurat e përgjithshme të Bashkisë Tropojë nga të gjitha burimet e financimit parashikohen të jenë 683,141 mijë lekë, ose 20% më shumë se në vitin 2016. Këto të ardhura, sipas ligjit të mësipërm, vijnë nga dy burime të ardhurash, si më poshtë: *Nga burimet e veta vendore*, ku përfshihen të ardhurat tatimore (nga taksat vendore), jo tatimore (nga tarifat për shërbimet publike që ofrojnë dhe të ardhurat e tjera vendore); *Nga burimet qendrore*, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike. Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës së kushtëzuar. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Specifika e këtyre të ardhurave, sipas nenit 40/1 të ligjit është që nëse nuk shpenzohen brenda vitit fiskal, trashëgohen në vitin tjetër fiskal. Pra, pjesë përbërëse e këtyre të ardhurave janë dhe ato që trashëgohen nga viti i mëparshëm.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Tropojë, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Ndërsa niveli i transfertës së pakushtëzuar përcaktohet me ligj të veçantë nga Qeverisja Qendrore.

Gjithashtu planifikimi i të ardhurave të veta u realizua si proces në bashkëpunim me administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative, me Institucionet e Agjentët tatimorë, etj. Ky proces bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave të mundshme për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm në të gjithë territorin e bashkisë.



#### 16.2.2 Të ardhurat nga burimet e veta vendore

Këto të ardhura vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, nga tarifat për shërbimet publike dhe të ardhurat e tjera vendore, planifikimi i të cilave është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Tropojë, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Sipas nenit 35 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, bashkitë e ushtrojnë të



drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit të tyre brenda kufijve të kriterëve të përcaktuara me ligj si dhe krijojnë të ardhura nga tarifatat për shërbimet publike dhe veprimtaritë e tjera. Llogaritja e të ardhurave të kësaj kategorie mbështetet edhe në:

1. Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;
2. Ligjin nr. 9920 datë 26.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Vendimin e Këshillit të Bashkisë Tropojë Nr.84 datë 24.10.2016 "Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Tropojë".

Tabela e mëposhtme pasqyron të ardhurat e planifikuara nga burimet e veta sipas katër kategorive (nga taksat, nga tarifatat, nga gjocat dhe të ardhura të tjera jotatimore). Ato janë parashikuar me një trend rritjeje 4-5% çdo vit për periudhën 2018-2020.

Për vitin 2018, pjesë e rëndësishme e të ardhurave nga burimet e veta janë të ardhurat jotatimore nga tarifatat, të cilat zënë 51% të shumës së të ardhurave nga burimet e veta dhe 4% të totalit të të ardhurave të Bashkisë nga të gjitha burimet.

Nr.	LLOJET E TË ARDHURAVE	Plani 2018	Plani 2019	Plani 2020
A	Shuma të ardhura nga burimet e veta	57,327	60,184	63,384
I	Të ardhura nga taksat vendore/tatimore	25,173	26,429	28,429
	Në % ndaj totalit	4%	4%	4%
	Në % ndaj burimeve të veta	44%	44%	44%
II	Të ardhura nga tarfia vendore/jo tatimore	29,519	30,990	32,100
	Në % ndaj totalit	5%	5%	5%
	Në % ndaj burimeve të veta	51%	51%	51%
III	Të ardhura jotatimore të tjera/gjoca, etj.	2,635	2,765	2,915
	Në % ndaj totalit	0.4%	0.5%	0.5%
	Në % ndaj burimeve të veta	5%	5%	5%

Pesha kryesore në realizimin e të ardhurave për vitin 2018 i ngarkohet Njësisë Administrative Bajram Curri në vlerën 31,826 mijë Lekë, ose 58% të planit total të të ardhurave.

TË ARDHURA	Plani 2017	NJËSITË ADMINISTRATIVE							
		B Curri	Fierzë	Lekbibaj	Margegaj	Llugaj	Bujan	Bytyç	Tropojë
Nga burimet e veta (000/leke)	5,000	31,826	2,256	2,366	6,164	2,171	2,269	3,668	4,280

Tabela 1. Ngarkesa fiskale sipas njësive administrative



### 16.2.3 Kapacitetet fiskale të taksapaguesve

Paguesit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat për taksapaguesit e një viti më parë, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të vitit 2017 të miratuar nga këshilli i bashkisë. Në total numri taksapaguesve është parashikuar rreth 35,966 (familje, biznese dhe institucione). Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse e kapacitetit të taksapaguesve sipas kategorive dhe njësive administrative.

	Taksapagues	Familje	Banorë	Totali	Biznes i Madh	Biznes i Vogël	Institucione
1	Nj.A. B.Curri	2,588	8,230	322	26	296	26
2	Nj.A. Tropojë	1,746	5,464	17	2	15	
3	Nj.A. Bujan	941	2,881	5		5	
4	Nj.A. Llugaj	703	2,143	10	1	9	
5	Nj.A. Fierzë	766	2,465	14	1	13	
6	Nj.A. Margegaj	986	3,047	23	1	22	
7	Nj.A. Bytyç	682	2,103	25	20	5	
8	Nj.A. Lekbibaj	662	1,912	1		1	
	<b>Bashkia Tropojë</b>	<b>9,074</b>	<b>28,245</b>	<b>417</b>	<b>51</b>	<b>366</b>	<b>26</b>

Tabela 2. Kapaciteti i taksapaguesve sipas njësive administrative

### 16.2.4 Taksapaguesit familjarë

Në total, numri i familjeve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Tropojë është 9,074. Numri i familjeve në njësinë administrative Bajram Curri zë peshën kryesore me 2,588 familje ose 29% të numrin të përgjithshëm të familjeve në Bashkinë Tropojë, por familjet e Nj.A. së bashku përbëjnë 71% të totalit të familjeve.

Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke ju përafëruar kapaciteteve reale të familjeve rezidente. Në planin e të ardhurave janë parashikuar lehtësi fiskale për familjet me probleme sociale, si për familjet që janë përfitues të ndihmës ekonomike, për pensionistët, për invalidët, etj., të cilët përbëjnë rreth 2,375 familje ose 26% të familjeve taksapaguese.



	Taksapaguesit	Totali i Familjeve	Familje me taksa/tarifa të plota	Familje që do të paguajnë 50% të taksës/tarifës
1	Nj.A. Bajram Curri	2,588	2,163	425
2	Nj.A. Tropojë	1,746	1,263	483
3	Nj.A. Bujan	941	708	233
4	Nj.A. Llugaj	703	481	222
5	Nj.A. Fierzë	766	582	184
6	Nj.A. Margegaj	986	688	298
7	Nj.A. Bytyç	682	424	258
8	Nj.A. Lekbibaj	662	390	272
	<b>Bashkia Tropojë</b>	<b>9,074</b>	<b>6,699</b>	<b>2375</b>

Tabela 3. Kapaciteti i familjeve taksapaguese

#### 16.2.5 Taksapaguesit biznese dhe institucione

Bazuar në regjistrat aktual, në total, numri i bizneseve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Tropojë është 417. Biznesi i vogël zë 88% të numrit total të bizneseve.

Numri i institucioneve që përfshihen në detyrimet fiskale janë rreth 26, ndër të cilat rreth 100% e tyre ndodhen në Njësinë Administrative Bajram Curri. Bizneset dhe institucionet janë të përqendruara në Nj.A. Bajram Curri (77%). Bizneset e vogla janë rreth 366 dhe kanë peshë të rëndësishme taksapaguese, ato zënë rreth 88% të numrit të bizneseve dhe institucioneve.

#### 16.2.6 Të ardhurat nga taksat vendore

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit të tyre. Këto të ardhura janë planifikuar me një rritje 3-4% çdo vit. Përbëjnë 4% të totalit të të ardhurave ose 44% të shumës së të ardhurave nga burimet e veta.

Nr.	LLOJET E TË ARDHURAVE	Plani 2018	Plani 2019	Plani 2020
I	<b>TË ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE</b>	<b>25,173</b>	<b>26,429</b>	<b>28,127</b>
	Në % ndaj totalit	4%	4%	4%
	Në % ndaj burimeve të veta	44%	44%	44%

Tabela 4. Struktura e të ardhurave nga taksat vendore



#### 16.2.7 Të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël

Sipas ligjit 142/2015 dt. 17.12.2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9632, datë 30/08/2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni 11 ndryshon dhe:

- shkalla tatimore për subjektet me xhiro nga 0 deri në 5 milion është 0 Lekë;
- ndërsa shkalla tatimore për subjektet me xhiro nga 5 milion deri në 8 milion është 5% e fitimit.

Tatimi i thjeshtuar për biznesin e vogël administrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila në rolin e agjentit tatimor mban një komision prej 1% të vlerës së grumbulluar, ndërsa 99% kalon në favor të bashkisë Tropojë. Parashikimi i të ardhurave për vitet 2018-2020 është bërë në një rritje prej 5% nga viti në vit.

Të ardhura	Parashikimi 2018 (000 lekë)	Parashikimi 2019 (000 lekë)	Parashikimi 2020 (000 lekë)
Nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për BV	1,190	1,249	1,311

Tabela 5. Të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël për vitet 2018-2020 në (000 lekë)

#### 16.2.8 Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Në taksën mbi pasurinë e paluajtshme përfshihet: a) taksa mbi ndërtesën; b) taksa mbi tokën bujqësore dhe c) taksa mbi truallin.

##### *Të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat*

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive.

*Baza e taksës* është sipërfaqja e ndërtimit në m<sup>2</sup> e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Gjatë vitit parashikohet zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- saktësisimit dhe vlerësisimit të drejtë të sipërfaqeve nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim;
- ndarjes në këste të pagesave;
- krijimit të arkave funksionale të agjentit tatimor më pranë zonave të banuara në njësitë administrative.

Në mungesë të të dhënave, deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vet-deklarimit të sipërfaqes së ndërtesës, detyrimi vjetor i taksës së ndërtesës:



Për familjet, llogaritet për një sipërfaqe mesatare prej 70 m<sup>2</sup> për qytetin dhe 100 m<sup>2</sup> për njësitë administrative dhe nuk është bërë diferencimi i banesave para dhe pas vitit 1993. Për banesat e tjera të dyta dhe ato të pashitura nuk janë llogaritur të ardhura. Politika e Bashkisë është ulja me 30% e nivelit ligjor për ndërtesat e banimit.

Viti 2018		Nj.A. Tropolje			Nj.A. të tjera			Total të ardhura 000/lekë	Totali i Sipërfaqes (m <sup>2</sup> )
Kategoritë e Ndërtesave të Banimit	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Niveli i taksës l/m <sup>2</sup>	Të ardhura 000/lekë	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Niveli i taksës l/m <sup>2</sup>	Të ardhura 000/lekë			
a) Ndërtuar para 1993	181,160	6	634	648,600	3	1,622	2,256	829,760	
<b>Totali</b>	<b>181,169</b>		<b>634</b>	<b>763,420</b>		<b>1,622</b>	<b>2,256</b>	<b>829,760</b>	
NË % ndaj totalit nga BV							4%		

Tabela 6.

Për ndërtesat e tjera për biznesin, detyrimin për taksën mbi ndërtesën e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme. Politikë e Bashkisë është ulja me 30% e nivelit ligjor për ndërtesat e biznesit.

Viti 2018		Nj.A. Tropolje			Nj.A. të tjera			Total të ardhura 000/lekë	Totali i Sipërfaqes (m <sup>2</sup> )
Kategoritë e Ndërtesave të biznesit	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Niveli i taksës l/m <sup>2</sup>	Të ardhura 000/lekë	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Niveli i taksës l/m <sup>2</sup>	Të ardhura 000/lekë			
a) Për tregti dhe shërbime	13,261	200	1,857	9,230	100	645	2,502	22,491	
b) Të tjera	3,480	40	4,87		20	0	487	3,480	
<b>Totali</b>	<b>16,741</b>		<b>112</b>	<b>9,230</b>		<b>645</b>	<b>2,989</b>	<b>25,971</b>	
NË % ndaj totalit nga BV							5.4%		

Tabela 7. Të ardhurat nga taksa vendore mbi ndërtesat e biznesit, viti 2018, në (000 lekë)

Tabela e mëposhtme është një përmbledhje e të ardhurave nga taksa mbi ndërtesat sipas taksapaguesve për vitet 2018-2020.





Kategorizimi	Parashikimi 2018 (000 lekë)	Parashikimi 2019 (000 lekë)	Parashikimi 2020 (000 lekë)
Biznesi i madh	359	376	394
Biznesi i vogël	2,630	2,762	2,900
Familjarët	2,256	2,369	2,488
<b>TOTALI</b>	<b>5,245</b>	<b>5,507</b>	<b>5,782</b>

Tabela 8. Të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat sipas taksapaguesve për vitet 2018-2020 në (000 lekë)

#### Të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore

Baza e taksës është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Politika e Bashkisë, për taksën e çdo kategorie të tokës bujqësore, ka një ulje të nivelit që shkon në 10%. Për vitin 2018 do të taksohet një sipërfaqe prej 7,386m<sup>2</sup> dhe do të sigurohen 5,318 mijë lekë.

Viti 2018	Për të gjitha Nj.A.		
Kategoritë e tokës bujqësore	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Niveli i taksës lekë/m <sup>2</sup>	Të ardhura 000/lekë
V	1,200	810	975
VI	2,400	720	1,708
VII – X	3,786	630	2,635
<b>Totali</b>	<b>7,386</b>		<b>5,318</b>
<b>Në % ndaj totalit nga BV</b>			<b>10%</b>

Tabela 9. Të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore për vitet 2018 – 2020 në (000 lekë)

#### Të ardhurat nga taksa mbi truallin

Truall është një sipërfaqe toke, jo bujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

Në këtë kategori do bëjë pjesë e gjithë sipërfaqja jashtë ndërtesës në funksion të saj; në ato raste kur ajo është në shërbim të prodhimit, tregtimit, magazinimit, riciklimit dhe kur shfrytëzohet për parkim, rrugë, ambiente rekreative nga subjektet e biznesit të madh.

Baza e taksës është sipërfaqja e truallit, në m<sup>2</sup>, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Niveli i taksës është ai sipas ligjit, për individët 0.14 lekë/m<sup>2</sup> dhe biznesin 12 lekë/m<sup>2</sup>.

Kategorizimi	Baza m <sup>2</sup>	Niveli lekë m <sup>2</sup>	Parashikimi 2018 (000 lekë)	Parashikimi 2019 (000 lekë)	Parashikimi 2020 (000 lekë)
Familjarët	829,761	0.14	116	122	128
Biznesi	25,971	12	312	327	343
<b>TOTALI</b>	<b>855,732</b>		<b>428</b>	<b>449</b>	<b>471</b>

Tabela 10. Të ardhurat nga taksa e truallit sipas taksapaguesve për vitet 2018-2020 në (000 lekë)



Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e këtyre taksave për vitin 2016, parashikimi për vitet 2018-2020 është bërë me një rritje prej 5% në çdo vit si mëposhtë:

*Të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel*

Taksa e fjetjes në hotel administrohet nga Bashkia Tropojë. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person, dhe përcaktohet me ligj. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes, dhe mbi të vlera e taksës.

Kategorizimi	Njësia	Niveli lekë m <sup>2</sup>	Parashikimi 2018 (000 lekë)	Parashikimi 2019 (000 lekë)	Parashikimi 2020 (000 lekë)
Hotel me 3 yje	Lekë/natë fjetje	105	2,492	2,616	2,720
Bujtinë, fjetinë, motel	Lekë/natë fjetje	35	126	132	138
<b>TOTALI</b>			<b>2,618</b>	<b>2,748</b>	<b>2,858</b>

Tabela 11. Të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel sipas kategorive për vitet 2018-2020 në (000 lekë)

*Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja*

Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut sipas përcaktimeve të udhëzimit të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

Bazuar në ligjin nr. 9632 dt. 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 107/2015 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 39 dhe neni 46 niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja jopublike është parashikuar si më poshtë:

LEJE NDËRTIMI		
1	Për leje ndërtimi për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit	5% e çmimit të shitjes
2	Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 1	1-3% e vlerës së investimit
3	Leje ndërtimi për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte	0,1% e vlerës së investimit
4	Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi	0,5% e vlerës së investimit

Tabela 12. Specifikime për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e kësaj takse për vitin 2017, parashikimi për vitet 2018-2020 është bërë me një rritje prej 5% në çdo vit si më poshtë:



Emërtimi	Parashikimi 2018 (000 lekë)	Parashikimi 2019 (000 lekë)	Parashikimi 2020 (000 lekë)
Taksa e ndikimit në infrastrukturë	4,179	4,388	4,600

Tabela 13. Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitet 2018-2020 në (000 lekë)

Struktura e ngarkuar për planifikimin dhe vjeljen e kësaj takse është Sektori i Urbanistikës pranë Bashkisë Tropojë.

*Të ardhurat nga taksa mbi kalimin e pronësisë për pasurinë e paluajtshme*

Taksa me nivelet sipas Ligjit Nr. 9632 paguhet para kryerjes së regjistrimit nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit tatimor përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Tropojë, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Taksa mbi kalimin e të drejtës mbi pronësinë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme si më poshtë:

- Ndërtesa banimi – 100 lekë/m<sup>2</sup>
- Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime – 300lekë/m<sup>2</sup>
- Ndërtesa të tjera – 200lekë/m<sup>2</sup>

Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e kësaj takse për vitin 2016, parashikimi për vitet 2017-2019 është bërë në një rritje prej 5% në çdo vit si më poshtë:

Emërtimi	Parashikimi 2018 (000 lekë)	Parashikimi 2019 (000 lekë)	Parashikimi 2019 (000 lekë)
Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë	105	110	115

Tabela 14. Të ardhurat nga taksa mbi kalimin e pronësisë për pasurinë e paluajtshme për vitet 2018-2020 në (000 lekë)

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tropojë.

*Të ardhura nga taksa e mjeteve të përdorura*

Bazuar ne ligjin 9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, ku pas arkëtimit nga institucione shtetërore në rolin e agjentëve tatimorë, një pjesë e këtyre të ardhurave transferohen në buxhetin e njësisive të qeverisjes vendore sipas përkatësisë nga burojnë. Referuar pikës 3, të Nenit 4 të Ligjit 9975, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimor, arkëton detyrimin nga pronari i mjetit për vlerën e taksës



për automjetin, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Baza e taksës është lloji i mjetit të transportit rrugor. Niveli i taksës shprehet në një kuotë të caktuar, sipas llojit të mjetit të transportit rrugor.

Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e kësaj takse për vitin 2017, parashikimi për vitet 2018-2020 është bërë me një rritje prej 5% në çdo vit si më poshtë:

Emërtimi	Parashikimi 2018 (000 lekë)	Parashikimi 2019 (000 lekë)	Parashikimi 2020 (000 lekë)
Taksa e mjeteve të përdorura	3,383	3,552	3,770

Tabela 15. Të ardhura nga taksa e mjeteve të përdorura për vitet 2018-2020 në (000 lekë)

#### Të ardhura nga taksa e rentës minerare

Baza e taksës: Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, (5%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Tropojë në llogarinë e degës së thesarit.

Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e kësaj takse për vitin 2017, parashikimi për vitet 2018-2020 është bërë në një rritje prej 5% në çdo vit si më poshtë:

Emërtimi	Parashikimi 2018 (000 lekë)	Parashikimi 2019 (000 lekë)	Parashikimi 2020 (000 lekë)
Taksa e rentës minerare	892	936	983

Tabela 16. Të ardhura nga taksa e rentës minerare për vitet 2018-2020

#### Të ardhurat nga taksa e tabelës dhe reklamës

Bazuar në Ligjin Nr. 9632, dt.30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:

Tabela për qëllime identifikimi, të cilat nëse janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2m<sup>2</sup> nuk taksohen.

Tabela për qëllime reklamimi, ku përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike.



Tabela për qëllime ekspozimi, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, për ekspozime të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj. Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet të cilët vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillohet aktiviteti, në hapësira të tjera publike ose private që shërbejnë për qëllime reklamimi.

Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e kësaj takse për vitin 2017, parashikimi për vitet 2018-2020 është bërë me një rritje prej 5% në çdo vit si më poshtë:

Kategoritë	Parashikim 2018 (000 lekë)	Parashikim 2019 (000 lekë)	Parashikimi 2020 (000 lekë)
<b>a) Për qëllime identifikimi</b>			
Biznes i Madh	1,155	1,213	1,280
<b>b) Për qëllime reklamimi</b>			
Biznesi i Vogël	52	55	58

Tabela 17. Të ardhurat nga taksa e tabelës për vitet 2018-2020 në (000 lekë)

#### 16.2.9 Të ardhurat nga tarifafat vendore

Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifafat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore; dhënie e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj. Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikafat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.

Tabela e mëposhtme pasqyron të ardhurat nga tarifafat për vitin 2018-2020, sipas llojit të shërbimeve që Bashkia Tropojë do të ofrojë për qytetarët, bizneset apo institucionet. Këto të ardhura përbëjnë 5% të totalit të të ardhurave ose 51% të të ardhurave nga burimet e veta.

LLOJET E TË ARDHURAVE	Plani 2018	Plani 2019	Plani 2020
TË ARDHURAT NGA TARIFAFAT VENDORE	29,519	30,990	32,540
<i>Në % ndaj totalit</i>	5%	5%	5%
<i>Në % ndaj burimeve të veta</i>	51%	51%	51%

Tabela 18. Të ardhurat në total nga tarifafat për vitet 2018-2020

Nëse i referohemi strukturës së të ardhurave nga tarifafat, pjesë e rëndësishme janë të ardhurat nga tarifafat e shërbimeve publike, të cilat zënë 74% të totalit nga kjo kategori. Këto të ardhura përdoren për mbulimin e kostos së shërbimeve që u ofrohen familjeve dhe bizneseve.





*Të ardhurat nga tarifa e shërbimeve publike*

Tarifës së shërbimeve publike i nënshtrohen të gjitha familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Tropojë dhe njësisive të saj administrative. Nivelet, baza e tarifave, kategoritë, nënkategoritë janë kompetencë e plotë e këshillit të bashkisë.

Në tarifën e shërbimeve publike përfshihen të gjitha shërbimet e ofruara nga Bashkia Tropojë të tilla si pastrimit dhe largimit të mbetjeve, ndriçimi publik, gjelbërimi dhe mirëmbajtja e K.U.Z, mirëmbajtja e varrezave, etj.

Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij dhe paguhet nga familjet apo bizneset të cilët kontribuojnë dhe e përfitojnë këtë shërbim.

Politika e Bashkisë për mbulimin e koston së shërbimeve prej 20,518,000 lekë është që 65% të saj duhet ta mbulojnë Familjet dhe 35% Bizneset dhe Institucionet.

Familjet	Politika për çdo Nj.A.	100%	47%	53%
Politikat e mbulimit të koston	Kosto e shërbimeve publike	Totali i koston/ lekë	Nj.A. B.Curri	Nj.A. të Tjera
		20,518,000		
65%	Familjet	13,336,700	6,268,249	7,068,451
	Tarifa mesatare	1,470	2,422	1,090
Biznesi i madh	Politika për çdo Nj.A.	100%	30%	70%
		15%	Biznesi i Madh	3,077,700
	Tarifa mesatare	60,347	55,635	65,247
Biznesi i vogël	Politika për çdo Nj.A.	100%	81%	19%
		15%	Biznesi i Vogël	3,077,700
	Tarifa mesatare	8,409	4,887	23,303
Institucionet	Politika për çdo Nj.A.	100%	100%	
		5%	Institucionet	1,025,900
	Tarifa mesatare	39,458	39,458	39,458

Tabela 19. Politikat e tarifave për çdo subjekt drejt mbulimit të koston së shërbimit

Ngarkesa e tarifimit është shpërndarë duke u bazuar në:

- vendndodhjen (zonë urbane apo zonës rurale),
- në llojin e aktivitetit (tregti, shërbim, prodhim, profesion i lirë, fermer, aktivitet transporti, ndërtimi, karburanti, institucion, ojf, etj.)
- në statusin e subjektit (familjar, biznes i madh, biznes i vogël, institucion shtetëror, ambulant etj.).

Referuar tabelës më sipër, këshilli i bashkisë ka miratuar tarifa më të ulta, se ato të llogaritura mbi bazën e politikave të diferencuara për subjektet dhe konkretisht:



### Për Familjet

Për familjet në nevojë si më poshtë ka lehtësi fiskale:

- Do të paguajnë 50% të tarifës së mësipërme, pra 1,100 lekë/vit dhe 525 lekë/vit;
- Përfituesit e ndihmës ekonomike;
- Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/ bashkëshortes);
- Kryefamiljarët gra me mbi dy fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç).

### Për Bizneset

Bazuar në nivelet e tarifave sipas paketës fiskale të miratuar në këshill, të ardhurat nga tarifa për shërbimet publike, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Emërtimi	V.2018 (000 lekë)	V.2019 (000 lekë)	V.2020 (000 lekë)
Biznesi i madh	3,797	3,987	4,186
Biznesi i vogël	8,182	8,591	9,020
Familjarët	9,050	9,502	9,977
Institucione	1,400	1,470	1,544
<b>TOTALI</b>	<b>22,429</b>	<b>23,550</b>	<b>24,727</b>

Tabela 20. Të ardhurat nga tarifa e shërbimeve publike, vitet 2018-2020 në (000 lekë)

Të ardhurat nga tarifa e shërbimit sipas natyrës së biznesit të madh:

Nr.	Lloji i aktivitetit	Niveli lekë/vit	Baza Nr. subj.	2018 (000 lekë)	2019 (000 lekë)	2020 (000 lekë)
1	Subj. që përpunon metale ose të ngjashme (Fonderi)	0	0	0	0	0
2	Subjekt që përpunon bitum	25,500	0			
3	Subj. përp. inerte (prodhim beton thërmim gurësh etj.)	25,500	1	26	27	28
4	Subj. shërbimi, tregt. artizanat, bankat, farmaci, lojëra fati, magazinimi	38,000	20	798	838	880
5	Çdo njësi prodhimi, njësi përpunimi	25,500	0	0	0	0
6	Rritje, tregtim, blegtori, gjë e gjalle	0	0	0	0	0
7	Per komplekse (hoteleri, restorant, karburant etj.)	48,000	11	554	582	611
8	Subjekt ndërtimi dhe subjekte fabrika	70,000	8	588	618	649
9	Për çdo njësi tregtimi shitje (hekur, inerte, çimento)	25,500	3	80	84	88
10	Subjekte që përpunojnë mbetje plastike, letre, drurë etj.)	0	0	0	0	0
11	Për çdo karburant	48,000	7	353	370	388.5
	Subjekte miniere	63,000	24	1.588	1.667	1750
	<b>TOTALI</b>		<b>74</b>	<b>3,987</b>	<b>4,186</b>	<b>4395</b>

Tabela 21. Të ardhurat nga tarifa e shërbimeve publike (pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, mirëmbajtjes) nga biznesi i madh për 2018-2020



Për kategorinë e subjekteve fizike ose juridike, që ushtrojnë aktivitet jo fitimprurës, si fondacione vendase ose të huaja, të regjistruara si të tilla në gjykatë, niveli për këtë tarifë do të jetë 10,000 lekë/vit.

*Të ardhurat nga tarifa e shërbimeve sipas natyrës së biznesit të vogël*

Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e kësaj takse për vitin 2017 parashikimi për vitet 2018-2020 është bërë me një rritje prej 5% në çdo vit si më poshtë:

Kategoria	Niveli (lekë/vit)	Nr. bizneseve	2018 (000 lekë)	2019 (000 lekë)	2020 (000 lekë)
Njësi tregtim art. ind.	23,500	100	2,467	2,590	2,719
Njësi aktivitet shërbimi	23,500	87	2,146	2,253	2,367
Shëndetësia (Farmaci, dentist)	29,000	4	122	128	134
Njësi tregti ushqimore, fruta perime	23,500	43	1,060	1,113	1,168
Njësi bar-restorant-kafe	23,500	92	2,270	2,383	2,502
Pika tregtimi karburante	48,000	7	352	370	389
Furra buke	23,500	3	75	79	83
Transport mallra udhëtimi	47,000	2	99	104	109
<b>TOTALI</b>		<b>338</b>	<b>8,591</b>	<b>9,020</b>	<b>9,471</b>

Tabela 22. Të ardhurat nga tarifa e shërbimeve publike (pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit, mirëmbajtjes) nga biznesi i vogël për vitet 2018-2020

*Të ardhurat nga tarifa për shërbimet administrative*

Në këtë tarifë kemi parasysh shërbimet që ofrohen nga sektorët brenda bashkisë. Nga vërtetime, autorizime, dokumente të tjera, tarifat e propozuara janë si më poshtë:

1. Vërtetime	100 lekë
2. Vërtetime për tender	200 lekë
3. Aplikim për:	
- Leje ndërtimi, leje zhvillimi, leje infrastrukturore, leje përdorimi	10,000 lekë
- Tarifë për shesh ndërtimi	
- Ndërtesa banimi, shkolla, çerdhe	5,000 lekë
- Ndërtesa social-kulturore	10,000 lekë
- Azhornim Gen-planesh	40 lekë
- Tarifë për përcjellje dokumentacioni në ZIRPP	500 lekë
- Tarifë për shërbime njohje pronësie	1,500 lekë
4. Tarifë për tërheqje dokumente nga arshiva:	
- Për dokumente pronësie	100 lekë
- Për dokumentet e reja	100 lekë
- Vërtetim page për bazën e vlerësueshme	100 lekë

Tabela 23. Tarifat e shërbimeve administrative



Nivelet e kësaj tarife për periudhën 2018-2020 janë caktuar në bazë të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2017.

Emërtimi	V.2018 (000 lekë)	V.2019 (000 lekë)	V.2020 (000 lekë)
Tarifa për shërbimet administrative	1,050	1,102	1,152

Tabela 24. Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve administrative për vitet 2018-2020 në (000 lekë)

#### Nga tarifa për vulosje veterinerë të bagëtive të therura

Tarifat e parashikuara për shërbimet veterinarë janë parashikuar si më poshtë:

Nr.	Llojet e tarifave	Vlera/lekë për krerë
<b>I</b>	<b>Tarifa për çdo bagëti të therur</b>	
	1. Për lopë, ka, buall	100
	2. Për viça dhe derra	60
	3. Për bagëti të imta	10
<b>II</b>	<b>Shërbimi për kontrollin veterinar</b>	
<b>A</b>	<b>Kontrolli para therjes</b>	
	1. Për lopë, ka, buall	70
	2. Për viça dhe derra	40
	3. Për bagëti të imta	10
<b>B</b>	<b>Kontrolli i mishit</b>	
	1. Për lopë, ka, buall	70
	2. Për viça dhe derra	40
	3. Për bagëti të imta	30
	4. Kontrolli i peshkut	50/100kg
<b>III</b>	<b>Certifikata e veterinerit</b>	
	1. Për lopë, ka, buall	60
	2. Për viça dhe derra	60
	3. Për bagëti të imta	50

Tabela 25. Tarifa e shërbimit veterinar

Llogaritur mbi të njëjtat nivele e baza dhe duke parë ecurinë e kësaj takse për vitin 2017 parashikimi për vitet 2018-2020 është bërë si më poshtë:

Emërtimi	V. 2018 (000 lekë)	V.2019 (000 lekë)	V.2020 (000 lekë)
Tarifa e shërbimeve veterinarë	105	110	115

Tabela 26. Të ardhurat nga tarifa e shërbimit veterinar

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është sektori i shërbimit veterinar.

#### Nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit, autorizime

Për dhënien e lejeve të transportit të udhëtarëve dhe të mallrave, në zbatim të udhëzimeve për transportin rrugor propozohen këto tarifa.



Nr.	Emërtimi	Njësia	Tarifa/lekë Afati 5 vjeçar
<b>I</b>	<b>Transport udhëtarësh</b>		
	<b>Brenda vendit</b>		
	1- Licencë transporti udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Për linjë	40 000
	Certifikatë transporti udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Për mjet	5 000
	2- Licencë transporti udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	Për linjë	20 000
	Certifikatë transporti udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	Për mjet	7 500
	3- Licencë transporti udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut	Për linjë	75 000
	Certifikatë transporti udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut	Për mjet	7 500
123	Punëtorë mirëmbajtjeje shërbimesh (elektricitist)/ maintenance and service worker (erector)	"		Kod pune/ Labor Code	
124	Punëtor mirëmbajtjeje dhe shërbimesh (për sistemin e kanalizimeve)/ maintenance and service worker (for sewage system)	"		Kod pune/ Labor Code	
	<b>- Brigada e Gjelbërimit/ green spaces brigade</b>	q. b. c.	4		
125	Punëtor gjelbërimi/ gardener	"		Kod pune/ Labor Code	
126	Punëtor gjelbërimi/ gardener	"		Kod pune/ Labor Code	
127	Punëtor gjelbërimi/ gardener	"		Kod pune/ Labor Code	
128	Punëtor mirëmbajtjeje për varrezat/ maintenance for cemeteries	varr. qyt.		Kod pune/ Labor Code	
	<b>- Brigada e Pastrimit/ cleaning brigade</b>	q. b. c.	13		
129	Manovrator (shofer)/ driver	"		Kod pune/ Labor Code	
130	Manovrator (shofer)/ driver	"		Kod pune/ Labor Code	
131	Manovrator (shofer)/ driver	"		Kod pune/ Labor Code	
132	Punëtor ngarkim-shkarkim/ stevedore	"		Kod pune/ Labor Code	
133	Punëtor ngarkim-shkarkim/ stevedore	"		Kod pune/ Labor Code	



	134	Punëtor ngarkim-shkarkimi/ stevedore	"		Kod pune/ Labor Code	
	135	Punëtor ngarkim-shkarkimi/ stevedore	"		Kod pune/ Labor Code	
	136	Punëtor pastrimi/ cleaning employer	"		Kod pune/ Labor Code	
	137	Punëtor pastrimi/ cleaning employer	"		Kod pune/ Labor Code	
	138	Punëtor pastrimi/ cleaning employer	"		Kod pune/ Labor Code	
	139	Punëtor pastrimi/ cleaning employer	"		Kod pune/ Labor Code	
	140	Punëtor pastrimi/ cleaning employer	"		Kod pune/ Labor Code	
		Punëtor shërbimesh në njësitë Administrative/ service staff in the administrative units				
		Njësia administrative Tropojë/ Tropoja administrative unit	pun. shërb.	5	Kod pune/ Labor Code	
VIII/	1	Njësia Administrative Bytyç/ Bytyç administrative unit	pun. shërb.	2	"	
X/1		Njësia Administrative Margegaj/ Margegaj administrative unit	pun. shërb.	4	"	
XI/1		Njësia Administrative Lluga/ Lluga administrative unit	pun. shërb.	1	"	
XII/	1	Njësia Administrative Lekbibaj/ Lekbibaj administrative unit	pun. shërb.	2	"	
XIV	/1	Njësia Administrative Fierzë/ Fierza administrative unit	pun. shërb.	3	"	
XIII/	1	Shuma e punëtorëve të shërbimeve në Njësinë Administrative/ sum of the service staff of the administrative unit		17		
		Total/ total				
	141	Punëtor sezonal, 6-mujor, 32x3:12 =8/ seasonal employer, 6-months, 32x3:12=8		8	"	
VII/	1	Total/ total		16		
		Sektori i shërbimit pyjor, Transferte specifike/ sector of forest service, specific transfer		6	Punonjës/ Employer	
		Arsimi Parashkollor/ pre-school education		74	"	
		Bordi i kullimit/ drainage board		3	"	
		Shërbimi zjarrfikës/ fire-fighting service		14	"	
		Punëtor të mirëmbajtjes së rrugëve/ road maintenance employer		15		



Si rrjedhojë, këto ndryshime të mëdha dhe nevojat tepër të ndryshme të qytetarëve dhe të territorit në zhvillim, kërkojnë ngritjen e kapaciteteve institucionale në të tjera nivele, për të përballuar me sukses realizimin e këtij Plani të Përgjithshëm Vendor.

Mbështetur në Vendimin nr. 56, datë 02.06.2016, “Për ndryshimin e Strukturës dhe Rregullores së Bashkisë Tropojë” që i referohet VKB nr. 314, datë 18.12.2015, “Për miratimin e ndryshimit të VKB nr. 281, datë 09.09.2015, “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Tropojës, institucioneve në varësi dhe të Njësive Administrative”, struktura organizative e bashkisë Tropojë përbëhet nga 316 punonjës, grupimi i të cilëve sipas hierarkisë institucionale tregohet në dokumentin e cituar më sipër.

Gjatë procesit të punës për hartimin e Plani të Përgjithshëm Vendor, analiza e kujdesshme e kryer mbi aspektet institucionale të Bashkisë Tropojë nxorri në pah një sërë çështjesh kryesisht të lidhura me mangësi. Për këtë, një sërë sugjerimesh dhe rekomandimesh janë hartuar dhe renditur në vijim. Këto rekomandime prekin si zbatimin e planit vendor, ashtu dhe ngritjen/përmirësimin e kapaciteteve institucionale të domosdoshme për hartimin e *Planeve Sektoriale, Planeve të Detajuara Vendore* apo dhe *Masterplaneve*. Më hollësisht, analiza mbi gjendjen institucionale të bashkisë së Tropojës arriti të dallojë si përparësi të rëndësishme:

- Praninë në qytetin e Tropojës të një sërë institucionesh kryesore si Qarku, Prefektura, Agjencitë e ndryshme Rajonale etj.;
- Pozicionin e favorshëm strategjik si faktor lehtësues për të përfituar fonde (IPA, CBC). Praninë e disa përfaqësive të huaja (konsullata, programe ndërkom-bëtare, misione etj.);
- Përvojën institucionale në bashkëpunime me financime të huaja;
- Konfirmimin si qendër historike në nivel kombëtar e rajonal;
- Traditën e mirë të bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm;
- Afirmimin si qendër rajonale në ofrimin e shërbimeve;
- Kapacitetet e larta njerëzore të përfaqësuara nga tradita e qytetit pasuruar nga migracioni;
- Praninë aktive të Shoqërisë civile.

Ndërsa mes kufizimeve, ato me ndikim më të ndjeshëm janë:

- Mangësitë në shërbime në pjesët e reja të territorit bashkiak, i cili është disa herë më i madh nga ai që bashkia e vjetër e Tropojës administronte para reformës;
- Mungesa e kapaciteteve të specializuara dhe ekspertizës në zonat rurale;





- Mungesa e përvojës institucionale në trajtimin e çështjeve të zhvillimit rural, bujqësor;
- Mungesat në të dhënat dhe informacionin mbi territorin e ri;
- Shkalla e ndërgjegjësimit ndaj detyrimeve publike veçanërisht në zonat rurale;
- Mungesat e njësive administrative në bazë materiale të domosdoshme për performancë efikase si PC, Printer, Software, etj.;
- Mungesa e kapaciteteve të plota të specializuara në hartimin e planeve të menaxhimit, planeve të detajuara vendore.

Bazuar mbi gjendjen që paraqitet aktualisht, gjykohet se problemet më të hasura dhe që kërkojnë zgjidhje nëpërmjet rritjes së kapaciteteve institucionale dhe përmirësimit të shërbimeve ndaj publikut janë:

- Pabarazia në ofrimin e shërbimeve (menaxhim i dobët larg qendrës);
- Vështirësitë në ngritjen e kapaciteteve lokale në zonat periferike;
- Vështirësitë në menaxhim (zhvillim i ngadaltë);
- Pabarazi në zhvillimin rajonal krahasuar me vendet fqinje.

Së fundmi, duke iu referuar ndryshimeve të fundit në kuadrin ligjor të funksionimit të pushtetit vendor, por edhe të një sërë risive në ofrimin e shërbimeve etj. në përballjen e bashkisë së Tropojës me çështjet e territorit, mund të renditen si mundësi:

- Menaxhimi i integruar i territorit;
- Efikasiteti që sjell mbështetja në Planin e Përgjithshëm Vendor sidomos në lidhje me dallimin e prioriteteve;
- Dixhitalizimi i disa shërbimeve dhe ofrimi në mënyrë elektronike (*online*);
- Qendrat e ofrimit të shërbimeve me një ndalesë.

#### *Përfshirja e publikut në qeverisjen vendore / transparenca*

Bashkia e Tropojës synon të rrisë transparencën ndaj publikut dhe të përmirësojë shërbimet, duke modernizuar dhe dixhitalizuar një sërë shërbimesh të cilat lidhen me Bashkinë. Në këtë kontekst do të ofrohen shërbime elektronike për bizneset me anë të të cilave mund të kryhen veprimet për shlyerjen e detyrimeve. Po kështu, me të njëjtën logjikë më pas do të dixhitalizohet edhe shërbimi për qytetarin duke u bazuar në një portal të vetëm në të cilin mund të merret informacion si dhe të përftohen shërbime apo



kryhen veprime të ndryshme. Portali do të jetë i përdorshëm si nga “telefonat e lëvizshëm inteligjent” ashtu dhe në *website*.

Gjithashtu do të krijohen programe të cilat synojnë përfshirjen e qytetarit në hartimin e projekteve komunitare. Do të krijohen mundësi ku qytetarët të shprehin opinionin e tyre dhe dëshirën për hartimin e projekteve të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë.

Në planin afatgjatë, në vizionin e bashkisë, pas ngritjes së kapaciteteve, qendrat me një ndalesë do të luajnë dhe rolin e katalizatorit përsa i përket planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Në bashkëpunim me përfaqësitë komunitare do të ngrihen kapacitetet që të arrijnë të zhvillojnë projekte dhe më pas të zbatojnë ato. Qendrat me një ndalesë gjithashtu do të konkurrojnë me njëra-tjetrën për tërheqjen e financimeve nga Bashkia.

#### *Bashkëpunimi Rajonal*

E ndodhur në pozitë gjeografike tepër të favorshme, si në raport me rajonin e Mesdheut, Adriatikut, ashtu dhe me vendin, Bashkia e Tropojës do të duhet të synojë ngritjen e strukturave për bashkëpunimin ndërkufitar midis bashkisë Tropojë dhe bashkive të tjera të vendit si dhe atyre në brigjet përballë Italisë por edhe më gjerë. Ky program është më tepër i karakterit të marrëdhënieve institucionale, por shërben edhe në ngritjen e kapaciteteve për hartimin e planeve të përbashkëta si dhe në aplikimin për projekte në thirrje (*INTERREG IPA II CBC ITALIA, ALBANIA, MONTENEGRO*).

#### **17.2 Marrëveshjet e zbatimit, procedurat dhe stafi i strukturës së nevojshme për zbatimin**

Në kuadër të zbatimit të PPV, bashkia Tropojë duhet të hartojë një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme qeveritare si dhe me partnerë të tjerë lokale apo edhe me komunitetet. Një sërë marrëveshjesh ndërlidhen me:

- Marrëveshje në fushën e zhvillimit ekonomik, turizmit dhe zhvillimit rural;
- Marrëveshje në fushën e mobilitetit urban;
- Marrëveshje në fushën e mjedisit;
- Marrëveshje me institucione akademike dhe profesionale për ngritjen e kapaciteteve vendore në fushën e planifikimit dhe menaxhimit të territorit;
- Marrëveshje me MZHU/AKPT për mbështetje në zbatimin e PPV;



- Marrëveshje në fushën e bashkëpunimit ndërkuftar / rajonal.

Gjithashtu, sugjerohet përcaktimi i një *PIU (Project Implementation Unit)* e cila mund të jetë me financim të bashkisë ose në marrëveshje me donatorë të ndryshëm për të koordinuar punën në zbatimin e planit gjatë vitit të parë të zbatimit. PIU gjithashtu do të shërbejë edhe në ngritjen e strukturave dhe kapaciteteve vendore për zbatimin e PPV.

Marrëveshjet e ngritura në kuadër të zbatimit të PPV mund të kenë si fokus disa çështje të ndryshme si:

- marrëveshje për zbatim projektsh të përbashkëta;
- marrëveshje për monitorimin e situatës ekzistuese dhe plotësimin e bazës së të dhënave;
- marrëveshje për hartimin e planeve sektoriale vendore;
- marrëveshje për menaxhimin e hapësirave publike;
- ndërgjegjësimin e publikut;
- ngritjen e kapaciteteve vendore;
- monitorim të situatës mjedisore.

Në këtë kontekst, janë identifikuar një sërë aktorësh të ndryshëm me të cilët bashkia Tropojë mund të lidhë marrëveshje të reja ose të zgjerojë ato ekzistuese përsa i përket zbatimit të PPV-së:

- Grupi i konsulentëve (*Studio B&L+Pier Vittorio Aureli+Martino Tattara*);
- Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, UPT;
- EU Delegation;
- UNESCO;
- PLGP/USAID;
- SIDA;
- ADA;
- Swiss Helvetica DLDP;
- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit;
- Ministria e Zhvillimit Urban;



- Ministria e Ekonomisë;
- Ministria e Mjedisit;
- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
- Ministria e Transportit;
- Ministria e Kulturës;
- Komuniteti Musliman;
- Komuniteti Katolik;
- Komuniteti Ortodoks.

Gjithashtu, sugjerohet lidhja e marrëveshjeve edhe me shoqërinë civile dhe me shoqatat e ndryshme të cilat operojnë në Tropojë.

Bazuar mbi gjetjet e mësipërme, gjykohet se një sërë masash do të mund të kontribuojnë në rritjen e performancës së bashkisë Tropojë sidomos në çështjet e territorit, administrimit dhe zhvillimit të tij. Si më të rëndësishmet ndër këto masa, renditen:

- Krijimi dhe formalizimi i bazës së informacionit;
- Gjatë hartimit të planit të përgjithshëm vendor të bashkisë Tropojë është krijuar një bazë e mirë informacioni, të cilën, bashkia duhet ta mirëmbajë, ta përdorë me efikasitet dhe ta plotësojë në mënyrë të vazhdueshme;
- Të krijohet një zyrë e mirëfilltë e statistikave vendore që duhet të grumbullojë të dhëna statistikore bazuar në treguesit e propozuar në plan si dhe për nevoja të tjera lokale;
- Të plotësohet baza e informacionit dhe inventarizimit të pyjeve, kullotave, tokave bujqësore dhe elementeve të tjerë të klasifikueshëm që përfshihen në territorin e bashkisë Tropojë;
- Të kryhet inventarizimi dhe krijimi i një baze të mirë informacioni në lidhje me zhvillimin ekonomik;
- Të plotësohet baza materiale e vetë bashkisë si dhe e njësive administrative me pajisjet e domosdoshme për arritjen e këtij objekti si PC, Printer, software të nevojshëm si Autocad, GIS, etj.

Organizimi i trajnimeve të vazhduara dhe plotësuese të stafit të bashkisë në fushat më prioritare si më poshtë:

- Planifikim dhe Menaxhim Terriori;





- Hartim politikash zhvillimi;
- Përdorimi i instrumentave të drejtimit të zhvillimit;
- Përdorim i GIS dhe Regjistrit të Territorit;
- Menaxhim Projektesh;
- Rregulla të përdorimit të tokës;
- Trajtim i çështjeve sociale (duke përfshirë aspekte të barazisë gjinore, grupeve të marginalizuara, emigracionit, moshës së tretë, konfliktit mbi pronën, etj.);
- Trajnime për trajtimin e rasteve të dhunës në familje;
- Trajnime për trajtimin e grave të dhunuara;
- Trajnime për këshillimin e të rinjve;
- Trajnime për strehimin social;
- Trajnime për trajtimin e grupeve të marginalizuara të popullsisë;
- Trajnime për këshillimin mbi konfliktet e pronës;
- Zhvillim Rural dhe Menaxhimin e pasurive natyrore;
- Menaxhim të pasurive ujore (lumenj, rezervuarë etj.)
- Turizëm dhe guida turistike;
- Menaxhim i rreziqeve natyrore;
- Transport (publik) dhe lëvizshmëri e butë.

Në kuadër të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tropojë është i domosdoshëm angazhimi i një sërë sektorësh/departamentesh në vënien me sukses në praktikë të tij, duke qënë se planifikimi është një proces i vazhdueshëm dhe jo vetëm një koncept urbanistik.

Në këtë kontekst, përfshirja e drejtpërdrejtë dhe marrja e përgjegjësive institucionale gjykohet tepër thelbësore veçanërisht për sektorët që përballen me zinxhirin e zbatueshmërisë së PPV-së:

- *Drejtoria Ligjore me sektorët: Juridik, i Prokurimeve Publike, i Gjendjes Civile, i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve*, të cilët mbështesin drejtorinë e planifikimit të territorit dhe zhvillimit urban duke ofruar konsulencën e nevojshme ligjore në zbatimin e planit si dhe në plotësimin e dokumenteve të



rregullores së planit apo të vendimeve/udhëzimeve në funksion të zbatimit të PPV sipas rastit dhe nevojave lokale, të cilat mund të parashtrihen pas miratimit të planit. Gjithashtu, këto hallka duhet të mbajnë të përditësuar drejtorinë e planifikimit të territorit në lidhje me ndryshimet e mundshme ligjore, të cilat mund të ndodhin pas miratimit të planit, në mënyrë që PPV të përditësohet rast pas rasti sipas nevojës. Prokurimet do të duhet të bëhen një mekanizëm lehtësues dhe garantues i suksesit të investimeve të mundshme si në hartimin e instrumenteve të përcaktuar nga PPV ashtu dhe në programet e projekteve pilot të ndarë sipas fazave. Asetet publike, veçanërisht menaxhimi i hapësirave publike dhe objekteve, marrin gjithashtu një rëndësi themelore në sugjerimet e PPV.

- *Drejtoria e Shërbimeve Sociale, me sektorët e Ndhmës Ekonomike dhe Invaliditetit, Shërbimeve Sociale*, përgatit në mënyrë periodike raportin e monitorimit të situatës së ndihmës ekonomike. Është përgjegjëse për zbatimin e programeve për ndihmën ekonomike. Sektorët zbatojnë politikat përkatëse për strehimin dhe monitoron mbarëvajtjen në lidhje me strehimin social. Gjithashtu, në kuadër të zbatimit të planit, është i nevojshëm krijimi i një databaze hapësinore në lidhje me kërkesat për strehim si dhe përgjigjes ndaj tyre. Kjo drejtori është përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit të projekteve në fushën e strehimit në bashkëpunim me drejtorinë e planifikimit të territorit. Ajo duhet të përgatisë në mënyrë periodike raportin e monitorimit të situatës së strehimit.
- *Drejtoria e Shërbimeve me sektorët e Shërbimeve, Projektmeve & Infrastrukturës, Ndjekjes së Investimeve & Ndërmarrjeve, Administrimin e Pyjeve dhe shërbime të tjera*, është drejtpërdrejt e lidhur me koordinimin e investimeve të parashikuara në planin e veprimit të Strategjisë Territoriale si dhe parashikimet për investime të planifikuara në PPV. Në kushte të caktuara mund të marrë nismën për hartimin e planeve sektoriale ose për plotësimin e rregulloreve përkatëse me nene shtesë në përgjigje të nevojave lokale. Koordinon dhe monitoron situatën mjedisore dhe menaxhon pyjet e ujërat. Harton plane menaxhimi për pyjet në kuadër të planifikimit sektorial vendor. Çdo vit përgatit raportin e monitorimit të PPV në lidhje me çështjet mjedisore dhe ofron rekomandimet përkatëse për përshtatjen me situata të reja. Është përgjegjëse për zbatimin e masave në mjedis, të parashikuara në PPV dhe për monitorimin e drejtpërdrejtë të rezultateve të tyre. Përgatit raportin përfundimtar të monitorimit në lidhje me ecurinë e investimeve si dhe jep rekomandime për ndryshimet përkatëse në PPV.
- *Drejtoria e Planifikimit & Kontrollit të Zhvillimit të Territorit me sektorët e Arkivit teknik, Kadastrës-Hartografisë dhe Menaxhimit të Gjeoinformacionit, Kontrollit të Territorit, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Legalizimit*, kontrollojnë



drejtpërdrejt zbatimin e PPV për Bashkinë Tropojë. Shërben si koordinues edhe për sektorët e tjerë. Detajon PDV sipas rastit. Ajo është hallka më e rëndësishme në procesin e monitorimit të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor. Koordinon dhe monitoron mbarëvajtjen e zbatimit të investimeve në fushën mjedisore dhe monitoron situatën mjedisore. Monitoron zbatimin e planit dhe në fund të çdo viti përgatit një raport vlerësimi, ku ofron dhe rekomandimet përkatëse për PPV.

- *Drejtoria Ekonomike me sektorët e Financës dhe Buxhetit*, që është monitoruese e programit buxhetor dhe sigurohet që parashikimet e PPV të reflektohen në PBA. Monitoron situatën e buxhetit dhe çdo vit paraqet raportin për buxhetin ku ofrohen dhe rekomandimet përkatëse për zbatimin e planit. Monitoron të ardhurat të cilat gjenerohen nga bashkia dhe të ardhurat të cilat vijnë drejtpërdrejt nga parashikimet dhe zbatimi i PPV. Në fund ofron rekomandimet përkatëse dhe ndryshimet e nevojshme në PPV.
- *Drejtoria e Burimeve Njerëzore me sektorët e Personelit, Protokoll-Arkivës, Informacionit dhe Teknologjisë së Shërbimit dhe Shërbimeve Mbështetëse*, që mbështet drejtoritë e tjera në zbatimin e PPV duke ofruar asistencë në zhvillimin e prokurimeve si dhe me anë të shërbimeve të tjera mbështetëse sipas nevojës; mbështet sektorët e tjerë në zbatim të PPV duke ofruar ekspertizë teknike. Ndihmon në përgatitjen e termave të referencës për *software* të ndryshëm dhe në zbatimin e programit të qeverisjes elektronike. Çdo vit, harton një raport monitorimi mbi zyrën e integruar me një ndalesë.
- *Drejtoria e Politikave të Zhvillimit me sektorët e Politikave të Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Analizës-Statistikës & Planifikimeve Afatmesme dhe Sektorin e Bujqësisë*, që është përgjegjëse për monitorimin e zhvillimit ekonomik në territorin e bashkisë. Jep rekomandimet përkatëse për politikat ekonomike të cilat bashkia duhet t'i ndjekë në bazë vjetore, si dhe ndryshime të cilat mund të jenë të nevojshme në strategjinë territoriale. Mund të marrë nismën për hartimin e një plani sektorial vendor për zhvillimin ekonomik. Gjithashtu, merret drejtpërdrejt me zbatimin e programeve për zhvillimin e turizmit. Mund të hartojë një plan sektorial vendor për turizmin për të fuqizuar dhe detajuar më shumë sektorin. Monitoron situatën e zhvillimit të turizmit në Bashkinë Tropojë dhe çdo vit përgatit një raport monitorimi. Merret drejtpërdrejtë me zbatimin e programeve për zhvillimin rural dhe bujqësinë. Mund të hartojë një plan sektorial vendor për zhvillimin për të fuqizuar dhe për të detajuar më shumë sektorin. Monitoron situatën e zhvillimit rural në Bashkinë Tropojë dhe çdo vit përgatit një raport monitorimi.
- *Institucionet në varësi të bashkisë Tropojë*. Secili institucion në varësi të



bashkisë Tropojë koordinon me drejtorinë e planifikimit të territorit të Bashkisë zbatimin e PPV-së si dhe të programeve përkatës. Çdo vit, drejtoritë hartojnë raportet përkatëse të monitorimit, të cilat i paraqiten bashkisë Tropojë së bashku me rekomandimet specifike dhe konkrete.

- *Njësitë administrative* koordinojnë me drejtoritë e planifikimit dhe kontrollit të territorit zbatimin e planit dhe monitorimin e tij. NJV ofrojnë shërbime këshilluese ndaj qytetarit.

#### *Për ngritjen e këshillit teknik për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi*

Kryetari i Bashkisë Tropojë ngre, me urdhër, grupin përbërës për shqyrtimin dhe këshillin teknik për lejet e ndërtimit. Grupi i ngritur, me urdhër të kryetarit shqyrton dokumentacionin si dhe përgatit me shkrim raportin teknik së bashku me rekomandimet dhe vërejtjet përkatëse për kryetarin e bashkisë. Grupi duhet të përbëhet të paktën dhe jo vetëm nga:

- Përfaqësues i drejtorisë Ligjore (1 përfaqësues);
- Përfaqësues i sektorit të planifikimit të territorit (2 përfaqësues - njëri prej tyre kryetar i grupit të punës);
- Përfaqësues i sektorit të kontrollit të territorit (1 përfaqësues);
- Përfaqësues i sektorit të mjedisit (1 përfaqësues);
- Përfaqësues i drejtorisë së Politikave të Zhvillimit (1 përfaqësues);
- Përfaqësues i drejtorisë së shërbimeve dhe infrastrukturës (1 përfaqësues);
- Përfaqësues nga rajoni (për njësinë administrative Tropojë) ose përfaqësues nga njësia administrative ku aplikohet leja.

Grupi i punës mund të mblidhet në mënyrë periodike për shqyrtimin e kërkesave për leje, në mënyrë që të respektohen afatet ligjore përkatëse. Gjithashtu, për koordinimin e grupit të punës përdoret sistemi elektronik i lejeve.





### 17.3 Vlerësimi i nevojave për personel dhe hapësira

Zbatimi i Planit të Përgjithshëm Vendor kërkon një qasje më realiste ndaj burimeve njerëzore që disponon sot Bashkia Tropojë. Mundësia e lartë për të patur ndërthurje dhe kombinim të kompetencave të drejtorive dhe sektorëve të ndryshëm mund të shtojë nevojën e rishikimit të strukturës. Funksione të ndryshme, që lidhen me proceset e lejeve të ndërtimit, nxjerrin në pah domosdoshmërinë e pranisë së arkitektëve/urbanistëve/planifikuesve të kualifikuar, që do të kenë përgjegjësi kryesore në procese teknike si dhënia e përshtatshmërisë apo aplikueshmërisë së legjislacionit në projekte. Po kështu, inxhinierë ndërtimi do të duhet të vlerësojnë zbatimin e normave teknike. Për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor janë të nevojshëm një sërë ekspertësh të të gjitha fu-shave që kanë të bëjnë me territorin, si arkitekt, urbanist, inxhinier ndërtimi, inxhinier ujësjellës-kanalizimi, inxhinier elektrik, inxhinier mjedisi, inxhinier transporti, agronom, topograf etj.

Më konkretisht, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit me 28 punonjës, nga të cilët aktualisht 4 janë specialistë të sektorit të Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve, 11 specialistë të Sektorit GIS-Kadastër, 2 të atij të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe 2 të sektorit të Mjedisit, është në nevojë të fuqizimit me staf profesional, veçanërisht në sektorin e Planifikimit dhe atë të Mjedisit. Gjithashtu, shihet e nevojshme prania nën këtë drejtori e një specialisti të çështjeve juridike që lidhen me specifikat e fushës së planifikimit. Ky, mund të jetë edhe një pjesëtar i shtuar i stafit të drejtorisë ligjore, por që nëpërmjet trajnimit të profilizohet veçanërisht në legjislacionin e planifikimit, projektimit dhe ndërtimit.

Po kështu, Drejtoria e Shërbimeve me sektorët e Shërbimeve, Projektive dhe Infrastrukturës, Ndjekjes së Investimeve dhe Ndërmarrjeve, Administrimin e Pyjeve sugjerohet të ristrukturohet për të mundësuar që sektori i pyjeve të kombinohet ndoshta me atë të mjedisit në drejtorinë e planifikimit. Më tej, drejtoria e shërbimeve do të duhet të shtojë staf në sektorin e projektimit dhe infrastrukturës, sektor që do të përballet me një territor sa kompleks aq dhe në nevojë për ndërhyrje e monitorim. Drejtoria e Politikave të Zhvillimit me sektorët e Politikave të Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Analizës-Statistikës dhe Planifikimeve Afatmesme dhe Sektorin e Bujqësisë, lypset të fuqizojë të tre sektorët me ekspertizë të kualifikuar në çështjet komplekse të turizmit, të planifikimeve, statistikave dhe ato të bujqësisë, që në kuadrin e zbatimit të PPV do të jenë fusha determinuese të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit të bashkisë së Tropojës.

Në lidhje me integrimin e sistemit të gjeoreferencimit në dhënieve të lejeve të ndërtimit dhe në planifikimin urban, bashkia e Tropojës ka siguruar një numër të konsiderueshëm specialistësh, performanca e të cilëve duhet parë gjatë procesit. Ndërkaq, është e nevojshme të përforcohet ky sektor i ri me specialistë të fushës edhe stafet e njësive administrative, ndër të cilat vetëm ajo e Manzës disponon një teknik topograf.



Nëse stafi i tanishëm i Bashkisë së Tropojës është një bërthamë funksionale me përvojë që garanton një proces koordinues efikas të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, në njësitë administrative nuk ka ende specialistë të fushës së planifikimit, arkitekturës e urbanistikës. Kjo mungesë mund të reflektohet në probleme gjatë zbatimit të planit dhe projekteve të tij, veçanërisht në njësi ku ka zona të ndjeshme me vlera dhe nën presion zhvillimi. Për këtë arsye, sugjerohet pasurimi i organikave, në fillim të njësive të caktuara, me specialistë arkitekt/urbanist por edhe agronom (aty ku nuk ka) apo specialist mjedisi.

Në njësitë administrative të Tropojës (Bashkia Tropojë) vlerësohet se gjendja e hapësirave të punës ofron mjaftueshmëri sasiore. Përsa i përket gjendjes fizike dhe pajimit, bashkia e Tropojës qëndron në nivel më të lartë se njësitë e saj, edhe pse ende edhe në këtë institucion mbetet shumë për t'u përmirësuar, veçanërisht në pjesën e teknologjisë dhe pajisjeve në dispozicion të stafeve teknike. Ndërkohë, përsa i përket njësive administrative nevojiten disa ndërhyrje jo në zgjerimin e mjediseve sesa në rregullimin dhe rikonceptimin e tyre për t'i bërë më efikase e për t'u përshtatur me kërkesat e reja.

Më tej, lidhur me logjistikën që pritet të mbështesë bashkinë e Tropojës në zbatimin e PPV dhe kontrollin e zhvillimit të mëtejshëm të territorit, vlen të theksohet se do të nevojitet një përmirësim i kushteve të punës dhe përforcim i kapacitetit logjistik të bashkisë me mjete transporti, të nevojshme për t'i bërë të gjitha territoret e reja, të përfshira rishtazi nën këtë bashki, të arritshme dhe menaxhueshme në kushte optimale.











**18 KONSULTIME ME PALËT E INTERESUARA**





### 18.1 Dëgjese publike për planin e zhvillimit territorial, rregullorja lokale dhe vlerësimi strategjik mjedisor

Kryetari i Bashkisë Tropojë, z. Besnik Dushaj, bën hyrjen e dëgjësës dhe prezantimin e grupit projektues dhe pasi falenderon grupet e punës, stafin dhe pjesëmarrësit në takim ia lë fjalën z. Ermal Blea nga Studio B&L.

Z. Ermal Blea, pas falenderimit për stafin dhe pjesëmarrësit, bën një përmbledhje të punës që është bërë, duke theksuar objektivat dhe mënyrën e punës. Në fjalën e tij z. Blea shprehet për trajtimin e territorit jo si një njësi të shkëputur por si pjesë të një territori më të gjerë që vazhdon përtej qendrave urbane, kufijve të bashkisë apo atyre kombëtarë. Pas kësaj, pas prezantimit të z. Pier Vittorio Aureli nga studio DOGMA, i lihet fjala këtij të fundit për prezantimin.

Z. P. V. Aureli pas një falenderimi për pjesëmarrësit për praninë e tyre e hap prezantimin duke folur për kujdesin e veçantë që i tregohet territorit në këtë plan. Fillimisht bën një përmbledhje të shkurtër të analizës së territorit duke ndaluar te rëndësia që ka mjedisi, mbrojtja e tij dhe marrëdhënia që ka me ekonominë dhe komunitetin, për të kaluar më tej në objektivat strategjike. Me listimin e tyre kalohet në hartën e përgjithshme të territorit ku tregohen skematikisht projektet pilotë për secilën kategori të ndërhyrjeve.

Më pas Pier Vittorio Aureli merr me radhë llojet e ndërhyrjeve dhe rregulloret që i shoqërojnë, duke filluar nga mbrojtja e mjedisit, për t'u pasuar nga turizmi dhe bujqësia, si ekonomi bazë për zhvillimin e territorit e më tej me propozimet për peizazhin urban. Këtu përcaktohet rregullorja për përdorimin e tokës dhe jepen skemat për raportin ndërtesë-parcelë. Rëndësi i jepet dhe llojit të ndërtimeve dhe ndërhyrjeve nëpër territor, veçanërisht zonave të mbrojtura. Prezantimi vijon me infrastrukturën dhe sigurimin e lëvizjes dhe transportit publik, energjitikës dhe furnizimit me ujë. Më tej jepen zgjidhjet për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe kanalizimet. Në fund listohen konkluzionet dhe sugjerimet për institucionet arsimore dhe shëndetësore.

*Pyetje, diskutime dhe vëzhgime nga pjesëmarrësit*

**PPI.** Pyet për situatën e ndërtimeve në zonën e Valbonës, pasi situata është paqartë dhe për momentin po vazhdon të ndërtohet.

**P.V. Aureli.** Shpjegon se zona e Valbonës, si zonë e mbrojtur, ka rregullore të posaçme që rregullon mënyrën e ndërtimit, dhe që ndërtimet që janë aty për momentin e mbulojnë kërkesën për strehim nëse lind nevoja. Megjithatë, sipas tij, bazuar mbi ligjin në fuqi, aty ku lejohet mund të ketë ndërtime të përkohshme.







## 18.2 Forumi për Bashkërendimin e Planifikimit në nivel vendor (FBPV)

*Data e zhvillimit të takimit:* 11 Korrik 2017

*Ora e fillimit të takimit:* 10:00

*Kohëzgjatja e takimit:* 2 orë


Takimi nisi nga përfaqësues të studios konsulente për Malësinë e Madhe (Ariela Kushi), me prezantimin e gjetjeve të Analizës Territoriale për rajonin e Malësisë së Madhe si dhe të një analize të të dhënave statistikore të ardhura nga INSTAT dhe nga anketat e kryera në terren. Më tej u prezantuan objektivat strategjike dhe fokusi i grupit të projektimit gjatë procesit të planifikimit, ku u theksua dhe rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet territoreve të ndryshme. Gjatë prezantimit, territori i Malësisë së Madhe u cilësua si zonë me rëndësi për hyrjen në territorin e Shqipërisë e më tej në zonën e Alpeve.

Më përfundimin e prezantimit nga grupi i projektimit për Malësinë e Madhe, pasoi prezantimi nga përfaqësuesi i studiove konsulente për Bashkinë Tropojë (Saimir Duçellari) ku sërisht, niset me një përmbledhje të analizës së territorit dhe evidentimin e problematikave e mundësive që ofron territori për të vazhduar me objektivat strategjike. Duke qënë se një pjesë e madhe e territorit është peizazh i mbrojtur natyror, vihet theksi mbi rëndësinë që ka ekuilibri komunitet-mjedis dhe mbrojtja e tij në vitet e ardhshme. Po ashtu, prezantimi flet dhe për raportin parcelë-ndërtim dhe bazat e ekonomisë për zhvillimin e rajonit.

Prezantimi i fundit gjatë këtij forumi ishte për Bashkinë e Vaut të Dejës nga përfaqësuesi i studios konsulente për këtë plan (Gjergj Islami). Për të ky territor përbën një nga portat hyrëse më interesante në territorin e Alpeve dhe vihet theksi në linjën lumore Kukës - Fierzë - Koman - Vau i Dejës - Shkodër. Territori prezantohet kryesisht si terren natyror me një përqindje të madhe të tij tokë bujqësore, ndërkohë që Vau i Dejës është i vetmi qytet me rëndësi administrative në zonë. Aset i rëndësishëm në zonë është liqeni i Vaut të Dejës që mund të përdoret si për turizëm dhe për transport e më tej edhe për plotësimin e nevojave për energji, ujë, etj.

Nga AKPT u qartësua se bërja bashkë e të gjithë aktorëve në këto procese planifikuese është detyrë e FBPV/Q, forumet e të cilëve janë mbledhur dhe do mblidhen në vazhdimësi nga ana e AKPT. Fjala e përfaqësuesve të AKPT u pasua nga një seri diskutimesh mes grupeve të projektimit dhe përfaqësuesve të ministrive të ndryshme për të sqaruar pika të paqarta ose për të çuar më tej propozimet specifike në territor.





### 18.3 Këshillim publik në Bajram Curri

Në kuadër të mbylljes së fazës së tretë të procesit të hartimit të PPV të bashkisë Tropojë, DLDP mbështeti organizimin e një ekspozite me qëllim transparencën dhe komunikimin me publikun për gjetjet dhe propozimet kryesore të këtij dokumenti.

Ekspozita e PPV filloi aktivitetin direkt pas dëgjësës publike të organizuar në datën 19 gusht 2017 dhe qëndroi e hapur për një javë, përfshi dhe fundjavën, deri me 25 Korrik. Ekspozita qëndroi vetëm në qytetin e Bajram Currit, në sheshin para bashkisë (paraditeve) dhe në fillimin e pedonales, poshtë Muzeut "Bajram Curri", në oraret e pasdites.

Të dhënat e mbledhura nga ekspertët që qëndruan pranë ekspozitës, tregojnë që numri i personave që kanë shprehur interes për materialet e shfaqura të PPV është 306. Këtu janë përfshirë personat që kanë shprehur interes konkret për një çështje të caktuar në lidhje me hartat e shfaqura dhe PPV në përgjithësi, por jo ato që thjesht e kanë vizituar. Në grafikun e mëposhtëm jepet numri i të interesuarve sipas ditëve që ekspozita ka qëndruar e hapur.

Sqarojmë që ditën e VII-të nuk ka patur aktivitet, pasi kushtet atmosferike e bënë të pamundur hapjen e ekspozitës. Nga të dhënat (grafiku) shihet qartë që interesi maksimal ka qenë 3 ditët e para, duke ardhur kryesisht në rënie në ditët në vazhdim.

Nga 306 të interesuar, 176 persona kanë plotësuar Pyetësin e PPV të bashkisë Tropojë, i vënë në dispozicion pranë ekspozitës. Pyetjet e përfshira në këtë Pyetësor, në përputhje me hartat e ekspozitës, trajtonin çështjet kryesore zhvillimore me një përshkallëzim nga niveli rajonal në nivel parcele/toke (përdorimi i tokës). Në plotësimin e pyetësorëve, banorët u asistuan nga ekspertët e planifikimit të territorit të bashkisë që në mjaft raste sqaronin qytetarët edhe për aspekte dhe interesa të veçanta që shpreheshin.

Nga të dhënat që vetë banorët kanë plotësuar rezulton se 50% e tyre (87 persona) janë nga qyteti i Bajram Currit, duke vazhduar me Njësinë Administrative Margegaj me 20% (ose 35 persona) e me rrallë, Nj. A. Tropojë, Bujan, Llugaj dhe Fierzë. Nga Nj.A. Lekbibaj dhe Bytyç nuk rezulton asnjë pyetësor i plotësuar. Duke patur parasysh që vendndodhja e ekspozitës ka qenë fikse, pra vetëm në qytetin e Bajram Currit, shpërndarja e banorëve që kanë plotësuar Pyetësin është e kënaqshme. Kjo në aspektin e përfshirjes së banorëve edhe nga Njësitë e tjera Administrative të Bashkisë Tropojë. Gjithashtu rezulton se 10% e banorëve nuk kanë regjistruar të dhëna personale (as emër, mbiemër as vendbanim).


Në trajtë të përmbledhur, më poshtë jepen grafikisht të dhënat sasiore, sipas shpërndarjes në Njësitë Administrative, për pyetësorët e plotësuar.

Shihet qartë që pozicioni gjeografik (distancat e largëta) i qendrave të banuara në Njësitë Administrative ka ndikuar në pjesëmarrjen apo numrin e të interesuarve për ekspozitën e PPV.







### Numri i interesuar sipas ditëve



### Pyetësorë të plotësuar sipas Njësive Administrative



### Pozicioni Bashkisë Tropojë





### *Analiza e pyetësorëve të Bashkisë Tropojë*

Pyetjet që përmban Pyetësi-1 janë hartuar në përputhje me hartat e ekspozitës së PPV. Pra, ato kanë një përshkallëzim dhe kërkojnë të kapin mendimin e të interesuarve nga niveli rajonal (interes i përgjithshëm për zhvillim) në nivel parcele (interes personal). Nga plotësimi, konstatohet se kryesisht banorët kanë plotësuar 3 pyetjet e para, që kanë kryesisht lidhje me pozicionin e bashkisë në nivel rajonal, Vizionin dhe Projektet Zhvillimore të propozuara.

#### **Pyetjeve:**

1.1 Si e vlerësoni pozicionin gjeografik të bashkisë Tuaj;

1.2 Mendoni se pozicionin gjeografik/rajonal mund të ndikojë në zhvillimin e bashkisë Tropojë,

mbi 94% të të interesuarve janë përgjigjur që pozicioni i bashkisë Tropojë është i favorshëm dhe mund të ndikojë në zhvillimin e ekonomik dhe social të komunitetit atje.

#### **Ndër komentet pozitive cilësohen:**

- Bashkia Tropojë, pozicion strategjik për komunikimin me vendet e rajonit;
- Natyra e mrekullueshme.
- 

#### **Mangësi të evidentuara:**

- Mungesa e infrastrukturave bën që dimri i ashpër të vështirësojë zhvillimin e turizmit malor;
- Rruga buzë Drinit dhe e Curraj të Epërm cilësohen si primare në zhvillimin e turizmit;
- Shfrytëzim i resurseve natyrore dhe investime në zonat rurale;
- Lidhja me Malin e Zi;
- Komente negative që nuk e cilësojnë të favorshëm pozicionin e Bashkisë Tropojë;
- Nuk jemi as me Shqipërinë as me Kosovën, kemi ngelur si ishull;
- Emigrimi i njerëzve, kryesisht i të rinjve.

#### **Pyetjes:**

2.1 Cili është sektori kryesor ku bazohet vizioni i zhvillimit në bashkinë Tuaj? mbi 65% i janë përgjigjur: Turizmi, e në vazhdim Bujqësia dhe Urbanizimi.


2.2 Çfarë duhet të bëjë bashkia për të rritur mirëqenien dhe zhvillimin?

Në përputhje me sektorin kryesor të zhvillimit, banorët kanë kërkuar kryesisht:

- Investime në infrastrukturën rrugore për turizmin;
- Menaxhim mbetjesh për mbrojtje mjedisi;
- Investime në infrastrukturën e ujitje-kullimit të sipërfaqeve bujqësore;
- Ngritjen e strukturave për magazinimin e produkteve bujqësore etj.




*Sektori ku duhet të bazohet vizioni i Bashkisë*




■ Bujqësi ■ Turizëm ■ Urbanizim

*Përdorimi i tokës në Bajram Curri*



■ Urban ■ Bujqësi ■ Natyrë

*Përdorimi i tokës në Njësitë Administrative*



■ Urban ■ Bujqësi ■ Natyrë



Ajo që të bie në sy është që mbi 70% e komenteve, përveç të tjerave, kërkojnë nga bashkia PUNËSIM.

Pyetjeve 3 dhe 4, në lidhje me Prioritetet dhe Projektet (shiko Aneks 1), ku duhet të fokusohet bashkia Tropojë në 10-15 vitet e ardhshme, banorët e Bajram Currit kryesisht kanë plotësuar Turizmin dhe Transportin, ndërsa ata nga njësitë e tjera administrative, në shumicën e rasteve, kanë plotësuar të gjitha mundësitë e vëna në dispozicion, fakt ky që tregon mungesën e pothuajse të gjitha shërbimeve primare në këto zona.

Për Pyetjen 5, në lidhje me përdorimin e tokës, në Pyetësorë janë vënë në dispozicion 3 mundësi në përputhje me sistemet bazë sipas legjislacionit të planifikimit të territorit (sistem bujqësor, urban, natyror, infrastrukturor dhe ujqor). Kuptohet që sistemi ujqor dhe infrastrukturor janë përjashtuar nga mundësia e plotësimit, pasi këto përdorimet kryesisht janë faktike dhe nuk mund të tjetërsohen.

Më poshtë analiza e komenteve është e ndarë për Bajram Currit me karakter urban më vete dhe Njësitë e tjera administrative me karakter bujqësor dhe natyror më vete.

Siç pritej, personat e interesuar nga qyteti i Bajram Currit që kanë plotësuar formularët, në masën 70% kërkojnë që përdorimi i tokës për pronën e tyre të jetë urban. Por, ka mjaft prej atyre që kanë kërkuar dhe përdorim bujqësi ose natyrë. Nga komentet vërehet që edhe ato që kanë kërkuar përdorim urban thuhet të gjithë kërkojnë të ndërtojnë struktura në shërbim të bujqësisë dhe turizmit, por jo për banim.

Grafiku më poshtë pasqyron komentet e banorëve në lidhje me përdorimin e tokës, nga Njësitë e tjera Administrative, duke përjashtuar Bajram Currit. Nga përgjigjet e plotësuar, mbi 80% të banorëve kërkojnë përdorim bujqësor.

Në vijim janë treguar disa nga propozimet që kanë dhënë vetë banorët.

- Struktura në shërbim të turizmit (bujtina, motele, restorante);
- Qendër për përpunim produktesh artizanale të zonës;
- Fabrikë për përpunim produktesh bujqësore;
- Struktura për magazinim të produkteve bujqësore (përfshi boronicën).

Siç u përmend dhe më sipër, në asnjë rast nuk përmendet banimi si qëllim për ndërtim. Në disa formularë konstatohen dhe problematikat që shfaqin banorët në lidhje me problemet e pronësisë, këto si në aspektin e menaxhimit institucional aktualisht por edhe me problematikat e trashëguara.



Emri, Mblemri:

Njësia Administrative ku jetoni:

## 1 POZICIONI RAJONAL I BASHKISË

1. Si e vlerësoni pozicionin gjeografik të bashkisë Tuaj	<input type="checkbox"/> I favorshëm
	<input type="checkbox"/> jo i favorshëm
Komentoni: çfarë konsideroni avantazhe dhe disavantazhe të pozicionit të bashkisë?	

2. Mendoni se pozicionin gjeografik/rajonal mund të ndikojë në zhvillimin e bashkisë Tropicë	<input type="checkbox"/> Po
	<input type="checkbox"/> Jo
Komentoni: si mund të kthehej në potencial pozicioni gjeografik? cilat mund të ishin lidhjet e preferuara?	

## 2 VIZIONI I ZHVILLIMIT TË BASHKISË

1. Cili është sektori kryesor ku bazohet vizioni i zhvillimit në bashkinë Tuaj ?	<input type="checkbox"/> bujqësia
	<input type="checkbox"/> turizmi
	<input type="checkbox"/> urbanizimi
Komentoni:	

2. Çfarë duhet të bëjë bashkia për të rritur mirëqenien dhe zhvillimin?
Komentoni:





<b>3</b> PRIORITET DHE OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË BASHKISË	
Cili duhet të jetë prioriteti i bashkisë Tropojë ?	<input type="checkbox"/> Mbrojtja e mjedisit
	<input type="checkbox"/> Ruajtja e aseteve kulturore
	<input type="checkbox"/> Zhvillimi i turizmit
	<input type="checkbox"/> Bujqësia dhe blegtoria
	<input type="checkbox"/> Transporti rrugor dhe akses
	<input type="checkbox"/> Konsolidimi i qendrave urbane dhe rurale
	<input type="checkbox"/> Përmirësimi i hapësirave/objekteve publike
<input type="checkbox"/> Bashkëpunimi ndërkufitar	
Komentoni:	

<b>4</b> PROJEKTET E BASHKISË	
Cilat duhet të jenë projektet që duhet të mbështesë bashkia Tropojë me qëllim përmirësimin e jetës së komunitetit?	<input type="checkbox"/> gjelbërim dhe hapësira publike
	<input type="checkbox"/> ujësjellës - kanalizime
	<input type="checkbox"/> rrugë
	<input type="checkbox"/> bujqësia dhe blegtoria
	<input type="checkbox"/> shëndetësi
	<input type="checkbox"/> shkolla / kopshte
	<input type="checkbox"/> mbledhja e mbeturinave
<input type="checkbox"/> ndriçimi	
Specifikoni të tjera:	

<b>5</b> PËRDORIMI I TOKËS	
Propozo përdorimin e pronës që keni.	<input type="checkbox"/> urbane
	<input type="checkbox"/> bujqësi
	<input type="checkbox"/> natyrë
Çfarë mendoni të zhvilloni në pronën Tuaj në të ardhmen:	















